

FLORI BRUQI

DIADEMË LETRARE

II

Tiranë, 2014

Titulli : DIADEMË LETRARE II

Autori : Flori Bruqi

Redaktor : Rexhep Shahu

Recenzent : Izet Duraku

Ballina & arti grafik : BoV Desing

Fotografia e ballinës është e autorit të librit

© Të gjitha të drejtat janë të autorit

ISBN: 978-9928-07-283-2

Shtëpia botuese : Mirgeeralb

Shtypshkronja : Vision Print Prishtinë

LIBRI I 34-t I FLORI BRUQIT - “DIADEMË LETRARE II”

Që në krye të këtyre shënimeve për librin e fundit (i 34-ti), “Diademë Letrare II”, të gazetarit, shkrimtarit, kritikut e studiuesit shkencor Flori Bruqi, po e them se nuk do ta ndjek traditën e pahijshme të shkrimeve që bëhen për autorë apo për libra të ndryshëm, ku shkruesit e shkrimeve prezantuese, promovuese apo analizuese, në vend që të flasin rreth autorit e librit që marrin në dorë, fillojnë e rrëfejnë, keq e shumë keq, për dijet e tyre të mangëta, për bëmat e tyre të bëra keq, të pabëra apo të ëndërruara e të pamundura, që shpalosin erudicionin e tyre të mangët e shterpë, që gjejnë rast të nxijnë faqe letre, në gazeta, revista a në libra të huaj, për me folë për veten e tyre e përrallat që kanë dëgjuar kafeneve dhe rrallë, fort rrallë, flasin ndonjë fjalë që s’thotë asgjë për librin e autorin e librit që marrin në dorë apo marrin përsipër ta trajtojnë, duke shpalosë një krekosje acaruese, një padije të thellë e një

servilizëm të pështirë ndaj autorit për të cilin duan të flasin, nga ndonjë qëllim jashtëletrar ose për shkak të rrethanave të caktuara, të dyshimta, që shtojnë pabesueshmërinë e artikujshkruesve dhe dëmtojnë e cënojnë autoritetin e librit e të autorit të librit për të cilin nxijnë faqe kompjuteri apo letra të bardha.

Në të shumtën e rasteve, krahas padijes e servilizmit, këto lloj shkrimesh i prodhon ndonjë interes i ngushtë çasti dhe pandershmëria e atyre që shkruajnë.

Them që në krye shënime, pasi është e vështirë t'i klasifikoj këto radhë apo fjalë në ato që njihen si rregullat e qarta të klasifikimit për shkrimet kritike që bëhen për libra të ndryshëm që botohen.

Them është e vështirë sepse ky libër i Flori Bruqit çelet pikërisht me një shkrim të gjatë profesional mbi kritikën letrare dhe kriteret që janë caktuar për të bërë një kritikë, shkrim që e trajton kritikën letrare në thellësi që në fillimet e saj, duke krahasuar e ballafaquar përvoja të ndryshme të huaja e vendase për kritikën dhe kritikën letrare.

Unë e kam të vështirë ta bëj kritikën e kritikës. Thjeshtë po e përshëndes këtë libër të 34 të Flori Bruqit, si një kontribut me vlerë në letrat shqipe, si “një libër që i shtohet mendimit kritik për letrat shqipe” siç shkruan poeti dhe shkrimtari Izet Duraku.

Në këtë libër të Flori Bruqit shfaqet gjeografia e gjërë e tematikës që ai trajton, gjeografia e gjërë e interesave të tij letrare, e autorëve dhe veprave që analizon e merr në shqyrtim. Dhe gjithmonë po flasim për atë që ai ka shkruar, për atë që është në libër dhe jo për ato gjëra, fjalë e qëndrime që mungojnë në libër dhe autori nuk i ka marrë në trajtim në këtë

vëllim të dytë të librit të tij “Diademë Letrare II”, por që i gjenden të botuara në organe të ndryshme të shtypit të shkruar a të medias elektronike.

Në Diademë Letrare II, Flori Bruqi ka guxuar të merret me tema të rënda, me autorë të përmasave të mëdha, të cilët me ndikimin e tyre në letrat shqipe e më gjërë në fushën e letrave në shkallë europiane e botërore, janë rrezatues e imponues, janë “të frikshëm” për t’u marrë me to, apo për t’u afruar pranë tyre.

Pas një trajtimi të gjërë e të thellë të kritikës letrare, çfarë është e pse është ajo, si është, ku është e si duhet e mund të jetë në letrat shqipe, kur fillon e si fillon, si është lëvruar e si ka evoluar, Flori Bruqi na paraqet Frojдин me tërësinë e tij dhe të zgjidhjes së enigmave që ky shkencëtar ka bërë për njerzimin.

Flori Bruqi i krijon lehtësi e komoditet lexuesit edhe jo profesionist që ta kuptojë e të bindet për ndikimin e madh që pati në botë e në fushën e letrave Frojdi si psikologu që me tezat e tij u bë i pashmangshëm dhe imponues për t’iu referuar gjithkush që merret me letrat, kritikën letrare dhe laboratorin e krijuesit apo studiuesit shkencor.

Me durim e vullnet të spikatur studiuesi Flori Bruqi analizon tërësinë e veprave kritike të Ibrahim Rugovës dhe ndikimin që ai pati në historinë e letrave shqipe, duke qenë ndër të parët që i drejtoi kamerat dhe interesat letrare e shkencore nga shkenca letrare perëndimore për ta avancuar kështu kritikën dhe studimet letrare të autorëve shqiptarë dhe për t’u shkëputë nga shkolla lindore, term ky thjeshtë konvencional, ashtu siç ishte perëndimor edhe shkrimtari i parë modern i letrave shqipe, Pjetër Bogdani, të cilin Rugova e ka

studiuar dhe analizuar në tërësi e në thellësi edhe si artist edhe si filozof paraprijës i modernitetit shqiptar.

Pasi paraqet, siç e përmendëm Ibrahim Rugovën me gjithë plotninë e tij si kritik e studiues i epërm i letërsisë që shërben si model për pasuesit me po atë fuqi e lartësi si politikan i pambërritshëm e i papërsëritshëm i kombit shqiptar, Flori Bruqi sjell vështrimin e tij për Krist Malokin – dijetarin shqiptar të Gracit të Austrisë, këtë aristokrat modern të letrave shqipe, i cili me fuqinë e argumentit e të dijës së thellë u rri si kurorë letrave shqipe dhe shërben si model i vështirë e “arrogant” për pasardhësit për shkak të dijeve, fuqisë dhe elegancës në analiza. Pak dihet për Krist Malokin për shkak edhe të nënvleftësimit a lënies mënjane me dashje nga politika dhe shkenca letrare zyrtare e udhëhequr nga politika dhe për shkak edhe të skrupulozitetit të tij e të raportit të tij të pakompromis me të vërtetën gjatë analizimit të letërsisë apo të çfarëdo fenomeni shoqëror apo letrar.

Flori Bruqi kalon nga Dante Aligeri te Ismail Kadare i shtyrë nga mesazhet e mëdha që përcjell letërsia e madhe e autorëve që kanë fuqi rrezatuese e unifikuese për letërsinë e tyre kombëtare. Ferri ferr mbetet si dje, sot e nesër.

Qëndresa si vlerë kombëtare e shqiptarëve apo si ëndërr e dëshirë e përhershme e shqiptarëve në shumë vepra të Kadaresë, dimrat si stinë e dimrat si vuajtje për shqiptarët, si metaforë në letërsinë e Kadaresë, urat e kështjellat, besa e mbajtja e fjalës së dhënë, janë qëmtime, gjetje e pohime që Flori Bruqi i lehtëson për lexuesin e pangeshëm a dembel të letërsisë së Kadaresë dhe i paraqet me gjuhën e studiuesit në “Diademë Letrare II”.

“Princin shqiptar të kinemasë”, Bekim Femiun, këtë artist të përmasave botërore, këtë Uliks a Odise shqiptar, këtë patriot shqiptar që bëri për shqiptarët më shumë se divizione e taborre bashkë duke pohuar kudo skenave botërore se ishte shqiptar dhe nuk guxuan t’ia ndërrojnë asnjë germë të emrit asnjëherë, që edhe me vdekjen e vet dhe derdhjen e hirit të trupit të tij në Lumbardhin e Prizrenit i shërbeu Kosovës e shqiptarëve, Flori Bruqi e bën pjesë të librit të tij “Diademë Letrare II”, jo për shkak të librit me kujtime që ka shkruar Bekim Femi, por për shkak se gjithë jeta e vepra e tij ishte në shërbim të artit e ishte art.

Edhe poeti, shkrimtari, këngëtari e patrioti idealist Jusuf Gërvalla është vështruar në tërësinë e tij nga Flori Bruqi me dashuri e konsiderata për artin e jetën e tij në shërbim të Kosovës e të çeshtjeve shqiptare.

Nga “Diademë Letrare II” mësova se Jakov Mile, autori i librit “Raca Shqiptare”, mik i Migjenit, patriot i thekur shqiptar, kishte qenë ministër bujqësie në Shqipëri dhe u ndjeva me turp që nuk e kam ditur kur është dashtë me e ditë për me ia vendosë portretin krahas portreteve të gjithë ministrave të tjerë të bujqësisë të Shqipërisë të ekspozuar në mjediset e Ministrisë së Bujqësisë në Tiranë. Flori Bruqi edhe për shkak të doktorimit të tij e të shkollimit në fushën e shkencore të Defektologjisë, është njohur në thellësi me veprën e Jakov Miles, me thëniet e kundërthëniet, me tezat e kundratezat dhe është përfshirë edhe vetë në debatet shkencore e jo shkencore mbi librin e bujshëm “Raca Shqiptare”. Vështrimi për këtë vepër e këtë çështje zë vend të rëndësishëm në këtë pjesë të dytë të Diademës Letrare.

Në “Diademë Letrare II” ndërthurën të vjetrit me të rinjtë, të huajt me shqiptarët, të gjallët me të vdekurit e gjallë, shkrimtarët që jetojnë në Kosovë, në Shqipëri, në Diasporë, ata që shkruajnë shqip e ata që shkruajnë për tema shqiptare në gjuhë të huaj dhe ndërthurën mes tyre natyrshëm Aleksandër Xhuvani studiues, gjuhëtar e veprimtar i kulturës kombëtare, Naim Kelmendi poet e publicist, Shefqet Dibrani publicist e poet, Amiko Kasaruho autoritet i rrallë moral i shqiptarëve që shkroi tmerrin e diktaturës komuniste të Shqipërisë që e provoi në kurriz dhe përktheu mrekulli nga letërsia botërore në gjuhën shqipe, shkrimtari Mehmet Kajtazi me korpusin e veprave të tij, Ramiz Kelmendi me kontributet e tij të shumta, Kadrush Radogoshi me jetën e veprën e vet, Engjëll I. Berisha me poezitë e tij, Jakov Xoxa, Sterjo Spase, Haki Stërmilli, Foqion Postoli si katër shkrimtarë të fillimeve të letërsisë së ndërprerë në Shqipëri para diktaturës dhe në fillimet e saj si dhe dhe kompozitori i njohur Rexho Mulliqi që mbetet krenari dhe emblemë në krijimtarinë muzikore shqiptare në Kosovë.

Një libër është si një godinë. Flori Bruqi kishte aq shumë material e lëndë të parë për libër sa nuk mjaftojnë tre – katër libra 300 faqësh për ta përfshi gjithë materialin e lëndën e parë në dispozicion. Shpresojmë se autori do të “ndërtojë” libra të tjerë me shkrimet e shumta që ka të shpërndara gjithandej nëpër website e organe të ndryshme shtypi.

Rexhep Shahu

Tiranë, shtator, 2014

MBI KRITIKËN LETRARE

“Nuk ekziston kritika e mirëfilltë letrare për arsye se nuk ekziston as letërsia e mirëfilltë”, kështu tha paradokohësh një shkrimtar i njohur shqiptar.

E, sipas kësaj teze, meqë nuk ekziston e para, s’ka pse të ekzistojë as ajo e dyta, e cila jetën e ka të kushtëzuar me qenien e së parës.

Interesantja e kësaj deklarate nuk qëndron tek vërtetësia e saj, gjë që mund të diskutohet deri në pambarim, por pse, kur, ku dhe si u bë ajo?

Kjo tezë e plasuar në një rubrikë gjysmësatirike të një të përditshmeje nuk është e askujt tjetër, përpos e shkrimtarit dhe dramaturgut Teki Dervishi.

Qëndrimi nihilist i Dervishit për kritikën letrare (në këtë rast edhe për letërsinë) nuk është ndonjë fenomen i ri.

Dukuria ka një moshë po aq të vjetër sa edhe vetë kritika letrare dhe ai nuk është i vetmi që mendon kështu. Pjesa dërmuese e letrarëve, studiuesve dhe gazetarëve që merren me letërsinë, në diskurset e tyre janë duke përsëritur deri në neveri këtë qëndrim, përherë ashtu “rastësisht”, fragmentarisht e në kapërcim e sipër, pa marrë kurrë mundin që t’i qasen seriozisht kësaj çështjeje dhe gjithmonë duke harruar se nuk janë vjelësit e rrushit të Rahovecit shkaktarët për qenien apo mosqenien e kritikës letrare, por edhe ata vetë.

Teki Dervishi shprehjen e lartëpërmendur e lëshoi në etër gjatë një diskutimi “salloneve letrare e intelektuale” të Prishtinës rreth moralit dhe saktësisë së mendimeve të kritikës letrare.

Kjo, pas publikimit të një eseu që mëtonte të rradhisë shkrimtarët e pesë dekadave të fundit në grupe e stile. Seleksionim që shkaktoi muhabete dhe që këtë shkrimtar e nxiti të reagojë në mënyrën e përfolur më lart, pra “...s’ka kritikë letrare” dhe atë me pseudonim.

Si shumë të tjerë, ai, nuk pati kohë ose nuk ia deshti të djersisë trurin as për ta trajtuar më gjërë e më thellë këtë temë e as të argumentojë qëndrimin personal, sepse, së fundi, pra bëhet fjalë për diçka që “s’është fare”. Së paku për të.

Në vetvete ky shembull nuk do të ishte edhe gjithaq interesant dhe i përveçëm, po që se nuk do të demonstronte qëndrimin negativ dhe injorues (në rastin e Dervishit mohues) të opinionit ndaj kritikës letrare, respektivisht kritikut.

Prej nga ky qëndrim mohues, nënçmues? Është pasojë e mllefrit të autorëve për shkak të mungesës së institucionit që do të merrej me vlerësimin e veprave të tyre? Apo kemi të bëjmë me një divizion ekspeditorësh të zhgënjyer që e kanë neveri një zhanër, i cili i ka refuzuar ata, kur kemi parasysh se në gishta mund të numërohen ata autorë, që nuk i kanë bërë ose vazhdimisht i bëjnë hapat e parë në këtë lëmi?

Sido që të jetë imazhi i kritikës letrare si institucion është përdhë. I kritikut si person edhe më keq. As në plan universal, përtej kufinjve të mendësisë shqiptare, nuk është ndryshe. Jo rastësisht ka lindur thënia “Come here, good dog”, kur bëhet fjalë për kritikun. Gjeneza e saj daton madje edhe para lindjes së kritikut dhe kritikës si institucion. Historia e arteve njihet simbolin e qenit të fjetur (kyon) dhe atij kafshues (kynikos) si amblemë të kritikut, i cili kur zgjohet bëhet cinik.

Kush nuk e njih vargun shumëdomethënës të megapoetit gjerman J. W. Goethe “Mbyteni qenin! Është recenzent!”, që është bërë moto e cilitdo autor, sa herë që të dojë të hedhë gurë mbi kritikën.

Po ky qëndrim degradues ndaj kritikës letrare manifestohet edhe në letrat shqipe. Vërtetë s'ka kritikë letrare shqiptare, por vetëm argatë “llomotitës” mbi letërsinë artistike, të cilët nuk kanë arritur të gjejnë ndonjë profesion të “denjë” dhe kanë përfunduar si deshifrues të enigmave parapoetike oborreve e klaneve letrare?

Po çka është kritika letrare? Cila është historia e saj, respektivisht e kaluara e kritikës letrare shqiptare? Çka do të thotë të krahasohesh me qenin? Kush janë e kush s'janë kritikët shqiptarë? Parasëgjithash: përse përpiqen njerëzit të interpretojnë përrallat e shpikura të autorëve; cilat janë kriteret në bazë të të cilave vlerësojnë e gjykojnë kritikët dhe teorikët e letërsisë shqiptare librat e sapobotuar; cili është katalogu i vlerave që ata kërkojnë nga një tekst letrar? Ekziston ndonjë metodë vlerësimi që mund të pranohet e aplikohet si metoda më objektive, absolute?

Këto janë pyetjet, të cilave mëtojmë t'iu përgjigjemi përmes këtij shkrimi.

Termi *kritik* si në shumë gjuhë e kultura tjera edhe në shqipe vjen nga ai latin “*criticus*” (vlerësues kritik). Që të dy këto terma prejardhjen etimologjike e kanë nga folja *krinein*, e cila ka kuptimin e ndarjes, dallimit, vendimit dhe gjykimit bashkë, pra *criticus* është

ai që gjykon ndan të mirën nga e keqja, të vërtetën nga gënjeshtra e kështu me radhë.

Deri në shekullin e 17-të *criticus* është thirrur ai dijetar që ka pasur aftësinë dhe kompetencën e vlerësimit të teksteve në gjuhën latine dhe greke. Me ardhjen e tipit të ri të kritikut të shkolluar me metodologjinë racionale (sipas René Desacrtes, Le Clerc i cili studimin filologjik të tekstit e bën adekuat për rikonstruimin e domethënies së tij dhe atë përtej dy gjuhëve të atëhershme “zyrtare”) lind e ashtuquajtura “*critique mondaine*” ose kritiku universal (me Michel de Montaignes si idol).

Kritikë që nuk shkruan më vetëm në latinisht e greqisht dhe që nuk merret më ekskluzivisht vetëm me tekstet e dijetarëve. Ajo angazhimin e saj e përqëndron dhe kufizon tashetutje më shumë në prodhimin aktual të librit dhe novatorja në këtë aksion është: komentimi në gjuhën e popujve. Komentet dhe interpretimet nuk botohen vetëm si libra që shërbenjnë si lektyrë për qarqet universitare, elitore të shoqërisë, por ato botohen qëllimisht nëpër revista duke iu ofruar edhe masave të gjëra.

Konkretisht: që këtej detyra kryesore e kritikut është komentimi, interpretimi i librave në gazeta, revista! (Atëkohë kjo nuk ka nënkuptuar vetëm intereptimin e letërsisë artistike, por mbarë prodhimin intelektual).

Në shekullin 18 hidhen konturet e para të kritikës letrare si institucion (disiplinë).

Tashmë bëhet një paraseleksionim ndërmjet literaturës ndryshe dhe asaj poetike si; poezia, proza, drama etj. Jo në secilën gjuhë e kulturë do të merret një për një koncepti francez (Le Clerc) i kritikës.

Në hapësirën anglosaksonike për shembull me “*criticism*” nënkuptohet shpjegimi i arsyeshëm, sistematik (nën diktatin e të të ashtuquajturit “common sense”) i arteve, vlerësimi i veprave dhe teknikave të tyre.

Teoria e bazuar në studimet e Ivor Armstrong Richards (1924) dallon nga ajo franceze, e cila për parim ka përvojën estetiko-subjektivë në perceptim dhe vlerësim të arteve, kjo mbi të gjitha praktikon argumentimin dhe arsyetimin logjik në vlerësim e gjykim të letërsisë artistike.

Edhe pse René Wellek në librin e tij “Definicionet themelore të kritikës letrare” (1963) ndan *Teorinë e Letërsisë* nga *Historia e Letërsisë* dhe *Kritika Letrare*, as ai nuk cënon gjithaq “metodën shkencore të interpretimit të vlerave”.

Nisur nga ky botëkuptim kuptojmë qartë vijën gati të padukshme dalluese ndërmjet shkencës së letërsisë dhe kritikës letrare në këtë hapësirë gjuhësore (anglosaksonike).

Edhe sot e kësaj dite “kritika letrare” në botën anglofone është sinonim i “interpretimit shkencor të veprave letrare”.

Gjermanët kanë ndarë qartë “shapin nga sheqeri”.

Me kritikë letrare gjermanofolësit nënkuptojnë tërësinë e teksteve ose shprehjeve (të lira dhe që mund të jenë edhe subjektive) komentuese, vlerësuese, denoncuese, klasifikuese e seleksionuese mbi letërsinë artistike, të cilat publikohen kryesisht në masmedia, ndërsa shkencën e letërsisë ata e definojnë si: “tërësi e prodhimit dhe aktivitetit në shkolla, institutet hulumtuese, universitetet dhe akademitë”.

Troç dhe qartë.

Ndarje strikte, që në botën romane është e paparafytyrueshme. Është pikërisht përvoja subjektivo - estetike (të cilët e refuzojnë anglezët dhe diferencojnë gjermanët) shtylla kryesore e komentit tradicional prohumanist italian mbi letërsinë.

Ndoshta këtu qëndron arsyeja e mungesës së një instance kritike si poeti dhe filozofi dhe profesori Giosue Carducci ose Benedetto Croce në dy gjuhët e përmendura.

“Argjentinasi Jorge Luis Borges madje ka përbashkuar veprat e gjitha kohëve dhe zonave në hapësirën e njëkohësisë imagjinative që atje t’i krahasojë dhe vlerësojë ato” (G. Seibt), ndërmarrje që, sipas të gjitha gjasave, po ta bënte i pari ndonjë studiues, kritik anglez a gjerman do të përqueshej si i marrë.

Origjina e kritikës letrare shqiptare

Ashtu si në botën romane (italo-hispanike), në historinë e letrave shqiptare vija në mes “kritikës letrare” dhe “shkencës së letërsisë” është pothuaj e padukshme. Teoriku është kritik dhe anasjelltas. Ose, thënë më sinqerisht, deri sot ende nuk është zhvilluar një diskutim konkret qoftë shkencor a medial rreth kësaj çështjeje, prandaj edhe nuk ekziston, përveç ca skicave e fragmenteve studimore që aludojnë në njërën apo tjetrën shkollë, një pozicionim i qartë i studiuesve shqiptarë rreth asaj se cili, bazuar në traditën dhe të tashmen autoktone, është dallimi ndërmjet këtyre nocioneve e as që janë hedhur deri tani parimet “institucionale” se si duhet definuar njërën, tjetrën apo të dyja bashkë.

“Kritika letrare” ose “Teoria e letërsisë” (le ta quajmë si të duam) ka ecur dhe ende ecën sipas binarëve pozicionues të instituteve të huaja, studimet e të cilave kemi mundur t’i përkthejmë në gjuhën shqipe.

Në Republikën e Shqipërisë modeli i kritikës letrare është huazuar nga rusët, ndërsa në Kosovë nga gjuha serbokroate (e cila ka qenë një mish-mash i instituteve të Moskës – Pragës - Parisit) e pjesërisht të shkollave frankofone.

Kjo është “historia”, ndërsa fakti se dhjetë vjetëve të fundit janë përkthyer edhe teori tjera nga gjuhë angleze, gjermane etj. nuk është relavant, për arsye se nga njëra anë ndikimi i tyre nuk duket ende në horizont dhe, nga ana tjetër, praktika na tregon se në përgjithësi

ende (dhe atë me bensikëri) punohet sipas modeleve tashmë të adaptuara.

Po ky “huazim” shumëburimor e bën situatën edhe më konfuze sa i përket identifikimit, orientimit e parasëgjithash konceptimit të kritikës letrare si të tillë dhe pengon në formulimin e saktë dhe të drejtë të kësaj fushe, në përcaktimin se do t’i dallojmë ato ose do të vazhdojmë kështu si deri më tani?

1. Faik Konica

Se kush mund të jetë shqiptari i parë që ka praktikuar formën konkrete të tekstit kritik gjatë kohës kur është shkruar latinisht e greqisht nuk dihet. Ose vetëm mund të supozohet.

Studimi i parë që ka të bëjë tërësisht me letërsinë shqipe është ai i Alberto Stratico-s “Manuale di literatura Albanese” (Milano, 1896, shqip: Doracak i letërsisë shqipe) i cili megjithatë ka më shumë nivelin prezentues se sa atë vlerësues, ndërsa tekstet e para vërtet kritike (recensionet) shqiptare e bartin firmën e Faik Konicës.

Tekstet si “Baba Tomori” (1902) për poezinë e Çajupit, “Reze dielli” (1904) për Asdrenin etj. janë recensionet e para konkrete në gjuhën shqipe. Arsyen e kësaj “vonese” e shpjegon Konica në diskursin e tij “Letërsia shqiptare” (1897) ku thotë: “E gjithë letërsia

shqiptare mund të përmblihet në pesë apo gjashtë vëllime mjaftë të holla”.

Përveç praktikimit të drejtëpërdrejtë të recensionit si formë interpretimi të veprës letrare, Konica në shkrimin e tij “Kohëtore e letrave shqipe” (1906) e bën një minimanifest për kritikën letrare shqiptare. Në këtë manifest të Konicës vërejmë nga njëra anë “amshueshmërinë” e dilemës rreth përcaktimit ose ndarjes së shkencës së letërsisë nga kritika letrare dhe në anën tjetër përballemi me realitetin e hidhur se në këtë drejtim, edhe sot i kemi po të njejtat probleme si në vitin 1906, ngase edhe 98 vjet më vonë vërejtja e Konicës:

“Kur del një njeri e më thotë se aksh libër është “fort i bukur”, mund të ketë të drejtë, por nuk jam i shtrënguar t’i zë besë fjalës së tija. Edhe një çau sh a një dragat mund të presë me hanxharë gjykime të atilla. Kritika është një punë tjetër, dhe ca më e vështirë. Kur më pëlqen e kur më çpëlqen një vepër, nuk arrin të kërcej a të fryj: duhet të shfaqë përsetë e pëlqimit a të çpëlqimit tim...” nuk ka humbur hiçgjë nga aktualiteti i saj.

Padyshim se Konica nuk është zbuluesi i tezave që tenton të “imponojë” nëpërmjet diskursit a manifestit të tij, por vetëm përçues nga gjuhët tjera. Kryesisht nga gjuha frënge, mirëpo me argumentimet që bën duke ftuar shembuj nga letërsia angleze shihet edhe ndikimi nga ana tjetër. Andaj edhe pozicionimi konfuz “kritika letrare është subjective” e jo shkencë ku çdo e thënë mund të

provohet me “dy e dy bëjnë katër”, e cila bie ndesh me atë që Konica kërkon në citatin e lartëshënuar “...duhet të shfaqë përsetë e pëlqimit apo çpëlqimit...”.

Pse na qenkan të nevojshme përsetë kur çdonjëri mundka ta ndjejë si të dojë e të shprehë po ashtu si të dojë ndjenjat e përfituara gjatë leximit? E mbi të gjitha cila është ajo metodë, që do ta detyronte Konicën të jetë objektiv e mos ta merrte në qafë ndonjë autor a vepër edhe në ditën kur ai do të ishte ters, me ndjenja të trazura a me disponim të keq? Pikërisht ato rregullat shkencore, të ftohta e të definuara që nuk dallojnë shumë nga ai kalkulimi “dy dhe dy bëjnë katër” apo?

Këto pyetje bërë Konicës pa hamendje mund t’i parashtrojmë edhe sot, thjeshtë për shkak se përgjigja ende nuk ka filluar të kërkohet si duhet. Konica është i pari që bën kërkesën pragmatike për një kritikë letrare shqiptare. Se a mund të merret ai (ose rregullat e përkthyer nga frëngjishtja e anglishtja) si themelues (në plotë kuptimin e fjalës) i saj, siç aludon studiuesi Sabri Hamiti, mbetet çështje diskutabile.

Ndërsa fakti se Konica është nismëtari i kësaj fushe është i pakontestueshëm.

2. Retrospektiva

Nonda Bulka, Justin Rota, Eqrem Çabej, Namik Resuli dhe Karl Gurakuqi janë emrat që bëjnë vlerësimet

e para mbi letërsinë si të tërë dhe veprat e veçanta letrare.

Edhe pse tek shumica e këtyre emrave, kritika, vlerësimi, gjykimi dhe interpretimi konkret luan rol sekondar e qëllimi kryesor i tyre është paraqitja positive e vlerave të letërsisë shqiptare, studimet dhe vështrimet (ose pjesë të tyre) munden pa dilemë të kualifikohen si kritikë letrare.

Disa prej tyre, të shkolluar e formuar nëpër qendra të rëndësishme universitare disponojnë me njohuritë më aktuale rreth vlerësimit dhe gjykimit të artit të shkruarit.

Në këtë kontekst veçohet intelektual i universal e i doktoruar në Vjenë, Eqrem Çabej.

Vështrimi i Çabejit “Mbi poezinë e Lasgush Poradecit” (Gazeta e re, 22 shkurt 1929, f.3) dëshmon jo sall për qenien e kritikës (së mirëfilltë) letrare në botën e letrave shqipe, por edhe për integritetin e pavarur të bartësve të saj.

Ata nuk imitojnë parimet e shkollave të njohura mundane, vetëm sa për t’i sjellë kulturës shqiptare “diç të re nga perëndimi”, përkundrazi, nëse analizojmë dhe krahasojmë shkrimet, studimet dhe tezat e tyre, vërejmë se jo rrallë përvoja e përvetësuar në katedrat universitare tejkalohet dukshëm. Synimi është formimi i një kritike letrare që do të përputhej me tipicitetin dhe specifikat e letërsisë së deriatëhershme shqiptare. Parakushtet për të krijuar institucionin e kritikës letrare shqiptare ishin po

aq të volitshme si ato që kishin gjermanët, austriakët, italianët etj .

Mirëpo ashtu siç e do “fati i gjorë i të vegjëlvë”; sa herë që bëhen gati të festojnë, iu ndodhë ndonjë tragjedi. Në krahasim me letërsinë artistike, e cila vazhdonte hovin e saj, kritika letrare do të ngecte. Ose ajo bënte jetë sporadike.

Çabej, shpresa më e madhe, i përkushtohet ekskluzivisht gjuhësisë dhe kulturologjisë, intelektualët tjerë, që njihnin thellë shkencën e letërsisë dhe letërsinë vetë, si Lasgush Poradeci e të ngjajshëm, u tërhoqën krejtësisht nga skena. Pseja: ardhja e komunizmit edhe në hapësirat shqiptare. Ashtu si për sferat tjera të jetës shqiptare edhe për letërsinë e kritikën letrare nis një jetë tjetër, ndryshe nga ajo, siç e kishin projektuar bartësit e saj.

4. Kritika pseudomarksiste

Gjersa letërsia, duke u lakuar dhe përshtatur sipas situatës e motit nuk ul intensitetin e saj, kritika letrare vazhdon të jetojë hajdutërisht deri në fillim të viteve të 60-ta. Paskëtaj, në Shqipëri fillon kritika ideologjike. Nis proletarizimi i artit. Kritikë që formulohej në këtë mënyrë:

“...Letërsia e realizmit socialist ka edhe një mbështetje ideologjike të caktuar. Ajo mbështetet në botëkuptimin revolucionar të klasës puntore: në

marksizëm leninizëm! Duke pasur në themel të saj këtë botëkuptim, del e qartë vetvetiu se edhe letërsia e re ndeshet me tërë ato rryma, metoda ose shkolla letrare që kanë në thelb të tyre botëkuptimet idealiste dhe reaksionare të klasave të përmbysura. Këtë ndeshje të vazhdueshme me këto klasa e këto ideogji e vëmë re edhe në rrugën e lindjes dhe të zhvillimit të letërsisë sonë të re”. (Historia e letërsisë shqiptare, 1977)

E qartë: Çdo rrymë tjetër letrare dhe me këtë dhe çdo kritikë letrare që koketonte me ndonjë model analizimi jashtë oborrit, përpos asaj që bazohet në doktrinën marksiste-leniniste, duhej të asgjësohej. Që këtë çdo prodhim letrar do të interpretohet nga këndi ideologjik marksist – leninist. E kjo nuk ishte çorbë e gatuar vetëm nga shqiptarët, por i njejtë qëndrim, ku më pak e ku më shumë, u mor në të gjitha vendet ku orgjitet e cenzorëve fillonin me himin e internacionales.

Madje edhe në Rusi dhe të mos flasim më për vendet tjera si Çekosllovakia, Hungaria, më vonë pjesë të caktuara të Jugosllavisë (Sllovenia, Kroacia) etj, *qarqet letrare* e sidomos *kritika* gjenin mundësitë, që, aq sa mundnin, të shpëtonin artin nga vënia e tij totale në shërbim të politikës, sistemit, respektivisht diktatorit.

Nga ajo luftë e sipër prej modelit primitiv të vlerësimit në baza të doktrinës politike (duke përjashtuar çdo instrument tjetër si jorelevant) të artit u kalua në metodën shkencore materialiste – marksiste, në të ashtuquajturën “*Teoria e reflektimit*” të realitetit, e

themeluar nga György Lukács. Mund të debatojmë se sa objektive e dëmshme, degjeneruese a fitimprurëse mund të jetë kjo teori, mirëpo nuk mund t'ia injorojmë kualitetet që përmban ajo në segmente të caktuara të vlerësimit.

Ajo si metodë është po ashtu një formë vlerësimi si të tjerat: privilegjon këndvështrimin socrealist gjatë vlerësimit, por megjithatë pa përjashtuar procesin empirik!

Në Shqipëri nuk ecej me kohën. As me kohën e bllokut që i përkiste dhe lëre më me atë jashtë saj. Kritika letrare i shërbente klasës politike më me besnikëri se sa “qeni t’zotin”.

Saherë që ndonjë interpret, të humbëte rrugën jashtë oborrit dhe hapaqorras të bënte ndonjë kritikë pa përmendur mëmë Partinë dhe burrin e saj, dërgohej për riedukim në prodhim, “në gjirin e masave punonjëse”.

Kur analizojmë “teoritë”, “historitë”, “recensionet”, “studimet” e periudhës 48 – 90 të nënshkruara nga Dalan Shaplo, Koço Bihiku, Dhimitër Shuteriqi, Klara Kodra, Jorgo Bullo, Razi Brahimi, Jakup Mato e shumë të tjerë, nuk përballemi vetëm me një soldateskë ideologjike e të përbetuar (ndryshe ndoshta as që kanë e mundur, përveç se të përfundonin në llogore), por edhe me një “elitë” sharlatane, shamateske, pa fije energjie së paku (nëse jo tjetër) për të arrirë të bëjë një kritikë kualitative, sipas metodës ortodokse marksiste.

Domethënë një kritikë letrare ndryshe nga ajo që kanë bërë; pa fije strukture, rregulla që u përngjajnë interpretimeve të atyre falltoreve (duke përjashtuar zotësinë e parashikimit që e kanë pasur) të kohës së Faraonit.

Se kritika letrare e asaj kohë s' ka poseduar fije kualiteti shihet kur po të njejtët kritikë, edhe pse kanë pastruar fjalorin e tyre nga partishmëria, heronjtë pozitivë dhe nuk e kanë kokën më nën kamxhikun e diktaturës, shkruajnë tekste: ato nuk janë asgjë tjetër përveç se mozaikë përsëritjesh, riprodhime fjalësh të autorit, pa guximin për të konkluduar apo vlerësuar argumentativisht. Atyre u mungon metoda, ngase atë që ata kanë ushtruar pesdhjetë vjet s'ka qenë e bazuar në ndonjë shkollë me liçensë shkencore, por ka lindur si model për keqpërdorimin e artit në favor të sistemit dhe diktatorit të saj.

Fillimisht edhe në Prishtinë, përkundër se kërkesat e sistemit ndaj kritikës letrare nuk kanë qenë aq të egra si në RPSSH, bëhet vetëm ajo lloj kritike si në Tiranë. Model që, edhe pse më vonë, kritikët letrarë të Prishtinës do të marrin udhë të tjera, ka pasur dhe ka ithtarët e vet. Ndoshta me një masë më të modifikuar dhe përparuar, por me thelb të ngjajshëm.

5. Akademik Rexhep Qosja

Historiani, studiuesi dhe romancieri i njohur shqiptar, akademik Rexhep Qosja është ai që e krijon kritikën letrare shqiptare dhe ia jep asaj përmasat e “institutit” serioz, të bazuar në parimet universale të vlerësimit. Librat “Kritika letrare”, “Episode letrare”, “Dialogje me shkrimtarët” etj, janë veprat kryesore ku hidhen themelet e kritikës së angazhuar, pra shembujt e parë se si duhej të dukej kritika letrare.

Qosja dallon nga kritikët dhe teoricientët e tjerë të bllokut socrealist, sidomos sa i përket konceptit teorik të estetikës reflektive, që kishte marksizmi ortodoks.

Ky nuk e sheh artin thjeshtë vetëm si refleksion të rrethanave shoqërore, përkundrazi, studimet e tija historike, kritika praktike letrare e zhanre tjera të letërsisë ku ai angazhohet, janë një Antithesis e asaj, që mbizotëronte ose kërkohet. Më saktë formuluar; kritika e tij aludon në racionalitetin autonom e vetjak të artit e jo në kushtëzimin e paskajshëm të tij me racionalitetin e përvojës shoqërore.

Kjo troç dhe shqip do të thotë: Qosja funksionon kundër synimit të idologjisë për të vënë artin në shërbim total të saj dhe atë pa deformuar metodën e analizës dialektiko-marksiste, por duke e hapur këtë metodë (së paku në botën shqiptare) edhe ndaj modernes, deri atëherë të refuzuar.

Metoda se si vepron akademik Rexhep Qosja në vitet e gjashtëdhjeta, dhe kjo është interesante, do të

“legalizohet” veç më vonë edhe në hapësirat tjera përreth e më gjërë.

Para spekulimit, se Rexhep Qosja mund të ketë qenë i ndikuar nga neomarksistët apo teoria dialektike kritike e “Shkollës së Frankfurtit” dhe kryeveprës së saj “Dialektik der Aufklärung” (1944-47) që ka për autorë Max Horkheimer dhe Theodor Adornon, më bindëse është teza se qëndrimi i tij mund të ketë rezultuar nga përgjegjësia intelektuale që ka ndier ndaj artit e sidomos ndaj etnisë që i takon (të mendojmë në romanin “Vdekja më vjen prej syve të tillë”).

Edhe diçka tjetër shkon në favor të këtij konstatimi: estetët e analizës së tekstit, sipas metodës ortodokse marksiste, refuzojnë kategorikisht artin abstrakt dhe “absurd” modern dhe kapen fortë pas realizmit të shekullit 19-të, filozofët dhe sociologët e shkollës së Frankfurtit përqëndrohen më shumë në modernen dhe nuk i përfillin gjithaq teoritë e realizmit.

Studiuesi shqiptar Rexhep Qosja, ndryshe nga shkollat e përmendura, trajton e analizon në mënyrë të barabartë dhe pa nënvleftësuar ose mohuar (me përjashtime të diktura nga ideologjia = shih “...Romantizmi”) konceptet e realizimit dhe të modernes.

Rexhep Qosja është themeluesi i institucionit “kritikë letrare shqiptare” dhe njëkohësisht bartësi i teorisë neomarksiste e të ashtuquajtur “metoda dialektiko - kritike” në letrat shqipe.

Kritika letrare e akademikut tonë të mirënjohur R. Qosja megjithatë nuk do të marrë përmasat e shkollës. Dhe kjo për dy arsye:

1. Ajo nuk përfillet atëbotë nga Tirana

2. Asnjëri nga studentët dhe pasardhësit e tij në Prishtinë e gjetiu nuk arrin t'i afrohet profilit të “profesorit”. Disa, madje, spekulojnë se gjoja Rexhep Qosja ka ndërmarrë gjithçka për të penguar shfaqjen eventuale të ndonjë konkurrence, me qëllim që të jetë i pazëvendësueshëm.

Nëse shikojmë përtej mureve të këtij spekulimi, vërtet habit fakti se ata që kanë ndjekur gjurmët e Qosjes dhe teorisë së tij ose kanë përfunduar në ndjekës të zbehtë të tij (me prof. dr. Agim Vincën në krye) ose janë avulluar. Kryesorja, prej tyre nuk ka dalë ndonjë format kritiku me rëndësi relevante, përpos Agim Vincës.

6. Akademikët Ibrahim Rugova dhe Sabri Hamiti

Dy kritikët akademikë, Ibrahim Rugova dhe akademik Sabri Hamiti (në vitet ‘70) nuk i bashkangjiten synimit për të përparuar metodën ortodokse marksiste në favor të lirisë dhe autonomisë së artit. Ata e injorojnë atë komplet. Dhe praktikojnë teori të tjera moderne të letërsisë.

Ibrahim Rugova në fillim të veprimit të tij si kritik letrar e deri tek studimi i shkëlqyeshëm “Vepra e Bogdanit – Cuneus Prophetarum” (1982) përdor (jo

vetëm, por theksueshëm) metodën *hermeneutike*. Model që parasëgjithash bazohet në “teorinë e të kuptuarit” të tekstit e që bazën e ka në interpretimet e teksteve të Biblës, që i bëri reformatori gjerman Martin Luter (....) : mënyrë interpretimi, që, më vonë, do të definohet si “interpretimi i botës” nëpërmjet objektit në analizim e sipër. (Gadamer: për të kuptuar një tekst, paraprakisht duhet pasur një parafytyrim se ç’është ai tekst, në cilën kohë është e situar, kush është autori i saj e kështu me rradhë). Në filozofi kjo metodë për pionerë ka filiozofët Wilhelm Dilthey dhe Martin Heidegger.

Akademiku dhe studiuesi gjerman Robert Elsie në librin e tij “Historia e letërsisë shqiptare” për Sabri Hamitin thotë: “si kritik ai ka sjellë nocione dhe koncepte të reja në studimin e letërsisë shqiptare, duke këmbëngulur në një interpretim të pavarur nga proceset jashtëletrare”. E njehta gjë, pra, para mund të thuhet për Rugovën ose për të dy bashkë dhe më shumë: Rugova dhe Hamiti janë themeluesit e Hermeneutikës dhe Strukturalizmit në letrat shqipe, për shkak të krijimit (zbulimit) të formulave interpretuese, pa të cilat do të përjashtoheshin tipiciteti dhe natyra e karakteristike e letërsisë shqiptare, nëse këto teori do të merreshin një për një, dy studiuesit e përmendur nuk mund të konsiderohen thjeshtë vetëm si përçues të këtyre metodave nga gjuhët e huaja, siç aludojnë indirekt dhe me gjysëmzë ca kritikë.

Rugova dhe Hamiti, për dallim nga kritikët ideologjikë të Tiranës, të cilët analizën e mbështetnin në luftën e klasave dhe neomarksistët e Prishtinës, të cilët përpiqen të zbulojnë formulën e fekondimit apo ç’fekondimit të reales me imagjinaren dhe anasjelltas, “nuk çajnë kokën” me faktorët jashtëletrarë, siç bënin neomarksistët ose nuk vërdallen pa cak e qëllim siç bënin teoricientë të ndryshëm në planin universal për t’i dhënë primatin njëres nga metodat e shumta interpretese (hermeneutike, biografike, psikanalitike etj), por në këtë aspekt ata bëjnë ashtu siç bënë formalistët rusë dhe përqëndrohen ekskluzivisht në tekstin letrar, të ashtuquajturit “fakt letrar”.

Themeli i kësaj lloj analize qëndron në pyetjen: Çka e bën një vepër artistike të tillë?

Më tej metoda e tyre interpretuse shihet se për bazë ka teorinë strukturaliste të Claude Lévi Strauss, Roland Barthes, Claude Bremond, Gérard Genette etj, e të iniciuar nga gjuhëtari gjenevas Ferdinand de Saussure (.....) sidomos me “Cours de linguistique générale”, në shqip “Kursi i Gjuhësisë së Përgjithshme”, përkthyer nga Akademik prof. dr. Rexhep Ismajli, Prishtinë 1977.

Strukturalizmi niset nga parimi themelor se fenomenet nuk shfaqen të izoluara, por në lidhshmëri me fenomenet tjera. Detyra kryesore e metodës është që të zbulohet kjo lidhshmëri: Fenomenet gjatë shfaqjes së tyre krijojnë një lidhshmëri të strukturuar. Në këtë e

sipër struktura konstruohet nga vëzhguesi (intepretuesi) në model.

Sipas kësaj teorie, struktura nuk ekziston në nivel të realitetit, por vetëm në nivel të modelit vetë. Epiqendra e strukturalizmit shkencor është analiza e skemës formale të renditjes së figurave, analiza e kompozicionit rrëfyes dhe domethënies retorike e figurative në tekst e para së gjithash, siç u cek më lart, hulumtimi i letraritetit specifik në tekstet estetike dhe dallimi nga tekstet e natyrave të tjera.

Dyshja prishtinase përveç se është shkaktarja e thyerjes së monopolit të kritikës marksiste e neomarksiste (dialektikës materialiste) dhe sjellësja e dy metodave të elaboruara më lart, ajo, siç shihet, fut edhe pluralizmin si mundësi të re studimi në “pallatin e institutit të kritikës letrare”.

7. Ramadan Musliu

Si kritik i rëndësishëm me stil të vetin, pas këtyre dyve, dallohet Ramadan Musliu me recensionet e botuara viteve të tetëdhjeta dhe nëntëdhjeta (pjesërisht të përmbledhura në librin: “Konfiguracione narrative”, Prishtinë 1996) për romanin shqiptar.

Analizat diskursive të Musliut janë shembulli tipik se si mund të harmonizohen metodat e ndryshme të interpretimit në një katalog unik vlerësimi.

Interpretimet e Musliut varësisht nga tema, lënda dhe autori, i referohen herë njëres e herë tjetres metodë vlerësimi e gjykimi. Është kjo mënyrë vlerësimi rezultat i formimit universal të autorit apo aksion i qëllimshëm i tij për të krijuar një “metodë personale vlerësimi” duke përzier suksesshëm elementet e shumë shkollave në një, nuk ka fare rëndësi. I rëndësishëm në këtë plan është efekti i kësaj mënyre interpretimi.

Që në kritikën shqiptare shfaqet për herë të parë si e tillë. Këtë metodë, që tek shumëkush ka dështuar në fazën e eksperimentimit, Ramadan Musliu (me tekstet e përmbledhura në librin “Konfiguracione narrative”) e finalizon dhe “legalizon” si sistem të suksesshëm vlerësimi.

Pikërisht për këtë, që nga zanafillat e saj, nëpër baltën e banalitetit ideologjik, në institucionalizimin dhe pluralitetin e saj, metoda e Musliut, që akumulon dhe përbashkon shkollat në favor të një sistemi specifik për vlerësimin e një letërsie po ashtu specifike, është me rëndësi shumë të madhe për qenien, zhvillimin dhe studimin e kritikës letrare shqiptare.

8.Shefqet Dibrani

Libri voluminoz i vërejtjeve letrare “Libra dhe mbresa” i autorit të mirënjohur Shefqet Dibrani (Albanisches Institut, St. Gallen, 2005) i prezantohet lexuesit në formë të kompletuar dhe gjithësesi me prirje

për një koncept letrar i përfshirë mbi 120 vepra dhe revista letrare dhe me qindra emra krijuesish dhe me shumë shënime bibliografike. Për t'i bërë shkrimet më të realizueshme studiuesi Shefqet Dibrani, i ka shoqëruar me recensione autoriale, ballina të librit, shënime përcjellëse për botuesin dhe kodin përkatës, kurse në fund janë "shënime për autorin", ndërsa për librat e përkthyer" shënime për përkthyesin". Në përgjithësi libri "Libra dhe mbresa" lë gjurmë të madhe për lexuesin dhe studiusin pasionant shqiptar, megjithë mangësitë e vogla që e përcjellin librin, qoftë si koncept apo edhe si përmbajtje.

9. Të tjerët

Natyrisht se kritikët që përmendëm më lartë nuk janë të vetëm. Numri i autorëve, që janë marrë dhe po merren me vlerësimin dhe interpretimin e letërsisë është gati po aq i madh sa edhe numri i autorëve të gjinisë më të përhapur ndër shqiptarë, ai i vjershëtarëve!

Përveç brigadës së sporadikëve ekziston edhe ajo e atyre që janë marë ekskluzivisht me këtë "zanat" të përvetësuar nga mjeshtër të ndryshëm, por pa lënë gjurmë të dukshme, pa sjellë ndonjë praktikë të veçantë studimi e analizimi të arteve.

Tashmë të përballur me këtë aksiomë, me këto informacione, ne nuk mund të shesim poza duke mohuar ekzistencën e institucionit të kritikës letrare, por mund të

debatojmë për zhvillimin e saj që këndeje e tutje, pozitën, gjendjen dhe rëndësinë saj aktuale. Me rëndësi kapitale në këtë kontekst është që të dimë se cilat janë funksionet qenësore të kritikës letrare në kushtet e së sotmes. Çka e arsyeton ekzistencën e saj?

Funksionet e kritikës

A luan si duhet kritika letrare shqiptare rolin që ka? Assesi! Pse?

Pas viteve të nëntëdhjeta, që atëherë kur de facto u hoq cenzura ideologjike, filloi një prodhim i pakontrollueshëm dhe masiv i veprave “letrare”. Erdhi koha e “të shtypurve”?! Si pasojë e kësaj çdo autor, magazinier e parelinj ngriti një ndërmarrje botuese, fillimisht më shumë për të botuar shkrimet e veta e pastaj edhe për të luajtur rolin e botuesit.

Pas një heshtjeje jo edhe të shkurtë me reagimet e tyre u shfaqën të privilegjuarit e hierarkisë së vjetër kundër vërshimit të kiçit, shundit, që për lau bibliotekat gjysmë të rrënuara shqiptare. Alarmet e këtyre autorëve dhe të tjerëve në lidhje me rreziqet që sillte akulturimi u morën si “britmë e fundit e kalit para se të ngordhë”.

Në realitet reagimi i tyre ishte me vend edhe pse shumica e tyre do t'i kishin bërë nder vetes më mirë të mbanin gojën mbyllur, sidomos ata që në të kaluarën kanë qenë tepër aktiv si “redaktorë e recensent” në vijë të proletariatit e partisë. Kjo gjendje orteku i përsheshti

edhe ato pak kritikë të specializuar që ishin. Nga njëra anë për arsye të prodhimit masiv e nga ana tjetër për shkak të kushteve të reja sociale e ekonomike me të cilat u ndeshën krijuesit pas deformimit të shoqërisë, si në Shqipëri ashtu edhe në Kosovë.

Kritika letrare, si shumë segmente tjera të jetës kulturore u vu në pozitën stand by.

Edhe sot pas pesmbëdhjetë viteve gjendja ka mbetur pothuaj e njëjtë.

a) Edhe sot kritika letrare ende nuk ka arritur të luaj rolin e saj informues e orientues duke dhënë një pasqyrë të mjaftueshme mbi botimet e reja. Edhe poqese ky qëllim të ekzistonte ajo një gjë të tillë do ta kishte të pamundshme, si për shkak mungesës së medimeve të specializuara, ashtu për shkak të mungesës së një sistemi koordinues ndërmjet botuesve e mediave.

b) Si pasojë e së parës, ajo nuk mund të luajë rolin e seleksionimit, duke veçuar e zgjedhur vepra që meritojnë të recensohen, vlerësohen e t’iu ofrohen lexuesve poetencial si literaturë e vyeshme që duhet blerë e pasur në bibliotekë. Ato pak kritikë të specializuar, pa pasur shteg tjetër, i janë përshtatur ligjit të xhunglës dhe janë detyruar për shkaqe ekzistence të lirojnë nervat dhe të vlerësojnë sipas “vendit e kuvendit”, kështu duke përjashtuar çdo parim serioz profesional.

c) Funksionin e saj didaktiko-ndërmjetësues kritika letrare e ushtron (!?) vetëm nëpër shkolla,

institute e fakultete. Publikut më të gjërë një mundësi e tillë i është uzurpuar qëmoti nga rrethanat mbizotëruese.

Opinioni, pra masa e lexuesve jashtë katedrave, nuk do e marrë vesh kurrë (nëse vazhdohet kështu) se ç'risi vijnë në letrat shqipe, cilët autorë e autore trajtojnë një problem të përgjithshëm, që duhet njohur e ditur e që është me rëndësi për çdo qytetar apo për shtresa të caktuara të shoqërisë. Lexuesit nuk i bëhet e qartë se cili autor është vërtet “gjeni i lindur”, e cili imitator i pararendësve dhe shkrimin e bukur e trajton si zeje.

Masa nuk merr shpjegime nga kritika se si duhen kuptuar veprat e reja dhe ato të retushuara të Kadaresë; ç'na sjell të re Dervishi me dramat e tij ekcesive; si duhet kuptuar famën e madhe të Ardian Kristian Kyçyikut në Rumani e gati mospërfilljen e tij në atdheun e tij; pse është interesant për t'u përkthyer romani “Shkëlqimi i huaj” i shkrimtarit prilepas Beqë Cufaj në gjermanishte e jo i shumë autorëve tjerë që shqiptarët i konsiderojnë elitore, e shumë, shumë çështje të tjera.

d) As në rolin e saj didaktiko-sanksionues që për prodhuesit e letërsisë (autorët dhe botuesit) është e një rëndësie të madhe kritika letrare nuk luan asnjë rol. Kritikët nuk merren parasysh si referencë që do të ndihmonin në dallimin e prodhimit kualitativ letrar dhe atij të pavlerë dhe të pasuksesshëm në treg, gjë që do të ndihmonte dukshëm në përmirësimin e kualitetit të botimeve të reja.

Janë të rralla ato shtëpi botuese që në redaksinë e tyre kanë lektorë profesional ose recensentë që do të bënin vlerësimin dhe gjykimin e veprës para se të vendosej botimi apo mosbotimi i saj. Shumica e shtëpive botuese përbehen vetëm nga pronari i saj e në të shumtën e rasteve nga një staf redaktorësh që vallëzojnë sipas xhepit të pronarit e jo sipas kriterieve të vlerësimit profesional.

Këto janë vetëm disa nga kushtet që duhej t'i plotësonte kritika letrare për tu pranuar si institucion koherent dhe serioz si dhe për të arritur që të stimulojë masat për më shumë lexim dhe të rikthejë imazhin e humbut të letërsisë artistike.

Sferat e angazhimit të kritikës

Për të përfituar nga kritika në favor të përmirësimit të kualitetit të letërsisë si dhe popullarizimit të letërsisë në masë, duhet që asaj t'i mundësohet pjesëmarrja në institucionet e prodhimit letrar si dhe mbikqyrja në procesin e punës së këtyre institucioneve. Kritiku duhet të jetë pjesë vitale dhe e pashmangshme e institucioneve të prodhimit letrar: ai është i vetmi kompetent që mund të vlerësojë autorin konkurues dhe t'ia oforojë botuesit, i cili pastaj e drejton për në shtypshkronjë dhe kujdeset që produkti i tij të plasohet e trajtohet si e sa duhet në mediat masive.

Prezenca e kritikës në zgjedhjen, botimin dhe vlerësimin publik të një vepre letrare ndikon edhe në punën e institucioneve të distribuimit: libraritë informohen për prodhimet e reja dhe vihen në kërkim të mallit për konsumatorët e vetë.

E njëjta gjë vlen edhe për stendat trotuareve nën shi në qytet tona shqiptare si dhe për bibliotekat rajonale dhe atë nacionale.

Është detyrë e kritikës që të luajë rolin primar në institucionet e zhvillimit, siç janë konkurset, shpërblimet e bursat e jo e autorët vetë dhe kryesitë e shoqatave, siç ndodhë aktualisht. Sidomos aty ku synohet legalizimi dhe popullarizimi i një çmimi ose ruajtja e seriozitetit që ka një çmim tradicional.

Edhe në institucionet e komunikimit si universiteti, shkollat e larta dhe institutet tjera kritika letrare ligjërohet pa sistem, në mënyrë konfuze dhe e papërcaktuar, për të mos thënë edhe më troç se janë pikërisht këto institucione që nuk kanë arritur ose nuk arrijnë të kualifikojnë kuadro të përgatitura që do të ndikonin në zhvillimin e kritikës letrare shqiptare.

Teoritë që ligjërohen aty nuk kanë ndonjë system, që do të mund të formonin kritikun e shkolluar, shkencor dhe praktik.

Prej aty dalin do melezë në kuptimin profesional) që nuk e dijnë se për ç'janë formuar saktësisht për teorikë, gjuhëtarë apo për mësues të letërsisë nëpër shkollat e mesme, kështu që më në fund

përfundojnë në vjershëtarë ose komentatorë politikë. Ato pak emra që dallohen si kritikë të specializuar nuk janë të tillë për shkak të fakultetit që kanë kryer, por më shumë falë angazhimit të tyre personal e autodidakt.

Një arsye tjetër që ka sjellë në këtë gjendje institucionet e komunikimit është edhe mungesa e metakritikës. Të krijohet përhstypja sikur asnjëri nga kritikët (me përjashtime) nuk merr guximin të vë nën dioptri punën e kolegëve të tij. Kjo është e rëndësishme, sepse roli dhe funksioni i kritikës nuk është vetëm interpretimi dhe vlerësimi i prodhimit të letërsisë artistike, por edhe i vetë kritikës letrare si të tillë: si shkruhen recensionet?

Nga cila pozitë gjykojnë kritikët e veçantë dhe ata të angazhuar në media etj. etj.

Teoria dhe praktika sot

Studiuesit e sotëm të letërsisë shqiptare, ata që ligjërojnë ose punojnë në universitete, luajnë po aq rolin e kritikut praktik sa edhe gazetarët dhe fejtivistët nëpër media. Po tu bëjmë një analizë punimeve të të dyja grupeve do të konstatojmë se dallimet janë minimale. Si studiuesi ashtu dhe gazetari, fejtivisti pretendon ta ekspozojnë veten me të dyja funksionet; atë të shkenctarit, që di të bëjë kritikë praktike dhe atë të gazetarit të pajisur me dijen shkencore. Në të dyja rastet rezultatet janë maksimalisht modeste e në të shumtën e

rasteve servohet një sallatë mendimesh që më shumë eksponon snobizmin e autorit sesa vlerësime rreth objektit në trajtim e sipër.

Për të qenë kritik letrar natyrisht se nuk nevojitet vetëm një dije elementare nga shkencat e letërsisë, por edhe një specializim në metodat e vlerësimit si dhe njohje të llojeve të shumta të interpretimeve. Pikërisht mungesa e këtij vetëdijësimi, sistemi dhe mungesa e diskurseve që do të qartësonin kompetencat e roleve ndërmjet shkencës edhe kritikës letrare praktike e zmadhojnë konfuzitetin dhe nuk lënë zhvillimin e asnjërës prej këtyre dyjave në nivel të nevojshëm.

Ndoshta këtu duhet kërkuar arsyen se pse kritika shkencore letrare ka mbetur vetëm në nivelin e eseistikës historike mbi epokat, mbi stilet e rrymat apo në nivel të reportazhit monografik për shkrimtarë të caktuar të historisë së letërsisë së arteve.

Mund të veçohen për të mirë kritikët e historisë së artit prof. dr. Hivzi Muharremi, prof. dr. Fejaz Drançolli, prof. dr. Jahja Drançolli, Flori Bruqi, Naim Kelmendi, etj.

Natyra eseistike, monografike e reportazheske e trajtimit të letërsisë nuk lejon që të bësh fjalë për kritikë shkencore, por maksimalisht për diskurse hipotetike mbi sfera, çështje dhe personalitete të caktuara të letërsisë shqiptare. Kështu siç edhe e kemi.

Në emër të kritikës shkencore, teorike pra, bën jetë stili fejtunistik i (para) gjykimit, (mbi ose nën)

vlerësimit dhe (gjoja)interpretimit e në vend të kritikës praktike vepron anarakia e hobi - interpretëve, gazetarëve pa fije përvojë teorike, që ta shpifin cilindo libër që përgojnë, edhe pse duken si “akte subjektive” të një lexuesi të singertë ato tekste s’përmbajnë asnjë argument të vetëm, përpos emrit dhe mbiemrit të autorit me pasionin për t’u bërë publik.

Ajo që mungon është procesi i konceptimit të kritikës letrare brenda zhanrit, dallueshmërisë ndërmjet të ashtuqujturës kritikë praktike (recensioni, fejttoni, eseu, polemika etj) dhe asaj shkencore (studimore, teorike). Këtu, si duket, ekziston një keqkuptim që edhe ka rezultuar në një degradim ku mungon ose dyshemeja ose kulmi.

Format e vlerësimit: Recensionit

Kritika letrare nëpër media (ose praktike) shërbehet me tipe të ndryshme tekstesh që synojnë intepretim dhe vlerësimin e veprave, epokave, problemeve letrare, autorëve e të ngjajshëm.

Gjersa portretet, letrat e hapura, intervistat, esetë, dialogjet e imagjinuara janë raritete dhe sidomos në dhjetëvjetëshin e fundit kanë marrë statusin e “species” në vdekje e sipër, recensionit dhe “vitrina e librit” (përshkrimet e shkurtëra për veprat e sapobotuara që i praktikojnë shumica e gazetave të përditshme shqiptare) vazhdojnë të mbijetojnë fjala vjen në Kosovë më tepër

me In memoriama dhe Shpallje publike (Kosova Sot, Infopress, Epoka e re, Bota sot, Prishtina post, Tribuna shqiptare etj)

Ato bëjnë jetë të hendikepuar, ama megjithatë po mbahen.

Recensionet që i lexojmë në të përditshmet shqiptare si: “Kosova Sot”, ”Koha ditore”, ”Lajm”, ”Tirana Observer”, “Shekulli”, Koha jonë”, Nacional”, ”Fakti” si dhe në revista e website të “specializuara” për letërsi (Fjala e Lirë, nga Fatmir Terziu, Axhencioni Floart - Press nga Flori Bruqi) në përgjithësi lënë shumë për të dëshiruar. Tekstet që vijnë të mbititulluara si recensione ose që sugjerohen si të tilla nuk përmbajnë në vete elementet themelore që duhet të kenë.

Të rrallë janë ata autorë që marrin mundin për të përfshirë të gjitha segmentet e nevojshme që kërkon recensionin për të qenë i kompletuar, si:

1. Të dhënat biografike për autorin (ky segment mund të lihet anash vetëm në rastin e autorëve shumë të popullarizuar, mirëpo përsëritja e biografisë është prapseprapë me rëndësi për shkak se biografitë ndryshojnë).
2. Informata në lidhje me veprat e mëpërparshme të autorit si dhe krahasimi i asaj të fundit me më të hershmet.
3. Analizimi i vlerësimeve kritike mbi autorin, vërtetimi, modifikimi apo kundërshtimi i tyre.

4. Krahاسimi i veprës së autorit me vepra të autorëve të tjerë aktualë.
5. Informata mbi temën, përmbajtjen, strukturën, gjuhën, intencionin dhe përgatitjen teknike të librit.
6. Vlerësimi i tekstit.
7. Konkluzionet vlerësuese mbi librin.

Nëqoftëse interpretuesi nuk punon sipas këtij katalogu parimor, themelor dhe teksti i tij nuk përmban në vete informatat e sipër radhitura, pavarësisht renditjes së tyre, ai asnjëherë nuk mund të jetë i bindshëm se di të shkruajë recension, ai nuk do të mund të jetë i besueshëm se ka lexuar, analizuar dhe njeh tekstin që trajton. Recensionin sipas katalogut që shtruan mungon. Në vend të tij bëjnë jetë interpretimet që mund të emërohen si gjithçka tjetër, por jo si recensione. Për çdo ditë na bie të hasim ndonjë tekst të mbititulluar si “recension”.

Lexuesi i privuar nga e drejta e ndërhyrjes, i cili luan vetëm rolin e konsumatorit të fjalës publike, është i detyruar të pranojë atë si të tillë. Me një mbititull të tillë paralajmërohet publikimi i ndonjë vepre të re. Autorët e teksteve të tilla, harrojnë përgjegjësinë që kanë ndaj lexuesit dhe japin konstatime nga më të çuditshmet pa qenë koshient për të arsyetuar mendimin e vetë. Ata thjeshtë shkruajnë; “ky është më i miri” ose “ai është më i keqi” pa ndier nevojën për të treguar konkretisht shkakun!

Në fund të një shkrimi, po ashtu të mbititulluar si “recension”, lexojmë konstatimin; “X është poeti më i mirë i filan gjeneratës së shkrimtarëve shqiptarë”. Autori i atij shkrimi pompoz që nga shkronja e pare e tekstit e deri në fund shihet se është një injorant i kategorisë së asaj sorte që me shumicë i gjen nëpër mediat shqipe.

Për të demonstruar sa më ashpër “dashurinë” ndaj poezisë ose lirikut vetë, autori kishte rishkruar, besojmë me dorë të vet, vargjet dhe i kishte futur ndërmjet fjalëve të veta, kështu që më në fund, pas një llogaritjeje të thjeshtë dilte se ai nuk kishte thënë më shumë se sa nja dhjetë fjali të fshehura ndër citatet që përmbushnin pothuaj gati një faqe gazete të formatit klasik. Ato dhjetë fjali, që të gjitha, rrotulloheshin rreth të njejtës gjë; “X. është poeti më i mirë, gjenial, kolosal...”.

Nëpër sallone apo në kafene edhe po të kërkoj dikush llogari për ndonjë konstatim të përshpejtuar, mund të refuzosh që të pish më tej me të në tavolinë dhe të çohesh e të ikësh, ndërsa fjala e thënë publike të nënshtron përpara një obligimi, përgjegjësie më të madhe, për arsye se çdo konstatim duhet të jetë i argumentuar, i “dokumentuar”, përndryshe ai mund të konsiderohet si shpifje. Keqpërdorim i lexuesit dhe mediumit ku plason mendimet.

Autori i konstatimit të lartëshënuar pa fije turpi donte t’i imponojë lexuesit të singertë mendimin e tij, pa ndier nevojë që t’i sqarojë atij; përse, sipas mendimit të tij, poeti X është më i miri!

Ata që kanë mundësinë ta sigurojnë librin do të shohin se autori i “recensionit” ose është gjetur ngushtë gjatë hulumtimit të vlerave, të cilat ai do t’i bënte shtyllë të tekstit të tij ose nuk e ka lexuar fare librin dhe gjithë frymëzimi i tij fillonte dhe mbaronte në kopertinat e librit në fjalë.

Kjo e dyta është më e sigurtë, sepse librat, për të cilat flasin “kritikët” e tillë jo rrallë përmbajnë vlera që mund të përfliten, mirëpo me parakushtin që ata, pra “kritikët” së pari duhet t’i bëjnë nervat tok e t’i lexojnë si duhet e mos të flasin përmendsh.

Domethënë kriteret themelore të vlerësimit nuk janë ato që kërkohen më lart, por: Lavdërimi i tepruar ose sharja deri në asht, bëhet nga disa maniak interneti. Për të mos rënë në pozitën e “recensentit” të përshkruar më lart, kritiku serioz duhet të manovrojë së paku me mjetet themelore të vlerësimit që analiza e tekstit i vë si parakusht. Kritiku i angazhuar dhe serioz asnjëherë nuk e nis interpretimin e tij për një vepër pa përshkruar së pari katalogun e pyetjeve themelore që kërkon analiza e tekstit. Katalog që në sipërfaqe duket skolastik, por që jo vetëm se është i pashmangshëm, por bashkë me çelësat personal interpretues (shih formularin mëposhtë) edhe përcakton nivelin e njohjes së objektit në studime e sipër dhe ajo më kryesorja dëshmon për punën, seriozitetin dhe besueshmërinë e vlerësuesit.

Kritika letrare dhe mediat

Në masmedia mungojnë rubrikat e rregullta, emrat e rregullt që do të përfohnin librat në mënyrë objektive dhe duke iu përmbajtur parimeve të formës së shkrimit (recensionit) dhe kondicioneve profesionale të printmediave, artikuj edhe pse me një gjërësi e natyrë gjuhësore ndryshe nga shkrimet publicistike, por megjithatë të ngritura në bazë të atyre pesë a gjashtë W-ve të famshme gazetareske.

Shkrimet “kritike” që botohen nëpër rubrikat apo shtojcat e kulturës nëpër media, dëshmojnë se faji kryesor prapë se prapë nuk është i përgjegjësve të këtyre medimeve, por vërtet stagnuese shfaqet pa aftësi e autorëve që përpiqen të merren me kritikë letrare e s’dijnë t’iu përshtaten as rregullave të profesionit që mëtojnë ta ushtrojnë e as atij të gazetarisë.

Sidomos gazetat e përditshme, ato që kanë për synim profesionalitetin sipas standardeve, janë të detyruara të tregohen refuzuese ndaj idesë për krijimin e një rubrike të rregullt, ku do të përfolej vepra artsitike.

Nga ana tjetër askush nuk beson se këto media nuk mund të sigurojnë për redaksitë e tyre nga dy a tre kritikë letrarë që në mënyrë të rregullt do ta ndiqnin, ama edhe do ta lexonin librin, pikturën etj, e do ta diskutonin atë publikisht.

Le ta marrin shembullin e mediave të huaja: nuk e kziston asnjë gazetë as e përditshme as periodike në

perëndim pa kritikun e vet të rregullt letrar, pa rubrikën e vet të rregullt për librin.

Natyrisht se, për të qenë mediumet më kualitative duhet të sigurojnë kuadro të përgatitura mirë profesionalisht. Nuk mungon as përshtypja se problemet apo të arriturat kulturore, sipas mediave që kemi në duar, përdoren vetëm si mjet elozhi, vetkënaqësie dhe onanie personash ambicioz që kanë fatin të jenë afër medimeve, kështu duke zmadhuar fatkeqësinë e kulturës e në veçanti atë të letërsisë shqiptare.

Për këtë një përgjegjësi të pamohueshme mbajnë përgjegjësit e medimeve.

Ata duhet të krijojnë ca rregulla që do të parandalonte vërshimin e sojit të pseudokomentatorëve, që manifestohen me gjithë makinacionet e mundshme të akulturimit.

Ndonjë vëzhgues i proceseve letrare dhe punës së mediave (Koha ditore, Kosova Sot, Lajm, Express, Epoka e re, Floart - Press, Fokusi javor, Java etj) në këtë drejtim do të thoshte se gjithë kjo tragjedi ka ardhur nga mungesa e “institucionit” të kritikës si dhe vazhdimit të sistemit të trashëguar socrealist.

Mirëpo e vërteta qëndron edhe diku tjetër. Një segment të dukshëm përbën edhe tipi i mentalitetit anadollak i disa shkruesve shqiptarë, të cilët në vend që të punësohen si ofiqarë në ndonjë administratë, aq sa e kanë edhe aftësinë, atyre nuk u vjen fare turp për t’u marrë me kritikë të letërsisë, duke shkruar “recensione”

që s'janë gjë tjetër se sa përdhunim i pashembullt i lexuesve, pra aventurierë të tipit, siç është shembulli më lartë.

Kritiku si është dhe si duhej të ishte

U tha: Sot kemi shumë pak kritikë të mirëfilltë letrar! Pse është kështu?

Shkollë speciale për kritik letrar nuk ka. Nuk dihet nëse ndonjëri nga universitetet shqiptare ofron ndonjë seminar apo kurs praktik në lidhje me Metodën e Vlerësimit të Tekstit, nëse po atëherë ato seminare apo kurse duhet të jenë aq të këqija saqë s'kanë mundur të nxjerin hiç më shumë se disa veta që mund të numurohen në gishta si profesionistë.

Shumica e gazetarëve që merren me kritikë letrare kanë të mbaruar fakultetin e letërsisë ose janë vetë autorë (shkrimtarë, poetë etj.). Fakultetet e letërsisë janë patjetër baza ku pretendentët e këtij profesioni aftësohen me njohuritë në shkencat e letërsisë, mirëpo kjo nuk do të thotë saora specializim edhe si kritik letrar.

Në krahasim me fushën ku ajo angazhohet, dmth me artet e bukura si vepër e gjenive dhe që nuk mësohet por është e lindur (I. Kant), kritika letrare është një aftësi praktike, zotësi që rrjedh nga dija. Diçka që duhet të mësohet. Përveç njohjes së letërsisë, historinë e saj, teorive mbi të, aktualitetin dhe tregun kritiku letrar, siç

dihet, duhet të njohë mirë edhe gazetarinë për të qenë i aftë që të publikojë refleksionet e tij.

Institutet ekzistuese, pra njohës të kompletuar të shkencës, arteve të bukura dhe gazetarisë, tash për tash nuk janë gjendje të nxjerin kritikë të këtij formati. Ndërsa nga përvoja kemi parë se kritikët e këtij kalibri, ata të kompletuarit, në këtë nivel kanë mbërritur falë angazhimit personal në këto fusha të ndryshme si dhe vetinicijativës. Ky realitet e hedh në erë bindjen infantile të shumëkujt se për të qenë kritikë letrar mjafton fakulteti i letërsisë dhe aftësia për të stilizuar e bërë llafe mbi artet e bukura pa studimin rigoroz të tyre dhe përkuljen para një disipline të rreptë e të mundimshme pune.

Si u vjen kritikëve serioz të cilët harxhojnë energji, mund e dije për ta lexuar e interpretuar një vepër arti me përkushtim, kur konfrontohen me prezencën e vërshuar të sharlatanëve, të cilët nuk kanë asnjë fije respekti ndaj të bukurës dhe muzës së gjenit? Numri i atyre kritikëve që për afërsisht plotësojnë kushtet e shtruara më lart në letrat shqipe, është më se minimal. Shkaqet që kanë çuar në këtë gjendje janë të njohura ose pjesërisht janë trajtuar edhe në këtë ese.

Morali dhe etika profesionale e kritikut

Përpos këtij deficiti ekzistojnë edhe një mori pengesash tjera, që profesionin e kritikut e bëjnë

joatraktiv ose edhe të pamundshëm. Asnjëri medium, madje as edhe shtëpitë botuese në hapësirën shqiptare nuk punësojnë dikë si kritik letrar. Personi i specializuar si kritik duhet së pari të bëjë punën e gazetarit, lektorit, korrektorit gjuhësor, redaktorit e punë të tjera për të siguruar ekzistencën e pastaj, nëse i mbetet kohë, mund të kontribuojë diçka për profesionin dhe pasionin e tij.

Nuk mjaftojnë vetëm aftësitë për të siguruar një vend në ndonjë medium që të ushtrosh “zanatin” e kritikut. Përveç përgatitjes profesionale duhet t’i takosh ndonjë klani a grupacioni (letrar, rajonal, gjinor e së fundi edhe fetar) që mban nën kontroll institucionin e caktuar.

Me sigurimin e kësaj lidhjeje kritiku automatikisht humb pavarësinë intelektuale dhe ndeshet me pengesa tjera, që ia bëjnë të mundimshme punën: klani ose personat që e kanë ndihmuar kërkojnë (edhe nëse nuk e thonë drejtëpërdrejtë, për mentalitetin shqiptar kjo është gjë e natyrshme) mirënjohje në vepër.

Me humbjen e kësaj mvetësie kritiku letrar fillon të shkruajë nga pozitat e mikut, avokatit, shërbyesit të grupit apo autorit (e ka ndihmuar të ngjitet shkallëve) dhe gjykatësit të njëanshëm, “edukatorit” joobjektiv, kur bëhet fjalë për vepra autorësh, që u përkojnë klaneve konkurente ose në luftë me atë, të cilit i takon (me dashje ose padashje) kritiku letrar (grupi i PEN-istëve kosovarë apo letraret e LSHK).

Ata që veprojnë jashtë këtyre rretheve e grupacioneve duhet të bëjnë luftë të ashpër për të mbetur gjallë publikisht. Se ç'morali dhe etike profesionale duhet të ketë kritiku letrar në këtë rast e përcakton shoqëria me gjithë mekanizmat e saj. Nëse gjendemi në një shoqëri të korruptuar edhe kritiku do të jetë patjetër i tillë, nëse funksionojmë në një shoqëri ku klanet, fiset dhe grupacionet e kanë fjalën kryesore edhe kritiku do të jetë altoparlanti ose falltori i oborrit të njërit nga këto formacione. Me këtë kritiku e ka të kufizuar veprimin e vet dhe nuk mund të trajtojë në mënyrë të barabartë të gjitha letërsitë e mundshme, por mbetet si kritik special i literaturës primare, të lauruar nga klani si elitore ose i asaj sekondare ose i asaj marginale ose i pop-letërsisë ose i asaj literature, që prodhon vetëm shefi i taborrit.

Nëse një kritik vendos që të bëjë luftë jashtë sistemit me qëllim të ruajtjes së integritetit personal, etikës profesionale dhe njerzore ai do të injorohet, izolohet deri sa ta gjejë një profesion tjetër ose të heq dorë fare edhe nga publikimi i studimeve të tij.

Kritika letrare sot

Kështu duket sot kritika letrare në pasqyrën e saj të grimcuar. E bërë pikë e pesë. Megjithkëtë, mund të jetë edhe ndryshe. Shpresat nuk janë djegur të tëra. Dhe kjo për dy arsye:

E para, se edhe më tutje mund të shpresojmë në aktivizimin dhe angazhimin e atyre kritikëve letrarë, që për një apo shumë arsye kanë kërkuar hije nën pyllin e profesioneve tjera dhe ia kanë kthyer shpinën pikërisht asaj që më së shumti ka nevojë për ta.

Dhe e dyta arsye, ajo që më së shumti ushqen shpresat, është se në letrat shqipe kanë hyrë dinjitetshëm (përveç brigadave të hobi interpretëve) edhe specialistë të shkëlqyeshëm të teorive letrare si Agron Tufa, i cili njëkohësisht është edhe eksperti i formalizmit dhe strukturalizmit. Pastaj dy Kujtimët (Kujtim Shala dhe Kujtim Rrahmani) nga Prishtina, Ndue Ukaj, Vehbi Miftari, Shefqet Dibrani e ndonjë tjetër. Ndërsa në fushën e kritikës letrare praktike mund pa hamendje të përmendim Ragip Sylajn, Sali Bytyçin, e ca të tjerë.

Nihilistët, (veçanarisht) gjenitë e hutuar të letrave shqipe le të mos brengosen se pas shkuarjes në atë botën tjetër askush nuk do të merret me artin e tyre, përkundrazi kritika do të merret edhe me ata që, sa kanë qenë gjallë, nuk kanë lënë gurë pa ia hedhur asaj në kokë.

Ky është vetëm njëri nga ato mallkimet me të cilin duhet të jetojë kritiku objektiv.

DANTE ALIGERI

Dante Aligieri i madh, kjo ikonë e letërsisë dhe mendimit të përparuar evropian, frymëzoi shumë pena të mëdha e mendimtarë në të gjithë rruzullin.

Për lidhjen e veçantë të veprës së tij me shqiptarët ka shkruar edhe Kadareja.

Në fakt kjo lidhje nuk ka qenë fizike, sigurisht..., por megjithatë shumëplanëshe, e ardhur nga kohët e largëta, e ridimensionuar disa herë në periudha e formate të ndryshme. Siç dihet madje, arriti t'i rezistojë edhe vetë monizmit, megjithëse veprat, mesazhet e vargjet e tij ishin mëse të qarta për një popull si ai i yni.

Dante Aligieri jetoi në pragon e Rilindjes Europiane, e cila lindi me të vërtetë titanë të mëdhenj për nga forca e mendimit, pasionit e karakterit. Dante më së

miri personifikon Perëndimin e Mesjetës feudale dhe afrimin e një epoke më të zhvilluar të historisë njerëzore. Por ai shihet edhe si një urë lidhëse dhe një udhërrëfyes për shumë breza gjatë historisë së njerëzimit, pasi mesazhet e tij gjenden në të gjithë brezat e kohët.

Dante, më i madhi poet i Italisë, një nga figurat më gjeniale të letërsisë botërore, poet i fundit i Mesjetës dhe njëkohësisht poeti i parë i kohës së Re. Biografët thonë se jo vetëm letrarët dhe njerëzit e kulturuar, por dhe njerëzit e thjeshtë lexonin dhe mësonin përmendësh pjesë nga Komedia.

Vetëm një pasion i thellë politik, një patriotizëm i flaktë, një “zemër e mbushur plot dhimbje për atdhenë e copëtuar”, mund t’i diktonte Dantes vargje të tilla si: Orëzezë itale, mbytur në lot e vaj, Anije pa pilot nëpër stuhi, Jo zonjë provincash s’je, po kupleraj! (Marrë nga Purgatori, kënga VI, vargjet 76-78). Si personalitet krijues, me ndjenja të zhvilluara patriotike, Danteja udhëhiqej nga besimi se poezia duhet t’i shërbente popullit, të ishte refleks i ngjarjeve politike dhe në funksion të ndërtimit të një shoqërie më të përparuar. Sipas Dantes, njeriu duhej të çlirohej nga kufizimet fetare dhe të synonte drejt shprehjes së lirë të mendimeve dhe të ndjenjave të tij, si dhe drejt zgjimit të vetëdijës qytetare e politike. Vetëm kështu do të mund të zotëronte, sipas tij, humanizëm dhe demokratizim në marrëdhëniet me njerëzit e tjerë.

Shumica e quan Danten poetin më të madh italian të të gjitha kohërave, por ai ishte, po ashtu, dhe një shkrimtar i shquar në prozë, mendimtar aktiv politik, filozof moralist e teoricien letrar.

Filloi të krijonte qysh në moshën 15 vjeçe. Si vazhdues i trubadurëve provansalë, që i këndonin “madonës” (vashës) e dashurisë kalorsiake dhe i ndikuar nga krijuesit e shkollës poetike të “stilit të ri e të ëmbël”, e veçanërisht nga bolonjezi Guido Guiniçeli, Danteja krijoi një lirikë të hollë, reale, të thellë e të sinqertë, ku dashuria tokësore e qiellore shkrihen e behën një. Më 1294 ose '95 shkruan në gjuhën popullore veprën “Jeta e re” (Vita nuova), historinë e dashurisë së tij me Beatriçen, të parin tregim autobiografik në historinë e letërsisë së Europës Perëndimore. “Rimat” (Rime) janë një përmbledhje sonetesh, baladash e këngësh, që i kushtohen Beatriçes dhe mikut të tij Guido Kavalkanti. Janë shkruar në gjuhën popullore sipas “stilit të ri të ëmbël”.

Në vitet 1306-1308, duke luftuar për krijimin e një gjuhe të përbashkët për popullin italian, shkroi traktatin “Mbi gjuhën popullore”, të parin traktat gjuhësor në Europë. Në të ai flet për origjinën e gjuhëve, sidomos romane, dhe ndalet në 14 dialektet e gjuhës italiane. ai synon krijimin e një gjuhe që të jetë po aq e përsosur sa latinishtja, që të matet pa frikë me frëngjishten dhe gjuhën provansale. Vepra mbeti e përkryer plotësisht. Këto vepra të tjera janë mjaft të rëndësishme, po ajo që ia dhe atij lavdinë e përgjeshme

është kryevepra me titull: “Komedia Hyjnore” (La divina Commedia). Dante te Ferri: “Jo më pak se dija, dyshimi më pëlqen”.

Komedia Hyjnore

Kjo vepër monumentale është shkruar në një periudhë tetëvjeçare (1313-1321). Danteja e titulloi veprën Komedi, sipas poetikës antike, duke dashur të përcaktojë gjininë e veprës: komedia është një vepër që përfaqëson një rrëfim me përfundim fatlum, e kundërta e tragjedisë. Në realitet dhe Komedia e Dantes përfundon fatmirësisht, meqenëse protagonistin e takon Zotin.

Më vonë, me sugjerimin e Xhovani Bokaçios, kësaj vepre iu shtua atributi Hyjnore, që të lartësohej më fuqishëm madhështia dhe bukuria e saj. Te “Komedia Hyjnore”, Danteja shfrytëzoi të gjitha pasionet e tij, sulmoi ashpër armiqët, u sul kundër tiranive dhe korrupsionit të selisë papnore, kundër veseve njerëzore, u tregoi bashkëkohësve të vet se si duhej ndrequr njerëzimi.

Vepra paraqet një alegori epike trikëngëshe të shpirtit njerëzor dhe një përmendore, në të cilën me fantazinë e tij të mrekullueshme, si arkitekt gjenial, ai ngriti ndërtesën e mbretërisë së botës së përtejme.

Me fjalë të tjera, është një përshkrim i udhëtimit fantastik të Dantes nëpër tri mbretëritë e përjetshme: Ferrit, Purgatorit dhe Parajsës. Gjatë këtij udhëtimi imagjinar, që zgjati vetëm 24 orë, Danteja provoi të

përshkruajë gjendjen e shpirtit të njeriut pas vdekjes. Shtegtimet nëpër rrugë të llahtarshme, me plot vajtime, dhimbje, pendime, dyshime e gëzime, përfshijnë një botë me njerëz të të gjitha kohërave dhe të të gjitha shtresave.

Përzierja në politikë, Dante aktiv për fatet e kombit

Pjesëmarrja aktive në jetën shoqërore e politike të Firences i siguroi Dantes karrierë të shpejtë e të ndritshme, por ndoshta edhe goditjen më të madhe e më të dhimbshme të jetës së tij. Por ai nuk u përkul asnjëherë, përkundrazi qëndroi:...I drejtë në këmbë, si një kala që e rrahin gjithkrah erërat e nuk tundet (“Purgatori”. Kënga V, vargjet 14-15)

Udhëtimi imagjinar

Në moshën 35 vjeçare, në mbrëmjen e 24 marsit të vitit 1300, poeti humb në një pyll të errët. Aty shfaqet hija e Virgjilit, e poetit të madh latin, dërguar prej qiellit nga Beatricja; ai e shpëtoi nëpërmjet një shtegu ku s’kalonte këmba e njeriut të gjallë. Të dy poetët, Danteja dhe Virgjili, zbresin në Ferr, ku në 9 rrathë dënohen mëkatarët. Fajet në Ferr Dantja i ndan sipas teorisë së Aristotelit, ku njeriu mëkaton nga shfrenimi (grykësia, koprracia etj), që për poetin janë më të lehta; pastaj nga shpirtligësia (dhuna, tradhtia), për të cilat poeti i jep

dënimet më të rënda. Këtu i shohim të gjithë mëkatarët si e vuajnë dënimin e tyre. Dhe, së fundi, si përfundim i lumtur i këtij udhëtimi mahnitës, ashtu siç ndodh pas një ëndrrë të vështirë, hipur mbi një qerre triumfi, vjen Beatricja dhe e shpie fluturimthi në qiejt e Parajsës, nëpër 9 qiejt danteskë, ku sundon drita e përjetshme.

Komedia e Dantes, planet shumëkuptimore

Komedia mund të lexohet në rrafshe të ndryshme kuptimore. Dante vetë thotë se vepra e tij ka më shumë se një domethënie. Është vështirë ta ritregojmë me disa fjalë subjektin e tërësishëm të Komedisë: në fakt, temat janë të ndryshme dhe ndërrojnë shumë herë. Elementet bashkuese janë prania e përhershme dhe e qëndrueshme e disa protagonistëve dhe tema e udhëtimit, i cili mund të shihet po ashtu si një ndryshim moral e fetar i personazheve. Danteja vepron si një profet që flet në interes të Zotit për gjithë njerëzimin. Udhëtimi i tij është një alegori për përparimin njerëzor në tokë dhe i progresit të tij drejt Zotit. Aligieri e kërkon shpëtimin te Perëndia dhe te besimi i thellë në forcën krijuese të mendjes njerëzore.

Poeti paraqitet si një kritikues i pamëshirshëm, i zjarrtë dhe i pasionuar që sulet kundër veseve, për të luftuar të keqen, për të vendosur mbi tokë një jetë më të drejtë e më të lumtur.

IBRAHIM RUGOVA KULTIVUES I MODERNITETIT

Shkrimet e para në letërsi Ibrahim Rugova i filloi me poezi, ashtu siç veprojnë pothuaj gjithë shkrimtarët, kur fillojnë të merren me letërsi. Ai botoi nja njëzet poezi, të cilat ishin në nivelin e poezive që botoheshin në atë kohë. Por shumë shpejt e braktisi këtë gjini për t’iu kushtuar studimit të letërsisë, veçmas kritikës letrare.

Madje qysh në përmbledhjen e tij të parë të shkrimeve në këtë lëmi, në atë “Prekje lirike”, 1971, dëshmoi për një prirje drejt letërsisë së avancuar perëndimore duke iu shmangur asaj të realizmit socialist, që kishte përfshi një pjesë të letërsisë së kampit të ashtuquajtur socialist, trevë kjo së cilës i takonte edhe

Shqipëria, por edhe Kosova si pjesë përbërëse e Jugosllavisë së atëhershme.

Punimet e këtij libri së pari u botuan në të përkohshmen “Fjala” me mbititull “Zenite letrare”, ku shihej orientimi i tij që të merrej me kulmet e letërsisë, kryesisht asaj botërore.

Në këtë kontekst duhen shikuar edhe përpjekjet e këtij krijuesi që të lirohet nga dogmat e realizmit socialist, që e kishin kapluar letërsinë që krijohej në atë kohë, veçmas atë që krijohej në Shqipëri e që në njëfarë mënyre ndikonte edhe në krijimtarinë letrare, që krijohej në trojet e ish- Jugosllavisë, ku jetonin dhe vepronin shqiptarët.

Është thënë dhe shkruar se Ibrahim Rugova ishte ndër të parët që e kundërshtoi këtë drejtim letrar me shkrimet e tij të botuara në shtypin e kohës.

Në të vërtetë, që në shkrimet e botuara në librin e tij paralajmëronte orientimin e tij, që synonte nga kulmet e letërsisë botërore, të asaj pjesë më progresive të kësaj letërsie.

Këtë orientim të tij ai do ta përsosë pas qëndrimit disa muajsh në Paris të Francës. Madje mund të thuhet lirisht se krijimtaria e tij lidhet me modernitetin në kulturën shqiptare, me modernitetin e kritikës letrare dhe shkencore, jo vetëm të asaj që krijohej në trojet e ish - Jugosllavisë, ku jetonin shqiptarët, por në të gjitha vendet ku flitet e shkruhet shqipja.

Në këtë mënyrë veprat e tij bëhen fanar që ndriçojnë aspekte të ndryshme të letërsisë, shikuar nga aspekte që deri më atëherë nuk ishin kultivuar në letrat shqipe.

Në ndërkohë Ibrahim Rugova botoi edhe veprat e tjera “Kah teoria”, 1971, “Strategjia e kuptimit”, 1980, “Vepra e Bogdanit, 1675-1685” , 1982, “Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504-1983”, 1983, “Refuzimi estetik”, 1987 dhe është bashkautor i dy veprave të tjera: “Kritika letrare” (bashkë me Sabri Hamitin), 1979, si dhe “Bibliografia e kritikës letrare shqiptare, “44-‘74” (bashkë me Isak Shemën) 1976.

Shtëpia botuese “Faik Konica” e Prishtinës e botoi kompletin e veprave të tij për të dëshmuar kështu vlerat e pakontestueshme të krijimtarisë së tij, që nuk e kanë humbur aktualitetin as sot e kësaj dite. Në të gjitha këto vepra hetohet mprehtësia e tij për t’i kapë gjërat, për të shqyrtuar me mjeshtri dhe aftësi të rrallë çështje që i shtrën në këto punime. Në të gjitha këto vepra duket qartë prirja e tij për të ndriçuar sa më mirë çështjet për të cilat shkruan, duke i qëndruar besnik orientimit të tij primar, që veprën ta analizojë nga aspekte e artit dhe të rolit të saj në zhvillimin e dijes.

Ibrahim Rugova ka bërë zgjedhjen dhe përgatitjen për shtyp të vjershave të zgjedhura të poetëve bashkëkohorë, si Din Mehmeti, Ali Podrimja, Beqir Musliu etj, të cilat i shoqëronte me parathënie, që në

realitet janë analiza të thukta të vlerave të këtyre veprave.

Dy janë veprat më të çmuara të këtij krijuesi e që më duket se janë kryeveprat e Ibrahim Rugovës : “Vepra e Bogdanit 1675-1685” dhe “Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504-1983”.

Në të parën ai do merret me studimin e gjithanshëm të veprës së këtij humanisti dhe shkrimtari, në të dytën Rugova do të merret me rrugët e zhvillimit të kritikës letrare në letërsinë shqipe.

Sipas tij, mendimi kritik për veprat e artit të fjalës së shkruar në letrat shqipe është shumë i hershëm, madje ai zë fill me paraqitjen e shkrimeve të para të shkrimtarëve shqiptarë.

Kështu, për shembull, ai ka shkruar edhe këta rreshta: “Po ashtu në vijën e humanizmit kemi edhe poetin dhe filozofin Mikel Maruli (1453-1500), i cili shkruante poezi në frymën e elegjive të Katulit dhe bënte interpretimin poetik të botës sipas Lukrecit.

Më 1497 botonte dy vepra të njohura “Epigrame” dhe “Himnet e natyrës”, si dhe la në dorëshkrim veprën “Mbi edukimin princëror”. Duke vepruar kështu ai dëshmonte për përkushtimin e tij që të gjurmojë dhe të gjejë elemente të mendimit kritik për vepra letrare edhe në vende të tjera e ndër popuj të tjerë, që ishin të botuara më herët. Në vazhdim të këtij studimi Ibrahim Rugova do të përqëndrohet në vlerësimet që janë dhënë për

letërsinë dhe për veprat letrare në kohë dhe në hapësira të ndryshme.

Një vend të rëndësishëm në veprën e tij zë mendimi kritik i shkrimtarëve të Rilindjes kombëtare dhe kontributi i çmuar i shkrimtarëve të kësaj periode, të cilët kishin botuar vepra të shumta në poezi, prozë apo edhe gjini të tjera të krijimtarisë artistike, por që kishin dhënë edhe vlerësime për veprat e botuara, në mesin e të cilëve ai do të përmendë Jeronim De Radën, mandej Faik Konicën, të cilin e radhiste në mesin e kritikëve më të çmuar të mendimit estetik në letrat shqipe, i cili që në shkrimin e tij në “Kohëtoren e etrave shqipe” dëshmonte për një vetëdije të lartë për nevojën e kritikës letrare shqipe, si pjesë e letërsisë, të cilën edhe e ndihmon në zhvillimin e saj.

Mund të themi lirisht se Faik Konica çmohet si njëri ndër kritikët më të mprehtë dhe një ndër ata që i ndihmoi zhvillimit të mendimit kritik në letërsinë shqipe.

Në këtë vazhdë duhen përmendur edhe shumë bashkëkohanikë të Konicës, në mesin e të cilëve po përmendim Fan S. Nolin, i cili veprat e përkthyer nga gjuhët e ndryshme në shqip i shoqëroi me introdukte, andaj edhe kritikën e tij ai i quan kritika introduktore. Pa dyshim se këto interpretime të Nolit janë një thesar i çmuar në zhvillimi dhe rritjen mendimit kritik e estetik në letrat shqipe.

Si do që të jetë, konsolidimi i kritikës letrare shqipe fillon më mjaft vonesë. Ai nis të zhvillohet dhe të

kultivohet pas fillimit të botimit të shumë revistave letrare në gjuhën shqipe, qoftë në Shqipëri apo edhe në diasporë. Në këto gazeta e revista fillojnë të botojmë shkrimet e tyre shumë pena që më vonë do të bëhen të njohura, duke i ndihmuar kështu kultivimit të kritikës letrare si pjesë përbërëse e letërsisë.

Kjo ndodh në vitet '20 dhe të '30 të shekullit të kaluar kur edhe fillojnë të botohen revistat “Djalëria”, “Shqipëria e re”, “Minerva”, “Illyria”, “Hylli i Dritës” etj. Në faqet e tyre do të gjejmë shkrimet e Eqrem Çabejt, Justin Rrotës, Mitrush Kutelit, Krist Malokit, por edhe ato të Dhimitër Shuteriqit, Gjergj Fishtës e shumë e shumë emrave të njohur të letërsisë shqipe.

Një pjesë e mirë e studimeve të Ibrahim Rugovës i kushtohet kritikës bashkëkohore, veç asaj që u krijua në Shqipëri e veç asaj që u krijua në Kosovë, gjegjësisht në ish- Jugosllavi.

Autori i veprës në shqyrtim ka sjellë analiza të hollësishme për orientimet dhe vlerat e kritikëve bashkëkohorë, qofshin ata që punimet e veta i botuan në shtypin e Shqipërisë apo edhe të Kosovës, bashkë me orientimet e tyre në këtë lëmi të krijimtarisë.

Veprat e veta Ibrahim Rugova i ka përcjellë me aparaturë shkencore, duke cituar burimet e shfrytëzuara, ashtu siç ka vepruar edhe me numërimin e literaturës së shfrytëzuar, treguesin historik të termave, treguesin e emrave e të ngjajshme me këto.

Në dy veprat tjera, në njërën ai e ka botuar edhe listën e përmbledhjeve të poezive bashkë me vlerësimin e shkurtër për secilën veç e veç, kurse në tjetrën, në atë të fundit “Refuzimi estetik” i ka numëruar romanet e botuara nga viti 1949 deri në vitin 1986, pra vetëm një vit para botimit të veprës në fjalë. Të gjitha këto e bëjnë veprën e tij me vlera të larta jo vetëm estetike, por edhe shkencore.

Mesjeta shqiptare dhe mesjeta evropiane

Studimi i Ibrahim Rugovës, “Vepra e Bogdanit”, ku është studjuar në mënyrë integrale vepra e njërit ndër krijuesit më të mëdhenj të mesjetës shqiptare, Pjetër Bogdani, bën pjesë në ato arritje kulturore përgjithësisht, e shkencore veçanërisht, që pos të tjerash, ngjallin respekt edhe për objektin e studimit. Njeriut të kohës sonë, të kësaj ngutie e hutie sikur nuk i mbetet kohë të merret edhe me trashëgiminë kulturore, shkencore, filozofike dhe letrare të stërgjyshërve.

Kjo mund të jetë edhe pasojë e mentalitetit tonë se gjoja çdo gjë fillon me ne ose së paku ka arritur zhvillimin e lakmushëm me ne. Andaj, vështruar nga ky kënd, studimi i Ibrahim Rugovës hap dritare të reja të dijes, duke shpaluar në këtë mënyrë errësirën shekullore, sidomos të Mesjetës, ku edhe si faktografi, ende nuk dihet për gjithë thesarin e trashëgimisë sonë shpirtërore.

Më tutje, “Vepra e Bogdanit” heq, pos të tjerash, edhe napën e mosnjohjes së trashëgimisë, e që është burim dialektik i njohjes së drejtë edhe të së tashmes, që bën të mundur të gjenden rrugë për perspektivat e ardhmërisë. Studimi i Ibrahim Rugovës insiston me ngulm në këtë çështje.

Çështjet që ka bërë përpjekje t’i ngrejë në nivel interesimi e interpretimi, t’i analizojë e t’i zgjidhë janë çështje të mëdha, që dalin para studiuesit dhe në të njëjtën kohë janë edhe pjesë e trashëgimisë sonë shpirtërore, por edhe të mira shpirtërore, në fondin e arritjeve kulturore europiane.

Duke u marrë me veprën e Pjetër Bogdanit, autori i studimit ka hetuar vlerat madhore të saj në fusha e plane të ndryshme të dijes, të arritjeve të mendjes njerëzore.

Vepra e Bogdanit “Cuneus Prophetarum”, e botuar për herë të parë në vitin 1685, në Padovë, në shtypshkronjën e Kardinal Barbarigos, është dëshmia më e mirë e zhvillimit të artit, të shkencës e të filozofisë mesjetare shqiptare.

Duke e vështuar këtë çështje, autori ka hetuar pararendësit shqiptarë dhe pararendësit europianë, për të krijuar hallkat e kontinuitetit të këtij zhvillimi. Në planin european ky zhvillim është moshatar i mendjeve të ngritura të Dekartit, Mellbranshit, Spinozës, Paskalit. Në planin e zhvillimit nacional, është pjellë e arritjeve dhe e përpjekjeve të Barletit, Buzukut, Budit e Bardhit.

Në studimin “Vepra e Bogdanit” është ndjekur një metodologji e ngultë shkencore, që e ka kushtëzuar edhe objekti i studimit.

Të dhënat e shumta historiografike, që i ofrohen lexuesit të sotëm, mund të duket se e rëndojnë studimin, por kjo është e domosdoshme për veprat e lartësisë, sepse vetëm në këtë mënyrë arrihet ai kontinuitet i mundshëm ndërmjet nivelit që i ofron objektit, i cili shqyrtohet në nivelin e arritjeve të mendimit shkencor në kohën e sotme.

Studimi “Vepra e Bogdanit”, hiq “shtojcat”, ndahet në dy pjesë. Në pjesën e parë autori është marrë me gjenezën e veprës, kurse në pjesën e dytë me analitikën e veprës së Pjetër Bogdanit.

Këto ndarje kryesore i shqërojnë pastaj nëndarjet e shumta të mëpastajme, që theksojnë çështje të shumta të planeve të veprës. Në pjesën e parë janë trajtuar çështje që janë kushtëzuar nga rruga e mundimshme e deri te krijimi i veprës së parë origjinale kombëtare “Cuneus Prophetarum”.

Autorit të studimi i është dashur të merret edhe me çështjet e përkufizimit të letërsisë së vjetër shqipe, do të thotë me probleme të sistematizimit të letërsisë. Më tutje, me klasifikimin e zhanreve dhe të formave që janë zhvilluar brenda letërsisë së vjetër, edhe me biografinë e autorit, vepra e të cilit është bërë objekt studimi. Për të hetuar kohën e tij, rrethanat shoqërore dhe kulturore të asaj kohe, është marrë edhe me anë të tjera jashtë natyrës

së veprës, për të kompletuar kësisoj jo vetëm kërshërinë shkencore, por edhe kërkesën e opinionit kulturor të kohës sonë. Sepse, siç ka thënë Shekspiri, e që e ka cituar edhe autori, “t’i kthehemi të vjetrës (antikës) se do të jetë një progres”.

Më poshtë autori ka dhënë të gjashtë botimet që ka pasur vepra e Bogdanit duke filluar nga viti 1685 e deri më 1977. Deri sot dihet se me veprën e Bogdanit nuk janë marrë shumë njerëz, mendojmë në mënyrë studimore, edhe pse vepra nuk ka pushuar të jetë objekt i interesimeve të ndryshme që nga botimi, 1685, e deri në ditët tona. Vepër e veçantë që dihet deri sot mbi Bogdanin dhe veprën e tij është ajo e Matteto Sciambra me titull “Bogdanica” II, botuar në Bolonjë më 1965, ku janë dhënë shumë dokumente të reja për Bogdanin, ku analizon aspektin gjuhësor dhe aspektin filozofik të veprës së Bogdanit.

Mirëpo, si objekt i interesimeve të ndryshme, vepra e Bogdanit ishte përherë në qendër të vëmendjes. Sipas autorit të studimit “Vepra e Bogdanit”, ndër studjuesit e shumtë mund të veçohen disa prej tyre: Mark Harapi, i cili transkripton dhe e pajis me shënime pjesën e parë të Cunesit, të cilën e boton në Shkodër më 1940 - 43. Duhet përmendur pastaj kontributi i prof. Alberto Stratigonit, Anton Santorit, Zef Jubanit, Sami Frashërit, Faik Konicës, Gaetano Potrotta, Eqrem Çabejt, Justin Rrotës, Injac Zamputit, i studiuesit serb Radoniqit, ku janë me interes fotografia e pasur rreth Bogdanit dhe

familjës së tij. Studimi i Jovan Radoniqit, me sa duket, është rezultat i polemikës që pati me Çedomir Mijatoviqin rreth origjinës së Bogdanit dhe familjës së tij, të cilën Mijatoviqi bënte përpjekje ta nxirrte me origjinë serbe.

Në pjesën e e dytë janë trajtuar çështje të shumta që dalin nga struktura e veprës. Kjo strukturë, siç del nga studimi i Ibrahim Rugovës, nis që me organizimin e jashtëm e formal të veprës “Cuneus Prophetarum” (Çeta e Profetëve) e që i shëmbëllen organizimit të Bibiliotekës, duke shkuar deri te ndarja në shkallë e rrathë të veprës, për ta interpretuar, analizuar e vlerësuar pastaj veprën e Bogdanit.

Për të hetuar të gjitha këto aspekte të vlerave të veprës së Pjetër Bogdanit, autori ka përcaktuar drejt edhe shtrirjen brenda kontekstit kohor, kur është krijuar ajo. Ky kontekst ka dy kahe: Mesjetën europiane dhe traditën nacionale. Siç shihet, plani krahasues ka qenë i pashmangshëm, sepse ai ka bërë të mundshme që të kuptohet drejt, dhe jo vetëm çështja e krijimit të veprës, por edhe niveli shkencor, filozofik e artistik i saj. Këto dhe çështje të tjera, të analizuara e të interpretuara me njohuri nga Ibrahim Rugova, e bëjnë studimin e tij për ato vepra si themele e baza të studimit të trashëgimisë sonë shpirtërore.

Duke hulumtuar shtresimet e vlerave të veprës, autori ka trajtuar çështje të estetikës e të poetikës, të retorikës e të semiotikës, të semantikës e të poetikës, të

semantikës e të etikës. Të gjitha këto janë të shoqëruara me argumente të mbështetura, në radhë të parë në vlerat burimore që i ka ofruar Vepra e Bogdanit.

Në traditën e shkrimit dhe të botimit të Mesjetës, dihet se brenda botimeve të natyrave të ndryshme janë futur edhe shkrimet në poezi. Autori i studimit, poezinë që është botuar në Cuneus, e quan praktikë poetike. Në këtë rrafsh autori ka folur edhe për stilin, për figurat, kurse në tërësinë e veprës edhe për tipa të ligjeratës e që, sipas tij, janë dy: ligjërimi shkencor dhe ligjërimi artistik. Këto dhe plane të tjera të vështuara në veprën e Pjetër Bogdanit kanë bërë të mundshme shpalimin e këndeve të ndryshme të vlerave, që kanë kushtëzuar gjallërimin e saj nga Mesjeta deri në ditët tona.

Autorit të studimit, duke mos iu mbushur mendja se ka prekur të gjitha rrafshet e Cuneus-it, në fund sjell një ese. Me këtë vepër, autori ka bërë përpjekje ta shqyrtojë praninë kreative të veprës së Bogdanit në krijimtarinë e mëvonshme të krijuesve tanë. Këtë interesim e nis me De Radën e Naimin dhe vazhdon me Nolin dhe Lasgushin dhe vjen deri në ditët e vona me Sabri Hamitin e ndonjë tjetër. Edhe pse këtë prani e quan si një punë që duhet të hulumtohet, del fakti se madhështia e Veprës së Bogdanit, me praninë e saj nuk ishte fiktive, por kreative.

(Botuar në librin e autorit Engjël Koliqi "Dr. Ibrahim Rugova Arkitekti i Dardanisë se re - Republika e Kosovës", Botues "Rugova Art", Prishtinë, maj 2011, fq. 55- 60).

KRIST MALOKI, DIJETARI SHQIPTAR I GRAC-it

Dy fjalë për jetën

Profesor Krist Maloki lindi në Prizren më 1900. Mësimet fillore i mbaroi në vendlindje, pranë shkollës katolike të Prizrenit. Në moshën 12 vjeçare dërgohet me bursë për studime në Austri. Aty kreu shkollën e mesme dhe mori dy doktorata, të parën me 1929 në Filozofi dhe të dytën në Shkencat Juridike më 1934. Qe profesor i rregullt i Akademisë Tregtare të qytetit të Gracit dhe profesor pranë Universitetit të Gracit për letërsinë shqipe e ballkanike. Më 1966 qeveria austriake ia akordon titullin Oberstudienrat (kryekëshilltar arsimor). Vdiq në Nëntor 1973 në Grac të Austrisë. Ka lënë shumë dorëshkrime të pabotuara në shqip dhe gjermanisht. Të

gjitha studimet e tij janë shpërndarë nëpër revista dhe gazeta shqipe dhe të huaja. Gjithashtu ka lënë një bibliotekë të pasur me vlera albanologjike.

Krist Maloki ishte një studiues brilant i palëvizshëm nga cilësia. Në raport me shumë çfaqje të jetës shpirtërore shqiptare, ai shpalosi universin e tij duke dhënë qartë shembullin e një intelektualit të zhveshur nga miti. Replikat intelektuale me Mitrush Kutelin, për një problem të tillë kulturor, në është apo jo poet kombëtar Lasgush Poradeci, janë shprehje të spikatura të një niveli të lartë që kishte elita shqiptare në atë periudhë. Duke përjashtuar plotësisht keqkuptimin që mund të lindë nga mediokriteti i shumë njerëzve që bëhen skllëvër të opinioneve, duhet thënë, se ai debat, nuk kishte qëllim në vetvete që të denigronte lirikun shqiptar, të cilin në të vërtetë e nderonte edhe vetë, por për të diskutuar klasin e tij. Pavarësisht nga diversiteti, që kanë dhe nga subjektivizmi i opinioneve, ato debate të ftojnë të guxosh. Sigurisht që kritiku i Prizrenit mendonte më ndryshe nga dijetari shqiptar i Bukureshtit. Ky qëndrim nuk shprehej as për modë dhe as për cinizëm, por për arsye kërkesash, shijesh dhe pretendimesh të ndryshme.

Maloki ishte një njeri që ishte rritur dhe arsimuar kryesisht në Perëndim. Duke marrë kulturë të mirë gjermane, ai kishte krijuar parametrat e tij të lartë, për të konsideruar një poet kombëtar, pra kishte rezervat e tij për një Gëte apo një Dante shqiptar. Edhe sot,

përmenden aty-këtu në shtypin e Tiranës dhe Prishtinës, këto dy kritika, dhe kujtohet "çudia" e këtij njeriu.

Në aspektin biografik lidhja e tij me problemet kombëtare shqiptare dhe pjesëmarrja aktive në të është fenomenale. Kjo shfaqje e jetës së tij na konfirmon emrin e një njeriu idealist dhe formalisht, i ngjan jetës së një shqiptari të rëndësishëm të jetës tonë kombëtare që lindi dhe u rrit në Ibrik Tepe të Turqisë nga ku u edukua në shkollë të tjera, por shqipen e mësoi më mirë nga shumë intelektualë të tjerë të rritur në vendin e tyre. Shumica e njerëzve që e njohin jetën e Nolit mezi e dallojnë dhe shumë rrallë këtë gjë. Kjo ndodh sepse ky njeri me atdhedashurinë e tij të madhe, e bëri gati të padukshme këtë ndarje. Aq të forta ishin lidhjet me atdheun e tij, saqë pavarësisht nga ambienti, ku ai i drejtohej i frymëzuar, dukej sikur ishte një individ, që edhe tërë fëmijërinë e kishte nisur nga atdheu.

Afërsisht kështu ka ndodhur edhe me Malokin. Lindi në Prizren dhe u rrit, kur Kosova ishte e ndarë me atdheun amë, dhe për pasojë lidhjet kulturore, nuk ishin kaq të lira. U edukua, u arsimua dhe u punësua në Austri, por lidhjet me atdheun u bënë të forta, sikur mendimet e tij ishin ndjenja të atij realiteti. Sot na merr malli për njerëz të tillë, që botës së sotme shqiptare të xhepit dhe të interesit ku idealizmi zvarritet në honet e ethshme të fitimit, po i duken fare pak. Në tërë veprimtarinë e shkruar e të botuar prej tij në shtypin dhe revistat e kohës ndiejmë përpjekjet e fuqishme të një intelektual

oksidentalist të përcaktuar qartë. Por këtë orientim ai e sugjeronte vetëm duke kaluar nëpërmjet rrugës tradicionale.

Privilegji i të jetuarit në ambientin e huaj perëndimor i kishte dhënë qartësi peshe dhe mendimi, për ta predikuar më mirë nga shumë të tjerë kalimin nëpër këtë rrugë. Ana nga e cila ne duhet që të shkojmë është oksidenti, - thoshte ai. Por flamuri i veprimtarisë sonë kulturore është tradicionalizmi. Mbas atij flamuri duhet që të marshojmë. E dimë se tek disa të ashtuquajtur përparimtarë të rinj, ndoshta në moshë, por të plakur në shpirt, këto pohimet tona shkaktojnë buzëqeshje përbuzëse. Ne e përkrahim dhe duhet që ta ndjekim me të gjitha përmasat e veta përparimin në çdo degë të diturisë dhe të jetës, por tradicionalizmin duhet ta ruajmë me vetëdije të plotë si komb. Jemi të bindur se po deshtëm me rrue në botë si shqiptarë, duhet të vemë në themel të bashkëjetesës sonë kombëtare traditën. Merret vesh traditën e kuptueme dinamikisht, të rrahun në frymë të kohës, të pastrueme nga ndryshku i paragjykimeve, që s'kanë të bëjnë me palcën e thjeshtë të brumit tonë fisnor. Duem, që breznitë e ardhshme ta endin jetën e tyre me elementat ma bujarë të përvojës së Etënve të lashtë. Kush lakmon përtëritjen e shkëputun nga tradita, ai verbërisht përgatitet me marrë traditat e të huejit.

Problematikën specifike të shqiptarëve ai kishte arritur ta njihte mirë dhe në polemikat që bënte shpesh mbi këtë problem pranonte mundësinë e zgjidhjes së

tyre, madje i quante absolutisht të zgjidhshme. Por zgjidhjen e këtyre problemeve, si fillim e kuptonte, si ndryshim për së brendshmi, pra duke ndryshuar jetën shpirtërore, si oksidentalit i prezantuar qartë, ai besonte në bërjen e një Shqipërie të re, duke ndryshuar së pari mënyrën e të menduarit, të punuarit dhe të jetuarit oriental.

Tek gjendja jonë e varfër shpirtërore, që kemi, sundon e kaluara, - shkruante ai. - Qëndron kapadaillëku, dembelizmi, trishtimi, melankolia, myku bizantin, tek të cilat vegjetojnë plagët tona shoqërore dhe sociale. Në procesin e gjatë e të vështirë të analizës së problemeve të shumta shqiptare gjenden hijet e pushtimeve të huaja dhe fryma e keqe, që ato krijuan dhe na lanë si dhuratë. Këto pushtime jo rrallë vijnë pa krisma armësh, dhe gjëmimi, por me frymën e ndotur të kulturës së prapambetur që sjellin. Era e rëndë orientale, që ka filluar të fryjë që nga epoka byzantine, shpirtit të shqiptarit i ka bërë dëme të mëdha.

Sipas autorit, orientalizmi shqiptar ishte një sistem i të menduarit, të ndjeri, të sjelluri dhe të vepruari, dhe ka krijuar botëkuptimin dhe filozofinë e tij. Ashtu, siç dallohet e veçohet çdo filozofi dhe botëkuptim nga disa pikëpamje karakteristike ashtu dallohet dhe karakterizohet edhe orientalizmi shqiptar, nëpër disa shprehje syptomatike dhe jetëfilozofike.

Në pamfletin e famshëm "Oriental apo oksidental" botimi i të cilit në revistën "Hylli i Dritës"

më 1937 bëri bujë dhe krijoi efekte të drejtpërdrejta tek opinioni më i zhvilluar, ai u prezantua hapur si një njeri, që kishte vrojtuar me kujdes me sytë e tij të mëndjes, një dekadë të rëndësishme të jetës kombëtare dhe ndryshimin ndërmjet "Pleqve dhe të rinjve" e trajtonte nga një këndvështrim, që rrallëherë, rrallë kush e vlerësoi kështu. Sigurisht, që kishte edhe njerëz dhe mendimtarë të tjerë, siç ka edhe sot, që problemin e "Të rinjve dhe të vjetërve" e trajtojnë me pak ose aspak përjashtime, si gomari i Qerosit, për bishti dhe jo për kapistre.

Ky problem, nuk u vendos dhe nuk u trajtua, si duhet, siç bëri Krist Maloki, i cili e vendosi si një problem të rëndësishëm, kyç për të ardhmen, mbi baza të sigurta filozofike, sociologjike dhe historike. Ndërsa sot po ndodh e kundërta. Gati tek çdo autor qoftë "i vjetër" apo "i ri", shihen inate e interesa efemere, shtrime e lajkatime, mbrojtje përpara "një sulmi" të pa qenë, mungesë e koncentritimit rreth ndonjë interesi të përbashkët, dhe kësodore duke rrahur secili ujë në havan të vetë, çështjet mjegullohen dhe problemet pështhellohen, duke u transformuar në kaçamak turli-turli pikëpamjesh dhe duke mbetur si rrjedhim një shpirt pa caktim dhe pa drejtim.

Pas një vlerësimi këmbëngulës me arsyeime filozofike dhe referenca social-historike, problemin shqiptar ndërmjet "Pleqve" dhe të "Rinjve", autori ynë e gjen tek orientalizmi ynë, i cili e ka brejtur nga brenda

shpirtin e shqiptarit, duke ia shpërbërë fuqitë e tij kolektivo-kombëtare. Lufta ndërmjet "Pleqve" dhe të "Rinjve" nga mosha, ka për të vazhduar sipas ligjeve të amashuem (dasht zoti) deri në mbarimin e botës, - thotë autori. Por lufta më e rreptë, që priti brezin e ri shqiptar, është mbrapa portës dhe na pret të fillojmë, - vazhdon ai. Kjo luftë dallohet nga të tjerat, nga drejtimi që ajo ka kundra një armiku të padukshëm dhe të rrezikshëm për shpirtin e kombit. Lufta e ardhshme është lufta e djalërisë shqiptare kundra armikut të zemrës së vet, është lufta e një mendjeje krijuese kundra një mendje destruktive, është lufta e një botëkuptimi drite, kundra një botëkuptimi errësire, është lufta për oksidentalizmin shqiptar, kundra orientalizmit shqiptar.

Dy fronte armiqësore po e copëtojnë sot zemrën e kombit tonë. Është mirë, që t'i tregojmë brezit të ri, se ku gjenden skatolet dhe llogoret e kësaj lufte. Koha hapësinore vërtet, që ka ecur përpara, por nga pikëpamja shoqërore koha shqiptare ka mbetur në vend. Problemet shqiptare, po përsëriten, po koklaviten dhe po bëhen të pamundura, për t'u zgjidhur si dikur. Koha e edukatorëve të atëhershëm, si Gjergj Fishta, Branko Merxhani, Vangjel Koça, Krist Maloki, Tajar Zavalani, Anton Harapi etj., të cilët me kulturën e tyre të lartë dhe punën e madhe që bënë duke iu krijuar një edukatë të re qytetare publikut shqiptar, tolerancë dhe mirëkuptimi trullit politik shqiptarë, është zëvendësuar nga koha e

shigjetarëve dhe inatçorëve të mëdhenj, që luftojnë për interesa personale me njëri-tjetrin.

Çudibërësit e politikës së sotme shqiptare, të cilët janë pozicionuar në luftë me njëri-tjetrin dhe njëherësh me faqen e përgjithshme të shqiptarëve, me sa duket kanë shijuar vetëm atmosferën e shijeve dhe veseve të ndotura të orientalizmit dhe nuk e kanë ndjerë kurrë kthjelltësinë e kulturës perëndimore, të kësaj plejade mendimtarësh, në të cilën është i ndjeshëm edhe kontributi i Malokit.

ALEKSANDËR XHUVANI

Aleksandër Xhuvani është personalitet i shquar i gjuhës, arsimit dhe kulturës shqiptare. Aleksandër Xhuvani ishte veprimtar i denjë politiko-shoqëror dhe mbante titullin profesor, ndërsa kishte marrë dekoratën "Mësues i Popullit".

I pari në listën e familjes së njohur elbasanase, ai i hapi rrugë pinjollëve të tjerë të shquar, të dalë tashmë nga kjo familje.

Arsimimi

Profesor dr. Aleksandër Xhuvani u lind në Elbasan më 14 mars 1880. Mësimet e para fillore i mori në shkollën greke në qytetin e lindjes. Kishte mësues

Tush Pinën, që fshehtas u mësonte nxënësve edhe gjuhën shqipe. Mbaroi gjimnazin grek në Cotel të Maqedonisë dhe studimet e larta i kreu në Fakultetin e Filologjisë në Universitetin e Athinës në vitet 1902-1906. Që kur ishte nxënës e student nis të shkruajë për gjuhën shqipe.

Në gusht të vitit 1906 shkoi në Napoli dhe u njoh me Luigj Gurakuqin dhe Ismail Qemalin. Me ndihmën e tyre zuri punë në kolegjin arbëresh të Shën Adrianit. Këtu krahas punës nis veprimtarinë patriotike dhe studimore, shkruante në shtypin e kohës artikuj gjuhësorë, letrarë dhe artistikë, ndonjëherë edhe politikë. Ai njihet mirë me gjuhën arbëreshe.

Pas shpalljes së Kushtetutës së Perandorisë Osmane më 23 korrik 1908, problemi i organizimit të shkollës në gjuhën shqipe doli në plan të parë. Më 2-9 shtator 1909 u mbajt Kongresi i Elbasanit, i cili vendosi hapjen e shkollës Normale. Prof. Aleksandër Xhuvani u thirr si mësues në këtë shkollë. Në këtë kohë ai iu fut punës për hartimin e tekstit shkollor të gramatikës shqipe.

Shkolla Normale u mbyll pas ekspeditës ndëshkimore të Shefqet Turgut Pashës në verën e vitit 1910. Në këtë kohë, Xhuvani largohet për në Kajro, ku emërohet redaktor i gazetës “Shkreptima”. Gazeta mbyllet në vitin 1911 dhe A. Xhuvani shkon në

Aleksandri, ku emërohet si sekretar i shoqërisë “Vëllazëria”.

Kontributi

Aleksandër Xhuvani u kthye në Atdhe pas shpalljes së Pavarësisë dhe u emërua drejtor i Normales në vitet 1913-1914 dhe 1917-1920. Në vitin 1918 është iniciator i krijimit të shoqërisë kulturore-letrare “Qarku letrar i Elbasanit”.

Në verën e vitit 1920 ishte kryetar i Kongresit Arsimor të Lushnjës, që mori një sërë masash për organizimin e arsimit kombëtar dhe vendime për përcaktimin e terminologjisë shkollore. Gjatë viteve 1920-1922 punoi në Këshillin e Epërm Arsimor të Ministrisë së Arsimit. Kthehet drejtor i Normales në vitet 1922-1929.

Në vitet e luftës politike të viteve 1921-1924 merr pjesë aktive përkrah forcave demokratike. Në vitin 1929-1933 shkon sërish në Ministrinë e Arsimit dhe pas vitit 1933 deri në vitin 1938 ai drejton shkollën Normale të Elbasanit. Në këtë vit shkon sërish në Ministrinë e Arsimit, por për ndjenjat patriotike në vitin 1940 u nxor jashtë kuadrit, duke mbetur në dispozicion për një kohë të gjatë. Më tej kalon në Inspektorinë Qendrore, ku merret me përpilime tekstesh, shqyrtime dhe redaktime.

Angazhimi

Familja dhe vetë profesor Aleksandër Xhuvani e pritën me neveri pushtimin fashist. Ai përkrahu Luftën Antifashiste. Njëri nga djemtë, Ptoleme Xhuvani, ra heroikisht si dëshmor në korrik të vitit 1943. Vdekja e djalit e hidhëroi, por nuk e ndali profesorin në lëmin e kërkimeve dhe studimeve në fusha të ndryshme.

Menjëherë pas luftës u thirr në Ministrinë e Arsimit, ku nis nga puna për hartimin e teksteve dhe metodologjive të reja. Jo vetëm kaq, por u bë edhe anëtar i Komisionit Iniciator për formimin e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë. Nga janari i vitit 1947 deri në shtator 1953 punon si shef i Seksionit të Gjuhësisë dhe e të Letërsisë të Institutit të Shkencave. Këtu organizon jetën shkencore dhe dha ndihmesë të madhe në përgatitjen e kuadrove, sidomos në fushën e shkencave filologjike. Deri në vitin 1957 ishte anëtar i Presidiumit të këtij instituti. Në vitin 1953 zhvillohet Konferenca e Ortografisë, e cila kodifikoi drejtshkrimin e shqipes.

Në vitin 1954 nën kujdesin e profesor Xhuvanit u realizua hartimi i “Fjalorit të Gjuhës Shqipe”. Që më 1945 ai zgjidhet përfaqësues i popullit në Asamblenë Kushtetuese dhe më pas deputet në të gjitha legjislaturat e Kuvendit Popullor. Për disa vjet me radhë zgjidhet edhe si nënkryetar i Kuvendit Popullor.

Vdiq më 23 nëntor 1961.

Aleksandër Xhuvani, figurë poliedrike

Aleksandër Xhuvani nuk ishte thjesht studiues i një fushe të caktuar. Ai u shqua edhe në realitete të tjera shkencore.

Veç gjuhësisë dhe letërsisë ai shkëlqeu edhe në pedagogji, psikologji, histori, tekstologji, memorialistikë. Në të gjithë këto shkenca ai njihet si themeluesi i parë shkencor. Disa nga librat mësimore të profesor Xhuvanit përmenden, "Libri i Gjuhës dhe Gramatikës 1919-1920", "Njohuritë e para të Sintaksës Shqipe" për shkollat e larta të fillores, "Sintaksa Shqip" për shkollat e mesme botuar më 1931, "Fillimet e Pedagogjisë" për shkollat normale dhe mësuesit e filloreve 1933.

Bashkë me K. Cikon hartoi "Fillimet e Stilistikës" dhe të letërsisë së përgjithshme. Ai përshtati "Historinë e Letërsisë Greke" për kurset e larta të liceut për vitin 1941, përpiloi Antologjinë e klasës së tretë të shkollave të mesme, më 1946 botoi biografi letrare, artikuj për vepra të autorëve arbëreshë si Rondinella, Gavril Dara i Riu. Ai kreu analiza të hollësishme, përktheu dhe përshtati krijime letrare si Jeta e Pirros etj. Këtu duhen përmendur edhe dhjetëra artikuj në shtypin e kohës.

Fushë tjetër e rëndësishme ka qenë gjuhësia. Ai studioi dhe lëvroi Gjuhën Shqipe i frymëzuar nga rilindësit. Punoi për pasurimin dhe ngritjen lart të kësaj gjuhe, e aktualizoi atë, e praktikoi dhe e kulturoi shqipen e sotme. Në këtë drejtim, Xhuvani la një sërë studimesh, tekste, monografi, artikuj shkrime dhe recensione me vlerë.

Vepra gjuhësore e prof. Xhuvanit shquhet për qartësinë dhe vlerën shkencore.

Ai shkëlqeu në gramatikë, leksikologji, leksikografi, studim historik i shqipes në sintaksë etj.

Xhuvani i kushtoi kujdes bashkë me Çabein, fjalëformimeve të reja të shqipes.

Ai është një leksikograf i talentuar i shqipes.

Me një përkujdesjeje të veçantë realizoi ribotimin kritik të fjalorit Shqip-Greqisht të Kostandin Kristoforidhit, duke e bërë atë më të kuptueshëm dhe të lexueshëm për lexuesin. Studimi historik i shqipes, studimet etimologjike dhe gramatika historike mbajnë firmën e profesor Xhuvanit.

ASPEKTET POZITIVE E NEGATIVE TE PSIKOLOGUT FREUD

Është e gabuar të besosh se një shkencë konsiston vetëm në parashtrime të provuara përfundimisht, dhe është e padrejtë të kërkohet që të jetë medoemos kështu. Është një kërkesë e atyre që ndiejnë nevojën për autoritet dhe nevojën për të zëvendësuar katekizmin fetar me diçka tjetër, qoftë ajo edhe shkencore. Shkenca në katekizmin e saj ka pak parime apodiktike; ajo konsiston kryesisht në parashtrime, që i ka zhvilluar në shkallë të ndryshme probabiliteti. Aftësia për t'u kënaqur me këto përafërsime në vend të sigurisë dhe aftësia për të vazhduar punën konstruktive pavarësisht nga mungesa e konfirmimeve të fundme, janë në fakt tipare të prirjes shkencore të mendjes.

Historia e Frojdit, ashtu si e kujto tjetër, nis me të tjerët. Në rastin e tij, “të tjerët” ishin mentori dhe miku i tij, Dr. Joseph Breuer, dhe pacientja e tij, Ana O.

Ana O ishte paciente e Joseph Breuer nga 1880 deri në 1882. Ana 21 vjeçare kalonte pjesën më të madhe të kohës së saj duke u kujdesur për të atin që lëngonte. Ajo kishte një kollë të fortë, që dukej se s’kishte baza fizike.

Kishte zhvilluar vështirësi në të folur, më pas u kthye në memece dhe filloi të fliste vetëm anglisht, në vend të gjermanishtes së saj të zakonshme.

Kur i ati ndërroi jetë, filloi të refuzonte ushqimin dhe zhvilloi një tërësi problemesh të pazakonta. Humbi ndjesitë në duar dhe në këmbë, zhvilloi disa paraliza dhe filloi të kishte spazma të pavullnetshme.

Ajo kishte halucinacione pamore dhe të parët “tunel”.

Por kur u konsultuan specialistë të fushës, nuk u zbuluan shkaqe fizike të këtyre problemeve.

Sikur të mos mjaftonte kjo, ajo kishte fantazira përrallash, luhatje dramatike të humorit dhe kreu disa përpjekje vetëvrasjeje.

Diagnoza e Breuer-it ishte që ajo vuante nga ajo çka quhej atëherë histeri (sot çrregullim i konversionit), çka do të thoshte se kishte simptoma që dukeshin si fizike, por që s’ishin të tilla.

Mbrëmjeve, Ana zhytej në gjendje që Breuer-i i quante “hipnoza spontane”, apo që vetë Ana i quante “re”.

Breuer zbuloi se, gjatë këtyre gjendjeve transi, ajo arrinte të shpjegonte fantazirat që i shfaqeshin gjatë ditës dhe përvoja të tjera, dhe, më pas, ndjehej më mirë. Ana i quante këto episode “pastrim oxhaku” apo “të folur shërues”.

Ndonjëherë gjatë “pastrimit të oxhakut” thirrej në kujtesë ndonjë ngjarje emocionale, që i jepte kuptim një simptome të veçantë. Shembulli i parë ishte kur kishte refuzuar të pinte ujë për ca kohë: ajo mbante mend se kishte parë një grua të pinte nga një gotë ku më parë kishte pirë qeni. Ndërsa e sillte këtë gjë në kujtesë, ajo përjetoi ndjenja të forta neverie... dhe, më pas piu pak ujë!

Me fjalë të tjera, simptoma e saj, shmangia e ujit, u zhduk menjëherë sapo solli ndërmend ngjarjen që e shkaktoi, dhe përjetoi një emocion të fortë që është normal për ngjarjen në fjalë. Breuer e quajti këtë katharsis, nga greqishtja “pastrim”.

Ishte 11 vjet më vonë kur Breuer dhe ndihmësi i tij, Zigmund Frojdi, shkruan një libër për histerinë. Në të, ata shpjeguan teorinë e tyre: çdo histeri është rezultat i një përvoje traumatike, e cila nuk mund të bëhet pjesë e të kuptuarit të personit për botën.

Emocionet që lidhen me traumën nuk shprehen në mënyrë të drejtpërdrejtë, por as nuk zhduken vetvetiu:

njerëzit e shprehin vetveten me anë të sjelljeve që, në një mënyrë të dobët, të mjegullt janë një reagim ndaj traumës. Me pak fjalë, këto simptoma janë kuptimplote. Kur klienti bëhet i ndërgjegjshëm për kuptimin e simptomave të tij ose të saj (nëpërmjet hipnozës p.sh.) atëherë emocionet e pashprehura çlirohen dhe kështu nuk është nevoja që ta shprehin me vetveten në formën e simptomave.

Është analoge me çarjen e çibanit dhe tharjen e infeksionit.

Kështu, Ana po çlirohej me radhë nga simptomat. Megjithatë duhet thënë se ajo kishte nevojë për Breuer-in që të arrinte këtë: sa herë që ishte në gjendje hipnotike, përpara se të fliste duhej të ndjente duart e tij për t'u siguruar se ishte ai! Dhe, për fat të keq, filluan të lindin probleme të reja.

Sipas Frojdit, Breuer e kishte kuptuar se ajo kishte rënë në dashuri me të, dhe se ai po binte në dashuri me Anën. Për më tepër, ajo po hapte fjalën gjithandej se ishte shtatzanë me fëmijën e tij. Mund të thuhet se ajo e donte kaq fort një fëmijë, sa që mendja i tha trupit të saj se ishte e vërtetë, dhe zhvilloi një shtatzani hysterike.

Breuer, si burrë i martuar dhe në një epokë viktoriane i ndërpreu menjëherë sesionet me të dhe humbi çdo interes mbi hysterinë. Ishte Frojdi që, më vonë, do të bënte të ditur atë që Breuer nuk e shpalli

publikisht: që dëshirat e fshehta seksuale janë në themel të çdo neuroze hysterike.

Për ta mbyllur historinë e Anës: ajo kaloi kohë në sanatorium. Më vonë u bë një figurë e respektuar dhe aktive, si punonjësja sociale e parë në Gjermani, nën emrin e saj të vërtetë, Bertha Pappenheim. Vdiq në 1936. Ajo do të kujtohet, jo vetëm për arritjet e saj, por edhe për frymëzimin që i dha teorisë më ndikuese të personalitetit që kemi patur ndonjëherë.

Biografia

Zigmund Frojd lindi në 6 maj 1856, në qytetin e vogël, Fraiberg, në Moravia.

I ati ishte tregtar me një mendje të mprehtë dhe një sens të fortë humori. E ëma ishte një grua e gjallë, grua e dytë e të shoqit dhe 20 vjet më e re se ai. Ajo ishte 21 vjeç kur lindi djalin e saj të parë dhe të zemrës, Zigmundin. Zigmundi kishte dy vëllezër më të mëdhenj nga ana e të atit, dhe gjashtë vëllezër e motra të tjerë më të vegjël.

Kur ishte katër apo pesë vjeç, s'ishte shumë i sigurtë se sa, familja u transferua në Vienë, ku jetoi pjesën më të madhe të jetës së tij.

Një fëmijë i shkëlqyer, gjithnjë i pari i klasës, ai shkoi në shkollën mjekësore, një nga opsionet më të mundshme për një djalë të mençur hebre në Vienën e atyre kohëve.

Atje, ai u përfshi në kërkime nën udhëheqjen e profesorit të fiziologjisë Ernst Brücke. Brücke besonte në atë që atëherë ishte një nocion i njohur, në mos radikal, të cilin sot e quajmë reduksionizëm:

“Asnjë forcë tjetër nuk është aktive në organizëm, përveç forcave fizike e kimike.”

Frojdi do të kalonte vite duke u përpjekur që ta “reduktonte” personalitetin në neurologji, kauzë që më vonë do ta braktiste. Ai ishte shumë i mirë në kërkimet e tij, duke u përqëndruar në neurofiziologji, madje shpiku një teknikë të veçantë të ngjyrosjes së qelizës. Por aty kishte vetëm një numër të kufizuar vendesh pune dhe të tjerë mbanin radhën para tij. Brücke i dha dorë të merrte një bursë studimi, si fillim me psikiatrin e madh Charcot në Paris, dhe më vonë me rivalin Bernheim në Nancy. Të dy këta zotërinj po studionin përdorimin e hipnozës në trajtimin e histerikëve.

Pas një kohe të shkurtër si rezident në neurologji dhe drejtor i një strehëze për fëmijë në Berlin, ai u kthye në Vienë, u martua me të fejuarën e tij prej disa vjetësh Marta Bernays dhe krijoi një praktikë në neuropsikiatri, me ndihmën e Joseph Breuer.

Librat dhe leksionet e Frojdit i sollën atij edhe famë, edhe shkëputje nga radhët e bashkësisë mjekësore.

Ai tërhoqi rreth vetes një numër simpatizuesish shumë të mprehtë, të cilët u bënë edhe bërthama e lëvizjes psikoanalitike. Për fat të keq, Frojdi kishte prirje të largonte njerëzit që nuk binin dakord me të. Disa u

ndanë me të miqësisht, disa të tjerë jo dhe vazhduan rrugën e tyre për të themeluar shkolla të tjera.

Frojdi emigroi në Angli para Luftës së Dytë Botërore, kur Viena filloi të bëhej një vend i rrezikshëm për hebrenjtë, sidomos për ata të famshëm si Frojdi. Jo shumë vonë pas kësaj, ai vdiq nga kanceri në gojë dhe mjekër, nga i cili kishte vuajtur 20 vjetët e fundit të jetës së tij.

Teoria

Për të qenë të saktë, nuk ishte Frojdi ai që e shpiku idenë e vetëdijes kundrejt pavetëdijes, por ai ishte përgjegjësi kryesor për përhapjen e saj.

Mendja e vetëdijshme është ajo për të cilën ju jeni të ndërgjegjshëm në çdo çast të dhënë, perceptimet, kujtimet, mendimet, fantazirat, ndjenjat e përjetuara në të tashmen. Të jesh i lidhur ngushtë me mendjen e vetëdijshme është ajo pjesë që Frojdi e quante paravetëdije, të cilën sot e quajmë “kujtesa e përdorshme”: çdo gjë në të mund të kthehet lehtësisht në vetëdije, kujtime që nuk i sjell ndërmend për momentin, por që mund t’i sjellësh lehtësisht në kujtesë. Askush s’ka probleme me këto dy shtresa të mendjes.

Por Frojdi sugjeroi se këto janë pjesët më të vogla të saj!

Pjesa më e madhe është pavetëdija.

Ajo përfshin të gjitha gjërat që nuk sillen lehtësisht në ndërgjegje, përfshirë këtu shumë gjëra që kanë origjinat e tyre aty, si për shembull motivet apo instiktet tona dhe gjërat që kanë zënë vend aty, pasi ne s'e kemi të lehtë t'i shohim, si për shembull kujtime apo emocione të lidhura me traumën.

Sipas Frojdit, pavetëdija është burimi i motivacioneve tona, qofshin ato dëshira të thjeshta për ushqim apo seks, kompulsione neurotike apo motive për një artist apo shkencëtar. Megjithatë, ne shpesh priremi të mohojmë ose t'i rezistojmë vetëdijësimit ndaj këtyre motiveve dhe shpesh ato na bëhen të përdorshme vetëm në mënyrë të kamufluar.

Do t'i kthehemi sërish kësaj.

Idi, ego dhe superego

Realiteti psikologjik frojdian fillon me botën e mbushur me objekte. Midis tyre ndodhet edhe një objekt i veçantë, organizmi. Organizmi është i veçantë pasi vepron në mënyrë të tillë që të mbijetojë dhe të riprodhohet dhe udhëhiqet drejt këtyre qëllimeve nëpërmjet nevojave të tij, urisë, etjes, shmangies së dhimbjes dhe seksit.

Një pjesë shumë e rëndësishme e organizmit është sistemi nervor, i cili ka si karakteristikë të vet ndjeshmërinë ndaj këtyre nevojave të organizmit.

Në lindje, ky sistem nervor është thajse i njëjtë me atë të çdo kafshe tjetër, është një “diçka” ose një id. Sistemi nervor, si një id, i shndërron nevojat e organizmit në forca motivuese të quajtura në gjermanisht Triebe, çka është përkthyer si instikte apo impulse. Frojdi i quajti edhe dëshira. Ky shndërrim nga nevojë në dëshirë quhet edhe procesi parësor.

Idi vepron për t’iu përshtatur parimit të kënaqësisë, i cili mund të kuptohet si kërkesë për t’u kujdesur menjëherë për nevojat. Përfytyroni foshnjën e uritur, që ulërin me të madhe. Ai nuk e “di” çfarë dëshiron në kuptimin e të rriturve, ai thjesht di që e do dhe e do tani. Foshnja, në këndvështrimin e Frojdit është një id i pastër ose thajse i pastër. Dhe idi nuk është asgjë përveç përfaqësimit psikik të biologjisë.

Për fat të keq, edhe pse dëshira për ushqim, si për shembull imazhi i një bifteku të shijshëm, mund të jetë i mjaftueshëm për të kënaqur idin, ajo nuk është e mjaftueshme për të kënaqur organizmin. Nevoja vetëm bëhet gjithnjë e më e forte dhe dëshirat vazhdojnë të lindin. Duhet ta keni vënë re se, kur nuk keni kënaqur disa nevoja, si për shembull nevojën për të ngrënë, ajo fillon të zërë gjithnjë e më shumë vëmendjen tuaj, derisa vjen një pikë kur s’mendohet dot për gjë tjetër veç saj. Kjo është mënyra sesi nevoja apo impulsi pluskon në ndërgjegje.

Për fatin e mirë të organizmit, është një pjesë e vogël e mendjes për të cilën folëm më parë, vetëdija, që lidhet

me botën e jashtme me anë të shqisave. Përqark kësaj vetëdijeje, gjatë vitit të parë të jetës së fëmijës, pak nga “idi” kthehet në “unë”, në ego.

Ego lidh organizmin me realitetin me anë të ndërgjegjes që ka dhe kërkon objekte për të kënaqur dëshirat që krijon idi për të përfaqësuar nevojat e organizmit.

Ky aktivitet i zgjidhjes së problemit quhet proces dytësor.

Ego, ndryshe nga idi, funksionon sipas parimit të realitetit, i cili shprehet “kujdesu për nevojën, sapo të gjendet objekti i përshtatshëm.” Ajo përfaqëson realitetin dhe në një shkallë të konsiderueshme edhe arsyen.

Gjithsesi, ndërkohë që ego lufton për të bërë të lumtur idin (dhe, në fund të fundit, organizmin), ajo përballet me pengesat e botës. Ndonjëherë has objekte që e ndihmojnë në arritjen e qëllimeve të saj.

Dhe ajo i regjistron këto pengesa dhe lehtësira.

Në veçanti, ajo regjistron shpërblimet dhe ndëshkimet që bëjnë dy nga objektet më ndikuese në botën e fëmijës: mami dhe babi.

Regjistrimi i gjërave që duhen shmangur dhe strategjive që duhen përdorur kthehet në superego.

Kjo nuk përfundohet deri në moshën shtatëvjeçare. Në disa njerëz, nuk kompletohet kurrë.

Ka dy aspekte të superegos: njëri është ndërgjegja, që është brendësimi i shpërblimeve dhe

paralajmërimeve. Tjetri është egoja ideale. Ajo vjen nga shpërblimet dhe modelet pozitive që njeh fëmija.

Ndërgjegja dhe ego ideale komunikojnë kërkesat e tyre tek ego me ndjenja si krenaria, turpi dhe faji.

Është njësoj sikur në fëmijëri ne të kemi fituar një tërësi nevojash dhe dëshirash shoqëruese, kësaj radhe të një natyre shoqërore më shumë se biologjike. Për fat të keq, këto nevoja mund të përplasen lehtësisht me ato që vijnë nga idi. Siç e shihni, superego përfaqëson shoqërinë dhe shoqëria shpesh nuk dëshiron asgjë tjetër përveçse që dëshirat e tua të mos plotësohen fare!

Instiktet e jetës dhe instikti i vdekjes

Frojdi e pa të gjithë sjelljen njerëzore si të drejtuar prej impulseve ose instikeve, të cilat nga ana tjetër janë përfaqësime neurologjike të nevojave fizike. Në fillim, ai iu referua atyre si instikte të jetës. Këto instikte përjetësojnë (a) jetën e individit duke e motivuar atë të kërkojë ushqim dhe ujë, dhe (b) vazhdimësinë e llojit, duke e motivuar të bëjë seks. Energjinë motivacionale të këtyre instikteve të jetës, nxitjen që i jep fuqi psikikës sonë, ai e quajti libido, nga fjala latine “unë dëshiroj”.

Përvoja klinike e bëri Frojdin ta shihte seksin si shumë më të rëndësishëm sesa nevojat e tjera në dinamikën e psikikës. Në fund të fundit, ne jemi krijesa

shoqërore dhe seksi është nevoja më shoqërore e të gjithave. Plus kësaj, duhet të pranojmë se Frojdi kuptonte shumë më tepër se aktin seksual me fjalën seks! Gjithsesi, libido tani nënkupton jo çdo lloj impulsi, por atë seksual.

Më vonë, Frojdi filloi të besojë se instiktet e jetës nuk janë të vetmet. Libido është një gjë e gjallë; parimi i kënaqësisë na mban në një lëvizje të vazhdueshme. Dhe sërish, qëllimi i kësaj lëvizjeve është të vazhdosh të jesh, të kënaqesh, të jetosh në paqe, të mos kesh më nevoja. Qëllimi në jetë, ndoshta do të thoshit se është vetë vdekja! Frojdi filloi të besojë se “nën” ose “në krah” të instikteve të jetës ishte instikti i vdekjes. Ai filloi të besojë se çdo njeri ka një dëshirë të pavetëdijshme për të vdekur.

Kjo duket një ide e çuditshme kur e sheh në fillim, dhe në fakt u kundërshtua nga shumë studentë të tij, por unë mendoj se ka njëfarë baze në përvojë: jeta mund të jetë një proces i dhimbshëm dhe sfilitës. Për pjesën më të madhe të njerëzve në botë ka më shumë dhimbje sesa kënaqësi, dhe kjo është diçka që e kemi të vështirë ta pranojmë!

Vdekja premton çlirim nga beteja.

Frojdi iu referua parimit të nirvanës. Nirvana është një ide budiste, shpesh e përkthyer si parajsë, por që në fakt do të thotë “fikje”, njësoj si fikja e qiriut. Kjo nënkupton mosekzistencën, asgjënë, boshllëkun, që është qëllimi i të gjithë jetës në filozofinë budiste.

Faktet e përditshme të instiktit të vdekjes dhe parimit të nirvanas janë në dëshirën tonë për paqe, për t'u arratisur nga stimujt, tërheqjen tonë drejt alkoolit dhe drogave, dobësinë tonë për arratisjet, si p.sh. përhumbjen në libra dhe filma, dëshirën për të pushuar dhe për të fjetur. Ndonjëherë ato paraqiten hapur si vetëvrasje dhe dëshira vetëvrasjeje. Dhe siç teorizoi Frojdi, ndonjëherë ne e nxjerrim këtë jashtë vetes në formën e agresivitetit, mizorisë, vrasjeve dhe shkatërrimit.

Ankthi

Frojdi tha dikur “jeta s’është e lehtë!”

Ego – uni – qëndron në qendër të disa forcave mjaft të fuqishme: realitetit, shoqërisë që përfaqësohet nga superego; biologjisë së përfaqësuar nga idi. Kur kërkesat ndaj egos përplasen, është e kuptueshme që ajo, pra, ju të ndjeheni të kërcënuar, të vënë poshtë, të ndjeheni sikur t’ju shtyp një peshë e madhe. Kjo ndjenjë quhet ankth, dhe shërben si një sinjal i egos që mbijetesa e egos dhe me të edhe i gjithë organizmi, është në rrezik.

Frojdi përmendi tre lloje ankthi: i pari është ankthi real, që unë dhe ju do ta quanim frikë. Edhe Frojdi kështu e quajti në gjermanisht. Por përkthyesit e tij menduan se “frika” ishte fjalë tepër e rëndomtë! Gjithsesi, nëse do t’ju hidhja në një gropë me gjarpërinj helmues, ju do të përjetonit ankth real.

Lloji i dytë është ankthi moral. Kjo është ajo që ndjejmë kur na afrohet një kërcënim jo nga bota e jashtme fizike, por nga bota e brendësuar shoqërore e superegos. Në fakt, është një fjalë tjetër për të përshkruar ndjenja si turpi dhe faji dhe frika nga ndëshkimi.

Lloji i fundit është ankthi neurotik. Kjo është edhe frika e mposhtjes nga impulset e idit. Nëse jeni ndjerë ndonjëherë se “po rridhni”, po humbni kontrollin, temperamentin, arsyen, pra mendjen, atëherë keni ndjerë ankth neurotik. Neurotik është një fjalë latine për “nervoz”, pra është ankth nervoz. Është lloji i ankthit që e intrigoi më shumë Frojdin dhe shpesh ne e quajmë thjesht dhe qartë, ankth.

Mekanizmat mbrojtës

Ego merret me kërkesat e realitetit, idit dhe superegos në mënyrën më të mirë që mundet. Por kur ankthi e mposht, ego duhet të mbrohet. Ajo e bën këtë në mënyrë të pavetëdijshme, duke bllokuar impulse, apo duke i shndërruar ato në një formë më të pranueshme, më pak kërcënuese.

Teknikat quhen mekanizma të mbrojtjes së egos dhe Frojdi, vajza e tij Ana, dhe dishepuj të tjerë kanë zbuluar mjaft prej tyre.

Mohimi ka të bëjë me bllokimin e ngjarjeve të jashtme nga përvetësimi në vetëdije.

Nëse një situatë është e tepërt për t'u përballuar, personi thjesht refuzon ta përjetojë atë. Siç mund ta imagjinoni ky është një mekanizëm mbrojtës primitiv dhe i rrezikshëm: nuk i shpëton dot për shumë kohë realitetit! Ai mund të veprojë i vetëm, por më shpesh kombinohet me mekanizma të tjerë që e mbështesin.

Njëherë isha duke lexuar, ndërsa vajza ime pesëvjeçare po shihte një film vizatimor (Smërfat, më duket). Ajo po rrinte siç e kishte zakon, shumë pranë televizorit, kur filloi të jepej një reklamë. Mesa duket, në atë televizion nuk e kishte mendjen njeri në punë, pasi dhanë një reklamë për një film horror, me thika të përgjakura, maska dhe ulërima tmerri. Meqë s'arrita ta pengoja fëmijën tim për të parë një horror të tillë, bëra atë që do të bënte çdo baba psikolog: fola në lidhje me të. I thashë “Bobo, çfarë reklame e frikshme që ishte, hə.”

Ajo u kthye “Hë?” i them “Reklama... ishte e frikshme apo jo?” Ajo tha “çfarë reklame?”

Unë i them “Reklama që sapo u dha, me gjakun, maskën dhe ulërimën...!”

Mesa duket e kishte lënë jashtë vetes të gjithë gjënë.

Që atëherë, kam vënë re fëmijë të vegjël që në njëfarë mënyre mpihen kur përballen me gjëra që më mirë të mos përballeshin. Kam parë njerëz që u bie të fikët në autopsira, njerëz që mohojnë realitetin e vdekjes së një të

dashuri të tyre, dhe studentë që nuk shkojnë të marrin rezultatet e provimit. Ky është mohimi.

Ana Frojd përmendi edhe mohimin në fantazi: kjo ndodh kur fëmijët, në imagjinatat e tyre e transformojnë një baba “të keq” në një arush të dashur, ose një fëmijë të pafuqishëm në një superhero të fortë.

Represioni, që Ana Frojd e quajti edhe “harresa e motivuar” është pikërisht kjo: të mos jesh në gjendje të kujtosh një situatë, një person apo një ngjarje kërcënuese. Edhe kjo është e rrezikshme dhe është pjesë e mbrojtjeve të tjera.

Kur isha adoleshent, më zuri një frikë e madhe nga merimangat, sidomos ato me këmbë të gjata. Nuk e dija nga më erdhi, por kishte filluar të bëhej shumë shqetësuese në kohën që hyra në fakultet. Në fakultet, një këshillues më ndihmoi ta kaloja (me anë të një teknike që quhet desensitizim sistematik), megjithatë ende s’e dija nga më ishte krijuar. Vite më vonë, pashë një ëndërr, tepër të qartë, që tregonte se si kushëriri më kishte mbyllur në një kasolle prapa shtëpisë së gjyshërve të mi, kur isha shumë i vogël. Kasollja ishte e vogël, e errët dhe kishte një dysHEME të pisët të mbuluar me, e menduat saktë, merimanga me këmbë të gjata.

Kuptimi frojdian për këtë fobi është mjaft i thjeshtë: unë represova një ngjarje traumatike – incidentin me kasollen – por të parët e merimangave krijonte ankthin e asaj ngjarjeje pa krijuar kujtimet e ngjarjes.

Ka mjaft shembuj të tjerë. Ana Frojd na sjell një që na tërheq ashtu si gjërat antike: një vajzë e re, në faj për dëshirat e saj të forta seksuale, priret të harrojë emrin e të dashurit të saj, edhe atëherë kur përpiket ta prezantojë atë tek të afërmit! Ose një i alkoolizuar nuk e kujton tentativën e tij për vetëvrasje, duke deklaruar se duhet t'i jenë errur sytë. Ose dikush tjetër gati mbytet kur është ende fëmijë, por nuk e mban mend ngjarjen edhe kur të tjerët përpiqen t'ia kujtojnë, megjithatë ai vazhdon të ketë frikë nga deti i hapur!

Vini re, se që të jetë një shembull i vërtetë i mbrojtjes, duhet të funksionojë në mënyrë të pandërgjegjshme. Im vëlla kishte frikë nga qentë kur ishte fëmijë, por s'kishte lidhje me mbrojtjet: atë e kishte kafshuar qeni njëherë dhe nuk donte t'i përsëritej më diçka e tillë! Zakonisht, janë frikërat irracionale që i quajmë fobi ato që rrjedhin nga represioni i traumave. Asketicizmi, ose heqja dorë nga nevojat, për të cilën pjesa më e madhe e njerëzve s'kanë dëgjuar, por që ka dalë sërish në përdorim me lindjen e çrregullimit të quajtur anoreksi. Paradoleshentët, kur ndjehen të kërcënuar nga dëshirat e tyre seksuale në lindje, mund ta mbrojnë vetveten në mënyrë të pandërgjegjshme duke mohuar, jo vetëm dëshirat e tyre seksuale por çdo dëshirë. Ata përfshihen në një lloj stili jete asketik (si të murgjve) në të cilin ato mohojnë interesin e tyre për gjëra që njerëzit e tjerë parapëlqejnë.

Sot tek djemtë, ka një interes më të madh në vetëdisiplinën e arteve marcialle. Për fat të mirë, artet marcialle jo vetëm që s'të dëmtojnë (edhe aq), por në fakt të ndihmojnë. Për fat të keq, vajzat në shoqërinë tonë zhvillojnë shpesh një interes të madh në arritjen e një standardi bukurie në lidhje me trupin e hollë. Në teorinë frojdiane, mohimi i nevojave për ushqim është një mbulim i mohimit për zhvillimin e tyre seksual. Shoqëria jonë konspiron bashkë me ta: në fund të fundit, atë që shumë shoqëri e konsiderojnë një figurë normale për një grua të pjekur janë nja 10 kile mbipeshë!

Ana Frojd diskuton në lidhje me një version më të zbutur të këtij mekanizmi të quajtur kufizim i egos. Këtu, personi humbet interesin në disa aspekte të jetës dhe fokusohet në diçka tjetër, në mënyrë që të shmangë përballjen me realitetin. Një vajzë e vogël, që i është mohuar afeksioni nga objekti afektiv, mund të shmanget nga gjërat femërore dhe të kthehet në një “intelektuale jo seksuale” ose një djalë, i cili është i frikësuar se do të turpërohet në ndeshjen e futbollit mund të krijojë një interes të thellë në poezi.

Izolimi (shpesh i quajtur intelektualizim) ka të bëjë me shkëputjen e emocionit nga një kujtim i vështirë apo një impuls kërcënues. Një person, mund të flasë në një mënyrë shumë kavalieri se si është abuzuar në fëmijëri, ose mund të shfaqë një kuriozitet të pastër intelektual mbi orientimin seksual që ka zbuluar së

fundmi tek vetja. Diçka që duhet të jetë me shumë rëndësi, trajtohet sikur të mos ishte kështu.

Në situata emergjente, mjaft njerëz hiqen si tepër të qetë dhe të përmbajtur derisa emergjenca kalon, pikë në të cilën ata rrëzohen. Diçka të thotë se gjatë emergjencës, nuk mund t'ia lejojnë vetes të rrëzohesh. Është e zakonshme që të gjesh dikë totalisht të përfshirë në detyrimet shoqërore në lidhje me vdekjen e një të dashuri. Doktorët dhe infermieret duhet të mësojnë të ndajnë reagimet e tyre natyrale ndaj gjakut, plagëve, gjilpërave dhe të trajtojnë pacientin përkohësisht, si diçka më pak se një qenie e ngrohtë, e mrekullueshme njerëzore me miq dhe familje. Adoleshentët kalojnë një stad në të cilin janë të fiksuar pas filmave horror, ndoshta për t'u përballur me frikërat e tyre. Asgjë nuk e shfaq izolimin më qartë se një teatër plot me njerëz që qeshin me eufori ndërkohë që jepet një person që e bëjnë copash.

Zhvendosja është ridrejtimi i një impulsi tek një objekt zëvendësues. Nëse impulsi, dëshira është në rregull, por personi ku e drejton është kërcënues, ju mund ta zhvendosni tek një person ose diçka që shërben si zëvendësues simbolik.

Dikush që urren nënën mund ta represojë urrejtjen, por ta drejtojë atë tek gratë në përgjithësi. Dikush që nuk ka patur mundësinë të dojë dikë, mund ta zëvendësojë qenien njerëzore me mace apo qen. Dikush që ndjehet i sikletosur me dëshirën e tij seksuale për një

person real mund ta zëvendësojë atë me një fetish. Dikush që është i frustruar nga shefat e tij ose të saj mund të shkojë në shtëpi, të godasë qenin, të rrahë një antar familjeje ose të përfshihet në djegie të kryqit.

Kthimi kundër vetes është një formë shumë e veçantë e zhvendosjes, ku vetë personi bëhet objekti i zëvendësimit. Zakonisht përdoret në emocionet e urrejtjes, zemërimit dhe agresivitetit, më tepër sesa impulset pozitive, dhe është një shpjegim freudian për shumë nga ndjenjat tona të inferioritetit, fajit ose depresionit. Ideja se depresioni është rezultat i zemërimit që ne refuzojmë ta njohim pranohet nga shumë njerëz, freudianë dhe jo freudianë.

Njëherë e një kohë, kur nuk ndjehesha edhe aq mirë, vajza ime, rreth 5 vjeç, derdhi një gotë të tërë me qumësht me çokollatë në dhomën e ndenjes. I bërtita duke i thënë se ishte shumë e ngathët dhe se duhej të mësonte të ishte më e kujdesshme dhe se i kisha thenë njëqind herë... e kështu me radhë, e dini vetë ju. Ajo qëndroi atje e ngrirë me një lloj vështrimi përlotës në sy dhe, e goditi veten në kokë disa herë! Sigurisht, do të kishte rrahur kokën time, por, ja që s'bëhet kollaj kjo apo jo? S'ka nevojë ta them se që atëherë ndjehem në faj.

Projeksioni, të cilin Ana Freudi e quajti zhvendosje të jashtme, është thuajse e kundërta e kthimit kundër vetes. Ai ka të bëjë me prirjen për të parë dëshirat e papërshtatshme të vetes tek njerëz të tjerë. Me fjalë të tjera, dëshirat janë aty, por nuk janë më dëshirat e tua. E

pranoj se sa herë dëgjoj dikë që thotë se sa agresiv është dikush tjetër, apo sesa perversë janë, vras mendjen nëse ky person ka vetë prirje agresive apo seksuale në brendi të vetes, që më mirë të mos e pranonte.

Më lejoni t'ju jap disa shembuj: një bashkëshort, i mirë dhe i ndershëm, tërhiqet jashtëzakonisht nga një grua lozonjare. Por në vend që të njohë këtë epsh të vetin, ai fillon të bëhet tepër xheloz për të shoqen, duke u shqetësuar vazhdimisht për besnikërinë e saj e kështu me radhë. Apo një grua që ndjen se ka ndjenja të vagëta seksuale për shoqet e saj. Në vend që t'i njohë këto ndjenja si tepër normale, ajo fillon të shqetësohet gjithnjë e më shumë për praninë e lesbikeve në komunitetin e saj.

Dorëzimi altruist është një formë projeksioni që në pamje të parë duket si e kundërta: këtu personi përpiket të plotësojë nevojat e tij dukshëm nëpërmjet njerëzve të tjerë.

Një shembull i zakonshëm i kësaj është shoku/shoqja (të gjithë e kemi patur një të tillë) që edhe pse nuk kërkonte marrëdhënie për veten, vazhdimisht nxiste njerëzit e tjerë rreth e rrotull dhe ishte veçanërisht kurioz se “ç’ndodhi natën e kaluar” apo “si po shkojnë gjërat?” Shembulli i skajshëm i lëshimit altruist është personi që jeton të gjithë jetën e tij për dikë tjetër ose nëpërmjet një tjetri.

Formimi i reagimit, të cilin Ana Frojd e quajti “të besosh të kundërtën” e ndryshon një impuls të papranueshëm në të kundërtin e vet. Kështu një fëmijë i

inatosur me të ëmën, mund të kthehet në tepër i shqetësuar për të dhe të shfaqë në mënyrë dramatike afeksionin për të. Një fëmijë i abuzuar mund të vrapojë drejt prindit abuzues. Ose dikush që s'mund ta pranojë një impuls homoseksual, mund të deklarojë se ndjen neveri nga homoseksualët.

Ndoshta shembulli më i zakonshëm ose më i qartë i formimit të reagimit gjendet tek fëmijët midis moshës shtatë dhe njëmbëdhjetë: pjesa më e madhe e djemve do t'ju thonë sesa të neveritshme janë vajzat, dhe vajzat do t'ju thonë me po të njëjtën forcë sesa të pakëndshëm janë djemtë. Të rriturit që i shohin në marrëdhënie mes tyre, gjithsesi, mund të thonë me lehtësi se cilat janë ndjenjat e tyre të vërteta!

Zhbërja ka të bëjë me veprime apo rituale “magjike”, që bëhen për të fshirë mendime apo ndjenja të pakëndshme që kanë ndodhur. Ana Frojd përmend një shembull të një djali, i cili e recitonte alfabetin mbrapsht sa herë që kishte një mendim seksual, apo do të kthehej dhe do të pështynte sa herë që takonte një djalë tjetër që kishte të njëjtin pasion si ai në lidhje me masturbimin.

Tek njerëzit “normalë” zhbërja është sigurisht më e ndërjegjshme dhe ne mund të angazhohemi në një akt ndëshkimi për disa sjellje, ose kërkojmë falje zyrtarisht. Por në disa njerëz, akti i ndëshkimit nuk është aspak i vetëdijshëm. Sillni ndërmend një baba të alkoolizuar i cili pas një viti abuzimesh verbale dhe ndoshta edhe fizike, përpiqet me mish e me shpirt për të bërë

Krishtlindjet më të bukura për fëmijët e tij. Kur stina mbaron, dhe fëmijët s'janë gënjer akoma nga sjelljet e tij magjike, ai kthehet në banakierin e njohur me ankesa për familjen e tij mosmirënjohëse dhe për faktin sesi e detyrojnë të pijë.

Një nga shembujt klasikë të zhbërjes ka të bëjë me higjenën personale pas seksit: është mjaft e arsyeshme të lahesh pas seksit. Në fund të fundit, pasojat mund të jenë të tilla! Por nëse ndjeni nevojën për të bërë tre a katër dushe me sapun me kokrriza, ndoshta seksi s'bën për ju.

Introjeksioni, i quajtur identifikim, është bërja të tuat e karakteristikave të personalitetit të dikujt tjetër, pasi kështu zgjidh disa vështirësi emocionale.

Për shembull, një fëmijë që lihet vetëm vazhdimisht, mund të përpiqet të kthehet në “mama” për të zvogëluar frikërat e saj.

Mund t'i shohësh që u thonë kukullave apo kafshëve që të mos kenë frikë. Nga ana tjetër, shohim një fëmijë më të rritur ose një adoleshent që imiton heroin e tij të preferuar në muzikë ose në sport në përpjekje për të vendosur një identitet.

Një shembull më i zakonshëm është gruaja që jetonte afër gjyshërve të mi. I shoqi i saj kishte vdekur dhe ajo filloi të vishte rrobat e tij, edhe pse të rregulluara sipas masës së trupit të saj. Ajo filloi të përdorte sjelljen e tij si p.sh. të pinte me llullë. Edhe pse komshinjtë çuditeshin dhe e shihnin si “grua burrë”, ajo e dinte identitetin e saj seksual.

Në fakt, ajo u martua sërish, duke e ruajtur deri në fund veshjen dhe llullën e të shoqit!

Duhet të shtoj këtu që identifikimi është mjaft i rëndësishëm për teorinë frojdiane si mekanizmi me anë të të cilit ne zhvillojmë superegon.

Identifikimi me agresorin është një version i introjeksionit që fokusohet në adaptimin, jo të tipareve të përgjithshme ose pozitive, por të atyre negative dhe të frikësueshme. Nëse keni frikë nga dikush, mund të përballeni pjesërisht me frikën se do të ktheheni si ata. Dy nga vajzat e mia, duke u rritur me një mace tepër të egër, mund t'i shikoje shpesh tek mjaullisnin, kthisnin, pështynin ose ngrinin kurrizin përpjetë në përpjekje për të shmangur që macja të dilte nga ndonjë qoshe e errët dhe t'i sulmonte.

Një shembull më dramatik është ai i quajtur Sindroma e Stokholmit. Pas një pengmarrjeje në Stokholm, psikologët u çuditën kur zbuluan se pengjet jo vetëm që s'ishin të zemëruar me pengmarrësit, por shpesh ishin simpatizues ndaj tyre.

Një rast më i fundit kishte të bënte me një grua të quajtur Patty Hearst, e familjes së fuqishme dhe të pasur Hearst.

Ajo u kap nga një grup i vogël i revolucionarëve të vetëdeklaruar të quajtur ushtria çlirimtare simboneze. Ajo u mbajt në dollape, u përdhunua dhe u keqtrajtua në mënyra të ndryshme. Megjithatë, ajo vendosi të bashkohet me ta, duke bërë video propaganduese për ata

dhe duke tundur një armë në një vjedhje parash në bankë. Kur më vonë u hodh në gjyq, psikologët sugjeruan se ajo ishte viktimë dhe jo kriminele. Gjithsesi ajo u dënua për vjedhje banke me 7 vjet heqje lirie. Dënimi i saj u tërhoq nga presidenti Karter pas 2 vjetësh.

Regresioni është kthim pas në kohë psikologjike, kur dikush përballet me stres.

Kur ne jemi të shqetësuar apo të frikësuar, sjelljet tona shpesh bëhen më feminare ose primitive. Femija mund të fillojë të thithë gishtin sërish ose të lagë në shtrat, kur u duhet të kalojnë ca kohë në spital. Adoleshentët mund të jenë nervozë, kur të sillen në një situatë sociale ku ndodhet edhe seksi tjetër. Një student fakulteti mund të dojë të marrë me vete një lodër nga shtëpia. Një mbledhje e njerëzve të civilizuar mund të kthehet në një turmë të dhunshme, nëse i nxit të besojnë se mirëqenia e tyre vihet në rrezik. Ose një burrë më i vjetër, pasi ka kaluar 20 vjet në një kompani dhe tani e gjen veten të papunë, mund të zërë poltronën dhe të kthehet në një fëmijë të varur nga e shoqja.

Ku strehohemi kur ndeshemi me stres? Në periudhën më të afërt në jetë, kur jemi ndjerë të sigurtë dhe të shëndetshëm, sipas teorisë frojdiane.

Racionalizimi është shndërrimi mendor i “fakteve” për ta bërë një ngjarje apo një impuls më pak kërcënues. Ne e bëjmë këtë mjaft shpesh në nivel të vetëdijshëm, kur e shfajësojmë veten. Por për shumë njerëz me ego të ndjeshme, shfajësimi vjen kaq i

natyrshëm, saqë nuk jemi të vetëdijshëm për këtë gjë. Me fjalë të tjera, shumë prej nesh janë të përgatitur për të besuar në gënjeshttrat që ngremë vetë.

Një mënyrë e dobishme për të kuptuar mbrojtjet është t'i shohësh ato si një kombinim të mohimit apo represionit me lloje të ndryshme racionalizimesh.

Të gjitha mbrojtjet janë gënjeshtra edhe nëse nuk jemi të ndërgjegjshëm që i bëjmë. Por kjo nuk i bën më pak të rrezikshme, në fakt i bën më shumë. Siç mund t'ju ketë thënë gjyshja “Kjo botë është e gënjeshtërt...”. Gënjeshttrat ushqejnë gënjeshtra dhe na largojnë gjithnjë e më tepër nga e vërteta, nga realiteti. Pas pak kohe, ego nuk mund të kujdeset më për kërkesat e idit, apo t'i kushtojë vëmendje atyre të superegos. Ankthet kthehen mbrapsht dhe ju rrëzoheni.

Megjithatë Frojdi i pa mbrojtjet si të nevojshme. Nuk mund të presësh që një person, sidomos një fëmijë, të marrë në sy dhimbjen e jetës ashtu siç vjen! Ndërkohë që dishepujt e tij sugjeruan se të gjitha mbrojtjet mund të përdoren në mënyrë pozitive, Frojdi vetë sugjeroi se kishte vetëm një mbrojtje pozitive, të cilën e quajti sublimim.

Sublimimi është transformimi i një impulsi të papranueshëm, qoftë ai seks, zemërim, frikë apo çfarëdo në një formë më të pranueshme shoqërisht, madje edhe produktive. Kështu dikush me një ndjenjë të forte armiqësie mund të bëhet gjuetar, kasap, futbollist ose ushtarak. Dikush që vuan nga një ankth i tepërt mund të

kthehet në një organizues, tregtar, shkencëtar. Dikush me dëshira të forta seksuale mund të kthehet në artist, fotograf, shkrimtar e kështu me radhë.

Për Frojдин në fakt, të gjitha aktivitetet krijuese ishin sublimime dhe sidomos të impulsit seksual.

Stadeti

Siç e thashë më parë, për Frojдин impulsi seksual është forca më e rëndësishme motivuese. Në fakt, Frojdi mendoi se ajo ishte forca parësore motivuese jo vetëm për të rriturit, por edhe për të vegjlit, madje edhe foshnjët. Kur ai paraqiti seksualitetin foshnjor në publikun vinez të ditëve të tij, ky i fundit mezi ishte i përgatitur për të folur për seksualitetin tek të rriturit, jo më tek foshnjët!

Është e vërtetë se aftësia për orgazëm është e pranishme që nga lindja. Por Frojdi nuk e kishte fjalën vetëm për orgazmën. Seksualiteti nuk nënkuptonte vetëm aktin seksual, por të gjitha ndjesitë e kënaqësisë që vijnë nga lëkura. Është e qartë edhe për më të ngurtin mes nesh se bebet, fëmijët dhe padyshim të rriturit i pëlqejnë përvojat e prekjes si p.sh. perkëdheljet, puthjet e kështu me radhë.

Frojdi theksoi se në kohë të ndryshme të jetës sonë, pjesë të ndryshme të lëkurës na japin kënaqësi më të madhe. Teoricienët e mëvonshme do t'i quanin këto zona erogjene. Frojdit i dukej se foshnja e gjente

kënaqësinë e tij më të madhe në thithje, sidomos të gjoksit. Në fakt, bebet kanë një prirje për të çuar thuajse çdo gjë nga ambienti në gojë. Pak më vonë në jetë, fëmija fokusohet tek dëshirat anale të mbajtjes dhe të lëshimit. Nga mosha tre apo katër, fëmija mund të ketë zbuluar kënaqësinë e fërkimit apo prekjes së gjenitaleve të tij apo të saj. Vetëm më vonë, në pjekurinë tonë seksuale, ne gjejmë kënaqësinë më të madhe në aktin seksual. Në këto vëzhgime, Frojdi ngriti themelet e teorisë së stadeve psikoseksuale.

Stadi oral zgjat nga lindja deri në rreth 18 muaj. Fokusi i kënaqësisë është sigurisht goja. Thithja dhe kafshimi janë aktivitetet më të parapëlqyera.

Stadi anal zgjat nga 18 muaj deri në tre apo katër vjeç. Fokusi i kënaqësisë është anusi. Mbajtja dhe lëshimi i jashtëqitjes janë më të parapëlqyerat.

Stadi fallik zgjat nga tre apo katër deri në pesë, gjashtë apo shtatë vjeç. Fokusi i kënaqësisë janë gjenitalet. Masturbimi është i zakonshëm.

Stadi latent zgjat nga pesë, gjashtë apo shtatë vjeç deri në pubertet, pra, diku tek 12 vjeç. Gjatë këtij stadi, Frojdi besoi se impulsi seksual shtypej për t'i lënë vend të nxënit. Duhet të theksoj se edhe pse shumica e fëmijëve duken të qetë seksualisht gjatë viteve të gramatikës në shkollë, gati një e katërta e tyre masturbohen ose luajnë “doktorash”. Në epokën represive të Frojdit, këta fëmijë të paktën ishin më të qetë sesa homologët e tyre të kohëve moderne.

Stadi gjenital fillon në pubertet dhe përfaqëson rilindjen e impulsit seksual në adoleshencë dhe fokusimin specifik të kënaqësisë në aktin seksual.

Frojdi besonte se masturbimi, seksi oral, homoseksualiteti dhe shumë gjëra të tjera që ne i gjemë të pranueshme në moshën e rritur sot, ishin të papjekura.

Kjo është një teori stadesh, që do të thotë se frojdianët besojnë se të gjithë kalojmë përmes stadesh, në këtë rend, dhe afër këtyre moshave.

Kriza e Edipit

Çdo stad ka disa detyra të vështira të lidhura me të që ka të ngjarë të shkaktojnë probleme. Për stadin oral, është lënia e gjirit. Për stadin anal është trainimi i uturakut. Për stadin fallik, është kriza e Edipit, e emërtuar sipas historisë së vjetër greke të mbretit Edip, i cili pa e ditur vrau të atin dhe u martua me të ëmën.

Ja, se si funksionon kriza e Edipit: objekti i parë i dashurisë për të gjithë ne, është nëna. Ne duam vëmendjen e saj, duam afeksionin e saj, duam perkëdheljet e saj, duam atë, në një mënyrë gjerësisht seksuale. Djali i vogël, gjithsesi, ka një rival për tërheqjen ndaj të ëmës: babanë e tij! Babai është më i madh, më i fortë, më i zgjuar dhe fle me mamanë, ndërkohë që djali i vogël fle vetëm në krevatin e tij. Babai është armiku.

Në kohën kur djali i vogël e kupton këtë situatë arketipale, ai është vetëdijësuar për disa nga ndryshimet më të fshehta mes djemve dhe vajzave, përveç gjatësisë së flokëve dhe stileve në të veshur.

Nga këndvështrimi i tij naiv, ndryshimi është që ai ka penis, dhe vajzat jo. Në këtë pikë, fëmijës i duket se që të kesh diçka është shumë herë më mirë se të mos kesh asgjë kështu që ai është i kënaqur me gjendjen e tij.

Por ama lind pyetja: ku është penisit tek vajzat? Ndoshta ajo e ka humbur diku. Ndoshta i është prerë. Ndoshta kjo mund t'i ndodhë edhe atij! Ky është fillimi i ankthit të tredhjes, një emër tjetër i ndryshëm për frikën e humbjes së penisit.

Për t'iu kthyer historisë, djali duke e njohur superioritetin e të atit dhe duke patur frikë për penisin e tij, përfshihet në disa nga mbrojtjet e egos: ai e zhvendos impulsin seksual për të ëmën tek vajzat dhe më vonë tek gratë; identifikohet me agresorin, të atin, dhe përpiqet të bëhet gjithnjë e më shumë si ai, pra, si burrë.

Pas disa vjetësh latente, ai hyn në adoleshencë dhe në botën e heteroseksualitetit të pjekur.

Vajza e fillon gjithashtu jetën me dashurinë për të ëmën, kështu që është problem për ta parë se si i përcjell afeksionet e saj tek i ati para se të ndodhë procesi i Edipit.

Frojdi sugjeroi këtu idenë e zilisë së penisit: vajza e vogël e ka vënë re gjithashtu ndryshimin mes djemve dhe vajzave dhe ndjen se asaj i mungon diçka.

Ajo do të donte të kishte një të tillë së bashku me fuqitë që lidhen me të. Së paku, ajo do të donte të kishte një zëvendësues të penisit, si p.sh. një bebe. Siç e di çdo fëmijë, njeriu ka nevojë për një baba dhe për një nënë për të pasur një fëmijë, kështu që vajza e vogël i hedh sytë tek i ati.

Babai sigurisht është zënë nga dikush tjetër.

Vajza e vogël zhvendoset nga ai tek djemtë dhe burrat dhe identifikohet me të ëmën, gruan që mori burrin që ajo dëshironte.

Vini re se ka diçka që mungon këtu: vajza nuk vuan nga motivimi i fuqishëm i ankthit të tredhjes, meqë ajo nuk mund të humbë diçka që nuk e ka.

Frojdi mendoi se mungesa e një frike të tillë kishte të bënte me faktin (siç e pa ai) që gratë janë më pak të qëndrueshme në heteroseksualitetin e tyre si edhe më pak të orientuara nga morali.

Përpara se t'ju mbetet mendja në këtë konsideratë jo aq të gëzueshme mbi seksualitetin e grave, rrini të qetë, pasi shumë njerëz kanë reaguar ndaj kësaj. Do të flas më tepër për këtë në pjesën e diskutimit.

Karakteri

Përvojat tuaja me kalimin e viteve kontribuojnë tek personaliteti juaj, ose karakteri, kur jeni i rritur. Frojdi mendonte se përvojat traumatike kanë një efekt veçanërisht të fortë.

Sigurisht, çdo traumë e veçantë do të kishte impaktin e vet mbi personin, çka mund të zbulohet dhe kuptohet mbi baza individuale.

Por traumat e lidhura me zhvillimin në stade, meqë secili nga ne duhet t'i kalojë ato, duhet të kenë më shumë qëndrueshmëri.

Nëse keni vështirësi në ndonjë nga detyrat e lidhura me stadet, lënia e gjirit, trainimi i uturakut, apo zbulimi i identitetit seksual, ju do të prireni të ruani disa sjellje të caktuara fëminore ose foshnjore. Ky quhet fiksion. Fiksioni i jep çdo problemi në çdo stad një efekt afatgjatë në drejtim të personalitetit apo karakterit tonë.

Nëse në tetë muajt e parë të jetës frustroheni në nevojën tuaj për të thithur, ndoshta sepse nëna juaj nuk ndjehet rehat apo sepse është e ashpër me ju, apo përpiqet që ta lini gjirin shpejt, atëherë ju mund të krijoni një karakter oral-pasiv. Një personalitet oral-pasiv priret të jetë tepër i varur nga të tjerët. Ata kanë shpesh interes në “kënaqësitë orale” si të ngrënë, të pirë dhe pirja e duhanit. Është sikur ata të kërkojnë kënaqësitë që nuk arrijnë në foshnjëri.

Kur jemi midis pesë dhe tetë muajsh, fillojnë të dalin dhëmbët. Një gjë shumë e kënaqshme kur dalin dhëmbët është të kafshoni, si p.sh. thithkën e gjirit. Nëse kjo shkakton mërzi apo çon drejt lënies së shpejtë të gjirit, ju mund të zhvilloni një personalitet oral-agresiv. Këta njerëz ruajnë një dëshirë afatgjatë për të kafshuar gjërat si p.sh. lapsa, çumçakiza dhe njerëzit e tjerë. Ata

kanë një tendencë për të qenë verbalisht agresivë, sarkastikë e kështu me radhë.

Në stadin anal, ne mahnitemi nga “funksionet e trupit” tonë.

Si fillim, ne mund të shkojmë kurdo dhe kudo që duam. Më pas, ashtu si papritur dhe pa kuptim e kupton se ka forca jashtë teje që duan që ti t’i bësh gjërat në vende të caktuara dhe në kohë të caktuara. Dhe prindërit duket se e vlerësojnë produktin final të këtyre përpjekjeve!

Disa prindër e vënë veten në mëshirën e fëmijës në procesin e trainimit për në tualet. Ata luten, përgjërohen, shfaqin gëzim të madh, kur ata e bëjnë mire këtë gjë, ata sillen sikur u thyet zemra kur nuk e bëni këtë gjë. Fëmija është mbreti i shtëpisë dhe ai e di këtë. Ky fëmijë do të rritet dhe do të jetë një personalitet anal i jashtëm (ose anal agresiv). Këta njerëz priren të jenë të pakujdesëm, të çorganizuar, bujarë ndaj gabimeve. Ata mund të jenë mizorë, shkatërrues dhe të dhënë mbas vandalizmit dhe shkrimeve nëpër mure. Personazhi i Oskar Medisonit në Ciftin e Çuditshëm është një shembull i mirë.

Prindër të tjerë janë striktë. Ata mund të bëjnë gara me fqinjët ose të afërmit se kush do t’i trainojë fëmijët më parë për në tualet (trainimi i hershëm sipas mendjes së shumë njerëzve lidhet me inteligjencën e madhe). Ata mund të përdorin ndëshkimin ose poshtërimin.

Ky fëmijë ka të ngjarë të përjetojë konstipacion ndërkohë që përpiqet me dëshpërim ta mbajë atë në çdo kohë dhe do të rritet si një personalitet anal mbajtës. Ai ose ajo do të priret të jetë i pastër, perfeksionist, diktatorial, shumë kokëfortë dhe dorështrenguar. Me fjalë të tjera, një anal mbajtës është i shtrënguar në çdo drejtim. Personazhi i Feliks Unger tek Cifti i Cuditshëm është një shembull i përsosur.

Ka gjithashtu dy tipe personalitetesh falllike, edhe pse askush s’u ka dhënë emra. Nëse djali mohohet ashpër nga e ëma dhe ndjehet i kërcënuar nga babai i tij tepër mashkullor ka të ngjarë që ai të zhvillojë një vetëvlerësim të dobët mbi seksualitetin e tij. Ai mund ta kalojë këtë ose duke u tërhequr nga ndërveprimet heteroseksuale, ose duke u kthyer në një djalë librash, ose duke veshur një petk prej “macho”-je. Një vajzë e mohuar nga i ati dhe e kërcënuar nga nëna e saj tepër femërore ka të ngjarë të ndjehet e dobët në vetvete dhe të kthehet në një lule zbukuruese ose në një “bukuroshe” ekstremisht femërore.

Por nëse djali nuk mohohet nga e ëma, por parapëlqehet kundrejt babait të dobët dhe të squllur, ai mund të zhvillojë një opinion shumë të lartë për veten (çka mund ta bëjë të vuajë shumë kur të përplasat me jetën reale, ku askush nuk e do siç e do e ëma) dhe të shfaqet mjaft femëror. Në fund të fundit, s’ka shkak për t’u identifikuar me të atin. Po ashtu, nëse një vajzë është princesha e vogël e babit dhe shoqja e tij më e mire, dhe

mamaja lihet në një rol shërbyeseje, atëherë ajo mund të kthehet në një person sipërfaqësor dhe egoist, ose edhe mjaft mashkullore.

Këto personazhe të ndryshme falllike tregojnë një pikë të rëndësishme të karakterologjisë frojdiane: skajet çojnë drejt skajeve. Nëse frustrohesh ose perkëdhelesh, do të kesh probleme. Dhe edhe pse çdo problem priret të çojë në karakteristika të caktuara, këto karakteristika po aq kollaj mund të krijojnë të kundërtat e tyre.

Kështu një person anal mbajtës mund të bëhet papritur shumë bujar, ose mund të ketë pjesë të jetës në të cilat është tmerrësisht rrëmujë. Kjo është frustruese për shkencëtarët, por reflekton realitetin e personalitetit!

Terapia

Terapia e Frojdit ka qenë më ndikuese se cilado teori tjetër dhe më ndikuese edhe se pjesa më e madhe e teorisë së tij. Këtu jepen disa nga pikat kryesore të saj:

Atmosfera relaksuese. Klienti duhet të ndjehet i lirshëm për të shprehur çdo gjë. Situata e terapisë në fakt është një situatë e veçantë sociale, një situatë ku nuk duhet të ndjeheni i frikësuar nga gjykimi apo përjashtimi.

Në fakt, në terpinë frojdiane, terapisti thuajse zhduket. Për ta kompletuar skenën shtoni kolltukun relaksues, dritat e ulura, dhe muret e izoluara hermetikisht nga zhurmat.

Asosacioni i lirë. Klienti mund të flasë për pothuajse çdo gjë. Teoria nënkupton që me anë të relaksimit konfliktet e pavetëdijshme do të pluskojnë në sipërfaqe. Vihet re një ngjashmëri midis terapisë frojdiane dhe të parit të ëndrrave! Gjithsesi, në terapi është terapisti, i cili është i trainuar për të njohur disa nga elementet e problemeve dhe zgjidhjet që duhet të shohë klienti.

Rezistenca. Një nga këto elemente është rezistenca. Kur një klient përpiqet të ndryshojë çështje, hutohet krejtësisht, bie në gjumë, vjen vonë, apo s'vjen fare në takim, terapisti thotë “aha!” Këto rezistenca sugjerojnë se klienti është pranë diçkaje në asosacionet e tij të lira, që në mënyrë të pandërgjegjshme i sheh si kërcënuese.

Analiza e ëndrrave. Në gjumë ne jemi disi më pak rezistentë ndaj pavetëdijes dhe ne lejojmë pak gjëra të vijnë në vetëdijen tonë në formë simbolike. Këto dëshira nga idi i japin terapistit dhe klientit më shumë elemente. Shumë forma të terapisë e përdorin analizën e ëndrrave të klientit, por interpretimi frojidian dallon në atë që ka prirjen për të gjetur kuptime seksuale.

Lapsuset.

Paraprakset ose lapsuset quhen shpesh lapsuse frojdiane. Frojdi mendonte se ato janë elemente që të të çojnë tek konfliktet e pavetëdijes. Frojdi ishte i interesuar në shakatë që tregonin klientët e tij.

Në fakt, Frojdi mendonte se thuajse çdo gjë nënkuptonte diçka në thuajse çdo kohë – rënia e një

numri gabim, marrja e një kthese të gabuar, keqshqiptimi i një fjale, ishin objekte serioze të studimit të Frojdit. Gjithsesi, ai vetë reagoi ndaj pyetjes së studentit se çfarë simbolizonte puroja që tymoste gjithnjë, duke iu përgjigjur “ndonjëherë puroja është thjesht puro.” Kështu të jetë vallë?

Frojdianët e tjerë krijuan interes në testet e projektive si Rorschachu ose testet e njollave të bojës. Teoria pas këtyre testeve është se kur stimuli është i vagët, klienti e plotëson atë me temat e veta të pavetëdijshme.

Sërish, këto shërbejnë për t’i dhënë elemente terapistit.

Transferenca, katharsis, dhe insight

Transferenca shfaqet kur klienti projekton ndjenjat që i takojnë njerëzve të tjerë tek terapisti. Frojdi besonte se transferenca ishte e nevojshme në terapi për të sjellë emocionet e shtypura që e kanë rënduar klientin për shumë kohë, në sipërfaqe. Ju s’mund të ndjeheni vërtet i zemëruar për shembull pa patur një person real për t’u zemëruar. Marrëdhënia mes klientit dhe terapistit, në dallim nga ajo që besohet, është shumë e ngushtë në terapinë frojdiane, edhe pse kuptohet që s’duhet të dalë jashtë kontrollit.

Katharsis është shpërthimi i papritur dhe dramatik i emocioneve që ndodh kur trauma del në

sipërfaqe. Prandaj gjendet edhe pakoja me shami letre poshtë tavolinës.

Insight-i është ndërgjegjësimi për burimin e emocionit, për ngjarjen traumatike. Pjesa më e madhe e terapisë kompletëhet kur përjetohen katharsis dhe insight.

Ajo që duhej të kishte ndodhur vite më pare – por që ju ishit të vegjël për ta përballuar ose nën presione të ndryshme konfliktuale – ka ndodhur tani, dhe ju jeni pranë të qenit një person më i lumtur.

Frojdi tha se qëllimi i terapisë ishte i thjeshtë “të kthente pavetëdijen në vetëdije”.

Diskutim

E vetmja gjë më e përhapur se admirimi i verbër për Frojdin duket se është urrejtja e verbër për të. Sigurisht, qëndrimi i duhur qëndron diku nga mesi. Le të shohim disa nga gabimet e dukshme në teorinë e tij.

Pjesa më pak e pranuar e teorisë së Frojdit është kompleksi i Edipit dhe idetë e ankthit të tredhjes dhe zilisë së penisit. Cili është realiteti pas këtyre koncepteve? Është e vërtetë se disa fëmijë janë shumë të lidhur me prindin e seksit të kundërt dhe shumë kompetitivë me prindin e të njëjtit seks. Është e vërtetë se disa djem shqetësohen për dallimet midis djemve dhe vajzave dhe kanë frikë se mos dikush do t’u presë penisin. Është e vërtetë se disa vajza janë të shqetësuara apo dëshirojnë të kenë një penis. Dhe është e vërtetë se

disa nga këta fëmijë i ruajnë këto afeksione, frikëra dhe dëshira deri në moshën e rritur.

Pjesa më e madhe e teoricienëve të personalitetit, gjithsesi, i shohin këta shembuj si raste nëpër të, më shumë sesa universale, përjashtime më shumë sesa rregulla.

Ato ndodhin në familje që nuk funksionojnë aq mire saç duhet, ku prindërit janë të palumtur me njëri-tjetrit, përdorin fëmijët kundër njëri-tjetrit.

Ato ndodhin në familje ku prindërit denigrojnë vajzat për mungesën e tyre të penisit apo flasin për prerje penisit tek djemtë e pabindur.

Ato ndodhin veçantërisht në lagjet ku nuk qarkullon as informacioni më i thjeshtë për seksin, dhe fëmijët mësojnë ide të gabuara nga fëmijë të tjerë.

Nëse ne e shohim krizën e Edipit, ankthin e tredhjes dhe zilinë e penisit në një këndvështrim më metaforik dhe më pak të drejtpërdrejtë, ato janë koncepte të dobishme: ne i duam nënat dhe baballarët tanë, por edhe jemi në garë me ta. Fëmijët ndoshta i mësojnë sjelljet standarde heteroseksuale duke imituar prindin e të njëjtit seks dhe duke e pare tek prindi i seksit të kundërt.

Në një shoqëri të dominuar nga meshkujt, të kesh penis – të jesh mashkull – është më mire se të mos kesh dhe humbja e statusit si mashkull është e frikshme.

Të duash privilegjet e të qenurit mashkull, përveç organit mashkullor, është një gjë e arsyeshme për t'u pritur nga femrat me aspirote.

Por Frojdi nuk kishte parasysh që ne t'i shihnim këto koncepte në mënyrë metaforike. Megjithatë, disa nga dishepujt e tij kështu bënë.

Seksualiteti

Një kritikë më e përgjithshme e teorisë së Frojdit bëhet në drejtim të theksit mbi seksualitetin.

Çdo gjë, si e mirë edhe e keqe, duket se rrjedh nga shprehja apo shtypja e impulsit seksual.

Shumë njerëz vënë në dyshim nëse ka apo jo forca të tjera që veprojnë. Frojdi vetë, më vonë shtoi edhe instiktin e vdekjes, që tregoi se ishte një ide tjetër jo aq e përqafuar. Së pari më lejoni të theksoj se në fakt, shumë nga aktivitetet tona në njëfarë mënyre janë të motivuara nga seksi.

Nëse e shihni me kujdes shoqërinë tone moderne, do të shihni që shumica e reklamave përdorin imazhe seksuale, që filmat dhe programet televizive nuk shiten nëse nuk përfshijnë stimuj të tillë dhe se industria e modës është e bazuar në lojën e vazhdueshme seksuale të “kukamsheftit” dhe se ne të gjithë e kalojmë pjesën më të madhe të ditës duke luajtur “lojën e çiftimit”.

Megjithatë ne nuk mendojmë se e gjithë jeta është seksuale.

Por theksi i Frojdit mbi seksualitetin nuk ishte i bazuar në sasinë e madhe të seksualitetit të dukshëm në shoqërinë e tij – ai bazohej në shmangien e fortë nga seksualiteti, sidomos në klasat e mesme dhe të larta, dhe sidomos në radhët e grave. Por ne harrojmë kollaj që bota ka ndryshuar mjaft në 100 vjetët e fundit. Ne harrojmë se mjekët dhe priftërinjtë rekomandonin një ndëshkim të forte për masturbimin, që fjala “këmbë” ishte një fjalë e pisët, që një grua e cila kishte dëshira seksuale konsiderohej automatikisht si një prostitutë e mundshme dhe se një nuse e re befasohej nga ngjarjet e natës së parë të martesës dhe i binin të fikët kur e mendonte.

Është meritë e Frojdit që arriti të dilte mbi qëndrimet e kulturës së tij për seksin. Edhe mentori i tij Breuer dhe i shkëlqyeri Charcot nuk e kuptonin plotësisht natyrën seksuale të problemeve të klientëve të tij. Gabimi i Frojdit ishte fakti që e përgjithësoi shumë dhe që nuk mori parasysh ndryshimet në kulturë. Është ironik fakti që shumë nga ndryshimet kulturore në qëndrimet seksuale i dedikohen në fakt veprës së Frojdit!

Pavetëdija

Një koncept i fundit që kritikohet shpesh është pavetëdija. Nuk argumentohet në lidhje me faktin nëse

a jo ndikon në disa nga sjelljet tona, por në lidhje me atë se sa ndikon dhe çfarë natyre ka kafsha brenda nesh.

Bihejvioristët, humanistët dhe ekzistencialistët besojnë të gjithë se (a) motivimet dhe problemet që mund t'i atribuoheshin pavetëdijes janë shumë më pak nga ç'mendonte Frojdi dhe (b) pavetëdija nuk është motori më i fuqishëm i aktivitetit tonë. Shumë psikologë sot e shohin pavetëdijen si gjithçka për të cilën ne s'kemi nevojë apo që s'duam ta shohim. Disa teoricienë nuk e përdorin aspak këtë koncept.

Nga ana tjetër, të paktën një teoricien, si Karl Jung, propozoi një pavetëdije para së cilës pavetëdija e Frojdit duket e papërfshillshme! Por do t'i lëmë këto për kapitujt e ardhshëm.

Aspekte pozitive

Njerëzit kanë prirjen e pafat që për një plesht të djegin të gjithë jorganin. Nëse s'bien dakord me idenë a, b dhe c, nxjerrin si përfundim se edhe x, y dhe z janë të gabuara. Por Frojdi na dha shumë ide të mira, kaq të mira, saqë janë përfshirë në mjaft teori të tjera, aq sa ne harrojmë t'ia dimë atij për nder.

Së pari, Frojdi na bëri të ditura dy forca të fuqishme dhe kërkesat e tyre tek ne. Dikur pas në kohë, kur çdokush besonte se njerëzit ishin kryesisht racionalë, ai tregoi sesa shumë sjellja jonë ishte produkt i biologjisë.

Atëherë kur kushdo i shihte njerëzit si veçmas të përgjegjshëm për veprimet e tyre, ai tregoi impaktin e shoqërisë. Kur secili i shihte burrin dhe gruan në role të përcaktuara nga natyra ose Zoti, ai tregoi sesa shumë vareshin rolet nga dinamika e familjes. Idi dhe superego – shfaqjet psikike të biologjisë dhe shoqërisë – do të jenë gjithnjë me ne, në një formë ose në një tjetër.

Së dyti është teoria bazë, duke u kthyer pas tek Breuer, e simptomave të caktuara neurotike të shkaktuara nga traumat psikologjike. Edhe pse pjesa më e madhe e teoricienëve nuk besonin më se të gjitha neurozat mund të shpjegohen, apo se ishte e nevojshme të çliroje traumën për t'u bërë më mirë, tani është kthyer në një besim të përhapur se fëmijëria e mbushur me neglizhim, abuzim dhe tragjedi priret të formojë një të rritur të palumtur.

Së treti është ideja e mbrojtjeve të egos. Edhe nëse s'ju pëlqen ideja e Frojdit për pavetëdijen, është e qartë se ne vazhdimisht përfshihemi në manipulime të vogla të realitetit dhe të kujtimeve tona mbi atë realitet për t'i përshtatur ato me nevojat tona, sidomos kur këto nevoja janë të forta. Unë do të sugjeroja që të mësoni t'i njihni këto mbrojtje: do të zbuloni se kur u vini emra, kjo ju ndihmon t'i vini re tek vetja dhe tek të tjerët.

Së fundi, forma bazë e terapisë duket se është ndërtuar gjerësisht prej Frojdit.

Përveç disa terapive bihejvioriste, shumë terapi të tjera janë një “kurë e të folurit” dhe ende përfshijnë atmosferën e relaksuar fizike dhe shoqërore.

Dhe edhe pse teoricienët e tjerë nuk shqetësohen për idenë e transferencës, natyra tepër personale e marrëdhënies terapeutike shpesh shihet si me rëndësi për të arritur suksesin.

Disa nga idetë e Frojdit janë të lidhura qartë me kulturën dhe epokën e tij. Ide të tjera nuk janë të testueshme kollaj. Disa mund të jenë çështje të lidhura me personalitetin dhe përvojat e vetë Frojdit. Por Frojdi ishte një vëzhgues i shkëlqyer i kushteve njerëzore dhe mjaft nga ajo çka tha, ka vlerën e vet edhe sot dhe do të jetë pjesë e teksteve të personalitetit edhe për vitet që do të vijnë. Edhe kur teoricienët dolën me ide krejt të ndryshme mbi mënyrën se si funksionojmë, në fakt ata i krahasojnë idetë e tyre me ato të Frojdit.

NAIM KELMENDI – POET E PUBLICIST

Naim Kelmendi, jetën e tij deri sot ia kushtoi çështjes sonë kombëtare. Pena e tij nuk pushoi kurrë së shkruari poezi e prozë për Kosovën dhe popullin e robëruar shqiptar, dhimbjet e të cilit do t'i përjetojë rëndë në shpirt, njësojë sikur mallin për babanë e tij, ngrohtësinë dhe zërin e ëmbël të të cilit nuk e shijoi kurrë në jetë.

Naim Kelmendi edhe tash vazhdon të shkruan poezi, të këndojë dhe t'i thurë këngë lirisë së fituar me aq shumë gjak, do të këndojë bashkë me popullin e tij të cilit i thuri aq shumë vargje, dhe për lirinë e të cilit ishte i gatshëm të sakrifikohet në çdo çast.

Poetët janë zëri më i bukur i një populli, janë këngëtarët më të mëdhenjë që i këndojnë lirisë, janë

bilbilat më të bukur të botës, që ia thonë këngës në çastet më të vështira, kur të tjerët vajtojnë, vetëm e vetëm që ta mbajnë të gjallë shpirtin e popullit kur ai kërcënohet me zhdukje, siç ishte rasti para një decenie me popullin të cilit i takonte Naimi. Për këtë ai deri më tani ka botuar mbi 12 përmbledhje poezish, ka shkruar me dhjetëra punime publicistike dhe gazetareske, është marrë me aktivitete të shumta kulturore, qoftë në Kosovë (Pejë, Ruhot, Prishtinë) në Zvicër, Shqipëri etj.

Naimi ishte redaktor i disa revistave shqipe në diasporë si “Top-Kultura”, “Mërgimtari”, etj. ka organizuar me dhjetëra takime dhe mbërme letrare, promovime librash, ishte reporter i parë i gazetës “Bota Sot” që arriti të raportojë nga fronti i luftës në Koshare, ishte bashkëpunor i shumë botimeve në gjuhën shqipe.

Veprimtaria letrare e Naim Kelmendit, siç na është e njohur mire, përveç vlerave të larta letrare, stilistike, ka edhe vlera pozitivisht të theksuara gjuhësore. I lindur e i rritur në Ruhot, ai si një fëmijë e më vonë si një djalë e veçmas më vonë si nxënës dhe student vërejti se të folurit e Rugovës ka një veçori të vetën, e cila po të mblidhet e të ruhet, jo vetëm që do të jetë një thesar i paçmuar për gjuhësinë, por edhe burim e leksik i pashterrshëm për letërsinë, posaçërisht për poezinë.

Qysh në përmbledhjen e parë të poezive me titull “Shtreza në fjalë” është hetuar tek ai se adhurimi i tij është shumë i fortë për leksikun autokton rugovas dhe se

ato fjalë të vjetra do të mund të shfrytëzohen pafundësisht në poezi. Kjo prirje e tij vazhdoi të thellohet edhe te veprat e tjera, deri tek ajo e fundit. Mund të thuhet se Naim Kelmendi një numër të madh fjalësh të leksikut rugovas e futi me gjeturi në poezi, ia gjeti vendin e përshtatshëm aty dhe ashtu e mbetur ajo u ngulit aty edhe më tej nga bashkëfrymëzuesit e tij, kështu që në sajë të meritës dhe të pasuesve të tij, gjuha jonë e ka rinuar një numër fjalësh e shprehjesh të vjetra, ua ka rigjetur vendin aty dhe aty kanë mbetur e do mbesin përgjithmonë si pasuri edhe e leksikut letrar.

Një meritë tjetër e Naim Kelmendit si poet e prozator e ka edhe për gjetjen e neologjizmave (fjalëve të reja), për krijimin dhe formimin e tyre, duke i dhënë një kontribut të madh neologjisë shqiptare. I dhënë pas letërsisë, ku e ka gjetur strofullën shlodhëse për shpirtin dhe ndjenjat e tij, ai si gjuhëtar tërthorazi ia begatoi leksikun gjuhës së vet, e cila në pendën dhe gjeturinë e tij, gjeti një mjeshtër kulmor për ruajtjen e të vjetrave dhe krijimin e fjalëve të reja sipas dhe në sajë të mendjes dhe syrit shigjetues të tij (Nyja e Gordit).

Nga leksiku popullor Naim Kelmendi ia doli të fusë në përdorimin letrar me dhjetëra e dhjetëra fjalë, të cilat, jo vetëm që nuk ia ulin vlerën letrare asaj gjuhe, por, përkundrazi ia ngrenë, ia larushojnë dhe ia mbushin me poezi. Natyrisht se një vlerë të tillë nuk mund ta ketë çdo fjalë e leksikut popullor, prandaj ai arriti mjeshtërisht të zgjedhë ato fjalë që në vetvete kishin

bukuri fjale, bukurtingëllim, veçanësi emërtimi ose shënjimi (Pse ashtu Pandorë).

Nga sa u tha, Naim Kelmendi në lëmin e leksikut ka sjellë një pasuri leksiku jo vetëm me brumin vetanak por edhe duke e rikthyer në jetë një numër fjalësh të gjuhës sonë, të cilat poezisë i japin hijeshi, gjerësi kuptimi e sidomos melodicitetet autokton.

Ndër krijuesit më të frytshëm të fjalëve veçohet i dalluar edhe Naim Kelmendi ashtu si Azem Shkreli dhe Ramiz Kelmendi. Prej pendës së Naimit kam qëmtuar dhe shënuar me dhjetëra fjalë të tipit të neologjizmave.

Ai me një “daltë fjale” në dorë këndoi edhe kur shkroi përmbledhjen me poezi “Përballje me vdekjen” me atë formën më të bukur që dinë poetët të bëjnë mjeshtërinë e fjalëve (“Eklipsi i diellit”, “Albanoi”, “Nyja e Gordit”, “Pse ashtu Pandorë”, “Kohë për të folur gurët”, “Sipërfaqja e padukshme” etj).

Naim Kelmendi është njëri nga publicistët që, me penën e tij, i doli përballë krimit që mbiu në Kosovë menjëherë pas përfundimit të luftës, pjesëmarrës i së cilës ka qenë edhe vetë si reporter në Koshare.

Për këtë guxim të tij, për këtë përpjekje në funksion të ndërtimit të një shteti të mirëfilltë ligjor, për vizionin e tij për një Kosovë demokratike-ishte për një kohë të gjatë i kërcënuar nga grupet kriminale që u konvenonte anarkia, për ta shfrytëzuar këtë (anarkinë) për pasurim brenda nate.

Naim Kelmendi krejt çka mendoi për zhvillimet e pasluftës në Kosovë, e tha haptaz. Prandaj, vlera e shkrimeve të tij qëndron jo vetëm te ana cilësore e tyre, por edhe te guximi për t'i thënë me emrin e vërtetë të bardhës e bardhë dhe të zezës e zezë.

Në shënjestër të shkrimeve të Naim Kelmendit, ndër të tjera, ka qenë edhe politika e “re” e Beogradit dhe lëvizjet e saj të vazhdueshme për ta frenuar procesin e pavarësimit të Kosovës. Çdo lëvizje antiKosovë nga ana e kësaj politike, publicisti në fjalë bën përpjekje ta demaskojë në sytë e opinionit tonë.

Njëkohësisht, i analizon edhe politikat ndërkombëtare në raport me Kosovën dhe, sa herë sheh të meta në të, bën thirrje që ajo të mos bjerë viktimë e taktikave të reja të politikës së “re” të Kalimegdanit kundër pavarësisë së saj.

Po ashtu, parashtrohet fakte të shumta në favor të pavarësisë së Kosovës, e cila edhe u realizua më 17 shkurt 2008.

Shkrimet e përmbledhura në këtë libër janë të shkruara në gazetën “Bota sot”, “Pavarësia”, “Pavarësia neës” etj. gjatë viteve të pasluftës. Në të janë përfshirë vetëm disa prej shkrimeve të tij të shumta të publikuara në këto gazeta.

SHEFQET DIBRANI - ANA TJETËR E POEZISË

Çdo popull ka nevojë për libra të mirë. Të shkruash një libër është një mund i madh. Shefqeti Dibrani shkroi nëntë libra me vlera kapitale. Kjo pasuri tani nuk është vetëm e Shefqetit, është e gjithë njerëzimit.

Fëmijët shqiptarë në diasporë, dihet mirë se janë të eksponuar nga rrethi ku ata jetojnë, dhe të rrallë janë ata fëmijë të "gastarbajterëve" që e dinë mire kulturën dhe gjuhën shqipe.

Shqiptarët, fjala vjen ku vepron shkrimtari Shefqet Dibrani, e flasin gjermanishten, frëngjishten, italishten e fare pak gjuhën shqipe. Kurse gjermanishtja

flitet në qytetin St. Gallen të Zvicrës, ku jeton prej vitesh poeti ynë tashmë i mirënjohur! Fëmijët tanë janë ekspozuar dukurive devijante, të cilat mund ta shpiejnë fëmijën tonë në një ekstrem të padëshirueshëm.

Nuk merret dituria duke mësuar libra e shkronja arabe në stilin aziatik përmendësh. As nuk merret dija duke lexuar libra apo revista mbi jetën private dhe intime të dinastive të ndryshme në Evropë e Azi, ta zëmë për kurorëzimet apo shkurorëzimet e princave e princeshave, për llojin dhe çmimin e veshjeve të brendshme apo llojin e shamponit me të cilin i lajnë flokët apo trupin.

Kjo dije e fëmijëve tanë (bile edhe këtu në Kosovë), lirisht e quaj "devijim kulerësh" që po rrezon me sjelljen e tyre devijante në mediat e shkruara dhe elektronike (në televizionet private e publike), me seritë e mërztishme alla braziliano-meksikane si dhe nga vetë misionarët fetarë, që paguhën nga burime të dyshimta.

Viteve të fundit të ne në Kosovë, po na servohen edhe libra të dyshimtë, qoftë në formate xhepi apo në forma të revistave të ndryshme pornografike, që dosido janë virus i së keqes.

Ditë më pare më ranë në dorë librat e Shefqet Dibranit. Si fjala vjen "Libra dhe mbresa", "Zhgënjim ballkanik 1 - 2" si dhe libri i tij i fundit që u botua këto ditë, falë përkrahjes së z.Nexhmi Balaj nga Qendra e Kulturës në Podujevë, me titull "Ëndërr e njëjtë, tokë tjetër", më bënë të mishërohem më fatin e venerimeve të autorit, sepse librat e Dibranit janë antologjikë dhe

lexuesi ynë ka rastin të mësoj se si shkruhet poezia, eseu, komenti politik etj.

Shefqet Dibrani, ka stilin e vet si një individualitet që përkon me bëmat e kolektivitetit, e që prekë dhe bën xëx në historinë dhe realitetin tonë.

Poezitë: "Në një zyrë integrimi"; "Zjarret dhe mërgimtarët", "Me fytyrë të kthyer nga atdheu" etj. përfaqësojnë bindshëm mendimin e theksuar më lartë. Ligjërimi poetik i tij ka sentenca humanizmi dhe njerëzoreje, element që e ndeshim sidomos te poema "Shekulli në mes inicialeve "V. ZH.", kushtuar shkrimtarit dhe mikut të tij Visar Zhiti.

Sh. Dibrani thotë:

*"I vyer je miku im vetëm
Atëherë kur nuk je në mesin tone
A kur të kalosh në amshimin tënd, të tjerë
Gëzueshëm mortojnë, madje do të ngritin dhe
dolli
Sepse sado që mbolle pemën e dashurisë
Hija jote pengonte rrezatimin e së keqes
Vetëm vdekja, miku im, të bën të afrueshëm
Dhe shumëfish të pranueshëm..."*

(Nga poema: "Shekulli në mes inicialeve "V. ZH.", faqe 89)

Pra, çdo varg i Shefqet Dibranit gjakon drejt dhembjes personale, e cila shkallëzohet dhe të bën për veti, duke ta shkund ndërgjegjen në perceptimin e realitetit jetësor të poetit. Një pohim të tillë i gjejmë edhe në këto vargje:

*"Dheu më tha: S'më kujtohet fytyra juaj
Kur trup e ndjenja i ke në vend të huaj"*

Ndërsa nostalgjia e poetit shihet nga vargjet:

*"Ngado shkoj e treti
Mbaj fytyrën kah At-Dheu"*

(Poezia: "Me fytyrë të kthyer kah At-Dheu", faqe 19).

Publicisti, gazetari dhe shkrimtari Shefqet Dibrani me librin e tij "Ëndërr e njëjtë, tokë tjetër" i hap vetes rrugën drejt një krijimtarie shumë kualitative.

Me siguri se një hise krenarie nga ky libër, bie edhe mbi profesorin Sadik Rustemi, (një mik i autorit), që Shefqetit "ia shtoi frymën" për frymimin dhe venerimin shul - shqip të tij edhe ne diasporë.

Nga Shefqeti dhe nga gjithë krijuesit shqiptarë presim libra të mirë, të cilët dosido duhet ta mbrojnë e drejtojnë gjeneratën e re nga asimilimi dhe nga antivlerat që kanë vërshuar me bollëk. Po ashtu, presim edhe nga të

rinjtë llapjanë që të shkruajnë libra më vlera kombëtare e njerëzore nga fusha e dijës dhe të humanizmit.

E përmbyll këtë shënim me porosinë:

"Të mësojmë nga librat e Shefqetit se si shkruhet recensionin (shih qindra recensione të botuara në librin e tij "Libra dhe mbresa", apo si shkruhet poezia që nga libri parë "Larg pikon hëna", Tiranë 1994, që i ka hapur udhën poetit për t'u prezantuar në antologjinë "Pema e ëndrrave", në Bari të Italisë, 1995), te libri "Strehët e gjakut" (Prishtinë, 2000), e deri te "Ëndërr e njëjtë, tokë tjetër" (Podujevë, 2007), ose te esetë e komentet politike të botuara në dyvëllimëshin "Zhgënjimi ballkanik 1 dhe 2" (Prishtinë 2005 / 2006), që mund t'i mësojë bukur shumë edhe VIP-at tanë në politikën kombëtare dhe globale.

Shefqetit i dëshiroj sukses në jetë dhe në veprimtari krijuese dhe padyshim pres nga ai që në venerimet e tija të ardhshme të ketë parasysh edhe "rastësinë" e një ndëshkimi nga një proces i kurdisur gjyqësor, i cili ishte patologjik, e aq më keq më ndërskamcat e "patriotëve me bateri" që e inskenuan, pseudoletërrarët shqipfolës.

JUSUF GËRVALLA, KËNGËTARI, POETI DHE ROMANCIERI

Jusuf Gërvalla u lind me 1 tetor 1945 në Dubovik të Deçanit.

E vranë mizorisht më 17 janar 1982 në Untergruppenbah të Gjermanisë.

Shembulli i tij mbeti i gjallë në gjithë ata intelektualë, shkrimtarë dhe qytetarë, që nuk po e marrin rrugën e botës, por rrinë e qëndrojnë.

Jeta e Jusuf Gërvallës ka qenë e vështirë, vdekja e tij ka qenë tragjike. Për këtë është thënë e shkruar shumë dhe do të thuhet e do të shkruhet shumë. Por, edhe shkrimtari Jusuf Gërvalla pësoi vështirësira të mëdha.

Për poetin, prozatorin dhe dramaturgun Jusuf Gërvalla është thënë e shkruar relativisht pak. Vepra e tij

letrare nuk është tepër e njohur, me gjithë botimin shembullor që ia bëri Jusuf Gërvallës më 1992 Sabri Hamiti.

Opinionin e respekton dhe adhuron dëshmorin e kombit, simbolin e luftës për liri, shembullin e kurajës prej qytetari dhe intelektual, ndërsa duket se e harron shkrimtarin e rëndësishëm që ishte dhe mbetet.

Roli i tij prej simboli të qëndresës e hijesuaka faktin se ishte poet i dorës së parë. Në letërsi, ai nuk i takonte qarkut të "lapidaristëve" të poezisë fjalëpakë që e shoshiste të tashmen me shkrimin simbolplotë alegorik në petkun e arkaikes mbikohore e në frymën e visarit të traditave të lashta gojore.

Zëri i tij poetik ishte zë më vete, mjaft origjinal, personal dhe individual.

Poezia e tij na flet drejtpërsëdrejti, ngrohtë, butë, thellësisht njerëzor e me një sensibilitet të stërholluar. Në dy përmbledhjet e tij të para - "Fluturojnë e bien" (1975) dhe "Kanjushë e verdhë" (1978), poezia e tij merrej kryesisht me vatrën e poetit, tek janë mjaft kuptimplotë titujt e cikleve "Shtëpia në kornizë" dhe "Skena nga jeta e fshatit".

Poezia e tij e përmallshme e këndon dashurinë, e kujton dhimbshëm (dhe pa idilë ruraliste) vendlindjen dhe na e rrëfen porosinë e saj qendrore, kërkimin e poetit për "pak frymë njeriu e pak dritë qiriri".

Me kohë, duke u bërë gjithnjë e më shumë refleksiv, poeti kaloi gjithnjë e më shumë te një qark më

i gjerë tematik dhe te të folurit poetik me bukuri e begati të rrallë metaforike e figurative. Kështu, poezia e tij e përmallshme e vendlindjes gjithnjë e më shumë bëhet edhe universale.

Në vëllimin e tretë poetik, "Shenjat e shenjta" (1979), kemi të bëjmë dhe me fjalë e elemente si "hije", "pluhur", "frikë", "terr", "ftohtë", "varr".

Shkallëzohen vetmia dhe shqetësimet e poetit, që flet shpesh edhe për fundin dhe vdekjen. Me një thellësi që nuk hetohet në lexim të cekët, na qet tabllo tejet të qëlluara të groteskës, që e quajmë "jeta".

Thelbi kryekëput human i vargjeve, ligjërimi lirik dhe substancial i poetit të mallit, të dashurisë, të dhembjes, të vetmisë e të vdekjes, e bëjnë Jusuf Gërvallën një zë të patjetërsueshëm të poezisë së re shqipe.

Kënga "Do të kthehem o nënë" e kantautorit dhe shkrimtarit Jusuf Gërvalla, është vetëm njëra nga perlat e tij muzikore, që i ka mbijetuar zhdukjes dhe si e tillë pas vrasjes së tij më 1982, për vite me radhë është dëgjuar fshehtas nga njerëzit në Kosovë (Shyqri Galica, Flori Bruqi, Skendër Tafaj, Fatime Llugiqi etj).

E ruajtur me kujdes, së bashku me shumë këngë të tjera, ajo në këtë fillim vjeshte i ngjan një rikthimi të vonuar të kanjushës së verdhë poetike dhe muzikore të një artisti, krijimtaria e të cilit u pre nga plumbat. Ky rikthim i vonuar, por i domosdoshëm i Jusufit tek njerëzit që aq shumë i deshi, thotë bashkëshortja e tij

Suzanë Gërvalla, duke folur për dy cd-të me këngët e Jusuf Gërvallës.

"Kam patur dëshirë përherë që të rikthej Jusufin në skenën muzikore, që të rinjtë ta dëgjojnë Jusufin, sepse nuk kanë patur ku ta dëgjojnë zërin e tij. Gjithashtu edhe gjeneratat tona të cilat e kanë dëgjuar Jusufin janë mallëngjyer shumë, e kanë pritur mirë, sepse dhe u ka pëlqyer kënga e tij. Aty do të jenë dy CD. Njëri do t'i ketë këngët origjinale të Jusufit, të cilat i këndon ai, ndërsa tjetri, do të ketë 7 këngë të përpunuara nga kompozitorë të tjerë", thotë zonja Gërvalla.

Krijimtaria muzikore e Jusuf Gërvallës është shumë e gjerë dhe si e tillë ajo përfshin dhjetra këngë, të cilat kur ishte gjallë Jusufi i ka kënduar nëpër koncerte të ndryshme apo i ka inçizuar në radio dhe televizion, thotë më tutje Suzanë Gërvalla, duke shtuar se për fat të keq, nga opusi i tij krijues muzikor, nuk kanë shpëtuar të gjitha.

"Fatkeqësisht në Radio Kosova nuk kishte asgjë. Ishin shkatërruar krejt. Televizioni ka xhirime, por nuk kanë mundur ende t'i nxjerrin të gjitha, kanë nxjerrë pak. Ndërsa këto këngë që janë nxjerrë të pastra, janë nxjerrë nga Radio e Shkupit dhe nga aktorja e Teatri Popullor të Kosovës z. Fatime Llugiqi, të ruajtura në një kasetë me kërshëri. Sa i përket këngëve, që janë përpunuar, unë e kam patur një kasetë, të cilën e kam inçizuar dikur, kur ka qenë Jusufi gjallë, e kam ruajtur dhe nga ajo kaseta i kemi nxjerrë këto këngë që i kanë përpunuar, më tha më

17 janar 1996 në promovimin e romanit tim “Vrasësit e liridonëve”, aktorja e mirënjohur zonja Fatime Llugiqi.

Krahas krijimtarisë muzikore të Jusuf Gërvallës, sipas zonjës, Suzanë Gërvalla, ai ka lënë pas vetes edhe veprën e tij letrare dhe publicistike, të cilën ajo është duke e mbledhur dhe përgatitur për botim.

"Kam shumë materiale të Jusufit. Më vjen keq që kurrkush nuk është interesuar deri sot për ato, t'i marrë, t'i përpunojë, t'i nxjerrë në dritë. Prandaj detyrohem unë që t'i bëj. Sivjet është 61 vjetori i tij i lindjes dhe unë kam marrë iniciativën, ka shumë muaj që unë punoj në bibliotekë dhe po i mbledh të gjitha shkrimet e Jusufit që janë të botuara në gazetë. Kam punuar në Shkup, i kam nxjerrë nga Flaka, nga Jehona. Këtu i kam nxjerrë nga Rilindja, Zëri, Jeta e Re, nga të gjitha gazetatat dhe kur të bëhet, dua t'ia bashkangjit edhe një libër me publicistikën e Jusufit," përfundon e shoqja e tij, Suzanë Gërvalla.

Duke rilexuar vëllimin "Vepra Letrare" të Jusuf Gërvallës, botim i Shtëpisë Botuese "Ora" të Prishtinës

Botimi i veprës letrare të Jusuf Gërvallës nga Shtëpia Botuese "Ora" e Prishtinës më 1992 me rastin e dhjetëvjetorit të rënjes së tij, janë shenjë nderimi e respekti ndaj figurës poliedrike të heroit, ngase para lexuesve nxori portretin letrar më komplet (deri më

tash), duke botuar kështu në një vëllim të gjitha veprat e tij letrare.

Botimi i kësaj krijimtarie për lexuesin shqiptar është një sihariq i rrallë dhe i çmuar, ngase për të, pra për krijuesin e artistin J.Gërvalla, gjithnjë mund të flitet e shkruhet në bazë të atyre veprave që na i la si të përfunduara, por edhe në bazë të veprave të nisura e të cilat s'arriti t'i përfundonte.

Ky botim na jep të kulluar krijimtarinë letrare të Jusuf Gërvallës të mbarshtruar, duke pasur për bazë kriterin e vitit të botimit të veprave të tij. Në këtë vëllim janë përfshirë të gjitha veprat letrare të këtij autori të botuara si vëllime të veçanta, qoftë për të gjallë të tij (përmbledhjet e tij me poezi: "Fluturojnë e bien" 1975, "Kanjushë e verdhë", 1978 dhe "Shenjat e shenjta"), qoftë pas vdekjes së tij (Romani "Rrotull", 1983 dhe drama "Procesi" 1984).

Kështu, duke marrë në dorë këtë botim ("Vepra letrare e Jusuf Gërvallës") lexuesi do të komunikojë më lehtë me Jusufin si poet të një shprehje të veçantë e spontane, të lidhur ngushtë me ambientin e vendlindjes (që e karakterizon një sërë e poezive të vëllimit "Fluturojnë e bien"). Këtu do të gjejmë poetin e vetmuar, të ngjyer me ndjenjat e mallit dhe të vetmisë e (kryesisht në brumin poetik të vëllimit "Kanjushë e verdhë").

Po ashtu lexuesi këtu do të gjejë poetin e pikëlluar i cili përmes idesë së vetmisë njerëzore e

zërthen faqen tragjikomike të jetës (kryesisht në poezitë e përmbledhjes "Shenjat e shenjta").

Në këtë botim lexuesi do të komunikojë edhe me romancierin, i cili me një gjuhë të pastër e të rindërtuar mbi shprehjen ambientale rrëfen dhe vetërrëfeket. Kemi pra këtu atë rrëfimin rrotull ose thënë ndryshe rrëfimin figurativ.

Romani "Rrotull" i Jusuf Gërvallës është një roman i personazhit, në këtë rast konkretisht, i personazhit Ketë Avdisë.

Ky personazh ka të lidhura rreth vetes fijet e linjat ngjyrëshumta të të gjitha të ndodhurave në një tërësi fabulore. Ngjarja e romanit shtrihet, apo zë fill që nga lindja e Ketës dhe mbaron me aktin e martesës së tij.

Përveç nga ky aspekt romani "Rrotull", mund të konsiderohet dhe të studiohet edhe nga një aspekt tjetër, si roman i ambientit.

Pikërisht katundi Vijujë (emër i figuruar) është ai ambienti romansor me të cilin ngushtë lidhen edhe artikulohen të gjitha veprimet, pasojat, dhembjet, ëndërrat, synimet, imagjinata e njerëzve të këtij ambienti e që janë ndërtues të fabulës së romanit "Rrotull", ku autori tenton të hyjë thellë në botën e njeriut të një realiteti të caktuar duke prekur kështu plagë të ndjeshme të tij, siç janë mentaliteti prapanik, varfëria, kurbeti, etj. Karakteristika këto të njohura për njeriun e këtij ambienti, apo plagë të njeriut të këtushëm që kullojnë vazhdimisht.

Pra, siç do të shprehej edhe kritiku e studiuesi Sabri Hamiti:

"Fuqia dhe vlera letrare e romanit "Rrotull" të Jusuf Gërvallës qëndron në fjalën, në domthënien dhe orkestrimin e saj në tërësinë e tekstit".

Siç shihet, Jusuf Gërvalla individualitetin e tij krijues e bëri në lëmin e poezisë, por ai nisi t'i kushtohej edhe prozës dhe dramës. Por, hapat e parë drejt krijimit të individualitetit të tij në këto dy gjini letrare u ndërpre në tragjikisht. Ai na la një roman të përfunduar (që na jep të kuptojmë se kishim të bënë me një prozator shumë serioz) dhe një dramë që siç shihet është hap i parë i tij në këtë fushë.

Pra, drama "Procesi", edhe pse e shkruar e fundit nga kjo penë estetikisht nuk është e nivelit të veprave të tjera.

Drama "Procesi", që trajton një proces gjyqësor në Prishtinë, të shpifur kundër veprimtarëve kombëtarë, të cilët të prirur nga ideali i lirisë nuk dorëzohen në asnjë mënyrë para shtypësve.

Drama jo vetëm që shpreh qëndresën e të burgosurve, të cilët para gjuqit e zhveshin maskën e pushtuesit, por në anën tjetër është një dëshmi tronditëse e një kohe të vështirë e shqiptarëve të Kosovës dhe luftës së tyre për çlirim.

Vëllimi "Vepra letrare e Jusuf Gërvallës", shoqërohet edhe nga një parathënie të thukët studimore e shkruar nga pena e kritikut tonë letrar, sot njëri nga më të

mirët në fushën e kritikës në letërsinë shqipe, Sabri Hamiti, i cili lexuesit ia zbërthen vlerat ideo - artistike e estetike të veprës së J. Gërvallës në përgjithësi.

Një studim i tillë gjithësesi është shumë i rëndësishëm për një botim si ky.

Ky botim shoqërohet edhe me shënime autobiografike, me një shënim të shkurtër për këtë botim dhe me një fjalë përkujtuese të Skënder Blakajt me rastin e dhjetvjetorit të vdekjes së J.Gërvallës dhe me rastin e këtij botimi, për të cilin ai shprehet kështu:

"Botimet si ky çojnë në takim të sërishëm me Jusufin tonë".

Duke shfletuar e rilexuar këtë botim të çmuar, shpresojmë se në të ardhmen, në një të ardhme të afërt, në një botim të këtillë do t'i kemi edhe poezitë e Jusufit që kanë mbetur jashtë veprave të tij të botuara, pastaj tekstet e këngëve që ai i këndonte me kitarë, prozat e pabotuara të shkruara gjatë viteve shtatëdhjetë dhe artikujt e tij të shumtë për artin muzikor e atë letrar.

AMIKO KASARUHO

Amik Kasoruhó u lind më 1932 në Tiranë. Është autor i disa librave: "Një ankth gjysmëshekullor" (1997), "Çmimi i një ëndrrë", botuar në Itali (2000), "Midis qiellit dhe burgut" dhe romanin autobiografik "Ikje nga trilli i perëndive".

Amik Kasoruhó ka përkthyer në shqip vepra nga Pirandello, Isabel Allende, Harold Robbins, Patrick O'Brian, John Selby etj. Është fitues i çmimit special të jurisë në konkursin Eks & Tra për shkrimtarët emigrantë në vitin 1999. Në 2000 ka marrë çmimin "Civitas - Arbëria 2000 Calabria" për mirëmbajtjen e revistës italo-shqiptare të arbëresheve "Katundi Ynë".

U nda nga jeta në Tiranë më 5 maj 2014.

Amik Kasoruho, shkrimtari që “përktheu” jetën e tij

I njohur si përkthyes i veprave të njohura botërore (“Kodi i Da Vinçit” të Dan Brown, seria e sagave për magjistarin Harry Potter të J. K. Rowling, janë vetëm disa prej tyre) Kasoruho kësaj radhe ka vendosur të “përkthejë” jetën e vet në romanin e fundit.

Romani i tij i fundit, “Ikje nga trilli i perëndive” është bërë sebp që autori i tij, Amik Kasoruho, publicist dhe njëri ndër përkthyesit më të mirë shqiptarë, të shkelë në Kosovë. Ai ka qenë mysafir në ditën e fundit të panairit të librit “Prishtina 2010”, me ftesë të shtëpisë botuese “Buzuku”, që ka sjellë në shqip romanin e tij.

Në një bisedë për “Koha Ditore”, Kasoruho zbulon rrëfimin prapa “Ikje nga trilli i perëndive”, të botuar fillimisht në italisht. Thotë se me të ka dashur t’i tregojë botës, e në mënyrë të veçantë vendit ku jeton tash gati tri dekada, Italisë, se si ka qenë historia e shqiptarëve. Përderisa atë e ka sjellë në shqip për një arsye të fortë: gjenerata e re të mos e harrojë historinë që fshihet prapa këtij romani.

I njohur si përkthyes i veprave të njohura botërore (“Kodi i Da Vinçit” të Dan Brown, seria e sagave për magjistarin Harry Potter të J. K. Rowling, janë vetëm disa prej tyre) Kasoruho kësaj radhe ka vendosur të “përkthejë” jetën e vet në romanin e fundit.

“Ikje nga trilli i perëndive” mban peshën e fatit të një njeriu, të cilin e burgosin në moshën 17-vjeçare, duke i mohuar rininë. Ky është vetëm një detaj autobiografik i Kasoruhos që ka zënë vend në “Ikje...”. Kasoraho (78) do të arrestohet në vitin 1949, kur ishte vetëm 17 vjeç, bashkë me një grup të rinjsh adoleshentë, mes të cilëve edhe një vajzë dhe e dënuan me 10 vjet burg me akuzën “se ka dashur të përmbysë me dhunë pushtetin popullor”.

Kur e arrestuan dhe i pushkatuan babanë e tij në shkurt të vitit 1951, së bashku me 22 intelektualë dhe njerëz të shkolluar për të ashtuquajturën “bombë në ambasadën sovjetike”, Amik Kasoraho ishte vetëm 20 vjeç. Pas tre vjetësh, ia pushkatuan edhe nënën. Më pas do të internohet në rrethinat e Lushnjës ku familjen që krijoi pas daljes nga burgu, ia dëbojnë për 25 vjet të mundimshëm në Gosë të Kavajës. Dhe në fund, ikja nga Shqipëria.

Të gjitha këto ai i ka hedhur në letër. “Ikje nga trilli i perëndive” ai thotë se është “përkthim i jetës së vet”. Por jo vetëm kaq.

“Çdo njeri që ka jetuar në ato kohë në Shqipëri ka një tregim të tij në këtë roman. Është jeta dhe historia e secilit shqiptar që ka jetuar kohën e asaj periudhe të tmerrshme për shqiptarët”, thotë Kasoraho. “Është një përkthim i vetvetes”, shton ai duke mos dashur që ta kujtojë aq shumë këtë periudhë.

Njeriu që solli në shqip veprat e Franc Kafkës, Luigi Pirandellos, Vicente Blasco Ibanez, Tracy Chevalier, Isabelle Allendes si dhe ia ofroi lexuesit italian veprat e Fatos Kongolit, Azem Shkrelit, Pirro Mishës, thotë se përkthimi dhe shkrimi nga uni i tij nuk dallojnë shumë.

“Edhe kur përkthej, edhe kur shkruaj, punoj me të njëjtën ndjejnë. Kur përkthen edhe ti je një autor, apo ndryshe, një lloj autori i atij libri për popullin tënd”, thotë Kasoruh. Ai ndalet tek përkthimi i “Harry Potterit”. Dhe për këtë ai ka një arsye.

“E veçanta e këtyre librave ka qenë se shumica e lexuesve kanë qenë fëmijë ose adoleshentë, dhe është shumë e zorshme, por edhe kënaqësi që t’u japësh atyre më të mirën, më të thjeshtë, por me imagjinatë të bukur që ato romane kanë”, thotë ai.

Por ka diçka të autorit të “Çmimi i një ëndrrë”, “Ankthi gjysmë shekullor - Shqipëria e Enver Hoxhës”, “Një fluturim tepër i gjatë në një orë udhëtimi”....nuk mund t’ia falë përkthimi i një vepre, rrëfimi në veten e parë. Për këtë ai thotë se me romanin e tij të fundit “Ikje nga trilli i perëndive” nuk i ka thënë të gjitha.

“Do të rikthehem përsëri. Ne kemi histori të cilat duhen treguar. Duhet ta përkthejmë secili veten”, thotë Amik Kasoruh.

MEHMET KAJTAZI

Mehmet Kajtazi, më 29 mars 2002, me rastin e shfaqjes së dramës “Nata e Fundit në Goli Otok”, tha: Fjalën FALEMINDERIT (në kuptimin e bimës dhe në kuptimin e tokës), e drejtoj sonte deri në përulje drejt NJËREZVE që qëndruan dhe u flijuan që ne të mos jetojmë përherë me erë të mollës, por mollën ta kemi në duart tona”.

Mehmet Kajtazi u lind në vitin 1944 në Kllodernicë të Drenicës (komuna e Skenderajt). Një kohë punoi arsimtar i gjuhës dhe letërsisë shqipe në vendlindje, në Turiqefc, në Runikë, në Klinë të Epërme dhe në shkollën e mesme “Isa Boletini” në Skënderaj, ndërsa, prej vitit 1973 ishte gazetar dhe redaktor i

fejtonistikës në të përditshmen “Rilindja” dhe së fundi deri në vdekje punoi si redaktor profesional për prozë në Ndërmarrjen Botuese “Rilindja”, Prishtinë.

Më së shumti lëvroi reportazhin ku trajtoi tema të aktualitetit dhe të historisë.

Ka botuar tregime, reportazhe dhe shkrime të ndryshme në revista dhe gazeta që botoheshin në gjuhën shqipe në Prishtinë, Tiranë, Shkup, Podgoricë dhe Zvicër.

Me krijimtari letrare merrej që nga shkolla e mesme. Ka shkruar kryesisht prozë për të rritur: romane, tregime, novela. Pjesë nga veprimtaria e tij artistike janë përkthyer dhe botuar në frëngjisht.

Mehmet Kajtazi ishte krijues që ka shfrytëzuar ngjarje të vërteta, personalitete historike e figura tjera, por edhe situata të veçanta të gërshetuara me ndodhi e personazhe fiktive, të cilat në laboratorin e krijuesit janë përpunuar artistikisht. Tema e fakte të realitetit tonë kombëtar e historik janë brumosur në një varg veprash letrare të Mehmet Kajtazit, të cilat me ngjyrim artistike janë fuqizuar.

Mehmet Kajtazi ka botuar pesëmbëdhjetë romane dhe dy përmbledhje tregimesh, “ku kryesisht përpush katrahurat e mëdha të etnisë, sfidat, shpresat dhe udhët që e ngjiten në majat e mbijetesës. Pra në të shumtën, në fabulën e veprave të këtij prozatori gëlojnë luftërat, varrëtarët, nënat shamizeza dhe heronjtë, të cilët përcjellin nga një brez në tjetrin gjësimet e rrufeve, zinë

e riteve mortore, kujet dhe prapë kumbimet e betejave dhe sërish kapërcimi i rrethakut të motjes. Të gjitha këto rrjedhin nga një rrafsh rrëfimor plot thyerje e kontraste dhe thuren me një gjuhë që duket sikur mezi e bart baladën, vëren Rushit Ramabaja.

Mehmet Kajtazi ka botuar këto vepra: "Nata në gur" (roman, 1984), "Rilindja", Prishtinë. "Plaku dhe urat" (roman, 1986), "Flaka", Shkup, "Zemër e Thyer" (tregime, 1987), "Rilindja", Prishtinë. "Fundi i legjendave" (roman, 1990), "Rilindja". Prishtinë, (Teatri Shqiptar "Kurora" nga Nyoni-i Zvicër (Theatre Albanais "Kurora" de Nyon) dramatizoi dhe shfaq romanin "Fundi i legjendave"). "Shqiptarët në Goli Otok" (roman, 1991), "Dielli", Zagreb. "Kodra e pajtimit" (tregime, 1993), "Ylberi", Prishtinë. "Ushtimë e Alboderit" (roman, 1993), "Shkëndija", Prishtinë. "Shote Galica" (roman, 1995), Shoqata e Shkrimtarëve të Kosovës, Prishtinë. "Minatorët" (roman, 1995), botoi "Onufri" Elbasan. "Thikë në portokall" (roman, 1995), Shoqata e Shkrimtarëve të Kosovës, Prishtinë. "Gjeli i katedrales" (roman, 1996), NB "Rilindja", Prishtinë. "Santa Ana" (roman, 1998), NB "Rilindja". Prishtinë. "Guri i dallëndyshes" (roman, 1998), NB "Rilindja", Prishtinë. "Lindja në qiell" (roman, 2000), "Rilindja", Prishtinë. "Udha I" (roman, 2000), "Rilindja", Prishtinë. "Ndezja e shiut" (roman, 2001), NB "Rilindja", Prishtinë. "Një diell tjetër" (roman, 2003), NB "Rilindja", Prishtinë.

Nuk janë të rralla rastet kur një vepër letrare shkruhet si reagim ndaj një modeli pararendës të llojit të vet, duke tentuar njëherit që mohimin e atij modeli ta mbështesë në argumentet që ofron përmes veprës së rë. Një dukuri të tillë e ndeshim edhe tek romani i Mehmet Kajtazit "Plaku dhe urat". Te ky roman, të bëjmë një paralele me konstatimet e deritashme, kemi tekstin që i shqipton situatat e jetës dhe tekstin që komenton këtë formë të shqiptimit dhe artikulimit artistik.

Romani "Plaku dhe urat" ka një kompozicion do të thoshim mozaik, ku tërësinë e rrëfimit e sajonnë reminishencat nga kujtimet e personazhit kryesor (Amnitore Fatorini). Pse është kompozicion mozaik, kur pjesa më e madhe e rrëfimit realizohet në veten e parë? Autori mbase edhe qëllimisht ikën nga një mënyrë strikte e zhvillimit të veprimit dhe rrëfimit romanësor, Shkruante R. Musliu për romanin "Plaku dhe urat" më 22.11.1986.

Proza "Shqiptarët në Goli Otok" ka për temë tragjikën e të burgosurve politikë në kohën e inkuizicionit sllavokomunist, të njohur si periudha e Informbyrosë. Në gjithë veprën "Shqiptarët në Goli Otok" të Mehmet Kajtazit, shkruante Rushit Ramabaja, rrëfimi është ndërtuar në formë mozaiku, ku si në ekran ravijëzohen fatet njerëzore.

Teatri Popullor i Prishtinës ka inskenuar dramën "Nata e fundit në Goli Otok", sipas romanit "Shqiptarët në Goli Otok"-5 nëntor 1992 u shfaq premiera e kësaj

drame dhe kjo dramë theu të gjitha rekordet duke patur mbi 300 repriza dhe është shfaqur në të gjitha trojet shqiptare dhe jashtë vendit.

Drama “Nata e fundit në Goli Otok”, sipas romanit të Mehmet Kajtazit, është dramë e dhembjes, dramë e ndërgegjes së vrarë, e mllëfit të frenuar, e zhgënjimit, e përpjekjes për ta mundur frikën, tmerrin, vdekjen, e përpjekjes për të tejkaluar vetveten, brenda greminave të thella shpirtërore të shkaktuara nga malli për lirinë e largët, që si fatomorganë sillet brenda grilave, shkruante Fadil Hysaj.

Duke lexuar tregimet e Mehmet Kajtazit, shkruante Rifat Kukaj, lexuesi gjithsesi do të provokohet me ngërthimet, psherëtimat, gjëmat dhe shpresën e njeriut tonë që nga kohërat më të hershme e deri më sot.

Zeqir Gërvalla, lidhur me veprën "Ushtimë e Alboderit" shkruante: “Trekëndëshi tredimensional i romanit "Ushtimë e Alboderit" janë tri kohërat në një kohë-harmoni në shesh të Brukselit duke hyrë në dimensionin e katërt të ringjalljes së një kohe të Re të Ribashkimit tonë Kombëtar Shpirtëror e Tokësor në një rend të ri të Ballkanit, Evropës e Botës liridashëse e përparimtare nën Diellin e të gjithëve, falë Zotit Një, Krijuesit të Gjithësisë.

Për romanin “Shote Galica”, Rushit Ramabaja shkruante: "Shote Galica" është një transponim i sukseshëm i njëres nga baladat tona kombëtare që në rrethakun e historisë sikur nuk po e presin njëra rjetrën.

Vangjush Saro shkruante: Vepër e frymëzuar drejtpërdrejtë nga ngjarjen në minierën e Trepçës në Kosovë, libër prej nga mesazhi i rezistencës, artistikisht dhe dokumentarisht, vjen e plotëson kuadrin e luftës për të drejtat kombëtare e qytetarëve. Autori i sjell kështu lexuesit një botë të pasur që vlon në galeritë e minierave, por me shumë në galeritë e shpirtit.

Ngjarja e romanit "Lindja në qiell", janë vitet tona të përgjakshme nën okupim, personazhet si Agon Zhuka, Adem Jashari, Curr Yjëzimi, Yllkë Dhogaqi, Gëzim Dushi e shumë të tjerë, i bëjnë jetë veprës e që është shumë e afërt me kohën dhe traumat, që i përjetoi populli ynë në Kosovë.

Mehmet Kajtazi me këtë roman tregoi edhe njëherë se është i lidhur ngushtë me fatin e kombit dhe historinë e tij, shkruante H. Perloka.

Romani "Ndezja e shiut" u nderua me çmimin "Hivzi Sylejmani" të Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës, për veprën më të mirë në prozë në vitin 2001.

Edhe në "Një diell tjetër" shkrimtari Mehmet Kajtazi preokupohet me kohë, hapësirat e ekzistencës e të etnisë shqiptare. Kjo unazë narrative-kompozicionale-figurative ka zbritur shumë afër kohës sonë: kalvaret e golgotat e dëbimit masiv të shqiptarëve gjatë luftës së fundit, tek e nisë me Bllacën famëkqë, e vazhdon. Edhe në këtë vepër autori, ashtu si edhe në veprat tjera, lëndën e merr nga jeta e përditshme në Kosovë, nga njerëzit e saj, nga problemet ekzistenciale me të cilat ballafaqohen

shqiptarët, për t'i bërë ballë gjithë katrahurave që ranë mbi ne nga pushtuesit e huaj tash e sa shekuj.

Romani "Një diell tjetër" i Mehmet Kajtazit paraqet tragjedinë shqiptare të viteve nëntëdhjetë, e cila triumfoi me luftën për çlirim. Duke u zhytur në dramën e etnisë Mehmet Kajtazi jep me ngjyra të theksuara kohën e aparteidit serb në vitet nëntëdhjetë të shekullit që lam pas. Romani "Një diell tjetër", siç vëren edhe shkrimtari i mirënjohur Rushit Ramabaja në pasthënie, i shkruar sipas modusit të ironisë së qëndrueshme, e shqipton dramën më të re shqiptare me një gjuhë e me një stil të mvetësishëm duke vendosur në një kompleks modern sintetizues.

Shkrimtari dhe miku ynë i mirënjohur Mehmet Kajtazi ndërroi jetë më 25 shtator 2003 në Lozanë të Zvicrës dhe u varros në Prishtinë më 27 shtator 2003.

BEKIM FEHMIU

Isha në veturë, kur spikeri i radios dha lajmin shokues për vdekjen e Bekim Fehmiut, që më shtangu. Nuk mund të besoja ç'po dëgjoja. Kujtova "takimin" e parë me të në një kafe të Prishtinës, dekada më parë. Ndiqja madhështinë e tij nga distanca. Regjistroja çdo lëvizje të tij dhe kisha dëshirë të papërkshkruar ta takoja. Por sikur edhe ta takoja, ç'do bisedonim, ç'do t'i thoja...

Spikeri tha se qe vetvlarë. U lehtësova kur dëgjoja se ishte vetvlarë. Ishte zgjedhja e tij. Gjithmonë kishte zgjedhur gjërat e duhura. Dhe repektoj vendimin e tij. Zgjedhi vdekjen e tillë, që të mbetej i pathyeshëm, i panënshtruar, që të mbetej - vetja.

Mbeti i ndershëm, në vendin ku ndershmëria është në zhdukje e sipër. Vdiq, siç vdesin ata që s'dorëzohen.

Spikeri vazhdoi të dëftonte se qe vetvrrarë në apartamentin e tij në Beograd. Ca thonin se jetonte në Beograd, ca të tjerë thonin se jetonte në Prishtinë, ca në Romë, ndërsa nuk jetonte as në Beograd, as në Prishtinë e as në Romë, por jetonte brenda mureve të një apartamenti "i vetëm", se nuk duronte sasinë e të keqes jashtë apartamentit.

Spikeri vazhdoi të fliste e dëftonte rolet ku kishte luajtur. Kujtova takimin e parë fizik me të, një dekadë pas takimit të parë platonik. Më dëftoi se kishte refuzuar të luante në filmin që kisha luajtur dhe unë. Refuzonte të luante, "Jo, nuk do të jem më aktor, po qe se nuk më lejojnë të jem njeri dhe shqiptar..." - tha.

Spikeri vazhdoi : ... kishte bërë gati për botim pjesën e dytë të rrëfimit autobiografik... Në takimin e fundit refuzoi të më nënshkruante librin e tij autobiografik "Blistavo i strasno", se së shpejti do botohej shqip...

Tani që Bekimi nuk rron fizikisht, me vdekjen e tij qe bërë lajm.Spikeri vazhdoi: ...telegrame ngushëllimi kishin dërguar dhe Presidenti i Serbisë, Boris Tadiq dhe Ministri i Kultures së Republikës së Kosovës, Lutfi Haziri.

Regjizori Fadil Hysaj ka shprehur keqardhje "që një artist kaq i madh nuk ka folur kurrë në gjuhën shqipe në ndonjë film në Kosovë, apo Shqipëri".

Shumë të prekur ishin edhe kolegët dhe miqtë e tij në Beograd. Regjizori Gorçin Stojanoviq e quajti

Bekim Fehmiun "njërin prej shpirtërave më të mirë të artit" dhe "një prej aktorëve më të mëdhenj nga hapsirat e ish - Jugosllavisë".

Aktori i njohur Dragan Nikoliq ishte i befasuar me lajmin për vetëvrasjen e Bekim Fehmiut.

Ai tha se Bekimi i ka dhënë këshilla shumë të rëndësishme për rolin e tij më të mirë në karrierën e begatshme. Branko Cvejiq tha se Bekimi atyre u ka munguar shumë vitet e fundit, duke shtuar se "ishte artist i jashtëzakonshëm".

Ndërsa regjizori Goran Markoviq, u shpreh se kurrë nuk do të harrojë gjestin njerëzor të Bekimit. Edhe pse në atë kohë ai ishte aktor me famë botërore, Bekim Fehmiu kishte pranuar që në filmin e parë të Goran Markoviqit të luante falas, me një angazhim sikur luante në projektin më të madh botëror...

Kujtova shumë takime mes takimit të parë dhe të fundit ndërkohë që muzika tallava që dëgjohej nga altoparantët e veturës nuk shkonte me pamjet që përftytyroja. Ndjeva dhimbje. Ndërrova kanalën e radios. Kanali i rradhës dëftonte të arriturat e qeverisë...

Mbërrita në shtëpi.

Një soj njerëzish që shfaqen në TV - të tona e që me titra quhen - analistë (kulturorë), filluan ta trajtonin vdekjen e Bekim Fehmiut. Kush me lot, kush pa lot, kush me zë të dridhur e kush pa zë, kush me emocion e kush pa emocion, na dëftuan madhështinë e tij duke na dëftuar filmografinë e tij e dashurinë që kishin patur për të.

Tani që s'është mes nesh, do të shkruajmë e do t'a trajtojmë ne, mjeshtrit e injorancës, ofendimit, obstruksionit, përbaltjes... Kjo do të jetë edhe më tragjike se vetë vdekja.

Në internet jepte mendim kushdo që kishte kycje. "Gjykohej" nga të njohur e të panjohur. Disa dënonin vetvrasjen, në vendin ku jeta të hahet nga vetë jeta...

Ndërsa duke mos bërë asnjë përjashtim nga ata që lartpërmenda, edhe unë mora guximin të shkruaj.

Pasi askush s'do të ma botonte një artikull me dy fjali, shkrova atë që shkrova, ndërsa e gjitha që desha t'ju thoja që kjo: Ju faleminderit për kohën që më keni dhuruar. Ju faleminderit për këshillat që më keni dhënë. Tani më jeni i shpëtuar. Lamtumirë Mjeshtër...

Jeta dhe vepra

Bekim Fehmiu u lind në Sarajevë më 1 qershor 1936 dhe vdiq më 15 qershor 2010 në Beograd.

Rrjedh nga nje familja e njohur gjakovare. Babai i tij, Ibrahim Fehmiu, ishte patriot i shquar, njëri ndër mësuesit e gjeneratës së parë në Kosovë dhe propagandues i madh i arsimit në gjuhën shqipe.

Fehmiu u bë i famshëm me filmin "Mbledhësit e Puplave", në vitin 1966. Deri në atë kohë, ai kishte studiuar dhe ishte bërë i njohur nga shumë shtëpi filmi nëpër botë. Ai është aktori i parë shqiptar i filmit dhe i

teatrit, i cili ka luajtur me sukses në filmat dhe skenat e gjithë hapësirës së ish-Jugosllavisë.

Ka qenë një nga personalitetet që ka lënë gjurmë në kinematografinë ballkanike, por mbi të gjitha, ai është i madh për kontributin artistik në kinematografinë botërore.

Rolet e tij në "Prova speciale", "Odiseja", "Aventurieri", "Rruga", "Vitet e nxehta", "Dezertori", përmenden si kryevepra. Nga filmat e parë ka qenë "Ko puca otvorice mu se", "Vitet e nxehta", "Protesta", "Eskadronet e partizanëve" dhe "Të kuq dhe të zinj".

Ai ka bashkëpunuar me John Huston, Olivia de Havilland, Ava Gardner, Robert Shohë, Dirk Bogart, Charl Aznavur, Irene Papas, Claudia Cardinale etj.

Ka interpretuar në shqip, sërbsisht, maqedonisht, turqisht, në gjuhën rome, në spanjisht, anglisht, frëngjisht dhe italisht.

I martuar me kroaten Branka Petriq, ai ishte nga ata njerëz që nuk e braktisi në asnjë moment Beogradin dhe nuk iu tremb të qënurit shqiptar. Shqipërinë e ka vizituar në vitin 1972 dhe nuk e ka fshehur kurrë mallin që kishte për të. I pyetur për dëshirën e tij ai ka thënë thjeshtë se: "Do të doja të njihja më mirë shqipen". Në të gjithë hapësirën ballkanike është gati në përmasat e një miti. Ndoshta kjo ka qenë një nga arsyet, që i biri quhet Uliks.

"Njeriu nuk duhet të fajësojë për diçka që i ndodhë as babanë as vëllezërit, as fqinjët, as perënditë,

por vetëm veten. Njëra nga tragjeditë tona lidhet me atë, që duke jetuar për shekuj së bashku nuk kemi mësuar nga njëri- tjetri, por dhe kur e kemi bërë këtë, kemi mësuar vetëm të keqen", - shprehet ai.

Bekim Fehmiu është artisti më i madh që ka dalë prej këtyre anëve. Në vitin 1987, kur në mënyrë demonstrative braktisi shfaqjen "Madame Kolontine" të Anete Playel, ku luante Leninin dhe Stalinin, në teatrin jugosllav të dramës, ai i dha lamtumirën aktivitetit artistik në Jugosllavi.

Pas disa kohësh mori dhe vendimin për t'i dhënë fund karrierës edhe në aktivitetet artistike botërore.

Pak koh më parë në Jugosllavi është botuar libri me kujtime i Bekim Fehmiut, "Shkëlqim dhe frikë", në të cilin përshkruhet perioda që nga lindja e tij në Sarajevë, duke përfshirë gjithçka deri në vitin 1955, kur u pranua në teatrin e dramës së Prishtinës.

Bekim Fehmiu është aktori i parë shqiptar, i cili para rreth 40 vjetësh "preku" qiellin e Hollivudit. Por për Bekimin ka vite që nuk është dëgjuar nëse është duke xhiruar diç, apo ka zgjedhur heshtjen pas atyre viteve të përgjakshme në këto hapësira. Për aktorët dihet se nuk dalin në pension, ata në njëfarë dore para kamerës apo në skenë janë deri në frymën e fundit. Për Bekim Fehmiun, aktor me energji të madhe, në të njëjtën kohë i suksesshëm si në film ashtu edhe në teatër, atë më pak mund të thuhet se nuk ka forcë të japë edhe shumë

emocione. Për herë të fundit xhiroi filmin "Xhingis Kan" (1992).

Karriera e tij prej aktori profesionist nisi menjherë pas mbarimit të Akademisë së Teatrit dhe Filmit në Beograd më 1960 me sukses të shkëlqyeshëm, kurse profesorët e Bekimit gjithmonë kanë folur për një aktor shumë të talentuar dhe me perspektivë. Krahas punës në Teatrin Jugosllav të Dramës, Bekimi paraqitet edhe në film, fillimisht në role episodike, në mënyrë që në vitin 1966 me rolin kryesor në kult filmin "Mbledhësit e puplave" të Aleksandar Petroviqit (apo siç njihet në botë me titullin "Kam takuar edhe ciganë të lumtur"), të bëhet aktori më i njohur në Jugosllavi. Interpretimi i tij brilant i romit Beli Bora do ta mahnisë edhe publikun e zgjedhur në Festivalin prestigjizor të Kanës në Francë në vitin 1967. Bekimi Fehmiu në këtë festival u bë një yll i vërtetë filmi. Tërë shtypi jugosllav me ditë të tëra shkruante në superlativ për suksesin e filmit e veçanërisht për Bekimin. Vallëzimi në gala mbrëmjen e festivalit dhe flirti me yllin e filmit amerikan Shirli Meklejn, e cila ishte anëtare e jurisë së festivalit, e vunë Bekimin në faqet e para të shtypit francez.

Regjisori Aleksandar Petroviq e ndan Çmimin e jurisë për regji me kolegun e tij shumë të njohur anglez Xhozef Louzi, i cili në atë kohë thuhej se refuzon të paraqitet të marrë çmimin bashkë me një regjisor nga Ballkani!

Në ditën e ndarjes së çmimeve të festivalit, kur Bekimi Fehmiu tashmë ishte kthyer në Beograd dhe të gjithë ishin të bindur se do të fitonte Palmën e artë si aktor, e priste një avion special për ta çuar në Kanë. Por, propozicionet festivalit ishin të tilla që një film nuk mund të merrte dy çmime, e Bekimi mbetet pa u shpërblyer. "Mbledhësit e puplave" një vit më vonë hyn në konkurrencën e ngushtë prej pesë filmave për çmimin Oskar në gjuhën e huaj, por triumfon çeku Jizhi Mencil me veprën "Trenat e kontrolluar rreptësisht".

Edhe një e dhënë për këtë film. Në të gjitha anketat me kineastëve jugosllavë "Mbledhësit e puplave" shpallet filmi i mirë i të gjitha kohëve në Jugosllavi. Por festivali i Kanës Bekimit do t'i hapë dyert e filmit botëror. Menjeherë nënshkruan një kontratë me producentin e famshëm Dino de Laurentis. Pason xhirimi i serialit "Odiseja" me regji të Franko Rosit dhe hapen dyert e filmit botëror për Bekimin. Në vitin 1968 shkon në Holivud për të xhiruar filmin "Aventurierët", me regji të Luis Xhilibertit. Bekimi luan rolin kryesor, të plejbojit Purfirio Rubiroza, sipas romanit të Harold Robinsit.

Krahas tij luajnë edhe shumë yje të njohura të Hollivudit, si Kendis Bergen, Olivia de Hevilend, Ernest Borgnin, Sharl Aznavur, Fernardo Rej, Li Tejlor Jang e disa të tjerë. Por në film luan edhe diva shumë e bukur italiane e operës Ana Mofo. Me këtë film Bekimi bëhet një yll internacioinal i filmit.

Në Holivud i propozojnë Bekimit ta marrë një emër tjetër, sepse vështirë e shqiptojnë amerikanët, por Bekimi refuzon kategorikisht. Përkundrazi ai me mburrje kudo që paraqitet e thekson përkatësinë e tij shqiptare. Premiera e këtij filmi mbahet në Nju Jork, ku Bekimi do të paraqitet me veshje të stilizuar kombëtare shqiptare, që ia kishte qepur disenjatori më i njohur jugosllav. Pas premierës Bekimi vjen në Prishtinë dhe në redaksinë e gazetës Rilindja rrëfeu gjerë e gjatë për filmin dhe përshtypjeve në Holivud, për djalin e tij të porsalindur Uliksin që e kishte pagëzuar nga dashuria për heroin e Homerit. Por një sëmundje e papritur e ndan përkohësisht nga kamerat. Pas pak kohe xhiron një film uestern me regji të Bërt (Burt) Kenedit - "Dezertori" - në të cilin luajnë edhe disa legjenda të Holivudit, si Xhon Hjuston, Vudi Stroud, Riçard Krena, Çak Konors. Bekimi luan rolin kryesor të një oficeri të ushtrisë amerikane i cili pas vrasjes së gruas arratiset për t'u hakmarrë...

Kthehet në Beograd ku xhiron disa filma në Jugosllavi dhe Itali. Me këtë rast duhet veçuar "Kurthin për gjeneralin", "Deps" (Kroaci), "Koshava", ndërkaq në Itali xhiron filmat "Libera, amore mio" (1973) me regji të Mauro Boloninit, ku luan edhe diva italiane Klaudia Kardinale, pastaj "Ultima neve di primavera", bashkë me Agostina Belin, "Kalostro", "Sallon Kiti". Në vitin 1975, Bekimi paraqitet në filmin "Leja për vrasje" bashkë me divën e njohur të Holivudit Ava Gardner, të cilën e

quante një "zonjë e rëndë" të filmit, dhe aktorin e famshëm anglez Dirk Bogard. Gjatë viteve '70 ai xhiroi edhe disa filma. Me këtë rast duhet veçuar filmin amerikan "E dielja e zezë" (Black Sunday) me regji të Xhon Frankenhajmer, ku Bekimi interpreton rolin e një palestinezi të vetëdijshur, i cili refuzon të marrë pjesë në ngritjen në erë të një stadiumi sportiv në SHBA.

Në vitin 1977 Bekimi do të xhirojë filmin "Edukata speciale" ku regjisor është një debutant, Goran Markoviq, i cili i takon shkollës së famshme filmike të Pragës. Është interesant të theksohet se ky film në festivalin e filmit jugosllav në Pula, pritet shumë mirë nga kritika, por kritikohet interpretimi i Bekim Fehmiut se kinse është shumë "hollivudian". Gjatë viteve '80, Bekimi do të xhirojë edhe disa filma dhe drama televizive në Jugosllavi e Itali, si "La voce", "Tregimi i fundit", "Disperetamente Giulia" "Të kuqtë e të zinjët" "Ili cuore e la spada", "Bambino di nome Jesus" etj. Ndaj Bekim Fehmiut, jo pak aktorë serbë kanë pasur xhelozë e smirë. Gjatë xhirimit të filmit "Koshava" (1974) intoleranca e aktorit serb B.Zh. ka mundur t'i kushtojë me kokë Bekimit.

Por ka pasur edhe aktorë që e kanë admiruar atë për karrierën e tij të suksesshme.

Gjatë karrierës së tij internacionale filmike ka interpretuar mbi 50 role në filma e seriale televizive.

ISMAIL KADARE

Qëndresa

Romanin “Kështjella” Kadare e nxori në 500-vjetorin e vdekjes së Skënderbeut dhe me të fitoi çmimin e parë të konkursit. Por ngasja për kështjellën, në një kuptim më të gjerë, në veprën e tij duket më herët dhe nuk mbaron me këtë libër. Figurativisht simboli i kështjellës është qysh tek “Poemë e blinduar”. Njëfarë kështjelle ishte padyshim edhe kali i drunjtë i Gent Ruvinës dhe i miqve të tij të ngujuar të novelës “Përbindëshi”. Një kështjellë gjigante është piramida në novelën “Ndërtimi i piramidës së Keopsit”. Kulla e ngujimit e Gjorg Brezftoftit në “Prillin e thyer”, bashkë me shumë kulla të tjera me një frëngji të vockël të vetëmbrojtjes prej hakmarrjes, janë kështjella të vogla që

sundonin malësitë shqiptare. Pallati i Ëndrrave, me seksionet e tij, është ndërtuar në formën e një kompleksi kullash të hekurta.

Vetë laboratorin krijues i shkrimtarit, i përshkruar me hollësi në librin "Ftesë në studio", ka pjesët e rezervuara të saj, që mbrohen prej daljes në dritë si në një burg të heshtur. Hauret dhe steretë e shtëpive gjirokastrite në "Kronikë në gur", shtëpia etnografike e princit të Mirditës (Gjomark) tek "Prilli i thyer", vila e frikshme dhe e harruar e ish-ministrit në prag të gjyqit tek "Koncert në fund të dimrit", kampi i rreptë i të internuarve tek "Përçmimi", baza ushtarake e Vlorës (Pasha-Liman) tek "Dimri i madh", shtëpia me portë (detyrimisht) të hapur e dijetarit Martin Shkreli në Prishtinë tek "Krushqit janë të ngrirë", janë vetëm disa nga variantet e shumtë të simbolit të kështjellës në veprën e Kadaresë.

Prej botimit të parë (1968), deri tek botimi i fundit (1995); prej "Kështjellës" deri tek "Daullet e shiut", për të cilën shkrimtari është shprehur se nuk ka për të vënë dorë më, ekziston një ndryshim i dukshëm jo vetëm artistik (si është shkruar), por edhe në përmbajtje (çfarë është shkruar). Nëse në botimin e parë romani është quajtur si një vepër e qëndresës historike shqiptare, si një përmendore e heroizmit kombëtar, me një aludim të qartë që mund ta quanim "antibllokadë", theksi i së cilës drejtohej kundër pushtuesve të huaj, që nuk lanë kërkim pa bërë për t'u ndërprerë zotërve të kështjellës

"Al-Hisar" edhe ujësjellësin; në botimin e dytë, ndonëse nuk ndryshon asgjë në evokimin e trimërisë së arbërve të shekullit të 15-të, ndryshon pothuajse rrënjësisht ai që mund ta quanim "mbitekst" apo "lexim i super-pozuar": "Daullet e shiut" nuk është romani i anti-blokadës së imponuar, por denoncim i vetëveçimit (izolimit) të zgjedhur vullnetarisht.

Sido që të jetë vetë simboli i kështjellës, në traditën letrare shqiptare, i ka bartur historikisht të dyja mbishtresat kuptimore: ajo është figurë qëndrese, rrethimi ose ngujimi (izolimi, në kuptimin modern).

Dilema mes Urës dhe Kështjellës

Bashkë me një varg veprash të tjera, "Ura me tri harqe" bën pjesë në një cikël romanesh e novelash, që Kadare i ka shkruar me një qëllim të qartë për të krijuar imazhin e një "Shqipërie tjetër", e cila ndryshon shumë nga ajo që shihet me sy, një Shqipëri me princa, kontë, dukë, ipeshkvinj, udhëtarë të ditur, prelatë të shkolluar, që gati ishin të përjashtuar nga letërsia si figura me misione pozitive.

Autori, në pamundësi për të shprehur hapur mendimin e tij mbi zhvillimin e avancuar të qytetërimit perëndimor, përpiket t'ua tregojë këtë lexuesve duke gjetur në traditën e "Shqipërisë tjetër" atë fazë të

historisë kur vendi, edhe sipas dijetarëve, ecte në një hap me fqinjët e tij përtej Adriatikut.

Shkrimtarin nuk mund të mos e shqetësojë fakti i njohur se balada shqiptare është e vetmja në Ballkan që bën fjalë për një murim kryesisht në kështjellë. Ai është i vetëdijshëm se kjo është kushtëzuar nga rrethanat kritike historike që kanë shoqëruar fatin e popullit të tij. Është e vështirë që një popull vazhdimisht në rrudhje të vendosë pëlqimin e urës para kështjellës. Kjo, ndoshta, është një nga dilemat më tronditëse që kanë përjetuar shqiptarët. Ura është për ta edhe e dëshiruar, por njëkohësisht edhe e frikshme, sepse "në urë kalon i miri dhe i keqi, miku dhe anmiku". Rreziku i ekspansionit, që mund ta kthejë urën e Ujanës së Keqe në një kuçedër, ndihet në gjithë romanin, si një kontekst historik i domosdoshëm për të treguar se edhe në "Shqipërinë tjetër" marrja e vendimit ka qenë e vështirë.

Sikurse në rrjedhat e historisë, edhe në këngë, populli i ka ngritur urat, duke u kushtuar edhe flijimin njerëzor, sa herë që kanë fryrë erëra paqeje dhe miqësie. Por shumë shpesh është mbyllur në kështjella, madje me tri - katër rrethime, pikërisht për shkak të erërave të frikshme që i kanë zënë vendin paqes.

Këto ndërrime lidhen jo me gjurmë vitesh, por me prurje kohërash historike. "Shtatqin vjet do t'i djeg kullat", i kërcënohet një prej heronjve kreshnikë të eposit shqiptar kundërshtarit të vet.

Në veprën e Kadaresë dilema midis urës dhe kështjellës është po aq tronditëse sa në vetë historinë e popullit. Në formën më të pjekur artistike kjo dilemë shprehet në romanet "Kështjella" dhe "Ura me tri harqe". Në një farë mënyre ato janë vazhdim i njëri--tjetrit.

Ai që krijoi kështjellën e qendresës në kushtet e darës së armiqësisë nuk mund t'i lejonte vetes të mbetej pa urë i ndarë dhe i vetmuar nga bota. Këtë ide Kadare e arriti duke krijuar "Urën me tri harqe", vështruar në shumicën e rasteve si një çmitizim i legjendës.

Ringjallja dhe kulti i besës

Romani i Kadaresë "Kush e solli Doruntinën" ka në qendër një personazh që ringjallet. Ndoshta nuk është aq e rëndësishme se ç'mundim a mision e kthen atë në këtë botë. Më e rëndësishme është se si u ringjall ai, me ç'fuqi shpirtërore erdhi prej andej nga nuk ka kthim, duke u barazuar me një Krisht?

Ringjallja e Kostandinit është kyçi i librit "Kush e solli Doruntinën". Ai dëshmon se fuqia e njeriut mund të jetë e barabartë me të hyjve. Pikërisht shpresa e një rilindjeje, besimi i një ringjalljeje të njeriut, të energjisë dhe shpirtit të tij, në një kohë kur rreziku i shuarjes së individit në bashkësi ishte evident, duket se ka qenë joshja e autorit. Kalimi prej ringjalljes biblike tek

ringjallja laike ishte një hap epokal, ndoshta po aq sa rrëmbimi i zjarrit perëndive në hershmëri apo dalja e njeriut jashtë sistemit yjor sot. Ky akt, i cili në shumicën e rasteve ishte lënë në një sfond mistik, u trajtua në mënyrë mjeshtërore në veprën e Kadaresë.

Doruntinën e solli fjala e dhënë, thotë kapiteni Stres që kryeson hetimet. Doruntinën e solli besa shqiptare, nxitojnë moralistët. Doruntinën e solli pengu i inçestit të pakryer, thonë psiko-kritikët. Doruntinën e solli një aventurier dashurie, një "dikush" i rastit, pohon njëri prej priftërinjve.

Nëse në të gjitha këto pohime ka diçka prej së vërtetës, mbetet pa u thënë thelbi: Doruntinën e solli Rilindja, era e furishme e ndryshimeve të saj, tronditja e moralit të Mesjetës dhe kërkimi i një dhjate të re humaniste, rebelimi i mendjeve të fuqishme të kësaj epoke për t'i dhënë njeriut kuptim sublim; përpjekja e tyre për t'u bërë zotër të vetes, për të mbërritur tek shën Njeriu. Atributi i ringjalljes, kësaj radhe nuk ndodh në versionin biblik,

Por sipas nje balade laike të vendit. Kostandini është, në mënyrën e vet, një Mesi për bashkatdhetarët. Ai mbërriti të parealizueshmen dhe u afroi njerëzve madhështinë: kthimin nga vdekja, mundjen e saj, qoftë edhe në formë të reduktuar. Fryma e rilindjes dhe shpresa e përtëritjes kanë krijuar historikisht energji shpirtërore të mëdha.

Kadareja ekspozoi një nënshtat krejt të mospërfillur të kulturës kombëtare.

Legjenda e Doruntinës nuk ishte "punë legjendash", por konkluzion i një epoke historike.

Ajo shpallte lidhjet e lashta të kulturës së popullit tonë me ato të vendeve të qytetëruara të kontinentit. Në më pak se 50 vargje të parët e shqiptarëve jepnin e merrnin me një botë të tërë, bënin krushqi gjer në Bohemi, lidhnin aleanca me baronë e fisnikë të afërt e të largët, lëviznin të sigurt në gjithë hapësirën kontinentale.

Ata ishin pjesë integrale e kësaj bote. Miqësitë e tyre gjendeshin "nëntë male kaptuarë". Të shkoje në viset gjermane apo dhe më tej për ta ishte njësoj si të thoshje: "po shkoj në krushqi".

Në Shqipërinë e mbyllur, pa një mik, pa një aleancë, pa një portë të hapur, të fundit të viteve '70, kjo ekspozë mund të ngjallte zemërimë e pakënaqësi, mund të shkaktonte inatë e mëri. Novela predikonte hapjen, kur politikanët kërkonin mbylljen.

Autori u paraqiste si shembull humanizmi bashkatdhetarëve të vet lashtësinë e tyre, kur në vend zotëronte një pikëpamje çuditërisht e ngulitur, sipas së cilës vlerat e vërteta ishin krijuar në gjysmëshekullin e fundit.

Mesazhi i Kostandinit është thirrja për një rilindje morale.

Dimrat në romanet e Kadaresë

Në qoftëse "Dimri i madh " (në botimin e parë titullohej "Dimri i vetmisë së madhe", 1973), i cilësuar nga kritika (pas përfundimit të fushatës sa cinike, aq dhe mediokre, të ndërmarrë kundër tij) si një roman-epope, kishte qenë dëshmi artistike e një tronditjeje dhe qëndrese heroike, "Koncert në fund të dimrit" (1988) do të jepte kryesisht dimensionin humoristik të një ngjarjeje krejt të ngjashme me të parën, veçse tashmë e njohur dhe e provuar nga protagonistët e saj, të mësuar në rrjedhat e historisë së tyre të lashtë, që rebelohen pa mundim ndaj supershteteve.

Në këtë roman serioziteti është po aq i pranishëm sa dhe e qeshura; drama dhe parodia, epopeja dhe farsa, tragjizmi dhe komizmi, aty shkrihen dhe aty alternohen, gjendjet emocionale janë nga më të befasishmet. Me të drejtë vetë autori, në një interviste dhënë gazetës franceze "Le Monde", e ka karakterizuar atë si një "roman me shumë registra, si një "vepër polifonike", si një libër artistik sa dhe shkencor, politik sa dhe filozofik, histori e luftërave ideologjike në shkallë të brendshme e globale, kronikë e një bote të trazuar në këtë fund shekulli novator. Kjo shkrirje e shumë planeve, emocioneve dhe ideve, flet për një vepër që gjykon kohën dhe botën, njeriun dhe shoqërinë, të sotmen, të shkuarën dhe të ardhmen. Ky roman është ndoshta vepra

më e kompletuar e Kadaresë nga pikëpamja e mendimit. Spektri ideologjik i saj i përmban të gjitha ngjyrat, bashkë me nuancat e tyre.

Polifonia që përmend autori nuk është gjë tjetër veçse një eufemizëm për shumësinë e ideve ose pluralizmin, siç e themi sot me vend e pa vend. I prerë në dy boshte, diakronikisht dhe sinkronikisht, romani ka shtrirjen dhe thellësinë e një vepre të fuqishme, ku hyjnë e dalin shqiptarë e të huaj, nëpunës të thjeshtë e zyrtarë të lartë, ministra të rrëzuar nga pushteti dhe autoritete të reja në ngjitje, djem e vajza shkollarë dhe plaka të sklerotizuara, gjithë bota jonë e vëzhguar nga brenda e nga jashtë, me një përfaqësim enciklopedik; gjithë koha që jetojmë, me një pasqyrim kaleidoskopik. Ai është një libër i menduar me tërë fuqinë intelektuale të shkrimtarit të madh dhe i shkruar fund e krye me gjithë spontaneitetin e poetit shpërthyes. Një libër që lind libra të rinj.

Nëpunësi i pallatit të ëndrrave

Libri "Nëpunësi i Pallatit të ëndrrave" e jep realitetin e kohës dhe të njerëzve të saj prapa metaforave të tilla të gatshme si "pallati i ëndrrave", nëpunësit dhe interpretuesit e tyre, ëndrra kolektive dhe individuale, ëndrra fatsjellëse dhe rrezikndjellëse, ëndrra e rëndomtë

dhe bash-ëndrra. Të gjitha këto Kadaresë ia ofroi mekanizmi i ndryshkur i shtetit të fuqishëm të perandorisë otomane në fundin e tij . Karakteri shumëkohësh i "Nëpunësit të Pallatit të Ëndrrave", përkundër karakterit shumëkuptimësh të një vargu veprash të tjera të Kadaresë, lidhet me raportin themelor që qëndron në boshtin e romanit: raporti i individit me shtetin, më saktë raporti i individit që ka ambicjen të integrohet në strukturat shtetërore dhe që e gënjen mendja se do të fuqizojë veten prej fuqisë së pushtetit, por në të vërtetë, duke e parë nga brenda këtë ngrehinë të përbindshme, ai njeh dobësinë dhe pafuqinë e tij, sheh peshën mbytëse të strukturave gjigande të makinës perandorake, e cila ndryshon vetëm nga përmasa fizike, por jo nga mënyra e të ushtruarit të artit të shuarjes së identitetit njerëzor.

Kadareja i ka dhënë karakterin e një konflikti të përjetshëm marrëdhënies pushtet/individ. Çdo përpjekje e individit për t'u matur me shtetin, për të depërtuar në brendësi të tij dhe për ta marrë me të mirë, është e dështuar. Individi në çfarëdo raporti që ta vendosë veten me shtetin, mbetet i kërcënuar prej tij. Fati i Ebu Qerimit, që e përjeton si shtegtim nëpër ferr kalimin nga një pjesë e "pallatit të ëndrrave" në tjetrën, ndonëse është i përkrahur nga një klan i fuqishëm që kontrollon e administron pushtetin, siç ishin Qyprillinjtë, është gjithnjë i kërcënuar dhe pikërisht për këtë arsye shërben si një paralajmërim për fatin e shtetasve në përgjithësi.

Rruga e mbërritjes tek thelbi i "Nëpunësit..." ka qenë e ngatërruar dhe plot keqkuptime, të shmangshme e të pashmangshme.

Mungesa për një kohë mjaft të gjatë e shtetit kombëtar krijoi tek shqiptarët nderimin ndaj tij; kjo ishte krejt e nënkuptueshme: në përgjithësi gjërat e munguara lindin respekt, lakmi, adhurim, deri hyjnizim. Për Shqipërinë e Pasluftës, të gjendur përballë detyrës së ngutshme për të çrrënjësuar monarkinë e për të ndërtuar një shtet me bazë të gjerë popullore, siç u nis në krye, ky ishte një shans i madh. Por ky shans mbeti vetëm një ëndërr.

Në marrëdhëniet midis individit dhe shtetit, që pasqyrojnë shkallën e qytetërimit të një shoqërie, në vend e në emër të nderimit hyri përulja, në vend e në emër të respektit hyri lakmia dhe arrivizmi -Ky ka qenë një nga deformimet më të thella dhe një shkallmimi i vërtetë i vlerave dhe i karaktereve njerëzore. Për fat të keq u desh plot një gjysmë shekulli për ta kuptuar këtë. Shkrimtari e pati parathënë një gjë të tillë shumë kohë më përpara. Por edhe këtij shansi iu kalua përmbri.

"Nëpunësi i Pallatit të Endrrave" u dha goditjen e parë këtyre marrëdhënieve krejtësisht të shtrembëruara midis të drejtës së njeriut dhe të drejtës së shtetit. Ai e ktheu përrnby, kokëposhtë, piramidën shtetërore. Ishte hera e parë që nomenklatura e ndereve denoncohej si shkallëzim i fajit dhe i përgjegjësive; që hierarkia e lavdisë karakterizohej si hierarki e turpit; që vlerat e

vërteta njerëzore kërkoheshin jashtë korpusit kryesor të piramidës së shtetit, jo brenda saj. Ndoshta kjo ishte arsyeja që kritikët nxituan të shmangnin çdo paralelizëm me kohën, duke zbuluar, madje, për çudi të çudirave, se "Tabir Saraj" paskësh qenë një institucion i vërtetë i administratës perandorake, kështu që "Nëpunësi..." nuk mund të ishte tjetër, përveçse një vepër historike, një kronikë e funksionimit të tij. Me qëllim historia dhe jeta bashkëkohëse, dita dhe tradita, ndryshe nga herët e tjera, u vështruan pa ndonjë lidhje midis tyre. Përfundimi do të ishte i rrezikshëm.

Kontestimi ishte hamletian. Duhej të ishte krenar për qenien në një nga zyrat e hierarkisë së lartë të shtetit apo, përkundrazi, duhej të ishte kokulur?

Një invers i tillë i përjetimit të statusit të nëpunësit s'ishte parë e dëgjuar ndonjëherë. Pyetja "karrierë apo kalvar", që paraqiti Kadare përmes fatit të Nëpunësit të Tabir Sarajit, qëndronte tashmë si një paralajmërim orakulli: "O ju që hyni në këtë shërbesë, a e dini fatin tuaj? Hiqni dorë nga iluzionet, ose, përndryshe, hiqni dorë nga vetja. Ajo që ju e quani rrugë e ngjitjes nuk është gjë tjetër veçse një mashtrim i madh. Nëse keni vendosur të mos ndaleni as pas këtij njoftimi, atëhere mos prisni famën, por çpersonalizimin, mos prisni lirinë por syrgjynin. Ju nuk i takoni më vetes!"

Me "Nëpunësin..." Kadareja nyjëtoi atë ide që ai vetë më pas do ta quante "faj kolektiv". Tabir Saraji

funksionon pikërisht mbi bazën e shoqërizimit të përgjegjësi.

Por, ndërkaq, ekziston edhe një shkallëzim krejt i qartë i tyre. Faji i shtetit të panënshtuar ndaj ligjit është kolektiv vetëm në kuptimin që bashkon në përgjegjësi të drejtpërdrejtë e të tërthortë njerëz në pushtet e jashtë tij, ideatorë e ekzekutorë, aktivistë e jallan- shahitë, konformistë e servilë. Por më tej faji ndahet sipas një rregulli krejt të përcaktuar.

Për të zezën e vet, administrata shtetërore krijoi e ligjëroi emërtesën e mburrjes e të karshillëkut, që do të shërbente më pas për një kallëzim të pagabueshëm të pjesëmarrjes në faj.

Gjyqësia e Kadaresë u vërtetua nga koha si një gjyqësi e mençur. Rreptësia ndaj atyre që shpërdoruan respektin e popullit ndaj pushtetit, mirëbesimin e tij, ishte më se e nevojshme dhe ndëshkimet krejt të merituar. Shkrimtari sulmoi bastionin më të rëndësishëm të shtetit, majën e piramidës së tij. Ai çmistifiloi enigmën e asaj që quhet "arsye shtetërore", në emër të së cilës mbulohen turpet dhe fëlliqësitë më të mëdha të kësaj bote. Ai shembi kultin e rangut, mitin e zyrës e të nëpunësit, idoltarinë e fryrë të "atyre që janë lart". Dhe aty ku fillon shembja e idhujve të remë, aty ka nisur emancipimi.

Kronikë në gur

"Kronikë në gur" është një prej romaneve të hershëm të Ismail Kadaresë. Ndryshe nga letërsia e deriatëhershme për Luftën Antifashiste, e karakterizuar nga dy kampe personazhesh - partizanë e pushtues, ky roman solli një imazh më të ndërlikuar të saj, ku ndërthuren fate ushtrish të huaja të pakteve të ndryshme kundërshtarë, fate shtresash të ndryshme brenda për brenda tyre, fate të njerëzve të lidhur vullnetarisht me rezistencën ose të mobilizuar prej komandës, fate të indiferentëve, të sehirxhinjve dhe të kundërshtarëve.

Që lufta ishte një kohë mjaft më e ndërlikuar se ajo që shërbehej prej një tradite letrare skematike; kjo mund të shihet edhe në fatin e një familjeje qytetare në vendin e "kronikës në gur", ku konflikti hyn brenda saj, duke ia tronditur regjimin tradicional.

Me këtë roman I. Kadare pasuroi temën e Luftës Antifashiste, duke sjellë një shikim prej fëmije për evokimin e ngjarjeve të saj. Rrëfimi në vetën e fëmijës, në vetën e personazhit që evokon fëmijërinë e autorit, me "pafajësinë" e vet, megjithëse i ka dhënë romanit njëfarë karakteri autobiografik, njëherësh e ka mbrojtur atë prej qëndrimit të kritikës.

Duke qenë vështrimi prej fëmije një vështrim thelbësor në roman, lexuesi e ka të vështirë të dallojë se

ku fillon koncepti i arsyetuar i saj e ku mbaron të konceptuarit si lojë.

Në studimin "Subversion kundër konformizmit" një studiues ka këmbëngulur se romani "Kronikë në gur" është një vepër hyjnizuese e Luftës Antifashiste, një "roman komisarësh", dhe se përpjekja e autorit për të hyrë në lëkurën e fëmijërisë së vet nuk është gjë tjetër veçse një procedim letrar për të mbuluar konformizmin.

Përkundër këtij mendimi, shumica e studiuesve bashkohen në vlerësimin se "Kronikë në gur" është një vepër atipike në pikëpamjen metodologjike, e shkruar me një liri që tejkalonte kufizimin ideologjik dhe vlerësimin e partishëm për luftën.

Sipas një pjese të studiuesve, "Kronikë në gur", duke pasur këtë vështrim, në fakt sjell tek lexuesi një përjasje psikanalitike frejdiste rreth luftës, ose jetës së qytetit në kohë lufte. "Kronikë në gur" është një prozë me subjekt të reduktuar, gjë jo fort e përshtatshme nga pikëpamja teorike për një letërsi të orientuar.

Me këtë vepër Kadare bëri përpjekjen e parë për t'i dhënë vlerë letrare së zakonshmes, së rëndomtës, madje së shëmtuarës dhe absurdes. "Kronikë në gur" është një vepër e përshkruar nga grotesku. Vështrimi i luftës me sytë e fëmijës i ka dhënë mundësi autorit që t'i shohë ngjarjet dhe personazhet e saj pa ndonjë partishmëri të dukshme.

"Kronikë në gur" përmban vlera të rëndësishme të një letërsie të mirëfilltë etnografike. Tradita e kësaj letërsie në qytetin e Gjirokastrës është më e hershme, ajo afirmohet mirë me botimet e Musine Kokalarit në vitet '40, sidomos me "Siç më thosh nënua plakë" dhe "Sa u tunt jeta". Etnografizmi në romanin e Kadaresë u jep edhe mjediseve një cilësi jotipike, ndryshe prej kërkesave të rrepta të metodës së realizmit socialist.

RAMIZ KELMENDI

Profesor Ramiz Kelmendi është themelues i fakultetit të parë të gazetarisë në hapsirat shqiptare, në fillim të viteve nëntëdhjetë, ndërkohë që ka lënë gjurmë në ngritjen e kulturës shqiptare në Kosovë, Shqipëri dhe Diasporë.

U lind më 20 dhjetor 1930. Kelmendi i takon plejadës së parë të krijuesve të pasluftës së Dytë Botërore, i cili lëvroi me sukses letërsinë tonë e që me shkrimet e tij asnjëherë nuk e humbi aktualitetin dhe komunikimin me lexuesit e tij edhe tash në moshën 80 vjeçare shkruan shkrime brilante në të përditshmën "Zëri ditor".

U gëzova shumë kur e pash sot (24.3.2010) në Sheshin Skënderbe të Prishtinës...

Ishte i freskët, shëndosh si topi, siç themi ne nga ana e Dukagjinit.

Dikush nga krijuesit e të njejtës gjeneratë për një kohë të shkurtër do të ecë përkrah Ramiz Kelmendit, e më vonë shkrimet e disave do të zbehen, kurse Ramiz Kelmendi gjithnjë e më tepër do të perfeksionohet për të arritur majat e suksesit letrar.

Shkrimtari dhe gazetari i mirënjohur shqiptar Ramiz Kelmendi, me rastin e ditëlindjes së 80-të, u nderua me çmimin "Pena e artë për vepër jetësore" nga klubi i gazetarëve "Feniksi" në Shtime. Me këtë rast, kritiku letrar Vehap Shita, shkrimtarin, publicistin, gazetarin, pedagogun dhe punëtorin e kulturës, siç e ka quajtur ai Ramiz Kelmendin, e quajti biri i Rugovës kreshnike, i rritur në Pejë rreth Alpeve Shqiptare. Sipas tij, Ramiz Kelmendi është i orientuar kah format bashkëkohore shprehëse e artistike duke aplikuar me plot sukses si novelën me tematikë dashurie, ashtu edhe atë me tematikë shoqërore e sociale. Kelmendi ka rekomanduar të gjithë nxënësit dhe studentët që vetëm me lexim mund të shënojnë arritje. Ramiz Kelmendi gjatë manifestimit kulturor "Takim me krijues" ka thënë se tash e tutje qyteza e Shtimes do të ketë një respekt të veçantë nga ai.

Si në çdo fushë tjetër, po ashtu edhe në letërsi ekzistojnë barriera, gracka, intriga e xhelozia, nga se për të dobëtit këto janë arma më e fuqishme për të penguar veprimtarinë jo vetëm të një fillestari, por edhe të një

njeriut me përvojë të gjatë. Ramiz Kelmendi, edhe pse aso kohe në moshë të re, do të dinte t'i përballonte intrigat e kohës dhe do të lundronte drejt arritjes së suksesit vetëm me punë kualitative, duke qenë i vetëdijshëm se vlerat do të jenë ato që e ngrenë personalitetin e një individi, e mbase edhe të një shoqërie. Mirëpo, ndër njerëzit tanë ka edhe shpirtngushtë, aq sa sukseasi i Ramiz Kelmendit disave po u verbonte sytë, disave po ua trulloste mendjen. Dhe, mjerisht, të paktë ishin ata që po i gëzoheshin arritjeve të djaloshit që vinte nga zona e Rugovës epike.

Ai injoroi xhelozet, intriguesit dhe sahanlëpirësit. Çuditërisht, smirëzinjtë do të ngulnin këmbë në qëndrimet e tyre të mbrapshta që nga mosha rinore e deri në kulmin e pleqërisë së tyre dhe të autorit.

Filozofi gjerman Shopenhaueri kishte shkruar se karakteri i njerëzve nuk ndryshon kurrë dhe se i keqi gjithnjë do të mbetet i keq. I keqi, për interesa të tij personale, mundet që për një moment të caktuar të shndërrohet në bamirës, por përseri do t'i kthehet karakterit të mëparshëm.

Ramiz Kelmendi tërë jetën më kot kishte shpresuar se një ditë edhe xhelozët, edhe intriguesit edhe sahanlëpirsit do të mbledhin mendjen. Andaj, më në fund një ditë publikisht do të detyrohej të hiqte dorë dhe t'i injoronte përjetësisht.

Ramizi nuk hoqi dorë nga askush, as nga ata që e xhelozonin, e as nga ata që e admironin, por thjeshtë

hoqi dorë nga lufta e kotë e thashethemeve të injorantëve primitivë, kështu që xhelozët i la të xhelozonin e tjerët ta admironin.

Në fund të fundit, nëse askush nuk të xhelozon, ti nuk ekziston. Vetëm debilët, të çmendurit e të cunguarit nuk i xhelozon askush. Përmes xhelozëve e kuptojmë sa vlejme. Xhelozia është një lloji mase e vlerave tona.

Tani në moshën 80 vjeçare Ramiz Kelmendi ndjen një krenari për rrugëtimin e tij krijues. Në moshë të thyer Ramiz Kelmendi do t'i kujtohën ditët e vështira të fëmijërisë dhe shkollimi i tij me njëqind vuajtje. Për çdo gjë që kishte vepruar dhe perjetuar gjatë jetës, Ramiz Kelmendi është ballëhapur, por në thellësinë e shpirtit të tij e ka vetëm një zbrazëturë, në thellësinë e zemrës e mbanë një peshë që e rëndon. Edhe në terrin e natës kur tjerët bëjnë gjumë të rehatshëm Ramiz Kelmendi e ka një dëshirë që kurrë nuk arriti ta plotësojë. Ah, vetëm edhe kjo dëshirë të ishte plotësuar dhe Ramiz Kelmendi do ta ndjente vetën njeriun më të lumtur në botë. Dhe, një ditë, më i mërzhitur se kurrë, Ramiz Kelmendi pa i treguar askujt do të dali për të ecur i vetmuar. Në vetmi mund të fliste me veten e me tjerët.

Në vetmi mund të komunikonte mbase edhe me shpirtëra të vdekur. Në ecje e sipër rruga e shpuri në varreza.

Nuk e dinte nëse rastësisht u gjend para varrit të babait apo qëllimisht ishte nisur për të komunikuar me prindin që tani bënte gjumin e amshuar.

U ndal. U gjunjësua. I rrodhën dy pika loti.

Ledhatoi barin mabi varrin dhe ndjeu sikur para tij iu paraqit vetë babai. "Ah, babë! Sa do dëshiroja që të ishe i gjallë e të shihje suksesin e birit tënd. Babë, unë jam Ramizi që dikur merakoseshe për fatin tim e tani shiko se ku kam arritur. Jo vetëm që e kam kryer fakultetin por edhe e kam krijuar fakultetin tim". U ngrit dhe sikur fytyrës ndjeu një përkëdhelje të lehtë. Ishte përkëdhelje e dorës së shpirtit të babait apo ndoshta vetëm një përkëdhelje e erës së lehtë, që përshkoi fusha e bjeshkë, këtë Ramiz Kelmendi kurrë nuk do ta dinte. U nis në drejtim të qytetit, më i lehtësuar dhe më i gëzuar, ngase kishte përshtypjen se fjalët e tij i kishte dëgjuar prindi që aq shumë kishte dëshiruar që fëmijet të kryejnë studimet.

"Shtatë persona ndjekin autorin"

Asnjëherë Ramiz Kelmendi nuk do t'i kuptonte ata të cilët e pengonin në punën e tij, e ndoshta pikërisht kjo i ka ndihmuar që autorit t'i lind ideja për shkrimin e romanit "Shtatë persona ndjekin autorin".. Por për arsyeje se tani është në 80 vjetorin e jetës në pika të shkurtra ia bën një analizë romanit "Shtatë persona ndjekin autorin". Pse shtatë? Nngase numri shtatë në legjendat tona është numër mitik? Koinçidencë, rastësi? Zgjidheni si të doni!

Artan Çeliku, një gazetar, e para së gjithash shkrimtar, një ditë prej ditësh zhduket nga syri i jetës së përdtishme të njerëzve që e rrethonin. Zhdukja e Artan Çelikut bëhet objekt i interesimeve të njerëzve të Prishtinës.

Rrethi intelektual, gjegjësisht pseudointelektual i Kryeqytetit të Kosovës, interesohet për zhdukjen misterioze të Artan Çelikut. Ku shkoi Artan Çeliku? Si humbi pa gjurmë? Artani u burgos nga policia për veprimtari armiqësore?

Ndoshta Artani e kishte kaluar kufirin pa u zënë nga policia?

Me pyetje të tilla e kalojnë kohën shtatë persona të cilët e kanë njohur Artan Çelikun.

Ndjenin dhimbje për burgosjen apo zhdukjen e Artan Çelikut, apo thjeshtë kënaqësi?

Shtatë personat që interesohen për fatin e autorit simbolizojnë segmentin më destruktiv të shoqërisë sonë.

“Shtatë persona ndjekin autorin”, si bosht kryesor të temës ka thashethemet e disa individëve të cilët tërë kohën e kalojnë duke u interesuar për mënyrën e jetës së tjetërkujt.

Xhelozia, intriga, gracka, dyfytësia dhe etiketimet janë shpirti dhe ushqimi shpirtëror i shtatë personave destruktive, të cilët i pengon suksesi i tjetrit. Të shtatë individët nuk e xhelozojnë njeriun e huaj, të ardhur nga larg. Jo. Tërë forcat e tyre i bashkojnë kundër njeriut të tyre me të cilin u rritën në të njejtin qytet, e

ndonjëri, madje, në të njëjtën lagje. Mund të arrijë sukses kushdo tjetër por jo ai me të cilin në fëmijëri luanin bashkë. Shtatë personat paraqesin shtatë veçoritë negative kryesore të çdo shoqërie. Këto shtatë veçori dallohen mes veti me nuanca shumë pak të dallueshme.

Autroi Ramiz Kelmendi në veprën "Shtatë persona ndjekin autorin", trajton anën psikologjike të personazhëve të tij dhe mjeshtrisht futet në botën enigmatike të individëve destruktive, të cilët janë të bindur se bota sillet rreth tyre dhe se pa ndihmën e tyre asgjë e askush nuk mund të ketë sukses.

Shtatë persona që intersohen për zhdukjen e Artanit janë sinonim i së keqës. Qe të shtatët, secili në vete ka zhdërvjelltësi dhe aftësi të veçanta që bënë të dallohet nga personazhi tjetër. Prirjet e secilit kanë veçoritë e tyre në fusha të caktuara thuase janë të specializuar në profesionet e tyre të së keqës. Edhe pse secili prej shtatë personazheve kanë karakteristika të veçanta në fushëveprimët e tyre shkatërrimtare, prapsepapë qe të shtatë kanë një karakteristikë të përbashkët, që quhet xhelozia për të shkatërruar jetën e njeriut të suksesshëm.

Ramiz Kelmendi shquhet si rrëfimtari i veçantë lirik, si krijues që ka zgjuar polemikë, si mjeshtrë shumë i mire i gjuhës me një leksikë tejet të pasur, me reportazhet e tij që ngjallin kërshtëri tek lexuesit.

MBI VEPRËN E KADRUSH RADOGOSHIT

Kadrush Radogoshi u lind në Gjakovë më 15 Shtator 1948. Shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në Gjakovë, ndërsa Fakultetin Filozofik (Dega e gjuhës dhe letërsisë shqipe) e kreu në Prishtinë. Po aty kreu edhe studimet pasuniversitare të letërsisë dhe mori gradën “Magjistër i shkencave filologjike” duke mbrojtur tezën “Poetika e romanit bashkëkohor shqiptar me tematikë të shekullit të XV”.

Prej vitit 1969 e deri në vitin 1981 punoi në arsim, kur e burgosën dhe e akuzuan në bazë të nenit famëkeq 133, alinea 1 të Ligjit penal të ish - Jugosllavisë për vepër penale “propagandë armiqsore”, që nënkuptonte sanksionim të lirise së mendimit dhe fjalës së lirë.

Pas daljes nga burgu u ekskomunikua dhe iu mor e drejta e ushtrimit te profesionit të profesorit për 18 vjet me rradhë. Persekutimi i tij politik nga burokracia politike e Gjakovës shpesh herë mori permasat e linçimit publik.

Argumenti më domethënës për këtë është fakti se ishte i vetmi gjakovar në mesin e 237 izolantëve shqiptarë, kryesisht intelektualë, të arrestuar më 28 mars 1989 e të dërguar fillimisht në Burgun e Leskovcit e pastaj të shpërndarë nëpër burgjet tjera të Serbisë.

Në rastin konkret Kadrushi u dërgua në Burgun e Prokuples. Motivacioni i këtij arrestimi ishte dyshimi se këta intelektualë, të cilët ishin shquar në kundërshtimin e rrënimit të autonomisë së Kosovës, mund të ishin të rrezikshëm për rendin kushtetues të ish - Jugosllavisë.

Ky arrestim nuk ishte bërë me ndonjë vendim gjykatë, por me vendim policie të sugjeruar nga komitetet komunale te Lidhjes së Komunistëve të ish Jugosllavisë.

Duke qenë “i papërshtatshëm moralo-politikisht” për “sistemin e vetqeverisjes socialiste jugosllave”, qe i papërshtatshëm për t’u pranuar në Shoqatën e Shkrimtarëve të Kosovës nga viti 1981 gjer në vitin 1990. I tillë ishte edhe për redaktorët e të vetmes Shtëpi Botuese “Rilindja”.

(Libri i tij “Nekrologji për Sodomën” u censurua 7 vjet me radhë).

I papërshtatshëm “moralo-politikisht” ishte edhe për dy- tre hartuesit e antologjive, të cilët e kishin monopolizuar të drejtën për hartimin e antologjive me pëkrahjen direkte të politikës.

Në vitet 90 të shekullit XX ishte njëri ndër themeluesit e Sindikatave të Pavarura të Kosovës dhe njëri ndër udhëheqësit e tyre, në mesin e të cilëve pos Prof. Dr. Hajrullah Goranit, ishin edhe Hamëz Jashari (hero i kombit), Agim Hajrizi (dëshmor i kombit) e shumë të tjerë.

Në vitet 1992 – 1997 ishte kryetar i Klubit Letrar “Gjon Nikollë Kazazi” të Gjakovës. Gjithashtu ka qenë redaktor i Revistës letrare “Shtigje” të botuar nga ky klub.

Ka shkruar poezi, prozë (tregime dhe romane), dramë, ese, kritikë letrare, artikuj studimorë për letërsinë dhe publicistikë.

Ka fituar shumë çmime letrare për poezi e tregim në konkurset letrare të gazetave dhe revistave letrare të Kosovës. Në vitin 2003, me librin “Nëpër universin letrar” fitoi çmimin “Pjetër Bogdani”, i cili jepej për veprën më të mirë letrare të botuar gjatë vitit në Kosovë.

Në vitin 2004 fitoi Çmimin Special të Festivalit “Sofra poetike Ymer Elshani”, ndërsa në vitin 2009 me librin poetik “Cabrat Antologjia” fitoi çmimin për libër më të mirë poetik në Kosovë të botuar brenda dy Mitingjeve poetike, që mbaheshin në Gjakovë.

Deri tash ka botuar 15 libra letrarë të zhanreve të ndryshme letrare.

Vlerat e veçanta të krijimtarisë letrare të Kadrush Radogoshit i kanë vënë në spikamë këta shkrimtarë, kritikë e studiues të letërsisë: Akademik Prof. Dr. Pajazit Nushi, Abdullah Konushevci, Rushit Ramabaja, Dr. Arben Hoxha, Mr. Sci. Hajdar Salihu, Mr. Sci. Kadri Rexha, Vasil Vasili, Prend Buzhala, Ismail Syla, Pal Ndrecaj, Mr.sci.Flori Bruqi, etj.

Për vlerat e veprimtarisë letrare të këtij autori, në letra të veçanta dërguar autorit, janë shprehur edhe dy personalitete të veçanta: Ismail Kadare dhe Ukshin Hoti. Disa poezi të tij janë përkthyer në gjuhën angleze, suedeze, rumune.

Në periudhën mars 2005 – mars 2007, ishte nënkryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës, ndërsa në periudhën mars 2007 – mars 2009 ishte kryetar i saj.

Në këtë periudhë, si përfaqësues i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës, ishte anëtar i Këshillit të Librit (organ profesional) në Ministrinë e Kulturës së Kosovës.

I zhgënjyer me rrjedhat negative në Kosovën e pasluftës, së bashku me familje, emigroi në Kanada në vitin 2010.

ENGJËLL I. BERISHA : KUJTESË E DEHUR

Emri i Engjëll I. Berishës në letrat tona është i njohur në radhë të parë si poet e mandej edhe si gazetar, publicist e prozator.

Ky krijues me vepër letrare ka dalë qysh në vitin 1992, me vëllimin poetik “Dita me hënë e me nuse” dhe që prej asaj kohe pothuajse është i pranishëm në odeonin e letërsisë sonë me shkrimet e veta qoftë letrare, qoftë publicistike. Poezia e këtij poeti është një zë që kordinohet me sukses në rrjedhat e poezisë bashkëkohore shqiptare, sidomos të brezit të viteve të fundit të shekullit të XX-të, brez i cili gdhend një shenjë në piramidën krijuese të saj. Andaj edhe ky vëllim i këtij poeti e shënon një gur të vendosur sigurt në murin e veprimtarisë letrare të Engjëll I. Berishës. Por, që në

fillim del konstatimi se në këtë vëllim hetohet diçka e veçantë, diçka tjetër, diçka paksa ndryshe nga ajo që është evidente në veprat e botuara deri tash të këtij krijuesi të letërsisë sonë.

E veçanta dhe e përbashkëta e vëllimit

Vepra “Kujtesë e dehur” përbëhet nga 36 poezi, nga 5 proza dhe nga fjala e poetit “Peng më mbetet fjala siç e kam lirinë”, e shkruar në formë të prozës në Gjakovë, Korenicë, në tetor 2003.

Vepra është e ndarë në gjashtë qerthuj (cikle) ku pesë të parët mbyllen me nga një prozë, që janë:

1. “Kartëpostalja e bronzte”,

2. “Anije e dehur”,

3. “Flaka e natës”,

4. “Shenjtërori i zi”,

5. “Hala e shqipes”

6. “Lutje e përbashkët”. Libri hapet, përveç fjalës së autorit, me poezinë “E përshpirtëshme”.

Brenda kësaj “kornize” letare shtrihet tërë vëllimi artistik i veprës që në lexim të parë duket se është një vepër e angazhuar. Kjo mund, mbase, të arsyetohet edhe me përkushtimin e shkrimtarit të vënë në vepër:

“Ky është libër i dëshmive. Imazhi i tragjikes është vetëm fillimi i dhembjes”.

Dhe mu me këtë moto, mu me këtë përkushtim dhe me këtë qëllim ai e ka shkruar veprën, por patjetër

duke u mbështetur në frymëzimin, i cili pritet, pse jo, që në këtë rast të jetë paksa i prekshëm, paksa tragjik, paksa edhe “i drejtëpërdrejtë”, në kuptimin e mirë të domethënies. Dhe të gjitha këtyre synimeve, Engjëll I. Berisha ia arrin, madje edhe atëherë kur rrëfimi, në prozat e veprës, duket real, i përjetuar edhe nga lexuesit, të cilët në një mënyre apo tjetër, ishin dhe janë pjesëmarrësit e drejtëpërdrejtë të të gjitha tragjediave që ndodhën në këtë pjesë të atdheut, para dhe gjatë luftës së fundit në Kosovë.

Madje, tragjikën e rrembimit, kidnapimit dhe të zhdukjes së personave në Meje e Korenicë, më 27 Prill 1999, autori e ka të përjetuar edhe në vatrën e tij familjare, por se ai lutet “për të gjithë ata martirët e 27 prillit 1999 dhe për të tjerët, të cilët janë bërë mësim se si vdiset për ta ruajtur pragun e shtëpisë, sepse janë gjaku ynë që nuk falet lehtë, duket se tingëllon aktualisht vargu emblemantik i poetit Ali Podrimja “Kosova është gjaku ynë që nuk falet”.

Bashkëdyzimi i këtij vargu me vargjet e tjera të veprës bëhen për qëllim të caktuar dhe duket se ato tash lëvizin nëpër kujtesën dhe frymëzimin e poetit Berisha, për të përmbushur disi obligimin që e gërryen në thellësi:

Hajt poet/shkruaje një fjalë/se ne ta donim fjalën në vargje/ dhe pse jo edhe për të bërë diçka për ata që të qetë e të pafajshëm janë shtrirë në Lëndinën e Lotëve të varrezave në Meje.

Udhëtimi real dhe udhëtimi poetik

Edhe pse vepra “Kujtesë e dehur” e Engjëll I. Berishës duket se është e koceptuar paksa ndryshe nga veprat e botuara deri tash të tij, ajo e ka një qëllim të caktuar, andaj bën pjesë në veprat e angazhuara artistike. Pse jo, kjo vepër i dedikohet luftës së fundit të Kosovës në përgjithësi dhe Masakrës së Mejës e të Korenicës, në veçanti.

Paraqitja poetike e lëndës në këtë vepër bëhet nëpër një udhëtim imagjinar të poetit, i cili në të vërtetë është një kalvar real i shqiptarëve, jo vetëm i kësaj kohe më të afërt, por i të gjitha kohërave të luftërave të tyre për liri dhe pavarësi. Ky udhëtim, nga autori shënohet, përveç me figura poetike edhe me emra konkretë gjeografikë, biblikë e mitologjikë, ku secili në dimension ka kuptimin dhe funksionin e vet.

Kalvari i udhëtimit shtrihet edhe nëpër ciklet poetike të veprës duke u nominuar kuptimisht, sepse fillon me një “Kartëpostale të bronzit” dhe kalon nëpër krajata tragjike me “Anije të dehur” duke u përbiruar “flakës së natës” një “shenjtëror i zi” andej kah “Hala e shqipes” e për t’u sosur më 23 Maj 2003 në rivarrimin e Mejës në Lëndinën e Lotve.

Krajatat e këtij udhëtimi duken se shpesh, me qëllim e pa qëllim, bashkohen nëpër kthesat e historisë, për t’u kalitur dhe për t’u skalitur si dhembje lotësh, por edhe si krenari dhe dëshmi brezash që këtu denbabaden

kanë jetuar shqiptarë që përpara janë identifikuar me emrin kombëtar e pastaj kanë treguar për përcaktimet e tyre fetare. Kjo duket se është ngritur në pedestalin e vetëdijes sonë, sidomos në kohën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, ndërsa sa herë që duhej luftuar për liri a vdekje ringjallej dhe marshonte vatrave e trojeve tona. Kjo aromë hetohet edhe në vargjet e veprës “Kujtesë e dehur” të Engjëll i. Berishës:

*“Ja pra sot në përbashkësi
ju o njerëz të Zotit
pushoni në përjetësi
dy konfeksione e një gjak
dy besime e një fat
dy besime e një motiv lirie
dy besime e vetëm një mënyrë e vdekjes”.*

Përfundimin e udhëtimit real, apo kalvarit të zhbirjes e të zhdukjes të shqiptarëve nga agresorët serbë, autori e sheh të bashkëdyzuar me fatin tragjik të vdekjes, e cila është e pamëshirshme, është e ftohtë, është e dhembshme, është përfundimtare. Kështu poeti vdekjen e zbut duke i dërguar të rivarrosurit në përjetësi për të mos e zbehur dhe për të mos e harruar kurrë kujtimin për ta, e sidomos kujtimin për vdekjen e tyre të përbashkët e cila në atë moment nuk kishte bërë kurrfarë zgjedhjeje as faljeje.

Andaj përjetësia e kujtimit të tyre duhet bërë e shenjtë me vargje, sepse “arti nuk njeh kufi”, ndërsa “Poezia është një vlerë e shenjtë”, thotë Milan Kundera.

Misionin e tij prej krijuesi Engjëll I. Berisha duket se nuk do ta përfundojë as realisht në Lëndinën e Lotve në Meje. Ai është i vetëdijshëm se riatdhesimi dhe rivarrimi i të zhdukurve ende nuk ka përfunduar, sepse ligjet tiranike janë ende prezente në këtë hapësirë dhe:

*“Kosova rrugë e moçme Golgotë
I ngjan gjykimit Jezu
kur Pilati hoqi dorë nga drejtësia
për ironi trupin ua dorëzoi të marrëve”*

Kështu shprehet ai në poezinë “Ligjet tiranike” në faqen 86 të librit “Kujtesë e dehur”.

Përfundimi i udhëtimit poetik

Një njëfarë forme dhe në njëfarë domethënie, përfundimi i golgotës shqiptare në kohë dhe hapësirë ende nuk ka përfunduar. Mbase ky shtresim disi hetohet edhe në këtë vepër të Engjëll I. Berishës. Edhe pse ai lutet që kjo më mos të përsëritet, mos të ndodhë, prapë se prapë, ai kërkon që kjo mos të harrohet kurrësesi, sepse njeriu duhet kërkuar që t’i falen mëkatet e edhe të falë, por kurrësesi nuk duhet harruar ajo që ka ndodhur.

Këtë qëllim ai e ka të shtruar edhe artistikisht në këtë vepër.

Kështu, bashkëdyzimi i përfundimit të udhëtimit real e poetik disi dalin funksionalisht dhe reciprokisht edhe pse poeti Berisha në fund të vëllimit “Kujtesë e dehur” në poezinë “Lindjet e popullit tim” shprehet:

*“ Bekoji lindjet e popullit tim
o Hy, kurdoherë të pafajshme
që vijnë në vullnetin Tënd
si lindje të paskajshme”.*

Kjo vepër e Engjëll I. Berishës me siguri do të jetë edhe një dëshmi poetike për një kohë, për një tragjedi, për një dhembje, për një padrejtësi, për një mall të pashuar kurrë në kujtesën e këtij populli të djegur e të pjekur në zjarrin e luftës së fundit çlirimtare të Kosovës.

Mbase, vargjet e tij do të jenë një jehonë e gjatë në kujtesën tonë që të mos harrohen kurrë të gjitha ato që janë përjetuar. Mbase ky është edhe qëllimi i shenjtë i poezisë në veçanti dhe i artit në përgjithësi.

LETËRSIA SOT NË KOSOVË DHE DIASPORË

Letërsia në Kosovë

Rrethana historike krejt të posaçme dhe sidomos një sundim i huaj prej më shumë se 5 shekujsh vonuan për një kohë shumë të gjatë çdo farë rilindje kulturele të shqiptarëve. Duke lënë mënjanë, folklorin, që mbush një kapitull shumë interesant, edhe atë sërë të gjatë prodhimesh religjioze që pati filluar qysh në shekullin e 15-të, rëndësia e të cilëve është sidomos gjuhësore; atëherë do të shohim se pjesa e dytë e shekullit të kaluar shënon shfaqjen e veprave të para letrare, që si me thënë, mund të merren për themelet e letërsisë sonë moderne.

Pjesa e letërsisë shqipe që zhvillohej në Kosovë, kishte afërsisht këto shenja paradalluese: e shkëputur nga letërsia e shtetit shqiptar që naivisht quhej e quhet shteti

amë (duke gabuar vetë ne pasi rrjedh që Kosova të jetë bijë, kur ajo është po aq amë sa është amë Shqipëria), dhe nga një pjesë e traditës letrare, ajo pothuajse nuk ishte fare në kontakt me të dhe nuk ishte e informuar për atë që ndodhte në fushën e letërsisë brenda kufirit të shtetit shqiptar që ishte i vetburgosur në izolim total.

Edhe para Luftës II Botërore në Kosovën letrare herë pas here ilegalisht, mbase edhe mund të depërtonte ndonjë vepër ose autor nga periudha e viteve 1930, kryesisht përmes atyre pak nxënësve që shkolloheshin aso kohe në Shqipëri. Pas kësaj lufte, në vitet 1950, krijuesit e parë të letërsisë shqiptare në Kosovë, për mbështetje kishin kryesisht letërsinë gojore (të pasur), fare pak vepra nga fondi letrar i traditës si dhe përvojat e huaja letrare, në radhë të parë ato sllave.

Nga emrat e shkrimtarëve, të cilët e kishin filluar veprimtarinë e vet letrare para luftës, do të përmendim këtu vetëm Esat Mekulin dhe Hivzi Sulejmanin.

Esat Mekuli u shqua me lirikën e angazhuar shoqërore dhe kombëtare të shkruar gjatë viteve 1930, ndërsa Hivzi Sulejmani solli përvojën e parë më serioze në llojin e prozës së gjatë me romanin dy vëllimesh "Njerëzit I" dhe "Njerëzit II", si dhe "Fëmijët e lumit tim". Para tyre Hivzi Sulejmani do të shkruante disa nga tregimet, që edhe sot tingëllojnë moderne. Ishte poezia ajo që arriti majat e letërsisë shqipe në Kosovë, duke filluar nga fundi i viteve 1950 e sidomos me emrat: Mark Krasniqi, Din Mehmeti, Fahredin Gunga, Rrahman

Dedaj, Enver Gjerqeku, Azem Shkreli, Ali Podrimja, Besim Bokshi, Eqrem Basha, Sabri Hamiti etj. Ndërsa në prozë dallohen: Anton Pashku, Ramiz Kelmendi, Azem Shkreli, Nazmi Rrahmani, Rexhep Qosja, Mehmet Kraja, Musa Ramadani, Iljaz Prokshi, Agim Vinca, Nuhi Vinca tj. Edhe në Kosovë shumë shkrimtarë patën fatin të burgosen, të persekutohen apo të arratisen e të jetojnë jashtë truallit të tyre (Adem Istrefi etj).

Pushteti serb ushtronte dhunën më të egër ndaj intelektualëve që me pushtetin e fjalës përpiqeshin të afirmnin vlerat kombëtare shqiptare. Kështu e pësuan rreptë nga kjo censurë: Adem Demaçi, Ramadan Rexhepi, Kapllan Resuli (i cili pasi u arratis në Shqipëri u burgos edhe atje) etj.

Krahas letërsisë shqipe që krijohet dhe botohet kryesisht në Prishtinë, ajo krijohet dhe botohet edhe në mesin e shqiptarëve të Maqedonisë, kryesisht me prozën dhe poezinë e Murat Isakut, Teki Dervishit, Abdylazis Islamit, e më pas, me veprën letrare të Resul Shabanit, Adem Gajtani, Agim Vincës, etj. Vlen të përmendet dhe një personalitet i shquar i kulturës, Luan Starova, (shqiptari më i përkthyer sot pas Ismail Kadaresë), por shumica e veprave të tij nuk janë në gjuhën shqipe.

Letërsia shqipe në diasporë

Edhe pse e zhvilluar në kushte të një izolimi gjeografik e ideologjik, fati dhe perspektiva e letërsisë bashkëkohore shqipe duhet vështruar në një kontekst dhe më të gjerë gjeografik, d.m.th dhe përtej kornizës ngushtësisht nacionale. Pavarësisht nga zhvillimet brenda Republikës së Shqipërisë, si dhe brenda viseve etnike si: Kosovë, Maqedoni, Mali i Zi, kjo letërsi pati dhe njohu zhvillime dhe në diasporë. Sa i takon zhvillimeve të saj në diasporë, letërsia shqipe mund të shikohet gjeografikisht brenda dy vatrave:

Vatra historike e diasporës shqiptare: Itali, Greqi, Rumani, Bullgari, Turqi etj.

Vatra të reja të diasporës shqiptare: Gjermani, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, etj.

Zhvillimet më të rëndësishme të letërsisë bashkëkohore shqiptare në diasporë ndodhën në Itali, aty ku sot e kësaj dite jetojnë rreth 90.000 arbëreshë, që vazhdojnë të flasin shqipen.

Në përgjithësi mund të thuhet se një "rilindje" e letërsisë arbëreshe ndodhi diku rreth fundit të viteve 1950, kur dhe nisi të botohej revista "Shejzat" nga Ernest Koliqi në Romë e më pas revistat "Zgjimi", "Katundi ynë", "Zjarri", "Zëri i Arbëreshëvet", "Lidhja", "Bota shqiptare".

Këto revista ndikuan në krijimin dhe publikimin e një brezi poetësh e shkrimtarësh që shkruan në

arbërisht. Veç të tjerash, një pjesë e tyre funksionoi dhe funksionon dhe si shtëpi botuese, duke publikuar kolana të tëra me poezi dhe vepra të tjera letrare.

Ndër shkrimtarët më të rëndësishëm të kësaj vatre duhen përmendur:

Françesk Solano (1914), i njohur me pseudonimin Dushko Vetmo, i lindur në Kozencë. Pas një periudhe të gjatë qëndrimi në Argentinë, Uruguai dhe Kili, ku dhe shugurohet prift, Solano kthehet në vendlindje. Aktiv në shumë fusha të letrave, ai është kryesisht poet, prozator dhe dramaturg. Ndër veprat e tij më të rëndësishme janë: “Burbuqe t`egra”, 1946, “Shkretëtira prej gurit”, dramë, 1974, “Tregimet e Lëmit”, etj.

Domenico Bellizzi (1931), prift nga Frasnita, i njohur me pseudonimin Vorea Ujko, është një ndër trashëgimtarët më të denjë të Jeronim De Radës e Zef Serembes. Ai me poezinë e tij arriti nivele të spikatura të ligjërimit poetik, veçanërisht me veprat: “Zgjimët e gjakut”, “Këngë arbëreshe”, 1982, “Hapma derën zonja meme”, 1990 etj.

Karmell Kandreva (1931), poet, bartës i identitetit kombëtar me anë të një ligjërimi poetik origjinal si dhe luftëtar i angazhimit social të arbëreshëve në ruajtjen e gjuhës dhe kulturës origjinale, ka shkruar triologjinë poetike: “Shpirti i arbërit rron”; “Shpirti i arbërit rron. Arbëreshi tregon”; “Shpirti i arbërit rron. Vuan dega e hershme”.

Zef Skiro Di Maxhio (1944), poet, përkthyes dhe dramaturg i shquar. I angazhuar edhe si drejtor i revistës "Bota shqiptare", i shquar për tonin e tij ironik e shpesh sarkastik, ai është autor i rreth dhjetë librave poetikë, ndër të cilat vlen të përmenden: "Nëpër udhat e parrajsit shqipëtarë e t'arbreshë". "Poemë gjysmëserioze arbëreshe", "Orëmira", "Për tokën fisnike të Horës" etj.

Padyshim që letërsia arbëreshe vazhdon jetën me të tjerë shkrimtarë, shumica syresh të rinj, duke luajtur kështu një rol të rëndësishëm jo vetëm në diversitetin kulturor shqiptar, por edhe atë italian.

Një tjetër vatër e rëndësishme historike, ku kanë lulëzuar shkrimet shqipe që në fundin e shekullit XIX dhe ku jeta kulturore e elementëve shqiptarë ka qenë e organizuar më së miri, është Rumania. Një ndër personazhet më të rëndësishëm të letrave bashkëkohore shqiptare është Viktor Eftimiu (1889 - 1972), autor i rreth njëqind vëllimeve letrare të shkruara në rumanisht. Mjaft prej veprave dramatike të tij janë ndërtuar mbi bazën e motiveve shqiptare e të fëmijërisë së tij në malet e vendlindjes.

Po aq e rëndësishme sa dhe Rumania në pikëpamje të jetës kulturore shqiptare mbetet edhe Bullgaria, ku janë njohur organizime të hershme të komunitetit shqiptar. Një figurë që vlen të merret në konsideratë nga njerëzit e letrave shqipe, është Thoma Kaçori, i cili shkroi në shqip disa romane e libra me tregime.

Në vatrat e reja të zhvillimit të letërsisë bashkëkohore shqiptare hyjnë ato vende në të cilat emigruan për motive kryesisht politike një pjesë e shkrimtarëve të talentuar shqiptarë, që duke mos u pajtuar me diktaturën dhe duke ndjerë etjen për liri, realizuan në periudha të ndryshme të regjimit komunist eksodet e sforcuara.

Një nga shkrimtarët e diasporës me peshë më të madhe që jetoi e krijoi në Gjermani, është Martin Camaj (1925 - 1992). Vepra e tij hyn në fondin më të shquar të letërsisë bashkëkohore shqiptare.

Ndërsa në Shtetet e Bashkuara të Amerikës zhvilloi veprimtarinë më të madhe studimore e letrare Arshi Pipa (1920- 1997), një ndër punëtorët më të mëdhenj të letrave shqipe, intelektual i shquar, poet, përkthyes, studiues e polemist. Më 1944 ai drejtoi revistën "Kritika" dhe po këtë vit botoi librin e parë me poezi "Lundëtarë". Në SHBA, ku emigroi në vitin 1958, punoi si profesor në disa universitete amerikane, deri sa doli në pension. Si dëshmi e asaj që kishte përjetuar në kampet dhe burgjet komuniste ai botoi në Romë vëllimin me poezi "Libri i burgut" 1959, dhe më vonë dhe vepra të tjera. Një ndihmesë të jashtëzakonshme Arshi Pipa do të japë dhe në studimet letrare, sociologjike e politike me vepra të dorës së parë, ku operon me metoda moderne studimi.

Si përfundim, mund të themi, se aktualisht po bëhen përpjekje që të gjitha këto baza dhe këta krahë të

shkëputur në kohë dhe në hapësirë të letërsisë shqiptare, të komunikojnë dhe të integrojnë mes vetes për ta përcaktuar dhe krijuar saktësisht nocionin letërsi kombëtare në gjuhën shqipe.

Sot një plejadë e tërë të rinjsh po ecën në gjurmët e Mjeshtëreve të vet. Kostë Çekrezi, Gj. Bubani, S. Malëshova, Z. Fundo, ia kanë hapur rrugën zhurnalizmit.

Tajar Zavalani, me një gjuhë populllore, zgjoi te populli shqiptar bukuritë e letërsisë ruse, me përkthimet nga Tolstoi, Çehovi e Gorki. Ernest Koliqi përkthyes i disa klasikëve italianë, në "Novelat" e tij të punuara me një stil mjaft të këndshëm, pasqyron qëndrimin e vet "borgjez".

Midis shkrimtarëve që s'janë ende veçse në periudhën e shkrimeve fillestare, disa duan të marrin pjesë në Gostinë e perëndive, ndërsa disa të tjerë, jo aq ambiciozë, kënaqen vetëm duke ngjyer bukën e tyre në çanakun modest të bariut, të fshatarit dhe të punëtorit.

Vlenë theksuar edhe një dyzinë shkrimtarësh dhe studiuesish letrarë që krijojnë prej viteve 90-ta në diasporë si Eshref Ymeri, Rasim Bebo, Gjek Marinaj, Kolec Traboini, Agim Bacelli, Adnan Mehmeti, Kozeta Zylo, Raimonda Moisu, Iliriana Sulkuqi, Rita Salihu, Mëhill Velaj, Anton Kote, Sotir Andoni, Peter Prifti, Dalan Luzi, Zef Pergega, Luigj Çekaj, Albana Mëlyshi, Ramiz Gjini, Dalip Greca, Fatmir Terziu, Engjell Shehu, Gëzim Ajgeraj, Elvira Dones, Ornella Vorpsi, Anilda

Ibrahimi, Besa Myftiu ,Hasan Aliaj, Shefqet Dibrani,
Brahim Avdyli , Ymer Shkreli, Pal Sokoli etj.

Shkrimtarët e ekzilit

Poetë që shkruajnë në gjuhë të huaj duhet të përfshihen në historinë e letërsisë shqipe apo duhet të konsiderohen pjesë e letërsisë së gjuhëve në të cilat krijojnë, shtrohet thuajse në të gjitha konferencat shkencore që zhvillohen në Shqipëri por edhe në Kosovë.

Në Itali sidomos është prezent një qark letrar i autorëve shqiptarë që shkruajnë letërsi në gjuhën italiane. Autorë që fitojnë çmime letrare me botimet e tyre, por që fare pak njihen në Shqipëri. Ndoshta sepse dhe ne vetë mendojmë “se ata nuk janë shkrimtarët tanë”... “Atdheu është çka flitet”, shkrimtarja rumune Herta Müller që shkruan në gjuhën gjermane do t’u drejtohej me këto fjalë atdhetarëve të saj kur mori çmimin “Nobel” në letërsi.

Ky fenomen është i natyrshëm një fenomen global, ku shqiptarët nuk kanë pse të jenë përjashtim. Nuk është një proces i stisur apo i paramenduar. Ai lind së brendshmi dhe nuk është thjesht një proces normal i të shkruarit. Janë shumë autorë shqiptarë, le t’i quajmë shkrimtarë në ekzil, që po prezantohen me sukses. Mes tyre dallojnë katër shkrimtare femra. Librat e tyre kërkohen dhe botohen nga shtëpi prestigjioze botimi. Elvira Dones që botohet nga “Feltrinelli” dhe “Einaudi”,

Anilda Ibrahimimi dhe Ornela Vorpsi (‘Einaudi’) janë treshja e letërsisë shqiptare e mërgimit në Itali. Kësaj treshe i bashkohet Besa Myftiu, që jeton në Zvicër e boton në Francë me logon “Fayard”. Përtej faktit se shkruajnë në gjuhë të huaj dhe jo në gjuhën e nënës, ajo çfarë i bashkon këto shkrimtare është dhe tematika që trajtojnë në veprat e tyre. Femra, herë në vetë të parë e herë në vetë të tretë është gjithmonë e pranishme. E shkuara gjithashtu; fëmijëria nën diktaturë, mentaliteti, dramat sociale, zakonet dhe kanunet e vendit të origjinës janë pjesë e rrëfimeve në krijimtarinë e tyre. Tema të identitetit mbeten të preferuara për këto autore shqiptare, që jo rastësisht kanë zgjedhur të krijojnë në gjuhë të huaj.

Në gjuhë të huaj, me tema shqiptare

“Shkrimi në gjuhë të huaj të jep liri, distancë”. Besa Myftiu nuk do të mund të shkruante asnjë nga historitë e saj në gjuhën shqipe. Ndjehet e frustruar, kur tenton të shkruajë në shqip. I druhet dhe paragjytimeve, ndaj ka zgjedhur rrëfimin në gjuhën frënge. E bija e shkrimtarit Mehmet Myftiu, ka shkruar dhe botuar 9 libra në frëngjisht, i fundit “Dashuri në kohën e komunizmit”, botuar nga “Fayard” në Francë.

Ornela Vorpsit gjithaq i nevojitej distanca për ta parë më qartë të shkruarën. Italishtja ishte për të një zgjedhje organike. “Po të kisha jetuar në Shqipëri,

ndoshta nuk do isha bërë shkrimtare. Ishte ekzili që më tregoi këtë rrugë. Nuk ishte ndonjë zgjidhje për të tradhtuar Shqipërinë, siç më sulmojnë shpesh. Ishte një zgjidhje shumë organike. Duke menduar pse kisha nevojë të shkruaja në italisht, pashë se në mënyrë organike kisha nevojë për distancë nga ajo çka tregoja”, – thotë ajo ndërkohë që veten tashmë e sheh si shkrimtare në një vend të huaj e që shkruan po ashtu në një gjuhë të huaj. Ornella Vorpsi vazhdon të shkruajë në gjuhë italiane, por siç thotë dhe vetë, në të njëjtën kohë mendon dhe flet katër gjuhë. Gjuha e nënës mbetet gjuha e parë, sepse shqipja për të është gjuha që mbart kujtimet e fëmijërisë e për këtë ajo ndjehet thellësisht e tërësisht shqiptare. “Besoj se gjuha e romaneve të mia është një sintezë e shumë kulturave, e shumë gjuhëve të përzierja së bashku”.

Janë të paktë shkrimtarët që arrijnë të jenë kreativë në dy gjuhë të huaja, por Elvira Dones sigurisht që ia ka dalë. Ajo është shkrimtare, gazetarë dhe dokumentariste, autore e shtatë romaneve, dy vëllimeve me tregimeve, artikujsh e filma dokumentarë. Tema si prostitucioni, drama sociale, lufta etj., e kanë bërë Elvira Donesin shkrimtare të mirëpritur në qarqet letrare. Letërsinë e saj e shkruar në dy gjuhë; në gjuhën e nënës shqip dhe në gjuhën italiane. Raporti i saj me gjuhën që zgjedh për të shkruar fillon qysh kur libri nis të ngjizet. “Është thelbësore atmosfera e fillimit, fjalitë e para ndoshta dhe një fjalë e vetme që “godet” në njërën gjuhë

në vend të tjetrës”. Pikërisht kjo i ndodhi Elvira Donesit kur shkroi romanin “Luftë e vogël e përkorë”, ritmi gjuhësor u krijua natyrshëm në gjuhën e saj të dytë, italishten. “Pashë se kisha nisur rrëfimin në italisht edhe për një arsye tjetër, për të cilën me sa duket kisha nevojë: më shërbente si filtër mbrojtës”. Në këtë rast është “terreni” për të cilën shkruan ai që zgjedh gjuhën, për shkrimtaren Elvira Dones. Ndërkohë ka në proces dy libra; njërin të shkruar në gjuhën italiane dhe tjetrin në shqip, që shumë shpejt do të jenë në duart e lexuesve. Edhe pse këto shkrimtare zgjedhin një gjuhë tjetër, bashkohen në një pikë: shfrytëzimi i temës së identitetit.

“A ka nevojë të shkruaj në shqip për të rrëfyer Shqipërinë e sotme?- bën pyetjen retorike Anilda Ibrahim. I ka qëlluar të lexojë në shtypin shqiptar (online) sesi shqiptarët e fyejnë në komentet e tyre për zgjedhjen e italishtes si gjuhë letrare. “Nuk ka asnjë akt tradhtie nga ana ime drejt gjuhës mëmë. Zgjedhjen time e shoh si përulje të një personi të ndërgjegjshëm që e do gjuhën e vet në atë farë mënyre sa të hiqet mënjane duke thënë: unë s’jam në gjendje, ka të tjerë që e bëjnë më mirë se unë, Shqipëria ecën përpara edhe pa mua! Nuk jemi të pazëvendësueshëm...”. Kjo është revolta e saj në përballjen për së largu me lexuesin shqiptar. Ndoshta për këtë arsye ajo edhe Ornella Vorpsi refuzojnë vazhdimisht që librat e tyre të përkthehen në gjuhën shqipe.

JAKOV XOXA

U lind në qytetin e Fierit. Që i ri mori pjesë në Luftën Antifashiste. Pas Çlirimit të vendit vazhdoi studimet e larta për filologji dhe njëkohësisht bëri hapat e para në poezi dhe në prozë. Më 1949 botoi veprën e parë në prozë “Novela”. Krijimtarinë letrare në këtë zhanër e vazhdoi dhe gjatë viteve '50, kështu në vitin 1958 botoi veprën e dytë, po me atë titull “Novela”. Ndërkohë botoi dhe dy drama: “Buçet Osumi dhe “Zemra”. Që nga viti 1957 punoi profesor në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë në Universitetin e Tiranës, ku për shumë vite ligjëroi lëndën “Teoria e letërsisë”. Për nevojat e studentëve, në formën e dispencës, botoi në katër vëllime veprën “Bazat e teorisë së letërsisë”, që ishte nga veprat më serioze të kohës (si degë e shkencës mbi letërsinë). Pikërisht se në të autori ofronte dije dhe

përvojë teorike letrare të gjerë, që dilte jashtë kornizave të teorive zyrtare të kohës, kjo vepër e rëndësishme për shkencën letrare shqiptare, nuk u botua kurrë. Autori i saj u qortua dhe ai pa bujë dhe zhurmë, ashtu siç ishte gjatë tërë jetës, i qetë dhe i mbyllur në vete, u tërhoq në vetmi. Natyrisht, vlerësimi dhe kritika (zyrtare) që nuk ishte e kënaqur me bindjet e tij, me vizionin përmes të cilit Jakov Xoxa e shihte dhe e projektonte artin në përgjithësi, bënë që sa që gjallë, të mos botohej vepra e tij e plotë ; ajo u botua në Prishtinë ("Rilindja" 1971).

Pjesën më të madhe të jetës krijuese Jakov Xoxa e kaloi në një fshat myzeqar afër Fierit, ku, në vetmi të plotë krijoi romanet : "Lumi i vdekur" (1965), "Juga e bardhë" (1971) dhe "Lulja e kripës" (1978), që hynë në rrethin e romaneve artistikisht më cilësorë të letërsisë shqiptare. Asnjë roman para tij nuk e pasqyron në mënyrë aq komplekse botën shqiptare në prag të Luftës së Dytë Botërore, si "Lumi i vdekur" apo dhe periudhën gjatë luftës, si romani "Lulja e kripës", ku gjejmë një shtrirje të pakufishme të rrëfimit që mbulon plotësisht hapësirën e jetës dhe të ekzistencës së mjedisit shqiptar. Jakov Xoxa është nga romancierët më në zë të gjysmës së shekullit XX. Në krijimtarinë e tij letrare ai individualizohet me parimin krijues realist : fati individual do të jetë ai që do të hedhë dritë mbi kontestin tërësor të mjedisit dhe të kohës së fokusuar në rrëfime. Shëmbëllyeshëm me romanet e shquara realiste, Jakov Xoxa do ta vendosë dramën jetësore të personazheve dhe

të familjeve në sfond të një kolektiviteti, të një gjendjeje apo të një rrjedhe historike. Parashenja më karakteristike e prozës së Jakov Xoxës është stili.

Gjuha e tij vërehet dhe veçohet si e një individualiteti të fuqishëm dhe të papërsëritshëm në letërsinë shqiptare : nga njëra anë është e pranishme fryma e urtisë popullore me tërë thellësinë e shpirtit kolektiv ; nga ana tjetër, kemi një rrëfim të rrjedhës së qetë, të shtrirë në gjerësi, por edhe në thellësi.

* * *

Ngjarjet te romani "Lumi i vdekur"i Jakov Xoxes shtrihen brenda viteve 1938 -1939 të shekullit XX. Rrëfimi i ngjarjes në romanin "Lumi i vdekur" fillon me shpërnguljen e dhunshme të familjes së Pilo Shpiragut nga fshati Grizë dhe mbyllet pas një viti, me shpërnguljen po të kësaj familjeje, tani nga fshati Trokth. Brenda këtij harku kohor janë vendosur një varg ngjarjesh, kryesisht dramatike, me intensitet shkallëzues.

Qerrja e ngarkuar me plaçkat e shtëpisë nis rrugën pa ditur ku do të degdiset. Sa për një natë Pilo Shpiragu vendos të strehohet tek hani i Bishtanakës, ku rastësisht ai do të gjejë "shpëtim" te tregtarët e Fierit, të cilët do ta punësojnë në fermën e fshatit Trokth. Në të njëjtën kohë ai do të njihet dhe me familjen kosovare të Sulejman Tafilajt. I helmuar nga shija dhe ndjenja e ardhacakut, e të huajit, prandaj do të provojë të përshtatet në kushtet e reja, si dhe familjet e fshatit

Troktë të vendosura në luftë të përhershme për t'u mbrojtur dhe për të siguruar ekzistencën. Paralelisht me këto rrjedha dhe e gërshetuar me to do të zhvillohet edhe lidhja intime mes vashës së Shpiragajve me emrin Vita dhe kosovarit Adil. Kjo linjë nga ana e vet ka shijen dhe domethënien e një simbolike.

Pakti mes Pilo Shpiragut dhe tregtarëve të Fierit nuk do të arrijë ta mbushë as rrethin kohor të një viti. Përmbytja simbolike e fshatit nga lumi i përçudnuar solli pasoja tragjike për Shpiragajt, të cilëve dhe ç'ka u mbeti nga gjëja e gjallë do t'ua rrëmbejnë përsëri trëgtarët. Kështu, familja Shpiragaj mbeti në mes të rrugës më e vetmuar dhe më pa asgjë se kurrë më parë.

Ballë për ballë me rrezikun për të mbetur pa ekzistencë, që të mbijetojë, Pilo Shpiragu vendos t'i bindet përsëri beut dhe të pranojë kërkesat e tij që si viktima të parë lakmonte Vitën, ai vendos ta punësojë atë kopile në oborrin e beut. Por, shpleksja e narracionit të romanit do të nisë me arratisjen e Vitës dhe të Adilit në male.

Figura e Pilo Shpiragut (dhe e familjes Shpiragaj) është strumbullar që i lidh tërë rrjedhat narrative të romanit. Ky përcaktim kompozicional i autorit ka rezultuar që, edhe pse bëhet fjalë për një nga romanet më voluminoze të letërsisë shqiptare, rrjedhat fabulare të tij lidhen përmes një kohezioni të qëndrueshëm, të brendshëm.

Edhe atëhere kur rrëfehen "mesele" nga urtia dhe përvoja jetësore e popullit, që në fakt është karakteristike e rrëfimit romanesk të këtij autori, ato, qoftë drejtpërdrejt ose tërthorazi, lidhen dhe kanë të bëjnë me shtratin bosht të ngjarjes së rrëfyer. Pilo Shpiragu është figurë tek i cili është përqendruar vëmendja e autorit. Dhe, ai, Pilo Shpiragu, është nisur të jetë i përkryer si njeri, që ta ruajë deri në fund pastërtinë, por ligjet e jetës mbi të kanë rënë me tërë brutalitetin dhe në çaste të caktuara e kanë detyruar të lakohet.

Megjithatë, Pilo Shpiragun e përjetojmë si figurë që rrezaton domethënie përgjithësuese, si person që shpreh dhe një pjesë të sprovave e të dilemave të kohës së vet. Autori mëton që në tiparet e tij (edhe te Koz Dynjaja) të koncentrohen paragjykimet dhe morali i fshatarëve shqiptarë të kohës; përmes tyre ai arrin të realizojë tipizimin letrar për rrethanat e mjedisit shqiptar të asaj kohe.

Natyrë energjike dhe me iniciativë Pilo Shpiragu beson se do të arrijë pavarësinë ekonomike të familjes, falë krahëve dhe djersës së vet, duke mos e ndjerë nevojën për solidaritet. Por ky ishte një iluzion. Pilo Shpiragu, këtë nevojë do ta ndjejë vonë.

Edhe figura e familjes kosovare, ajo e Sylejman Tafilajt, në vetvete është bërthamë që mpleks jehona të rëndësishme nga drama e përgjithshme kombëtare. E dëbuar dhunshëm nga pushtuesi serb ajo nuk do të rehatohet në moçalet malarike të Myzeqesë dhe nuk do

ta gjejë ngrohtësinë e mjedisit. Fati i familjes së arratisur dhe të dëbuar kosovare do të vazhdojë dhe në epokën e komunizmit shqiptar.

Jakov Xoxa i ka vërejtur me mprehtësinë e intuitës krijuese raportet mes fshatarëve të Myzeqesë dhe të Kosovës, që në fillim e kanë përjetuar si kundërshtar njëri-tjetrit, si palë që do ta rrezikonte apo vështirësonte ekzistencën e secilit. Tek romani “Lumi i vdekur”, krahas rrjedhave spontane të veprimeve të personazheve, qoftë të përcaktuara ato nga shtysat e jashtme ose të brendshme, ndjehet ndërhyrja e autorit, sado e fshehtë qoftë. I tillë duket dhe veprimi i arratisjes së dy të rinjve, i Vitës dhe Adilit.

A është ky një veprim i paramenduar si zgjidhje e mundshme, apo vetëm veprim i turbullimit të çastit, që se ka të qartë ecjen, drejtimin, cakun? Sikur ky vendim të ishte vendosur në një kontekst tjetër kohor, bie fjala në fillim të viteve '30, do të dukej plotësisht pa rrugëdalje, si një ikje drejt një horizonti fare të mbyllur. Kurdisjen e zgjidhjes si arratisje nga kurthi, autori e bën duke thirrur në ndihmë një alibi të fortë: arratisja në fund të viteve '30 përputhet me fillimin e një përmbysjeje të madhe historike, përmbysje që do ta sillte dhe që e solli Lufta e Dytë Botërore. Vetëdijshëm apo jo, dy të rinjtë do të gjenden në krahët e kësaj lëvizjeje për ndryshime të mëdha.

Një parim tjetër në praktikën krijuese të Jakov Xoxës është edhe synimi për të rrëfyer bindshëm. Ai që

rrëfen, pra tregimtari në emër të autorit, dëshiron ta bindë lexuesin në atë shkallë vërtetësie që nuk është e mundur pa qenë njëherë i bindur vetë, ai që rrëfen. Ky parim tregimtar e kultivon praktikisht sqarimin, arsyetimin, mbështetjen absolute të çdo detaji dhe të çdo veprimi.

Një dimension që romanin e Jakov Xoxës e bën tërheqës, është ndjenja se tërësinë e fabulës e rrëfen një dëshmitar i vërtetë i ngjarjeve dhe se ky tregimtar thotë të vërtetën, di të zgjedhë fjalë e shprehje të vërteta, t'i shqiptojë qetë ato, të nxisë kërkshërinë për të dëgjuar e për të ditur ç'ndodhi më vonë; të zgjojë interesim për personazhet. Kështu, Jakov Xoxa në mbështetje të përvojës krijuese realiste dhe të filozofisë jetësore të shpirtit kolektiv, ka artikuluar stilin, shkollën e vet në zhanrin e romanit shqiptar në përgjithësi.

LETËRSIA DHE PSIKOLOGJIA

Duhet të ekzistojnë gjithmonë dy lloj artesh: arti - arratiak ngase njeriu do të ikë ndërsa ka nevojë për ushqim dhe gjumë të thellë; dhe arti - parabolë, ai art që duhet t'i mësojë njeriut si të çmësojë urrejtjen dhe të mësojë dashurinë...

Nuk kam ndërmend të marr gjithsecilin shkrimtar emër për emër dhe të shqyrtoj ndikimin e Frojdit tek ta. Dua vetëm t'ju rrëfej se cili është thelbi i mësimave të Frojdit; këso dore lexuesi mund të gjykojë vetë për këtë. Po i rendis çështjet më të rëndësishme sa më shkurt të jetë e mundur.

1. Forca e brendshme në të gjitha format e jetës është instinktive: libidoja, që në vetvete është e

pandryshueshme dhe e pamoralshme, "fara e çdo veprimi dhe e çdo vetie që meriton të ndëshkohet".

2. Gjendjet zanafillore të kësaj force gjatë aktivitetit krijues janë në kuptimin e zakonshtëm të fjalës, fizike. Qelizat bashkohen dhe ndahen. Marrëdhënia më e rëndësishme dhe e dukshme mes individëve është marrëdhënia seksuale.

3. Me shtimin e rëndësisë së sistemit nervor qendror me më shumë kontroll qendror se sa periferik, numri i formave të kënaqësisë me të cilat libidoja përshtatet, bëhet kryekreje më i madh.

4. Njeriu ndryshon nga pjesa tjetër e botës tjetër organike në faktin se evolucioni i tij nuk ka përfunduar.

5. Njohja e vetëdijes shënoi një hap të madh në evolucion dhe gjithçka që shënjojmë si të keqe dhe mëkate, është rrjedhojë e kësaj. Frojdi ndryshon nga të dy, Rusoi i cili mohonte Rënien, duke ua mvëshur të keqen rrethanave fizike (Rusoi mendonte se njerëzit janë të këqinj për kah natyra. Ai e shihte të keqen tek ta dhe bënte një jetë vetmitarësh) dhe po ashtu prej doktrinës teologjike që e quan Rënien rezultat të një zgjedhjeje të paramenduar duke e bërë njeriun kësioj moralisht përgjegjës.

6. Rezultat i Rënies që një ndërgjegje e ndarë në vend të ndërgjegjes në nivelin e kafshës, që përbëhej më së paku prej tre pjesësh: e pandërgjegjshmja, nëndërgjegja e vetëdijshme, nëndërgjegja e

vetëdijshme, gjithçka e moralshmja dhe shoqëria kërkon e që duhet harruar dhe të mos shprehet.

7. Doktrina e shekullit XIX për progresin evolucionist të njerëzores që mposht kafshëroren dhe shuan instinktet shtazore është më së shumti e gënjeshtërt. Paraardhësit filogjenetikë të njeriut ishin të përunjur dhe socialë, ndërkohë që egërsia, dhuna, lufta, të gjitha të ashtuquajturat instinkte parake nuk shfaqen derisa qytetërimi të ketë arritur një nivel të lartë. Një epokë e artë, po të flasim në mënyrë përqasëse (ndërsa kërkimet antropologjike priren drejt kësaj), është një fakt historik.

8. Ajo çka quajmë të keqe ishte dikur e mirë ose është tejkaluar dhe nuk u çua më tej nga mendja e ndërgjegjshme me idetë e saj morale. Është kjo çështje e Frojdit që shtjelloi D.H.Lawrenc-i dhe së cilës i kushtoi jetën e tij: Njeriu është imoral ngase ka mendjen dhe kurrësi nuk e pranon këtë të vërtetë. Më e rrezikshmja në shkrimet e Lawrenc-it është lehtësia me të cilën mësimet e tij për të pandërgjegjshmen, me çka kupton ndërgjegjen e pavetëdijshme, mund të interpretohet si domethënëse që "duhet lënë ndërgjegja jote e vetëdijshme të shprehë veten", si acte gratuite e Andre Zhidit. Në marrëdhëniet njerëzore kjo në vetvete mund të ketë një efekt çlirues për individin. Nëse i marri do të këmbëngulte në marrëzinë e tij, do të bëhej i mençur. Porse marrëzia marrëzi mbetet sidoqoftë dhe një këshillë e llojit "Zemërimi është i drejtë - drejtësia kurrë nuk

është e tillë", e cila në jetën private është një kërkesë për ndershmëri emocionale, përbën një këshillë politike të dalëboje, kur kjo do të thotë "bjeru atyre që të kundërshtojnë". Po kështu, qëndrimi i Lawrenc-it në faktin se nëse doni të dini se çfarë është njeriu, duhet të kqyrni jetën e tij seksuale, fare mirë mund të bëjë të besojnë shumë syresh që përmbushja e nevojës seksuale është i vetmi aktivitet i nevojshëm.

9. Jo vetëm çfarë ne njohim si mëkat ose krim, por të gjitha sëmundjet janë të qëllimshme. Janë një përpjekje për t'u kuruar.

10. Gjithë ndryshimi, si ai paravajtës, si prapavajtës, shkaktohet prej frustrimit ose tensioneve. Po të ishte kënaqësia seksuale krejtësisht e mjaftueshme, evolucioni njerëzor s'do të kishte ndodhur kurrë. Sëmundja dhe aktiviteti intelektual janë të dyja reagime kundrejt së njëjtës gjë, por jo të barazvlershme.

11. Natyra e ideve tona morale varet nga natyra e marrëdhënieve me prindërit tanë.

12. Në zanafillë të të gjitha ndjenjave dhe mëkatit është një ndjenjë faji.

13. Kurimi përqendrohet në heqjen e kësaj ndjenje faji, në faljen e mëkateve nëpërmjet rrëfimit, rijetimin e përvojës dhe faljen, kuptimin e domethënies së saj.

14. Detyra e psikologjisë ose artit në lidhje me sa u përmend më sipër, nuk është t'u tregojë njerëzve se si të sillen, por të tërheqë vëmendjen e tyre te ajo çka

ndërgjegja e pavetëdijshme rreket t'u kumtojë dhe duke zgjeruar njohuritë e tyre për të mirën e të keqen, t'i bëjë më të zotë të zgjedhin, që të mund të jenë shumë herë më tepër të përgjegjshëm moralisht për fatin e tyre.

15. Për këtë arsye, Psikologjia u kundërvihet të gjitha përgjithësimeve. I bën njerëzit t'i përmbahen vetëm një përgjithësimi dhe padyshim do të vijë një kohë kur gjërat të rrjedhin asisoj që ai të mos mund të zbatohet. Atëherë ose do të përforcojë përgjithësimin, situatën, ndrydhjen, kur t'u fanitet, ose do të përfaqësojë pikëpamjen e kundërt. Vlera e këshillës varet krejtësisht nga konteksti. Ju nuk mund t'u tregoni njerëzve se ç'duhet të bëjnë, mundeni vetëm t'u rrëfeni parabola: dhe kjo është ajo që mund të quhet me të vërtetë art, histori të veçanta për njerëz dhe përvoja të veçanta e në varësi të nevojave të ngutshme e specifike ai mund të nxjerrë përfundimet e veta.

16. Të dy, Marksi dhe Frojdi, nisen nga dështimet e qytetërimeve, njëri nga të varfrit, tjetri nga të sëmurët. Të dy e shohin sjelljen njerëzore të determinuar, në mënyrë të pandërgjegjshme, nga nevojat instiktive, uria dhe dashuria. Të dy duan një botë ku zgjedhja racionale dhe vetëdeterminimi janë të mundshëm. Ndryshimi mes tyre është në mënyrë të pashmangshme ndryshim mes njeriut që studion turmat në rrugë dhe njeriut që sheh pacientin, ose të paktën familjen në klinikën private. Marksi e sheh kahjen e marrëdhënieve mes botës së jashtme dhe të brendshme

pa të fshehta, Frojdi anasjelltas. Kështu, të dy janë dyshimtarë kundrejt njëri-tjetrit.

Socialistët akuzojnë psikologët për prishje të status quo-së, ndërsa përpiqen t'i përshtatin neurotikën sistemit social, duke e privuar atë nga një revolucion i mundshëm. Psikologët kundërpërgjigjen se socialistët përpiqen t'i japin pikë vetes me terma që as vetë nuk i kuptojnë, ose me faktin që etja për para është forma e vetme e etjes për pushtet - kështu që pasi të kenë marrë pushtetin me revolucion, do të rikrijnë të njëjtat kushte. Të dy kanë të drejtë. Për aq sa qytetërimi mbetet siç numri i pacientëve që mund të shërojë psikologu është shumë i vogël, dhe sapo socializmi të marrë pushtetin, duhet të mësojë të drejtojë energjinë e tij të brendshme, pra do të ketë nevojën e psikologut.

Përmbyllje: Frojdi ka patur ndikime të dukshme teknike në letërsi posaçërisht në shtjellimin e kohës dhe hapësirës dhe përdorimin e fjalëve më shumë me vijueshmëri asociative sesa logjike. Ai e drejtoi vëmendjen e shkrimtarit kah materiale të tilla si ëndrrat dhe neurozat, gjer më tash të shpërfillura; kah marrëdhënie që gjer më tani nuk janë marrë parasysh sikundër është marrëdhënia mes njerëzve që luajnë tenis; ai e ka rishikuar kultin e njeriut hero. Ai është përvetësuar nga irracionalistët e etur për t'u ikur ndërgjegjes së tyre. Porse këto nuk qenë... shqetësimi ynë.

Unë u rreka të rrëfej se çfarë drite hodhi Frojdi mbi gjenezën e artistit, rendit dhe funksionit të tij në shoqëri dhe çfarë kërkesash ka ai për shkrimtarin serioz. Duhet të ekzistojnë gjithmonë dy lloj artesh: arti – arratiak, ngase njeriu do të ikë, ndërsa ka nevojë për ushqim dhe gjumë të thellë; dhe arti - parabolë, ai art që duhet t'i mësojë njeriut si të çmësoj urrejtjen dhe të mësojë dashurinë...

ANTROPOLOGJI - JAKOV MILAJ “RACA SHQIPTARE”

Në blogun tonë virtual "Floart-Press" u botua ky shkrim antropologjik që, kohë më pare, disa lugatë interneti u sulën si leopardë ndaj meje dhe studiusit elitar Jakov Milaj, tashmë të ndjerë. Këtu do të gjeni disa nga pjesët më të rëndësishme të studiuesit elitar të njohur me emrin dhe miemrin Jakov Milaj, i cili trashëgimi kulturore dhe shkencore la librin e tij lapidar “Raca shqiptare”(1944 dhe ribotuar 1997).

Ky libër është mbajtur në hije për më shumë se 50 vjet, që i rikthehet publikut shqiptar, si punim i një studiuesi virtuoz që është njëherit edhe i pakalueshëm deri më sot ndër shqiptarët në fushën e antropologjisë.

Jeta dhe vepra e Jakov Milaj

Jakov Milaj u lind në Fier më 25.03.1911. Ai u shkollua në Gjimnazin e Shkodrës, ku e mbaroi atë si një nga nxënësit më të mire në vitin 1931.

Si nxënës Milaj, drejtoi Shoqatën Kulturore “BESA SHQIPTARE”. Punoi si mësues në Fier, sekretar komune në nënprefekturën e Kolonjës, më vonë redaktor përgjegjës në organe të ndryshme të shtypit të Tiranës e sidomos në “Vatra” të Timo Dilos dhe në revistën “Perpjekja shqiptare” të Branko Merxhanit. Në këtë kohë ka krijuar shumë njohje, ku spikat mbi të gjitha miqësia e madhe me shkrimtarin tonë të madh Migjenin.

Për ata që kanë shfletuar në shtypin shqiptar të vitit 1930, është e pamundur që të mos hasin emrin Jakov Milaj apo inicialet e tij J.M.

Falë erudicionit të tij, ai shkruante në fushën etnografike, antropologjike, gjeografike, historike etj. Në vitin 1934 i është dhënë e drejta e studimit në Fakultetin e Veterinarisë pranë Universitetit italian të Torinos. Përkohësisht Jakov Milaj i ndërpret studimet (1935) dhe kthehet në Fier, ku merr pjesë në Kryengritjen e Fierit... Dështimi i kësaj kryengritje ishte fatal edhe për studentin Milaj. Regjimi i atëhershëm i mbretit Ahmet Zogu e dënon më burgim prej 101 vjetëve. Pas ndërhyrjes së organizatave të shumta ndërkombëtare, ai falet.

Më pas, emigron nga vendi për në Torino të Italisë për t'i vazhduar studimet e veterinarisë që i la në gjysmë. Në ditët e fundit të jetës së poetit tonë të mjerimit, Migjenit, Jakov Milaj, do të jetë pranë tij dhe të motrës në Senatoriumin e Tore Felices...

Madje, do të ishte ai, që do të sillte edhe fjalët e fundit të Migjenit dhe dorëshkrimet e fundit të tij, nga Spitali.

Në Shqipëri Milaj kthehet në vitin 1939, pasi kishte doktoruar veterinarinë në Torino. Jakov Milaj do të punonte në institucionet zyrtare dhe në qeverinë e atëhershme do të ishte pak muaj edhe Ministër i Bujqësisë dhe i Pyjeve. Shkak për largimin e tij nga posti i ministrit ishte se Milaj, kërkoj që "pyjet e Shqipërisë të shkëputeshin nga kontrolli italian dhe milicia italiane e pyjeve të zëvendësohej më shqiptarë". Kuptohet që ministri Jakov Milaj u detyrua të japë dorëheqjen e tij.

Pas Luftës së Dytë botërore, Milaj punoi në Stacionin e Veterinarisë në Durrës, Bilisht, Fier etj.

Regjimi komunist shqiptar e dënoi (1945) Jakov Milajn me 15 vjet burg të rendë, prej të cilave i vuajti mbi gjashtë vjetë burg (1945-1951) dhe katër vjetë internim (1951-1955). Vdiq më 02.01.1997, në moshën 86 vjeçare.

Në kryevepren e tij "Raca shqiptare" Jakov Milaj, për herë të parë shkroi për antropologjinë shqiptare. Vepra ka një karakter të theksuar shkencor, patriotik dhe kombëtar. Në aspektin antropologjik, ky është i pari punim, i shkruar mjeshtërisht me një gjuhë të pasur dhe të pastër, ku del tipi fizik shqiptar dhe ecuria e tij evolutive në rrafsh kombëtar, kanë thënë shkencëtarët e ndryshëm për këtë libër.

Por vetë autori, më mire se kushdo tjetër e ka treguar misionin e tij në këtë vepër. "Qëllimi i hartimit të kësaj vepre ka qenë që të nxjerr në shesh disa të vërteta, gjer më sot të panjohura, mbi racën tonë dhe t'u jap shkas, atyre që ndjejnë veten të zotin, për t'u marrë pak më tepër me biologji e antropologji. Përfundimet që ka për të nxjerrë lexuesi nga këto faqe janë të thjeshta dhe ndofta të njohura intuitivisht prej shumë shqiptarëve, megjithëse të mohuara prej të huajve dashakeq: se populli arbëror ka një origjinë të vetme të përbashkët: se është anas (autokton) në të gjitha viset ku banon sot; se as midis muslimanvet e kristjanvet, as midis Gegëvet e Toskëvet nuk ka ndonjë ndryshim racor; e, më në fund, se ndihet nevoja për një politikë shoqërore që të synojë fuqizmin fizik të racës shqiptare", shkruan Milaj.

Një pasqyrë e shkurtër e hulumtuesve tjerë

Dihet se, të dhënat e para të antropologjisë shqiptare janë të formës përshkruese. Përshkrimin e parë

të pamjes fizike e ka bërë F. Pouqueville (1805). Të dhëna përshkruese antropologjike dhanë edhe J. Pisko (1894), P. Trager-I (1990), E. Durham (1905) si dhe F. Nopesa (1912)... Hulumtimet e mirëfillta antropologjike mbi shqiptarët janë bërë nga A. Weisbach (1868) i cili në Stamboll mati 17 meshkuj shqiptarë për të cilët gjeti lartësinë mesatare 1664 mm .

L. Glück (1895) mati 30 shqiptarë kryesisht nga Kosova. A. Haberland dhe V. Lebcelter (1916) matën 106 meshkuj shqiptarë nga zonat malore dhe 13 nga Fusha e Kosovës.

K. Dronçillov (1921) bëri një punim antropologjik në 112 shqiptarë nga Kosova dhe Maqedonia Perëndimore. F. Luschan (1922) bëri matjen e kokës të 130 shqiptarë më banim në Turqi.

Si punim i plotë mbi antropologjinë e shqiptarëve mund të mirren matjet e bëra në 1.067 shqiptarë nga C. S. Coon (1930). Përveç të dhënave antropologjike në këtë punim janë pasqyruar dhe faktorët ekzogjen. Në bazë të dhënave që mblodhi Coon-I, përshkroi tipin dinarik të shqiptarëve dhe u mundua të shpjegoi prejardhjen e tyre ilire. Zh. Gavrilloviq (1967), bëri disa matje antropologjike të kokës dhe trupit në mostren prej 201 shqiptarëve nga Deçani (Kosovë).

Fillet e para të hulumtimeve antropologjike ndër shqiptarë hasën në dy broshura të Sami Frashëri, "Njeri" dhe "Përsëri njeri".

Punim më rendësi shkencor, si në matje ashtu edhe në përshkrueshmërinë morfologjike të trupit dhe të kokës së popullatës shqiptare të Shqipërisë është punimi "Gjurmime antropologjike për shqiptarët", i Aleksandër Dh. Dhima-s (1985). Autori në këtë punim jep të dhëna interesante për karakteristikat fizike të shqiptarëve. Përveç të dhënave përshkruese të pamjes së jashtme (ngjyra e syve, qepallat, piloziteti trupor, ndërtimi muskolor i trupit, etj) autori jep vlerat e disa matjeve trupore si dhe të kokës.

Ndër hulumtuesit e trevës sonë në këtë fushë studimi lypsen veçuar edhe hulumtimet e reja në hapësirat antropometrike, lëvizore fiziologjike nga Mustafë Aliu (1991), Hasim Rushiti (1999, 2000, 2001), Abedin Bahtiri (2004), Ajvaz Berishës (2002), Flori Bruqi (2003, 2004, 2005) etj.

Ju Rrëfej Për Racën Shqiptare (Botim I, Viti 1945; Ribotim 1997)
(Nga Prof. Dr. Jakov Milaj)

Shumë kohë përpara anthropologeve, filologë, poetë, gjeografë, historianë e udhëtarë të ndryshëm, që kanë kaluar nëpër Shqipëri, ose që kanë njohur, në ndonjë kënd të largët të Perandorisë turke a të Ballkanit, ndonjë grup shqiptarësh, nuk kanë përtuar të

përshkruajnë sa më mire që të jetë e mundur tiparet e këtij populli, që bie në sy për madhështi e bukuri.

Si na shihnin të huajt

Ami Boue, si qindra të tjerë që s'po i përmendim, është prekur nga dukja fizike e shqiptarëve. Në veprën e tij “La Turquie d'Europe” (Paris 1842): “ata iu përngjajnë më shumë grekëve se sa sllavëve dhe të kujtojnë tipat më të bukur të malësorve zviceran me fytyrë vezake, me hundën e gjatë e të hequr, me trupin e tyre më shumë të hollë se të trashë e me trajtat e hedhura”.

Cypren Robert-i, që ka njohur vetëm gegët, në një studim të botuar në “Revue des deux Mondes” thotë se shqiptarët kanë “sy të vegjël, shikim të drejtë e të ngulur, vetulla të holla, hundë të mprehtë, kokë të gjatë, ballë të sheshtë, qafë tepër të gjatë, kraharor të rrumbullakët dhe pjesën tjetër të trupit të thatë e nervoze”.

Nga shkrimtarë të tjerë, dikush thotë se shqiptarët i kanë sytë e shkruar ose bojë qielli dhe flokët e verdhë e gati t'artë; dikush tjetër-Pouqueville-i, psh., se sytë i kanë të zinj.

Këto shënime, megjithëse në përgjithësi flasin mire për ne, qëndrojnë kaq larg njëri tjetrit sa të bëjnë të besosh se nuk ka një fizike të tipit shqiptar.”...

Por, studimet më të plota mbi racën tonë, dihet se janë bërë prej shkencëtarëve austriakë A. Haberlandt e V. Lebzelter, prej Eeninger-it, prej studiuesit gjerman Von Luschan dhe prej antropologut zviceran, Eugene Pitard.

Dy të parët, gjatë Luftës së Madhe u mblodhën në Shqipërinë e pushtuar prej fuqive austro-hungareze. Bënë studime mbi një grup vullnetarësh, që shërbenin me armë në dorë për Fuqitë Qendrore dhe mbi një numër të vogël civilash e të burgosurish shqiptarë, që ishin kapur prej serbëve. Janë matur 140 vetë, të tërë meshkuj, madhor me moshë njëzet vjeç e lart dhe, që të gjithë, me sa duket, t'ardhur nga krahinat e Gegërisë.

Studimet e tyre u botuan më 1919 në “Archiv fuer Anthropologie” XVII, me titullin ”Zur physischen Anthropologie der Albanesen”.

Për dallimet fizike e paprekshmërinë e racës, Milaj thotë se “popujt që kanë patur të bëjnë me ilirët gjatë shekujve kanë qenë kolonizatorë, pushtonjës ushtarakë ose migrantë endacakë. Këta nuk kanë patur kontakt të barabartë me të gjithë turmën ilirike të përhapur në një trevë kaq të madhe. Por, ndërsa, ndrydhja e tyre ka qenë më fortë për disa fise e vise, ka qenë shumë më dobët ose nuk është ndier aspak ndër fise e vise të tjera. Disa nga këta popuj, nuk kanë lënë gjurmë veçse në qytetrim: kurse disa të tjerë kanë lënë shumë gjak ndër fiset e pushtuara.

Vetëm ai grup i Ilirve që më vonë u çuajt me emrin Shqiptar, qëndroi m'i pastërti dhe, me gjithë se e ndjeu mjaft ndikesen e qytetërimit të huaj, mbeti gati krejt i paprekur për nga raca.

Raca shqiptare nuk ka nxjerrë vetëm burra të pushkës, por edhe njerëz të mendjes e të shpirtit, filozofë, ligjvënës, burra shteti, shkencëtarë, letrarë, dijetarë, poetë e artistë të mëdhenj.

Numrit të njerëzve të dëgjuar, që njihen si shqiptarë, duhet t'i shtohet një numër tjetër shumë më i madh të panjohurish, që janë mbajtur si pjellë e ndonjë populli tjetër dhe që ne nuk ua dimë emrat.

Kontributin që kjo race i ka sjellë botës, në përpjesim më numrin e me kushtet në të cilat ka jetuar, nuk e vë prapa racavet të tjera fqinje. Tregon, për kundrazi, se paja shpirtërore e sajë është e madhe dhe e shumanshme.

Sipas Pittard-it, lartësia rupore mesatare e gegëve është 1.683 mm; ajo e Toskëve 1,673 mm.

Si shihet, grupi i Gegëve të Dobruxhës jep një lartësi mesatare 1 mm më të vogël nga mesatarja e Glueck-ut, pra gati të barabartë me lartësinë e kosovarve dhe 10 mm më e ulët nga ajo, që kanë gjetur Haberlandt-i e Lebzelter-i, ndërsa Wniger-i ka vënë re se "në mes të Gegëve e të Toskëve nuk ka asnjë ndryshim në lartësinë e trupit".

Sikur të krahasojmë shtatin e Shqiptarvet me atë të popujve fqinj, dalin në dritë disa fakte shumë interesante.

Përtej detit Adriatik gjendet një nga zonat me njerëzit më të shkurtër t'Evropës. Karta e Biasutt-it, e botuar në volumnin e parë të veprës “Razze e Populi della Terra”, është një pasqyrë e saktë e lartësisë trupore të popullsive që banojnë kundrejt bregdetit shqiptar. Që nga Ankona e gjer në thembër të çizmës italike, e gjithë pjesa qëndrore, jugore e ishullore e Gadishullit të Apeninevet, përmban njerëz që kanë një lartësi mesatare prej 158 deri në 162,9 cm, pra 6 deri 10 centimetra më të ulët se atë të shqiptarëve.

Nga kjo kuptohet se: për sa i përket kësaj veçorie, kryqzimet midis Shqiptarvet dhe Italianvet gjatë shekujve të kaluar duhet të kenë qenë shumë të kufizuara për të mos thënë se praktikisht nuk kanë eksistuar fare.

Në lindje të tokës së zënë prej popullit shqiptar gjendet Bullgaria.

E ndan prej sajë Maqedhonija më njerëz race të përzierë, shumica e të cilëve e mban vehten si bullgarë.

Bullgarët, sipas Wateff-it, kanë një lartësi mesatare prej 1.665 mm.

Përpjestimi i njerzve të lartë nga ata të krahinave lindore: ai arrin mesatarisht në 1.678 mm domë thënë në një lartësi krejt të barabartë me atë të Shqiptarvet që gjen Pittard-i, ose 15 milimetra më t'ulët nga ajo që na japin Habrelandt-i dhe Lebzelter-i.

Del, pra, në shesh se ata q'i thonë vehtes Maqedhonas duhet të kenë shumë gjak shqiptar dhe, për sa i takon lartësisë mesatare, ndryshojnë mjaft prej bullgarvet të vërtetë”, shkruan Jakov Milaj....

Treguesi qefalik dhe veçantitë

Milaj thotë: ”Në veri të Shqipërisë ethnike ndodhen Serbë, Boshnjakë e Malazezë.

Që të tre këta popuj kanë trup më të lartë nga Shqiptarët. Për të parët Deniker-i jep shifren mesatare 1.709 mm, që mund të shtohet në studime të ëvonshme.

Weissbach-u në 3.802 boshnjakë, që ka matur, ka gjetur si lartësi të mesme 1.726 mm.

Lartësi thuaj se të barabartë me këta kanë edhe Malazezët.

Në jugun e vendit tonë gjenden Grekët, të cilët kanë një lartësi trupi gati të njënjëshme me ne: 1.670 mm.

Kjo veçori e disa të tjera, që do të shohim më vonë, bëjnë të besosh se shumica e Grekvet, posaçërisht pjesa perëndimore, janë të një race me Shqiptarët, e bile, janë Shqiptarët, që kanë humbur gjuhën dhe, nëpërmjet shkollës e të Kishës, kanë trajtuar një ndjenjë kombëtare që, shpirtërisht, i ndanë prej nesh.

Gjatesija e gjymtyrve të poshtme, në grupin e matur prej Pittard-it, kalon prej 711 milimetra në 872

milimetra; mesatarisht kapet në 792,6 mm; kjo gjatësi shtohet rregullisht në përpjestim më lartësinë trupore.

Raporti mesatar i gjatësisë së shalëve në gjatësinë e përgjithshme të trupit është 47,25.

Shqiptarët kanë pra bustin më të zhvilluar nga të gjithë popujt e Ballkanit; kurse gjymtyrët e tyre, megjithëse të gjata, vijnë pas gjymtyrëve të Sërbëve e të Turqve.

Weninger-i ka gjetur ndër Gegë një gjerësi koke që kalon prej 145-172 mm me frekuenca më të shumta në 147-170 mm edhe ndër toskë një gjerësi që kalon prej 148-179 mm; me frekuenca më të dendura në 151-171 mm.

Në materialin e studiuar prej tij është vërtetuar se Toskët e kanë kryet më të gjërë nga Gegët.

Tregonjësi qefalik është veçoriya antropologjike më e rëndësishme; që bën të dallohet raca shqiptare nga racat tjera.

Është shumë i lartë dhe prandaj vërteton se populli i ynë është, në përgjithësi, shumë kokë-shkurtër.

Për seritë e ndryshme të Shqiptarvet, që ka matur Pittard-i, tregonjësi mesatar arrin në 86,4 dhe për atë që ka matur Haberlandt-i e Lebzelter-i është pak më i ulët 86,14", thotë Jakov Milaj.

Të tjerët për Milajn

Ka shumë studiues shqiptarë që e kundërshtojnë veprën e Jakov Milajt. Fjala vjen Mr. sc. Besnik Pula, në një reagim të tij në forumin “Alb-shkenca.org” dhe në gazetën “Koha ditore” : “...libri ka si paradigmë teoritë tashmë krejt të diskredituara, pseudoshkencore raciste që mbështeteshin në ide gjoja evolucionare e që argumentonin epërsinë gjenetike të racës së bardhë karshi grupeve të tjera racore, të legjitimuara "shkencërisht" nga antropologët në bazë vecanërisht të matjeve të kafkës, veçorive të fytyrës etj, si shenja që zbulonin shkallën e zhvillimit biologjik e kulturor të grupeve njerëzore.”

Më tej Pula shkruan: Këtë histori të pseudo-shkencës raciste e dokumenton dhe diskuton mirë Stephen Jay Gould në librin e tij "The Mismeasure of Man". ...Të njëjtat paradigma teorike bënin që zyrtarë të lartë të shtetit serb në shek. 19- të argumentonin se shqiptarët janë "njerëz me bisht" duke i përshkruar shqiptarët si popull "primitiv" dhe duke i projektuar mbi shqiptarët konceptet raciste, që evropianët kishin zhvilluar në kolonitë e tyre afrikane e aziatike.”

Kjo sipas Pulës, është pikërisht ajo që shqetëson më tepër se fakti që libri mbështetet mbi baza joshkencore...

Besnik Pula, thotë: “Më 1938, Musolini vendosi që ta anashkalonte akademinë italiane dhe angazhoi një student të ri të antropologjisë, Guido Landra, që ta hartojë një platformë shkencore për racizmin italian.

Studenti i ri, me bekimin personal të Musolinit, në korrik të atij viti nxorri një dokument me emrin “Manifesti i Shkenctarëve Racialë” (Manifesto degli Scientisti Razziali), i cili vendosi bazamentin ideologjik për politikën e mëtejshme raciale të regjimit fashist.

Manifesti shpalli italianët “racë Nordiko-Arjane”, konstantoi se italianët janë “racë e pastër dhe e veçantë”, formuloi definicionin biologjik të racës dhe shpalli raca inferiore çifutët dhe afrikanët.

Aplikimi i teorive raciste përbrenda regjimit fashist italian përbënte një risi, pasi që deri më 1938 Musolini i kishte rezistuar teorive të racës që promovonte homologu dhe aleati i tij në Gjermani, Adolf Hitleri.

Madje në një rast, Musolini gjatë një bisede private i kishte përshkruar ato teori si qesharake dhe të pavlefshme. Diçka e kishte bindur Musolinin që ta ndryshojë mendjen dhe menjëherë pas nxjerrjes së Manifestit, politika e regjimit fashist ndryshoi thelbësisht në raport me kolonitë afrikane dhe çifutët brenda Italisë, duke filluar një politikë persekutimi dhe represioni të haptë ndaj “racave inferiore” në bazë të një ligji racial të nxjerrë nga regjimi në po atë vit. Tani kur superioriteti dhe inferioriteti, pastërtia dhe ndotja e racave mund të vërtetohej shkencërisht, ishte e natyrshme që shteti të ndërmarrë veçimin dhe kategorizimin e njerëzve në bazë të “esencës” së tyre biologjike dhe gjenetike” etj.etj.

Milaj rreket që të identifikojë prejardhjen e asaj që ky e definon si "racë shqiptare", ku raca kuptohet si një bazament biologjik dhe gjenetik i shfaqjeve fizike dhe kulturore të një grupi njerëzor. Për Milajn, shqiptarët nuk përbëjnë vetëm komb kulturor, por edhe një popullatë që veçohet nga një prejardhje e veçantë gjenetike, që i bën shqiptarët të meritojnë cilësimin si "racë". Milaj, që kishte qenë ministër për bujqësinë në Qeverinë e parë fashiste në Shqipëri, nuk ishte antropolog, por në libër shkruan se ndjehej i cytur që teoritë raciale të gjejnë shprehje edhe në Shqipëri që të kuptohet "në baza shkencore" origjina dhe identiteti shqiptar.

Stephen Jay Gould në librin e tij "The Mismeasure of Man" ("Matja e gabuar e njeriut") hedh dritë mbi bazat false dhe pseudoshkencore të teorive raciale, të nocionit se kultura rrjedh nga biologjia, si dhe të metodave të klasifikimit të grupeve njerëzore në bazë të veçorive trupore (ngjyrës së lëkurës, formës së kafkës etj).

Dekada të tëra të punës së antropologëve dhe studiuesve të tjerë kanë dëshmuar se teoritë kishin karakter ideologjik e jo shkencor.

Teorinë e vet për "racën shqiptare" Milaj e mbështet pikërisht në këtë traditë të dështuar të pseudoshkencës mbi racën, me të cilën ai tenton të vërtetojë "pastërtinë" e racës shqiptare dhe t'i vendoste edhe shqiptarët diku brenda hierarkisë së racave që

kishin shpikur raciologët evropianë.
(Autori Besnik Pula është kandidat për gradën doktor në sociologji në University of Michigan, SHBA, ku specializon periudhën fashiste në Shqipëri).

Shkrimi të Besnik Pulaj, i kundërvihet Kolec Traboini, gazetar, shkrimtar, regjisor dhe publicist i njohur shqiptarë nga Bostoni në forumin virtual <http://WWW.ktraboini.com> dhe në disa forume të tjerë (Sport-ritmi i zemrës) më titull:

“Pasi Kolombi e ka thyer vezën”...

Besnik Pulaj bën te mençurin duke e quajtur Dr. Jakov Milajn racist..., në lidhje më denigrimin absurd e tejët cinik që i benë Besnik Pulaj veprës se Dr. Jakov Milajt "Raca shqiptare" duke e quajtur vepër raciste, shqetësim që e vlerësoj të drejtë sepse zotëriu kritizer në fjalë, flet më një stil gjoja akademik, por ex-catedra më një fjalor që nuk i shkon përshtat kurrfarë studiuesit, sado zemrak të jetë...

Duke e shitur vehtën si modern ky tip kritikuesi nuk e kishte për gjë te polemizonte me këdo që kishte frymë nacionaliste, ...transplantime idesh pa marrë parasysh rrethanat e veçanta që ka një komb e një popull...

Në analiza qoftë historike apo antropologjike, kushdo (duke përfshirë dhe z. Pulaj), mund të kenë

vërejtje për një studiues si Jakov Milaj, se koha ka bërë retushe, kanë ndodhur ngjarje të mëdha në histori si Lufta e Dytë Botërore, që në kohën kur u shkrua e botua kjo vepër nuk kishin dalë plotësisht në dritë, por të bësh të mençurin, pasi Kolombi e ka thyer vezën, është një absurditet i pashoq, për të mos thënë idiotësi në fushë të mendimit kritik. Jakov Milaj duhet gjykuar në rrethanat kur akoma nuk diheshin plotësisht ngjarje të tilla si gjenocidi i tmerrshëm ndaj izraelitëve.

E për më tepër nuk ka qenë ideja e Jakov Milajt superioriteti i racës shqiptare mbi racat e tjera, por për të zbukuar të veçantën, individualitetin që kishte raca shqiptare e çfarë nuk bie ndesh me vlerësimet historike të të huajve që kanë njohur tek shqiptarët cilësi të larta, qoftë si luftëtarë, qoftë në cilësitë morale si besnikërinë e mikpritjen.

Mirëpo edhe pse disa studiues i bëjnë punët mbrapsht e mbarë në Kosovë e në Shqipëri po i mbajnë me bukë gjithandej e shkrimet e tyre publikohen me bollëk e gjejnë mrekullisht edhe sponsor ndërkombëtarë...,që të kërkojë gjëlpëra në kashtë, pra racizmin tonë shqiptarë që vetëm ndonjë delirant në fushën intelektuale mund ta fantazojë,shkruan Kolec Traboini, nga Bostoni, SHBA...

Ndërsa " kritikuesi" tjetër Albert Nikolla, në Web faqen "Alb-Shkenca.org" me datën 13 maj 2005 shkruan: "...Personalisht mendoj se njeriu më adapt që ka përcaktuar racën tonë me objektivitet është studiusi

kroat më origjinë shqiptare Aleksandër Stipçeviç, i cili e përcakton kështu racën tonë: Raca shqiptare ashtu si dhe të gjithë racat e tjera evropiane, janë një produkt i pesë kulturave që kanë kaluar në teritoret Ilirike, përkatësisht një shartim Iliro-grek, iliro-greko-romak, më pas një shartim Iliro-romako-bizantin, dhe në fund, një produkt Iliro-greko-romano-bizantino-tartar (Turk).

Kjo tezë sipas Albert Nikollës, është shkencore pasi bazohet në elemente të rëndësishëm, si pushtimet e herë pas herëshme të trojeve shqiptare, në lëvizjet dhe migracionin e popullatave të ndryshme në drejtim të Shqipërisë, gjatë gjithë periudhave historike, në ekzistencën e disa tipave antropologjikë shqiptarë si tipi shqiptar mesdhetar, i shkurtër, brun, me kokë të madhe dhe sy të vegjël, tipi shqiptar origjinë kelte, i madh më sy blu deri në kafe, dhe më kafkë të madhe e shpatulla të gjëra, (sy të mëdhej) kryesisht në Malësinë e mbi Shkodrës dhe në Kosovë, dhe tipi shqiptaro-tartar me trup mbi mesatarën, kokë relativisht të vogël, këmbë të shtrembëra, flokë të zinj.

Evropa dhe kryesisht Ballkani, ka qenë një kazan popujsh, dhe nuk ekziston në asnjë vend të Evropës, përfshirë dhe Suedinë, që të ketë një racë, të pastër...

Me datë 26.06.2005 “Sport-ritmi i zemrës” z.

Enklid Milaj- nga Milano, lidhur më temën e shtruar në disa forume dhe revista shkruan:

Teoritë racore apo raciste

Letër e hapur drejtuar Muhamed Kullashit e Besnik Pulës për komentet mbi librin "Raca shqiptare" të Jakov Milajt

1. "Ti gjysh do më shumë kosovarët sesa shqiptarët", i thashë një ditë tim gjyshi, ndërsa shëtisja me të dhe vëreja që përshëndeste me shumë dashamirësi disa njerëz që mbanin qeleshe Kosove.

Im gjysh më shkuli lehtë veshin e më shpjegoi se "nga veriu i Mitrovicës e deri në jugun e Prevezës, të gjithë ishim shqiptarë". Dhe pyetjes sime, nëse edhe Gjylja, që ishte aq e zezë, ishte shqiptare - Gjylja ishte një rome që me një thes të madh vinte e lyppte në shtëpinë tonë - m'u përgjigj: "A nuk flet shqip, Gjylja?"

2. Pas reagimit emotiv ndaj artikujve tuaj, vendosa të rizbuloj gjyshin tim, jo plak 80-vjeçar, siç e kisha njohur unë, por si kishte qenë në kohën kur mendoi e shkruajti "Racën shqiptare".

E duke qenë se unë nuk jam filozof, pedagog recitimi o doktorant në SHBA (pa specifikuar ku e në çfarë) e nuk mund t'i lejoj vetes të jap gjykime mbi "antropologjinë fizike", u limitova të hap enciklopedinë "Larousse" të 1923, për të parë sesa larg do të gjendej përcaktimi i "racës" së përdorur prej "racistit" Jakov Milaj nga përcaktimi i kësaj enciklopedie jo raciste. Por për përcaktimin e "racës" që bën të vetin J. Milaj, "Për këtë vepër do t'ishte më i përshtatshëm përkufizimi i

Martial-it që iu shmanget rrymave politike, nuk lë përjashta pajën shpirtërore dhe i jep rëndësi kryesore historisë: Thirret racë përmbledhja e një popullsie, karakteret psikologjike të së cilës, të fshehura ose të shfaqura (posaçërisht gjuha dhe vizat antropologjike përbëjnë, brenda historisë, një njësi të dalluar", (f. 13/Botimi i vitit 1944) ishte thuajse i njëjtë me ato të Larousse-it.

Atëherë, i kënaqur me rezultatin, hapa me ndrojtje një enciklopedi bashkëkohore multimediale, "Rizzoli-Larousse 2001", me mendimin e induktuar nga ju zotërinj, se pas 60 e kusur vitesh nuk do të gjeja më një përcaktim të termit "racë" për njerëzit.

Por, tekstualisht atje, "Raca" përcaktohej në rendin antropometrik si "term i përdorur shpesh për komoditet klasifikimi, për të treguar një grup njerëzish që paraqesin një omogjenitet relativ të karaktereve somatik".

E atëherë, me më tepër guxim shfletova edhe një enciklopedi amerikane "Encarta 2002", e cila e përshkruan "Racën" si më poshtë: "Term i përdorur historikisht për të dalluar një popullsi nga një tjetër mbi bazën e elementeve biologjike."

Të gjithë njerëzit i përkasin species homo sapiens. Koncepti i racës rrjedh nga ideja që speciet njerëzore mund të ndahen në grupe të ndryshme biologjike.

Sidoqoftë, shkenca ka provuar që njerëzit nuk mund të ndahen në raca të pastra. Shumë shkencëtarë, sot e hedhin poshtë idenë e racës së ngurtë biologjike dhe e shikojnë njeriun si një proces në vazhdimësi.

Pavarësisht nga kjo, raca persiston si një koncept i fuqishëm social e kultural, që përdoret për të karakterizuar njerëzit në bazë të diferencave fizike të dukshme e të sjelljes".

Mora frymë thellë.

Përcaktimi i fjalës "racë" për njerëzimin vazhdoka të merret në konsideratë edhe sot e kësaj dite; nuk është, sigurisht, i njëjtë me atë që përdori, Jakov Milaj mbi 60 vjet më parë, por sidoqoftë nuk qenka herezi e, pavarësisht nga evolimi i saj, nuk qenka diametralisht i kundërt.

Nga leximet e mëpastajme arrita të kuptoj, që nga një anë ekzistojnë teoritë racore, e në anën tjetër ekzistojnë ato raciste.

Që teoritë racore flasin për tipin, llojin e specien. Që teoritë racore janë shpesh keqkuptuar e keqpërdorur.

Që nga keqpërdorimi i teorisë racore ka lindur racizmi. E që "teoritë raciste" flasin për superioritetin e domosdoshëm të një race ndaj një tjetre dhe legjitimojnë shfarosjen e asaj inferiore.

Me këtë background, e rilexova librin e Jakov Milajt, por në fund nuk e ndjeva aspak veten t'i përkisja një race më superiore se ajo e serbëve dhe e grekëve,

zotërinj, e nuk m'u ringjall asnjë lloj përbuzje për vllahët, jevgjit apo romët.

Aq më tepër kjo, kur autori shkruan se "Çështja e racave superiore dhe e racave inferiore, që është rrahur aq fort dhe vënë në mënyrë gjenerike, nuk ka kuptim". (F. 24, Botimi 1944).

Dëshpërimi im ishte i madh kur pashë se Muhamedin Kullashi, nga një anë përmend ndër emrat që kanë frymëzuar "racistin" Jakov Milaj, "racistët" Eugen Fiscer, F.Gall, Guenther e G.V. De Lapouge, që autori nuk i citon në librin e vet, nga ana tjetër, harron të shkruaj që "autori racist" ka përmendur në vitin 1944 edhe çifutin Norbert Jokl të vrarë prej nazistëve në vitin 1942 (f.44, Botimi 1944).

Por kritika juaj nuk mbaron me kaq.

Në vazhdim theksoni se "Milaj nuk bën asnjë vërejtje ndaj kësaj politike shfarosëse, veç konstatimit se nuk është e sigurt se do të përfundojë me sukses".

U habita! Këtë vërejtje, Milaj e ka botuar në janar të 1944, kur nazismi kishte zaptuar Shqipërinë. Nuk e di ku keni jetuar e sa zemërluan keni qenë ju, Muhamedin Kullashi apo paraardhësit tuaj gjatë diktaturave, por të jeni i sigurt që vënia në dyshim e realizimit të "objektivit madhor", konsiderohej nga nazizmi si krim, e për këtë ndëshkohej.

E së fundi, harroni qëllimisht, o nuk keni arritur të kuptoni, që Jakov Milaj nuk kishte marrë "racën e pastër" si premisë të punimit të vet, por kishte

parapëlqyer të mbetej nxënës i Pittard-it, duke e cituar këtë të fundit thujse 40 herë në veprën e tij.

Është e vërtetë që autori përmend togfjalëshin "racë e pastër", por e përkufizon këtë togfjalësh duke thënë se, "asnjë popull evropian nuk është i pastër nga pikëpamja e racës.

Luftërat mijëvjeçare midis fiseve, migrimet e popujve prej një vendi në një vend tjetër, përpjekjet e të fuqishmëve për të futur në dorë pasuritë natyrore që zotëronin popujt më të dobët, kanë shkaktuar gjatë shekujve përzierje kaq të shumta racash, sa që sot është e pamundur të flitet për pastërtinë e tyre të plotë. Por se përdorim me këtë kuptim përkufizimin e "racës së pastër", mund të themi me plot gojën se raca shqiptare është e pastër", (f. 141, Botimi 1944).

Për më tepër, ndërsa flet për "racën shqiptare", Jakov Milaj, jo vetëm nuk mohon ekzistencën e minoriteteve, por arrin deri aty, sa shkruan që ato "nuk kanë asnjë ndryshim prej tipit dinarik; dallohen prej nesh vetëm për gjuhën.

Hyjnë në grupin e tyre malazesët, bullgarët, grekët e kuçovllehët". (f. 126/ Botimi 1944)

3. Ndërsa ju, Besnik Pula, pohoni që autori i "Racës shqiptare" ishte fashist, pa i bërë pyetjen vetes çfarë do të thotë të jesh fashist. Përgjigjen nuk mund t'jua jap unë zotërinj, por mund ta gjeni në shtypin e kohës, ku Jakov Milaj shkruante herë me emrin e vet e herë me pseudonimin Horus.

Unë vetëm po limitohem t'ju kujtoj që Branko Merxhani, kryeredaktori i revistës "Përpyekja shqiptare", pas 7 prillit 1939, u largua nga Shqipëria, ndërsa bashkëpunëtori i tij, Jakov Milaj, që u emërua kryeredaktor i revistës pas largimit të Merxhanit, arriti të botojë vetëm një numër të kësaj reviste, se pastaj fashistët ia mbyllën.

Po zotërinj, Jakov Milaj ka qenë ministër i Bujqësisë së qeverisë së Maliq Bushatit në vitin 1943. Por para se të njollosni emrat, duhet të paktën të verifikoni se cili ka qenë konteksti historik në të cilin veproi kjo qeveri, cili ishte programi i saj. Pastaj për hir të së vërtetës, z.Pula duhet të shkruani se pas tre muajsh, ministri Jakov Milaj dha dorëheqjen. (A nuk është edhe ky një akt i guximshëm për kohët e fashizmit?). Dhe motivi i dorëheqjes ishte refuzimi i nënshkrimit të dhënies me koncension të pyjeve shqiptare italianëve. Falei kësaj here Jakov Milajn, zotërinj, ai si ministër bujqësie nuk mund të bënte më tepër se të emëronte 30 zotënikë e veterinerë të lartë të Shqipërisë në Kosovën “djerrë, por pjellore”.

E mos harroni, se në vitet '40, dy ishin kampet që ndesheshin me njëra-tjetrën. Nga njëra anë, nacionalistët, që duke shfytëzuar situatën e kohës, për herë të parë arritën të shihnin një Shqipëri të shqiptarëve, edhe pse nën hijen e rëndë të fashizmit, e nga ana tjetër, komunistët të themeluar nën kujdesin e Miladin Popoviçit, të cilët që në projektet e tyre fillestare donin

që kjo e fundit t'i bashkangjitej shtetit jugosllav. E mos harroni zotërinj, nëse jeni seriozë e pragmatikë, që një Shqipëri e shqiptarëve në ato kohë të vështira, ishte e mundur vetëm duke rinunçuar diçka e duke paguar një çmim tepër të madh, d.m.th. duke bërë kompromise me njërin kamp. A nuk duhet të paguajmë një çmim shumë të lartë e të bëjmë shumë kompromise edhe sot, që komuniteti ndërkombëtar të njohë pavarësinë e Kosovës?

Nuk e di, nëse me fjalët e mia ju kam mbushur mendjen që Jakov Milaj nuk ka qenë fashist e racist në vitet '30 e '40, por di që, në ato vite, shqiptaromadhi Jakov Milaj ishte mik i "malazesit" Migjeni e bujti në shtëpinë vet në Torino "internacionalistin" Asim Vokshi, që ishte nisur për në Luftën e Spanjës.

4. Për sa i përket rehabilitimit prej komunizmit, Jakov Milaj nuk ka nevojë për mëshirën e askujt. Jakov Milaj e kishte për nder të ishte lidhur në të njëjtat pranga me "fashistin" At Anton Harapi apo Bahri Omarin dhe jo vetëm i kishte falur me kohë persekutuesit e tij, por i mësoi edhe fëmijëve e nipërve të vet të falin, por mos të harrojnë.

5. Jakov Milaj e përdori "racën" në librin e tij, jo për të bërë klasifikime raciste, (më citoni një fragment në të cilin shkruhet se jemi superior ndaj grekëve e serbëve (f. 126 botimi 1944), por për të bërë një diversifikim. E diversifikimi është pasuri.

Jakov Milaj e përdori "racën" për të bindur labin kokëfortë, që kosovari është po aq shqiptar sa ai, për t'i

thënë shqiptarit të Mitrovicës që himarioti nuk është grek, për t'i mbushur mendjen të krishterëve me ortodoksë e integralistë, që edhe pse Muhamedin Kullashi e Mehmet Kraja kanë një emër që tingëllon aq turk, sa emri i një turku Stambolli, janë shqiptarë. Jakov Milaj e përdori “racën” në librin e tij, për t'i thënë shqiptarit “anakronik” të djeshëm e të sotshëm, që të ketë besim te vetja e të njohë vetveten në një kuptim të ri.

Patjetër, "Raca shqiptare" është një vepër që pasqyron edhe filozofinë, shkencën e terminologjinë e kohës së vet e të gjitha limitet e saj; që ka një titull që të sjell menjëherë ndërmend "racizmin"; që me relativitetin e kohëve të sotme shumë prej tezave të shkruara në të nuk janë më bashkëkohore e ndonjë edhe e gabuar.

Për fat të keq, teoritë mbi racën u degjeneruan, u keqpërdorën dhe u shndërruan shpeshherë në racizëm, duke prodhuar tragjedinë më të madhe të shekullit të kaluar. A mos vallë edhe doktrinat e shenjta si krishtërimi e islamizmi, kur janë keqpërdorur nuk kanë pjellë dhunë?

Sidoqoftë, sado dashakeqës o sipërfaqësor të jeni zotërinj, sado mos ta keni lexuar librin e të keni marrë guximin të gjykoni prej titullit të tij apo parathënies, nuk e keni të drejtën morale të gjeni "racizmin shqiptar aty ku nuk është" e ta radhisni emrin e Jakov Milajt mes atyre që kanë realizuar “shfarsosjen e çifutëve”.

Ndër reliket që ndodhen në shtëpinë ku banonte Jakov Milaj, është edhe një "hanuchia". Dhuratë, që miqtë çifutë të "racistit" Jakov Milaj, i bënë familjarëve pas vdekjes së këtij të fundit.

6. Një miku im çam, pasi lexoi shkrimet tuaja, këto ditë, më tha:

"Për sa kohë kosovarëve u duhej bashkim dhe identitet e ndryshmëri nga serbi, ata e kishin librin ungjill (fjalë të prof. A. Çetës, thënë në Fier, 1992). Tani që nevoja e do të hapen e të njihen nga bota e shkelen menjëherë".

Jo, - i thashë mikut tim, - nuk e shkelin kosovarët Jakov Milajn, pasi e dinë se, nëse Jakovi do të ishte gjallë e do të kishte edhe më të voglin dyshim, se libri i tij do të bëhej në çfarëdolloj mënyre pengese për njohjen e pavarësisë së Kosovës, do të ishte ai i pari që krijesën e vet të viteve '40, do ta kishte braktisur në hauret e harresës".

7. Kur nisa t'ju shkruaj këtë letër, isha i tronditur e druhesha se ajo do të dilte thjesht emotive.

Por tani që e mbarova, vura re se më shumë se unë, ka folur Jakov Milaj.

"I dua kosovarët – i thoshte Jakov Milaj nipave të vet – pasi pa kosovarët, Shqipëria nuk do të ekzistonte". (Enklid Milaj është nipi i Jakov Milaj. Enklidi është jurist pranë Studios Legale Internacionale "Lovells", Milano)

Bleron Baraliu, nga Prishtina publikon më datën 15.05.2005 shkrimin në Web faqen “Alb-shkence.org”, ku shkruan :...Nga përmbledhja, kam mundur të kuptoj vetëm se libri kërkonte të bejë identifikimin statistikor të karakteristikave fizike të Shqiptarëve dhe jo t'i klasifikojë ata si superior apo të klasifikojë ndonjë popull tjetër si inferior.

Motivet e studimeve të tilla nga gjermanët, psh., kanë qenë të errëta, por kjo nuk mund të na shfrytëzojë si paragjykim për studime tjera të kësaj natyre...

Në Web faqen Alb-shkenca.org më datën 21.06.2005., Flori Bruqi, zhvillon polemikën me titull: “Replikë për shkrimin e B. Pulës etj., në “Alb-shkenca.org” dhe “Koha ditore”.

Autori Jakov Milaj në librin e tij “Raca shqiptare” jep të dhëna interesante për karakteristikat fizike të shqiptarëve. Përveç të dhënave përshkruese të pamjes së jashtme (ngjyra e syve, qepallat, piloziteti trupor, ndërtimi muskolor i trupit ,etj.) autori jep vlerat e disa matjeve trupore si dhe të kokës. Me aplikimin e analizës faktoriale në hulumtimet antropologjike filloi një hulumtim më i suksesshëm i ndërlidhjes dhe ndikimit të ndërsjellë ndërmjet ndryshoreve të matura në të njëjtën hapësirë apo në hapësira të ndryshme antropologjike.

Analiza faktoriale është aplikuar në hulumtimet e shumta ku është trajtuar ndërtimi dhe forma trupore e njeriut (L . Rees , 1950, Miliceroëa, 1951, M.Lorr dhe

V.Fields, 1954, W.Hammond,1957.). Me matje antropometrike është marrë A. Skibinska (1970, 1977), Ferenc Bakoni (1968) , Josip Babiq (1986) , Jan Babiak (1987), Xh. Stevanoviq (1990). etj.

Ndër hulumtuesit e trevës tonë (Kosovë) duhet veçuar hulumtimet antropometrike, morfologjike, fiziologjike dhe anatomike të popullatës tone si bije fjala hulumtimet shkencore të prof. dr. sc Mustaf Aliu (1991-2005), Ass. prof. Dr. sc. Ajvaz Berisha (2002, 2005), ass. prof. dr. Hasim Rushiti (1999-2005), dr.sc. Abedin Bahtiri (2004), Mr. sc. Flori Bruqi (2001- 2005), prof. dr. sc. Ibrahim Behluli (1999-2005); prof. dr. sc. Bajram Nura (1999-2005); prof. dr. Hilmi Dautaj (1999-2007); prof. dr. Agim Vela, prof. dr.Hysni Daka, prof. dr. Natyre Karahoda etj.etj.

...“Raca shqiptare”, është e mbështetur në hulumtimet e bëra nga Pittard dhe të tjerë, të sjella me një tabelë matjesh cefalike dhe kranimetrike të tre popujve të siujdhesës Ballkanike: të shqiptarëve, grekëve, sllavëve (serbë dhe bullgarë); Tab 1. Skema e tipave cefalikë më përqindje (sipas J.Milaj)

POPUJT

1. Brakicefalë - Shqiptarët 79,50% 11,60% 8,90%
2. bC Mezocefalë-Grekët 48,98% 17,24% 33,70%

3. mC Dolikocefalë - Bullgarët 24% 22% 24%4. dC-Serbët 29,8% 30,70% 39,20%.

Siç shifet, në këtë tab kranimetrike, brakicefalia është shumë e lartë të shqiptarët, është e lartë të grekët, por mjaftë e ulët (në raport më shqiptarët dhe grekët) te sllavët, kurse dolikocefalia është mjaftë e lartë te sllavët, mesatare te grekët, kurse shumë e ulët te shqiptarët.

Brakicefalia e lartë të grekët ka qenë e vërejtur nga antropologët Pittard, Deniker, Bataglia etj. Ata shohin brakicefalinë dominante të grekët që banonin në përendim të maleve Pind (që nga Epiri dhe Etolia deri në Peleponezë, hapësira këto më përpara të banuara nga dorët), ndërsa, këta antropologë, dolikocefalinë e kanë parë me predominancë të lartë në lindje të vargmaleve Pind deri në Atikë.

Sipas këtyre shkencëtarëve, te rumunët predominon tipi brakicefal, kurse te jevgjit (ciganët) e këtyre hapësirave predominon dolikocefalia.

Prof. dr. Shefki Sejdiu, si dhe disa antropologë tjerë të shekullit 19 brakicefalinë e shpjegojnë si cilësi të popujve aziatikë, por Renato Bosuti (sipas nesh dhe Jakov Miljat) si dhe antropologjisë bashkohore rrënjët e brakicefalisë i shohin në Europë.

Antropologu gjerman L. Swidetzky mendon që, alpidët (Keltët) dhe dinaridët (Iliët) kanë pasur një kalim nga dolikocefalia, pra ka pasur një process dedolikocefalizmi, përkatësisht brakicefalizmi.

Në skemën e mëposhtme do të rekonstruktojmë procesin evolutiv të ndryshimeve cefalike nga shkalla primare e tipit cefalik me predominancë dolikocefalike (DC) tek indoeuropianët në djepin e tyre, që supozohet të ketë qenë hapësira e Europës Veri-Lindore e që, tani, është karakteristikë e popujve nordikë (gjermanë, skandinavë) dhe atyre të Europës Veri - Lindore (sllavët). Supozohet se ky proces ka qenë i hershëm.

Kalimi i tillë nga dolikocefalia në brakicefali i alpino dinaridëve (keltëve dhe ilirëve) është konfirmuar edhe nga P. Bosch - Gmimpera, antropolog i dhjetëvjetshit të fundit të shekullit të shkuar...

Siç kemi shkruar me herët në “Alb-Shkencë”; “Art-Café”, “Floart-Press” etj., sa i përket lartësisë së trupit, sipas matjeve të shkenëtarëve, serbët janë të gjatë deri në mesatare, shqiptarët kanë gjatësi mbi mesatare, kurse grekët kanë gjatësi mesatare të trupit.

Si tek Ilirët, ashtu tash edhe te shqiptarët, tipi dinarid apo Adriatik apo Ilirik është dominues si për kah forma e kokës dhe gjatësia e trupit, por edhe për kah ngjyra e lëkurës dhe syve; të shqiptarët dhe grekët hasen mjaft tipare edhe te tipit Mediteran. Kjo natyrë antropologjike dinarido-mediterane e shqiptarëve mund të spjegohet me praninë shumë të hershme të protoshqiptarëve në Ballkan dhe Mediteran.

Sipas shkencëtarit kosovar, prof. dr. sc. Shefki Sejdiu, për të kuptuar më mirë karakterin dolikocefalik të nordikëve dhe europianëve verilindorë, flokëverdhë

dhe atë të alpideve dhe dinaridëve mezocefalikë dhe brakocefalikë ndihmon shumë rregulla e Bergmanit, sipas të cilës qenieve të gjalla, për të mbijetur në hapësirë me klimë të ftohtë, u nevojitet një masë më e madhe trupore, por mutatis mutandis, në hapësirat e ngrohta apo në ato me klimë të moderuar nuk iu nevojitet një masë e madhe (mbrojtëse e tillë).

Sipas kësaj rregulle rezulton se populli Kelt dhe ai Ilir, më herët se popujt tjerë indoeuropianë u janë drejtuar hapësirave me klimë më të moderuar dhe më të ngrohtë të Europës Qendrore dhe Mesdhetare (Mediterranit).

Ky konstatim mund të përforcohet me faktin se edhe te francezët si dhe te shqiptarët përveç tipareve Alpiko-Dinaride hasen edhe ato Mesdhetare (Mediterrane).

Në fund mund të pohohet se shumë ndryshime antropologjiko-morfologjike (tipare të kokës, trupit, ngjyrës së lëkurës dhe syve) janë të kushtëzuara nga faktorë gjeoklimatikë dhe rrethana të tjera sociokulturore, historike, kontaktesh dhe raportesh substrato-adstrato-superstratike etj.

Te shqiptarët hasen gjithashtu gjurmë të lashta etnokulturore siç janë kuvada, kulti i diellit, kulti i gjarpërit, rite vdekjeje, si psh. mbyllja e syve të posavdekurit nga ndonjë i afërm i tij, rit ky i ngajshëm më atë të italikëve të periudhës romake dhe veprime siç

është gjakmarrja, e ngjajshme me viendettan korzikane apo ajo malazeze etj.

Në fushë të etnolinguistikës, përveç përdorimit virtual dhe simbolik sidomos të numrave 3, 7, 9,12 etj., që mund të hasen edhe te shumë gjuhë të popujve të hapësirës mesdhetare e më gjërë, te shqiptarët haset edhe një përdorim emotive i këtyre numrave. Të hangshin shtatqind mi dreqen ! etj.

Nga gjuhët e Ballkanit shqipja është e vetmja gjuhë që akoma ruan gjurmë të sistemit vigezimal si te dyzetë ($2 \times 20 = 40$); më përpara, në shqipe, për të shprehur nocionet “60” dhe “80”, janë përdorur strukturat vigezimale trezet (3×20) dhe katërzet (4×20).

Një logjikë e tillë e formimit të emrave haset edhe në baskishte ($2 \times 20 = 40$); në galishte ($2 \times 20 = 40$); $3 \times 20 = 60$; $4 \times 20 = 80$) në oksitanishte dhe në frengjishte të vjetër ($3 \times 20 = 60$; $4 \times 20 = 80$; $6 \times 20 = 120$ madje edhe $15 \times 20 = 300$); në frëngjishten e re gjithashtu haste $4 \times 20 = 80$ por edhe emra të tjerë të numrave të ndërtuar mbi këtë bazë për numrin, psh. 99 thuhet $4 \times 20 + 10 + 9 = 99$ etj.

Profesor i mirënjohur Dr. sci. Shefki Sejdiu shkruan : “...Në gjuhën shqipe gjallojnë struktura etnolinguistike apo më saktësisht antropolinguistike dhe kulturore që dëshirojnë se, që në lashtësi, kanë ekzistuar kontakte të protoshqiptarëve dhe të gjuhës së tyre, me popuj, gjuhë dhe kultura paraindoeuropiane të Mesdheut. Këto gjurmë hetohen të disa emra të sistemit të farefisnisë si elemente materjarkati, p.sh. tek emri

motër... Dhe në vend të konkludimit; këto gjurmë të lashta antropologji, etnokulturore, gjuhësore, racore që ndeshën të shqiptarët nuk janë sjellë këtu vetëm si fakte të ndara dhe të shpërndara, përkundrazi ne këtu jemi përpjekur që këto fakte ti shohim, si struktura dhe në sisteme (jo) raciste.

Pjesa më e madhe e këtyre elementeve dhe fakteve janë gjurmë dhe dëshmi e kontakteve direkte dhe e një jete në simbiozë, që në kohrat më të lashta, me popujt paraindoeuropeanë dhe indoeuropeanë si dhe me kulturat dhe gjuhët e tyre në hapësirat e Mesdheut.

Literatura

1. Aliu, M.: "Razvoj morfoloskih obeležja skolske populacije i razlike u tim obeležjima na kronolosku dob., Doktorska disertacija, 1992, Sarajevo.
2. Bozina, M.I.: Morfoloske osobine jugoslovenskih naroda, etnoantropoloski problemi, knjiga 11, Beograd, 1990.
3. Bruqi, Flori.: "Delikuenca e të miturve dhe ushtrimet trupore, Flomed, Prishtinë, botimi 1, 2003 dhe botimi 2, 2004.
4. Bruqi, Flori.: Ndikimi sistematik i ushtrimeve fizike në strukturën e personalitetit të sportistit, Flomed, 2003, botimi 1 dhe Flomed, 2004, botimi 2.
5. Bruqi, Flori.: Dallimet në disa ndryshore fiziologjike ndërmjet studentëve sportistë dhe jo sportistë para dhe pas vrapimit 400 metra, Punim magistrature, Prishtinë, 2005.
6. Bruqi, Flori.: Ndikimi i ushtrimeve trupore në personalitetin e të rinjve, Prishtinë, 2005, projekt

7. Bruqi, Flori.: Ndikimi i ushtrimeve trupore në fajshmërinë e adoleshentëve, Prishtinë, 2005, projekt
8. Durakovic, M. M., i suradnici, Morfoloska antropometria u sportu, Zagreb, 1995.
9. Milaj, Jakov "Raca Shqiptare", Tiranë, 1945 dhe 1997.
10. Materjale të shfrytëzuara të polemikave të autorit Flori Bruqi, të zhvilluara në forumet virtuale "Art-Café", "Alb-shkenca.org" dhe "Sport-ritmi i zemrës"(maj-dhjetor 2005), etj.

(Për shkrimin kritik në fjalë janë shfrytëzuar disertacionet e ndryshme shkencore si fjala vjen të ass. prof. dr. Hasim Rushitit, ass. prof. dr. Ajvaz Berisha, ass. prof. dr. Sadik Krasniqit, si dhe shumë punime të botuara në forume revista dhe gazeta, për çka ju jam mirënjohës autorëve).

STERJO SPASE

Sterjo Spasse u lind në Gllomboç të Prespës më 1914 dhe vdiq në Tiranë më 1989. Mësimet fillore i nis greqisht në vendlindje dhe i vazhdoi shqip në Goricë të Madhe dhe në Korçë.

Kreu Normalen e Elbasanit ku kishte profesor Aleksandër Xhuvani dhe Simon Shuteriqin.

Studimet e larta të pedagogjisë i kreu në korrespondencë në Firence.

Botoi shkrimet e para në revistën “Normalisti”, bashkëpunoi me revistat “Zëri i Korçës”, “Abc”, “Rilindja”, “Bota e Re”, ku botonte shkrime letrare e kritike.

Bashkë me Ismail Kadarenë kreu kursin e lartë të letërsisë në Bashkimin Sovjetik.

Jeta dhe librat

Romani i vitit 1955 “Afërdita përsëri në fshat”, nga veprat më të propaganduara të letërsisë shqipe në Kampin komunist, del në qarkullim sërish si botim i shtatë. Kjo shënon dhe shndërrimin e Sterjo Spases nga romancieri i parë modern i letërsisë shqipe në autorin e respektueshëm të metodës së realizmit socialist.

Për ribotimin e romanit “Afërdita përsëri në fshat” është kujdesur si gjithnjë, biri i autorit, Ilinden Spasse që e takuam në vendin ku për afro shtatëdhjetë vjet ka jetuar familja Spasse. Në truallin e shtëpisë me qerpiç është ngritur prej pak kohësh një pallat me mjedis të qetë ku, në orë të caktuara, dëgjohen kambanat e kishës katolike në Rugën e Kavajës.

Ajo shtëpi ishte blerë me paratë e Çmimit të Republikës të shkallës II, 100 mijë lekë, që Spasse i pati fituar më 1953 me romanin “Ata nuk ishin vetëm”.

Një shtëpi po aq e vjetër sa romani “Afërdita përsëri në fshat”. Romani ishte botuar më 1955, fillimisht në tri numra të Revistës “Nëntori” me titullin “Për jetën e re”. Fitoi Çmimin e parë me rastin e 10- vjetorit të çlirimit të Shqipërisë dhe autori u shpërblye me 75 mijë lekë. Me të dalë në qarkullim “përsëri filluan vërshimet e letrave, e kritikrat pozitive, lavdërimet dhe urimet... Ky ishte romani me të cilin Sterioja ishte lodhur më pak, e që pa dritën e botimit menjëherë e pa asnjë

telash”, shkruan Ilinden Spasse në kujtimet “Im atë, Sterjo!” (1995).

Zoti Ilinden ka vendosur mbi një tavolinë të vogël mjaft botime të “Afërditës...” në vendet e Kampit komunist.

Në gjuhën bjelloruse qarkulloi në 5000 kopje, në gjuhën ukrainase në 15 mijë kopje, u botua në greqisht më 1959, në bullgarisht etj. Por kampion është Kosova me ribotimet e “Rilindjes” e cila do të realizojë edhe botimin e veprës complete të Spasses. E shikojnë “Afërditën...” edhe lekturë shkollore për të rinjtë e Kosovës. “Afërdita... nuk është përkthyer në asnjë gjuhë perëndimore”, shton Ilinden Spasse 70-vjeçar. “As “Pse?”-ja nuk është përkthyer veçse vonë, në maqedonisht. Ka vepra që janë përkthyer në 20 gjuhë...”.

Burri që sa qe gjallë i ati, ka punuar shumë ngushtë me të aq sa ta quajnë sekretari i Sterio Spasses, sqaron se botimi i shtatë i “Afërditës përsëri në fshat” nuk ka asnjë ndryshim nga botimi i parë, i cili i rri besnik dorëshkrimit.

Kur shkruhej romani, Ilinden i ishte 12 vjeç dhe kujton se kapitujt e fundit i ati i pati shkruar gjatë udhëtimit dyjavor me vapor në Bashkimin Sovjetik. Këtë kapitull trashëgimtari nuk e veçon për ndonjë qëllim, ndërsa po veçojmë diçka e që është fjalja përmbyllëse e romani: “Mbi Grykas e mbi Pishë, si mbi të gjitha fshatrat e Shqipërisë, do të ndrisë ylli i kulturës bashkë me begatinë. Dhe kraharori i Afërditës u mbush e u

mbush me një gëzim të papërmbajtshëm dhe i erdhi që këtë gëzim t'ua shpërndante edhe të tjerëve, edhe natyrës, e të gjithë së bashku të këndonin këngën e ndërtimit të socializmit, këngën e jetës së re.”

“Patjetër që është roman i realizmit socialist. Kjo është historia e letërsisë”, thotë qetë - qetë zoti Ilinden. “E veçanta e tij është që ka personazhe bardhë e zi, po edhe personazhe të lëkundur. Në romanin “Afërdita” që e mbaroi më 1939 dhe u botua më 1944, personazhi është thjesht një mësuese, e cila shkon nga qyteti në fshat dhe tregon tërë ambientin dhe përpjekjet e saj për të emancipuar shoqërinë e viteve ‘30. Ndërsa te “Afërdita përsëri në fshat”, po kjo Afërdita ka dalë partizane dhe kthehet përsëri në fshat me ideale të tjera. E mira e këtij romani është që pasqyron periudhën e reformës agrare dhe arsimore, që u zhvilluan në të njëjtën kohë. Kjo ishte një luftë mes konfliktesh, midis të pasurve dhe të varfërve, midis besimit dhe mosbesimit, midis ndërhyrjeve nga jashtë edhe nga brenda. Më duket se është nga romanet më të mirë të asaj periudhe.”

Ky emër, Afërdita hyn në letërsinë e Spasses, fillimisht nën hijen e Gjon Zaverit, në romanin “Pse?” 1935.

Është vajza më e mirë e katundit me të cilën kërkojnë ta martojnë Gjon Zaverin, një intelektual i tërhequr dhe i vetëpërgjashtuar nga Korça e viteve '30.

Gjoni martohet pa dashuri me Afërditën dhe një ditë kryen vetëvrasje.

Në romanin e dytë “Afërdita” 1944, ajo është protagonistja që mendon se do të ndryshojë botën që e rrethon.

Studiuesit e letërsisë e cilësojnë “Pse?”-në si romani i parë modern i letërsisë shqipe. Edhe “Afërdita” i përket periudhës së modernitetit të Spasses. Kur vjen puna për të gjykuar letërsinë që Spasse shkroi pas lufte, ka studiues si Sabri Hamiti që e dallojnë qartë atë nga periudha pararendëse e kulmeve artistike të cilat Spasseja “nuk i përsëriti asnjëherë me veprat e mëvonshme”. Hamiti vlerëson risitë që solli ky autor në gjininë e romanit.

“Pse?” -ja, i shkruar gjatë kohës që Spasse punonte mësues në Devičan të Gjirokastrës, inauguron romanin social me një shtresë të fortë psikologjike duke artikuluar edhe pikëpamjet e ndjeshmërisë së një brezi.

Ndërsa në romanin e dytë kemi një heroinë, e cila zbulon jetën në realitetet shqiptare, por edhe bën përpjekje të jashtëzakonshme për ndërrimet e tyre.

“Utopia e romanit të dytë që lartëson aktivizimin, është në kundërshtim të plotë me romanin e parë.

Personazhi i Afërditës është më tepër një tip i idealizuar që ka shenjat e misionares në jetën shoqërore... Afërdita nuk ka jetë personale. Ajo jeton për të tjerët dhe me të tjerët”.

Hamiti shton (Letërsia moderne shqipe, UET Press, Tiranë, 2009) që mund të flitet për ndërrime të mëdha edhe në konceptet e vetë autorit: kemi një Gjon

Zaver meditant dhe një Afërditë militante, të dy parë në raporte me realitetet e vendit. Afërdita, sipas tij është një heroinë sociale e ndërrimeve, por më shumë një heroinë morale. Kështu, veprat që Spasse shkruan mbas Luftës së Dytë Botërore, “nuk lidhen as tematikisht dhe as me stil me veprat e periudhës së parë të krijimtarisë së tij letrare”.

Te “Afërdita përsëri në fshat” personazhi flet me këtë gjuhë:

“Një ditë, duke kuvenduar te lëmi i Shemos, ashtu vetëm siç kishte qëlluar rastësisht, Stefani, sipër e sipër, u përpoq t’i nxirrte ndonjë gjë, duke e pyetur me tërë sinqeritetin e vet:

- Vërtet, Afërditë, si u bë që erdhe përsëri këtu si mësuese?

Ajo e vështroi me habi, pastaj sakaq vuri buzën në gaz.

- Më pëlqen mësuesia, më pëlqen të jetojë me fshatarët, më pëlqen t’u ndihmoj me sa mundem e t’i shoh të lumtur, shumë të lumtur. Pastaj a ka gjë të më të bukur e më fisnike sesa të punosh për popullin e me popullin.”

Kanë ndërruar konceptet e vetë autorit, thotë Hamiti.

Në faqet e ditarit “Kuvendim me nipin”, letra që Spasse ia shkuan djalit të Ilindenit nga udhëtimi i tij i vitit 1975 nëpër Maqedoni e Kosovë gjejmë një përshkrim me interes për realitetet artistike që prekte

Sterio Spasse para dhe pas Çlirimit e që kanë ndikuar në shijet e tij:

“Para Çlirimit jam dehur dhe entuziazmuar nga arti realist italian duke vizituar galeritë e arteve të Romës, Firences, Napolit, Peruxhies e gjetkë, arti i pikturave e i skulpturave, por njëkohësisht edhe arkitekturave. Mikelanxhelo, Rafaeli, Botiçeli, Tiziani, Giotto, Peuxhino e dhjetëra të tjerë artistë të mëdhenj të Rilindjes italiane e botërore më kanë hyrë aq fort në zemër... Që atëhere më magjepsi edhe flamandezi Rembrand edhe Van Gogu, edhe... Ou edhe sa të tjerë! Pas Çlirimit u deva me artin rus e të përbotshëm në muzetë “Ermitazh” dhe Ruski Muze në Leningrad, e në Galerinë “Tratjakoskaja” dhe në muzeun “Pushkin” të Moskës... disa herë më radhë kur shikoja veprat e Matisit e të Pikasos”.

Një shkrimtar i ushqyer me perlat e artit ikonografik botëror do të shkruajë pas Çlirimit për shenjtoret e Grykasit. Sepse kërkohej një letërsi e re, një roman i ri?

“Letërsia jonë e re atëherë sigurisht që nuk i arrinte t’i plotësonte kërkesat e nevojat tona”, shkruan te “Koha e Kujtimeve”, Nasho Jorgaqi, bashkëkohës i Spasses. Ndoshta duhet shkruar “nevojat tona të reja”. Këto nevoja si fillim i plotësonte letërsia e përkthyer, kryesisht letërsia sovjetike, e përfaqësuar nga Gorki, Majakovski, Shollohovi, Fadajevi, Ehrenburgu. Por revistat e Lidhjes së Shkrimtarëve “Literatura e jonë”

(më vonë “Letërsia jonë”) ku një nga penat ishte edhe e Spasses, shpallte hapur nevojën për një letërsi të re që kolonë mbajtëse duhej të kishte ideologjinë e partisë. Kishim përqafuar një ideal që na frymëzonte për të ndërtuar një botë të re, ndërsa në Bashkimin Sovjetik ishte krijuar dhe një art i frymëzuar nga përpjekjet për të sulmuar qiejt”, shkruan Jorgaqi, një protagonist i mjedisit letrar të asaj kohe.

Pikërisht në revistën “Letërsia jonë” botohen fragmente nga “Çlirimtarët” dhe më pas “Harbutët” i Spasses (botuar me titullin “Ata nuk ishin të vetëm”) dhe të dy u hodhën njëherësh në qarkullim. Kështu “inauguruan romanin shqiptar të realizimit socialist”. “Ata nuk ishin vetëm” u përkthye në frëngjisht, ndërsa në Bashkimin Sovjetik thuhet se qarkulloi në 200 mijë kopje.

Pa botuar

“Babait i thanë dikur përpunoje “Pse?”-në dhe ai nuk e bëri. Ishte vepra e tij më e dashur, vepra e rinisë. Thonë që “Pse?”-ja është kryevepra e tij”, thotë Ilindeni. Por ai nuk e fsheh keqardhjen që në festat për 100 vjetorin e pavarësisë, nuk e sheh gjëkund të përmendur ciklin e romaneve “Rilindësit” të Sterjo Spasses. “Sepse është i vetmi shkrimtar që ka shkruar për periudhën e Rilindjes në aspektin historik ekonomik e social. Është cikli i romaneve për luftën heroike të popullit shqiptar

kundër sundimit turk dhe shovinizmit të fqinjëve gjatë kohës së Rilindjes”.

Ilinden Spasse ka përgatitur bibliografinë e të atit, e cila ka rreth 3000 zëra dhe mbi 1500 personazhe. Vetëm nga “Rilindasit” ka 900 e sa personazhe.

“Ndoshta do ta botoj për 100 vjetorin e Spasses, më 2014. Çdo gjë që kam botuar për babanë e kam bërë me paratë e mia, “Pse?”, “Afërdita, përsëri në fshat”, “Të fala nga fshati”, “Simfoni e pambaruar”. Edhe vetë i kam shitur. Po kjo është një torturë. Ndihmë nuk kam. As Korça, si bir i Korçës që ishte Sterjo Spasse, nuk ka bërë gjë”.

Zoti Ilinden flet dhe për një roman që Spasseja e ka lënë të papërfunduar. “Roman për vitin e parë të pas Çlirimit. Mua më pëlqen pasqyra reale e kësaj periudhë 1945-‘47. Them që po të ishte i realizuar, babai do ta kish botuar.”

Sterjo Spase shkroi këto libra: "Kuror rinie" (1934), "Në krahët e një femre" (1934), "Nusja pa duvak" (1944), "Të fala nga fshati" (1958), Novels[edit], "Pse ?" (1935), "Afërdita" (1944), "Ata nuk ishin vetëm" (1952), "Afërdita përsëri në fshat" (1954), "Buzë liqenit" (1965), "Zjarre..." (1972), "Zgjimi" (1973), "Pishtarë" (1975), "Ja vdekje ja liri" (1978), "Kryengritësit" (1983).

HAKI STËRMILLI – “SIKUR TË ISHA DJALË”

U lind në Dibër të Madhe ku mori mësimet e para. Kreu gjimnazin turk në Manastir. Në vitet 1920-1924 hyri në lëvizjen demokratike dhe u bë një ndër drejtuesit e shoqërisë "Bashkimi".

Pas dështimit të Revolucionit Demokratiko-Borgjez të qershorit 1924, si emigrant politik në Bashkimin Sovjetik, Itali, Austri, Jugosllavi e gjetkë, e vijoi luftën kundër regjimit zogollian dhe bashkëpunoi në faqet e "Lirisë kombëtare" dhe "Federacioni Ballkanik".

Më 1930 policia jugosllave ua dorëzoi autoriteteve të Ahmet Zogut që e dënoi me burgim. Haki

Stërmilli mori pjesë si partizan në Luftën ANÇ, ishte anëtar i KANÇ-it. Haki Stërmilli-ishte kryengritës i luftërave të Dibrës.

Hapat e parë në letërsi i bëri në fillim të viteve 20 me dramën ("Dibranja e mjerueshme", 1923, "Dashuni e besnikri" 1923, etj.), në të cilat i bëhet jehonë luftës heroike të dibranëve kundër shovinistëve serbë. Shkroi edhe librin "Burgu" (1935). Vepra e tij më e shquar është romani "Sikur t'isha djalë" (1936), ku kritikohen rreptë despotizmi familjar, normat e moralit sundues, që ndrydhnin personalitetin e femrës shqiptare. Romani u prit mirë nga shtresat demokratike dhe shpejt u bë një nga veprat më të lexuara të kohës. Më 1968 u botua romani "Kalorësi i Skënderbeut".

Në të dy këto vepra autori ka bërë përpjekje për një pasqyrim me vërtetësi të jetës, por nuk i ka shpëtuar një fryme sentimentaliste. Problematika e re e gjeti pasqyrimin në dramën për fëmijë "Trashëgimtarët tanë" (1950), ku trajtohet pjesëmarrja e fëmijëve krahas të mëdhenjve në luftën kundër zgjedhës fashiste. Mbajti një ditar që u botua me titullin "Shtigjeve të lirisë" (1966), me vlera njohëse e letrare. Në të autori rrëfen për ngjarje të rëndësishme të historisë së Luftës ANÇ në vitet 1943-1944, për patriotizmin dhe heroizmin e popullit. Haki Stërmilli la të papërfunduara disa vepra letrare e historike. Vecoria themelore e prozës së këtij autori është lidhja me temat sociale dhe mbështetja në ndjeshmërinë sentimentale ku : -Në rastin e parë është

lidhja me temat e së kaluarës kombëtare dhe në rastin e dytë autori gjithnjë kërkon një moral njerëzor në raportin në mes njerëzve në familje e në shoqëri.

"Stërmilli" bashkë me "Spasen" Janë krijuesit e romanit social në letërsinë shqipe të viteve të '30-ta.

Romani "Sikur të isha djalë" ishte një jehonë e kësaj lëvizjeje shoqërore dhe një nga veprat ku ajo u pasqyrua më gjerë e në mënyrë të drejtpërdrejtë. Romani ka formën e një ditari, të mbajtur nga personazhi kryesor i tij, vajza e re, Dija.

Nëpërmjet shënimeve të saj lexuesi njihet me jetën e përditshme të një familjeje të zakonshme qytetare shqiptare, ku ndihet edhe prapambetja e theksuar shoqërore, edhe pozita e mjeruar e gruas në familje, e cila duhet të bëjë një jetë të mbyllur brenda mureve të shtëpisë e sipas ligjeve patriarkale.

Bota shpirtërore, ndjenjat dhe dëshirat e saj duhet të ndrydhen e të shuhën, ndryshe shfaqja e tyre shkakton skandal në familje dhe në shoqëri. Për sa kohë jeton në familjen e saj, duhet të vendosë për gjithçka babai, e kur të martohet, të vendosë burri. Kështu, ajo është një skllave, që duhet të lindë fëmijë të cilët do të bëhen përsëri viktimë e këtyre ligjeve të egra sunduese në shoqërinë shqiptare të viteve `30.

Dija, ashtu si qindra e mijëra vajza, vuan nga këto ligje të egra, që nuk pyesin për ndjenjat, për dashurinë e për dinjitetin e saj. Por në dallim nga ato, ajo nuk do të nënshtrohet, nuk do të mbysë gjithçka që për të

është e shenjtë dhe nis të kundërvihet. Kundërvënia ndaj rregullave e ligjeve patriarkale fillon që me dëshirën e saj për të vajtur në shkollë, me përpjekje për të zgjeruar kulturën nëpërmjet librave, me protestën për të mos u mbuluar me ferexhe etj.

Dashuria për Shpendin, të cilin e njohu rastësisht te shoqja e saj, megjithëse duket sikur ia zbukuron e ia pasuron jetën e mjerë prej jetimeje e prej vajze të mbuluar me ferexhe, kthehet në një tragjedi për të. Nga njëra anë dashuria e saj bëhet tepër dramatike për shkak të fanatizmit të egër, izolimit brenda mureve të shtëpisë, nga ana tjetër, mungesa e ndonjë shprese se mund të bashkohej ndonjëherë me Shpendin në kushtet kur për gjithçka duhet të vendoste i ati, i cili as që mendon se vajza mund dhe duhet të ketë ndjenjat dhe dëshirat e saj që duhen nderuar. Vendimi i tij për ta martuar Dijen me një burrë të moshuar, sepse është tregtar i pasur, e shkatërron përfundimisht jetën e saj.

Gjithnjë e hajthme, e dobët, e trishtuar, e zhytur në mendime të zymta e munduar nga pamundësia për t'u takuar me të dashurin e saj Shpendin dhe me parandjenja se gjithçka do të përfundonte keq, e fyer vazhdimisht nga njerka e saj, e fyer nga i ati, e papërfillur dhe e përbuzur nga shoqëria, ajo sëmuret rëndë nga tuberkulozi dhe vdes, pak kohë pasi e kanë martuar me përdhunë.

Edhe përpjekjet e disa njerëzve me pikëpamje përparimtare të fisit të saj, edhe përpjekjet e Shpendit për ta rrëmbyer e për të ikur nga Shqipëria, dështojnë. Fati i

çdo vajze ishte përcaktuar ; nënshtrimi dhe bindja ndaj ligjeve patriarkale, mbytja e dëshirave dhe e dashurisë, ndryshe e priste turpërimi dhe asgjësimi fizik.

Por kjo kundërvënie tragjike e humbet deri diku forcën e saj për shkak të disa dobësive artistike të romanit, siç janë p.sh. mendimet e zgjatura, arsyetimet moralizuese, që janë dhënë nga pozita sentimentale e jo realiste, të cilat shpesh zëvendësojnë veprimin konkret të personazheve me ankime, psherëtima etj.

Megjithatë vepra, sidomos në kohën kur doli, e tronditi opinionin publik dhe pati një jehonë të madhe te lexuesi shqiptar, pasi heroina e tij tregohet e vendosur në luftën e vet kundër botës së vjetër, kundër normave etiko-morale të saj, pavarësisht se nuk arrin dot dhe s'kishte se si, në mënyrë individuale, të gjentë një rrugëzgjidhje për një problem aq të rëndësishëm shoqëror.

"Duhet të luftojmë në daçim të rrojmë si njerëz" - shkruan ajo në ditarin e saj. Por dihet që kundërvënia individuale ndaj shoqërisë është gjithmonë dramatike ose tragjike. Asnjë mjet, asnjë motiv që sjell autori në vepër, nuk e shpëton dot. As largimi nga vendi. Kritika ka pohuar disa herë që autori nuk arrin të sjellë një zgjidhje të drejtë me arratisjen e Dijes dhe Shpendit jashtë vendit. Po, në të vërtetë, ky nuk është një gjykim i saktë.

Autori pikërisht duke sjellë dështimin e kësaj përpjekjeje, i tregon lexuesit se s'mund kurrësi që kjo të jetë zgjidhja. Ky motiv është ndoshta nga më realistët në

roman. Jo ikja nga e keqja, po përplasja e lufta me të mund të sjellin ndryshime në ligjet dhe opinionin e egër e të prapambetur shoqëror. Dija është personazhi më i realizuar në roman, me një botë të bukur shpirtërore, me një psikologji të qartë dhe natyrë tërheqëse. Ajo i kundërvihet krejtësisht mjedisit ku u rrit dhe demaskon gjithë mënyrën e organizimit të jetës familjare e shoqërore shqiptare. Personazhet e tjera si Shpendi, Irena, babai, njerka etj., janë më tepër skicime.

Proza e Stërmillit ka tiparet e një proze sentimentale me meditime të shumta e përshkrime të imta të vuajtjeve e të dashurisë, po edhe me shprehje moralizuese e deklarime retorike, të cilat i japin asaj ngjyra pak artificiale dhe mangësi në zbërthimin psikologjik të personazheve.

Megjithatë, aty ka mjaft ndjenjë e dhembje të sinqertë, gjë që e tërheq lexuesin. Këto tipare lidhen, në radhë të parë me natyrën artistike të Stërmillit si shkrimtar sentimental. Po, duke qenë se ato ndihen edhe në disa prozatorë të tjerë të viteve `20-`30 si Postoli, Grameno, deri diku edhe te Spase etj., mund të themi se janë edhe tipare të prozës sonë ende të dobët, e cila në këtë kohë megjithëse përpiqet të trajtojë probleme shoqërore të rëndësishme të realitetit shqiptar, mbeti sentimentale.

FOQION POSTOLI, LULJA E KUJTIMIT

Foqion Postoli u lind në Korçë dhe aty mori mësimet e para. Në faqet e gazetës “Dielli” botoi si nënfletë romanet “Për mbrojtjen e Atdheut” (1919) dhe “Lulja e Kujtimit” (1922) etj, të cilat më vonë u botuan si libra më vete. Vdiq më 2 tetor të vitit 1927.

Veprimtaria letrare, politike dhe shoqërore e Foqion Postolit u zhvillua gjatë viteve të fundit të Rilindjes dhe periudhës së pavarësisë tonë kombëtare. Kjo ishte periudha e ngritjes më të madhe që pati lëvizja jonë kombëtare dhe përfundoi me pavarësinë e vendit më 1912. Por kjo ngritje u shoqërua edhe me rënie të menjëhershme që erdhi si pasojë e ndërhyrjeve të huaja dhe luftërave botërore.

Edhe pse jetoi në periudha të ndryshme të historisë në vepra, shkrimtari pasqyroi idetë e rilindësve tanë, siç ishin dashuria për atdheun, urrejtja e madhe për pushtuesit otomanë dhe krenaria për historinë e vendit. Autori në librat e tij është frymëzuar nga temat aktuale të asaj kohe.

Lulja e kujtimit

Në romanin tij "Lulja e Kujtimit" përshkruhen ngjarjet që i përkasin periudhës së përpjekjeve që bëheshin n'ato kohë për t'u çliruar nga zgjedha turke dhe influenca e propagandës greke, e cila ishte ishte një pengese serioze për lëvizjen tonë kombëtare. Në këtë roman popullor, gërshetohen konfliktet personale me ato shoqërore e politike, ku epërsinë e marrin kurdoherë këta të fundit.

Ngjarjet e romanit zhvillohen në një ambient tregtar, që është verbuar nga propaganda greke. Subjekti i romanit është i thjeshtë : djali i ri Dhimitri, që punon si kryeshërbëtor në dyqanin e z. Kristo, dashuron vajzën e tij të vetme, Olimbinë, e cila edhe ajo e do Dhimitrin me gjithë shpirt, ndonëse ai është i varfër.

Zoti Kristo, duke përparuar në tregti, sjell nga Greqia një sekretar, Nikon, për të drejtuar tregtinë e tij. Nikua fiton me dinakëri simpatinë e Z. Kristo, dhe ky, duke mos e njohur fytyrën e vërtete të Nikos, arrin deri sa t'i propozojë atij për ta bërë dhëndër. Olimbia, kur e

merr vesh këtë gjë protestonon energjikisht dhe i thotë t'et pa drojtje se ajo e dashuron Dhimitrin. Z. Kristo, që nuk mund të pajtohet me këtë mendim, harton bashke me Nikon planin për ta larguar Dhimitrin nga Korça duke e dorëzuar në duart e qeverisë turke si njeri kryengritës dhe që kishte marrëdhënie me shqiptarët jashtë Shqipërisë.

Dhimitri, i paralajmëruar nga Olimbia, largohet nga Korça, dhe niset për në Manastir ku njihte mjaft kryengritës. Mirëpo ishte një natë e egër dimri dhe Dhimitrit i del një tufë ujqërish, të cilët ja shqyejnë kalin; ai vete mezi shpëton gjallë me ndihmen e kryengritësve të asaj ane që vepronin atje.

Në këtë kohë në Korçë përhapet lajmi se Dhimitrin e kanë shqyer ujqërit. Kur e merr vesh Olimbia këtë gjë dëshpërohet aq shumë sa luan mendsh dhe mbetet ashtu gjashtëmbëdhjetë muaj, deri sa një ditë "Lulja e Kujtimit", që ja kish falur Dhimitri, i cili e kishte marrë nga nëna e tij që ja kishte sjellë burri (babai i Dhimitrit) nga Egjipti, i ngjall asaj kujtimet e së kaluarës dhe e sjell në vete.

Pas dy vjetësh Dhimitrin e gjejmë përsëri në rrethet e Korçës. Këtu ai vepron në krye të lëvizjes për çlirimin e Shqipërisë si e kish urdhëruar qendra e kryengritësve. Kur po vepronte në rrethet e Korçës. Dhimitri mundi të shpëtonte nga kthetrat e Nikos, i cili bënte plane djallëzore për t'ja grabitur pasurinë e Kristos dhe për ta detyruar me forcë Olimbinë të bëhej gruaja e

tij. Mirëpo Dhimitri planet e Nikos i ndaloi pasi u kthye ne shtëpine e tij. Pas këtyre ndodhive gjithashtu Dhimitri dhe Olimbia u martuan dhe të gjithë u gëzuan. Edhe z. Kristo u gëzua për të dy dhe i tha Dhimitrit:

"Që nesër e tutje unë nuk kam të bëj më me dyqanin tim; në duart e tua të mbetet shtëpia ime tregtare se unë u plaka dhe ju na shpëtuat nga vdekja dhe ç'nderimi".

KOMPOZITORI I HARRUAR REXHO MULLIQI

Kompozitori i njohur shqiptar Rexho Mulliqi u lind më 18 mars të vitit 1923 në Guci. Shkollën fillore e kreu në vendlindje për të vazhduar Medresenë e Shkupit, deri në vitin 1941. Paskëtaj u vendos në Prishtinë, ku qëndroi tre vjet (1941-1943). Më pas u regjistrua në Akademinë e Muzikës në Beograd (1946), por nuk i përfundoi dot studimet, sepse, për shkaqe politike, u përndodq dhe u burgos, duke vuajtur dënimin në Goli Otok.

Pas vitit 1953 u kthye në Kosovë, ku fillimisht dha mësim në Shkollën e Mesme të Muzikës në Prizren (harmoninë dhe kontrapunktin).

Në vitin 1956 shkoi në Prishtinë, pranë Radio Prishtinës së atëhershme dhe drejtoi veprimtarinë muzikore të këtij institucioni.

Së bashku me Lorenc Antonin, Rexhep Mulliqi është njëri ndër krijuesit e traditës muzikore profesioniste në Kosovë.

Ai është ndër të parët krijues të këngës korale, si autor i simfonisë së parë shqiptare në Kosovë, i së dytës në muzikën e gjithëmbarshe shqiptare, përfshirë edhe Shqipërinë.

Vepra e tij e gjerë dhe e larmishme përfshin pothuaj të gjitha gjinitë muzikore (përfshirë operën) dhe është ekzekutuar në veprimtari kryesore të jetës muzikore të Kosovës dhe të ish-Jugosllavisë. Për punë të palodhur, Rexho Mulliqi është nderuar me shumë dekorata dhe mirënjohje.

Rexho Mulliqi vdiq më 25 shkurt 1982.

Rexho Mulliqi bëri një muzikë që ishte dhe mbeti thellësisht shqiptare, në të gjithë përbërësit e saj. Ai thoshte:

“Muzika të cilën e krijoj, është rrëfimi im, por edhe i popullit tim, është apoteozë e nënqiellit të këtij vendi dhe e njerëzve të tij, këngë e maleve hijerëndë, e luginave të gjelbra, e lumenjve me zhurmë, rrëfim i legjendës, të kaluarës dhe këngë e agimit të diellit...”.

Në fillim e thërrisnin Rexhep Mullaj, Rexho Mulliq, Rexhep Mulliqi, kurse ai vetë, në të shumtën e rasteve, ka nënshkruar si Rexhep Mullaj. Megjithatë, ai

mbeti i njohur te ne si Rexho Mulliqi, kompozitor, i cili, në njerën anë çmohej dhe respektohej për punën që bënte, kurse në anën tjetër (jo rrallë) u anatemia dhe mbeti në harresë, për arsye që dikur nuk thuheshin, por që tani mund të thuheshin dhe të shpjegohen më qartë.

Anatemimi i tij i parë ishte politik, sepse në vitin 1948, në kohën Informbyrosë, u burgos dhe vuajti një dënim të rëndë në Goli Otokun famëkeq.

Por anatemimi më i rëndë erdhi më pas, kur individë të caktuar të mjediseve kulturore të Prishtinës, të nxitur nga motive të ulëta, smirë profesionale, por edhe nga ndonjë arsye tjetër, ia mohonin përkatësinë kombëtare shqiptare. Dhe kjo ndodhte në një kohë që ai vetë, pra Rexho Mulliqi, kompozoi një muzikë, që ishte dhe mbeti thellësisht shqiptare, në të gjithë komponentët e saj.

Jeta dhe krijimtaria

Veprat e tij skenike janë: "Nita", 1975, balet (i pambaruar) dhe "Legjenda mbi ngadhënjimin", balet; kurse pjesët "Vjeshta", 1958, për kor mikst, (bot. LKSHM), dhe në Colegium Cantorum, Prishtinë 1973; "Nji lule", përpunim për kor mikst (bot. në Collegium cantorum, Prishtinë, 1987, Vendi im, këngë masash, (bot. në Collegium Cantorum, Prishtinë, 1971 dhe në "Kënga Korale", SHKK Prishtinë 1984.

Pastaj: "Poema për ata", kantatë për solist, recitues, kor e orkestër me tekst të Fahredin Gungës, "Lulëzoi fusha, lulëzoi mali, për soprano, kor e orkestër, "Një lule që m'ka çelë tash", për soprano, kor e orkestër, Suita e vogël, për soprano, kor e orkestër, "Baresha", për soprano e orkestër, si dhe më se 150 harmonizime dhe përpunime këngësh popullore.

Më pastaj, këngët korale: "Marsh i divizionit VI shqiptar", "Demonstrat", "Mbajmë flamurin e lirisë;", "Këngë për lirinë;", "Marsh i brigadës së parë sulmuese" dhe "Vjeshta". Muzikë kamertale: Suitë, për piano dhe orkestër, Elegji, për violinë dhe piano, (1955), "Legjendë", për violinë dhe piano (1956), veprat simfonike: "Fantazi", për orkestër (1954), Simfonia nr.1 (1955), "Pastorale dhe loja", për orkestër (1956), "Akuarelet e Prizrenit", suitë për orkestër harqesh (1958), "Simfonia kosovare nr.2" (1962), Suita simfonike. Muzikë për filma artistikë: "Uka i Bjeshkëvet të Namuna" (1968), "Era dhe lisi" (1979), "Kapiten Lleshi", "Qërim hesapesh". Muzikë për filmin dokumentar: "Kokë më kokë", "Floriri i Kosovës" I, II, III, "Tuneli 117". Muzikë për teatër: "Omeri e Merima", "Tri motrat", "Tregimi i Irkutskut", "Martesa", "Pelinova, "Erveheja", etj

Veprat e modeleve klasike

Sikundër shihet, veprimtaria e Rexho Mulliqi ka qenë mjaft e gjerë. Gjithsesi, vepra e tij më e rëndësishme, për të cilën do të bëjmë fjalë me këtë rast, është "Simfonia e dytë kosovare".

Është theksuar tashmë dhe siç është pohuar edhe nga vetë Rexho Mulliqi, opusi krijues i tij është i lidhur ngushtë me nënqiellin e Kosovës, me folklorin muzikor shqiptar, tek i cili e ka mbështetur shumicën veprave të tij. Nga ana tjetër, krijimtaria e tij ka qënë e bazuar në modelet klasike, si për nga forma, ashtu edhe për nga shprehja, mirëpo më vonë gjuha e tij muzikore bëhet gjithnjë më e pasur dhe më domethënëse, si në melodi e në harmoni, ashtu edhe në formë, orkestrime etj.

Vende-vende, në kompozimet e tij hasim edhe në elemente të reja, të cilat në raport me kohën kanë qënë shumë larg, jo vetëm nga "radikalët", por edhe nga ata krijues që janë konisderuar si më "të përmbajtur".

Pra, Mulliqi nuk ka shfaqur ndonjë interesim që në kompozimët e veta të futë sadopak elemente të shprehjes më të avancuar. Nuk bëhet fjalë këtu për mosnjohje të trendeve të reja, as për jetën e varfër muzikore të rrethit ku jetonte, por thjesht ishte mosinteresimi i tij për të bërë hapat e parë drejt një muzike të re, më të avancuar për kohën kur ai jetoi.

Ndër veprat e shumta që la ky krijues, pa dyshim se simfonia e dytë e quajtur "Kosovare" është vepra më madhore e tij. Këtë e themi, sepse nuk takojmë në krijimtarinë e tij ndonjë vepër tjetër kaq serioze dhe të kompozuar me kaq përkushtim. Ajo është krijuar më 1972 dhe është incizuar nga Orkestra Simfonike e Radio Ljubljanes, por nuk dimë nëse është ekzekutuar "live" ndonjëherë. Titulli i saj "Kosovare" na e kumton qartë se nga cili burim rrjedhin frymëzimet e veprës së tij muzikore, sepse në tërë tematikën përjetohet fuqia e muzikës shqiptare, edhe pse ngandonjëherë nxjerr kokë, madje mbizotëron, melosi i muzikës orientale.

Vend nderi në muzikën tonë

Rexho Mulliqi thoshte se zanafillën e kësaj veprë e kishte menduar si koncert për piano dhe orkestër. Ky orientim ndihet edhe në vetë funksionin e pianos, i cili dominon gjatë tërë kohës dhe ngjyra e tij është ngushtësisht i lidhur me ngjyrën e melodisë folklorike, duke përkujtuar në njëfarë mase tingullin e çiftelisë dhe duke arritur kësisoj koloritin e ngjyrimin arkaik burimor, zanafillor të kësaj treve. Koha e parë ka një hyrje të pianos, në formë të sonatës, jo edhe aq qartë, bazuar në dy tema kontraste me elemente heroike, ndërsa e dyta është lirike.

Më vonë, me zgjerimin e përmbajtjes e të
 frymëmarrjes muzikore, fiton tingullin melodik të

melosit malësor. Në fund të kohës së parë trumbeta dhe trombonët i rimarrin e i përsërisin në unison fragmentet e temës së parë.

Koha e dytë veçorizohet nga një konstruksion më i lirë. Baza e saj pjesërisht është programore, e ndërtuar në frymën e melosit të këngës popullore "Kënga e Rexhës". Zhvillimi i melodisë, në sekondat vazhduese, na sjell ndërmend ngjyrën impresioniste, sidoqë është veshur me të kënduaritn arkaik, që na paraqitet nga tingujt lirikë të violinës. Finalja, në formë të rondos, le përshtypjen se ngjarjet e errëta dhe tragjike janë zhdukur, duke paralajmëruar agimin e ngadhënjimit të jetës.

Motivi i tij i parë tematik shquhet nga ritmi vallëzim, dialog i pianos me orkestrën, i dyti me shprehje pastorale, flauti solo, ndërsa motivi i tretë, fuga e shkurtër, është e lidhur me motivin e parë tematik. Në këtë vepër autori shpalos tërë atë bagazhin e njohurive profesionale në shumë aspekte, si në instrumentim, ashtu edhe në kulturë të tingullit e në harmoni, ku gjen shprehje zotërimi i duhur i pianos, si instrument solistik. Me këtë vepër Rexho Mulliqi vihet në mesin e krijuesve dhe të krijimtarisë së kohës, në të cilën jetoi dhe veproi.

Dhe, në fund, duhet të shtojmë se, meqë vitin e ardhshëm mbushen plot 25 vjet nga vdekja e Rexho Mulliqit, do të ishte e udhës që udhëheqja e Filarmonisë së Kosovës të përgatisë një koncert me dy veprat e tij madhore, pra me simfoninë e parë dhe të dytë. Do të ishte ky një homazh për këtë krijues edhe ashtu të

harruar, veçmas nga institucionet tona. Në shenjë respekti dhe kujtimi për një kompozitor, i cili, me veprimtarinë e tij krijuese, la gjurmë të thella në mbarë jetën muzikore shqiptare.

Falenderojmë Akademikun tonë të mirënjohur, kompozitorin, publicistin Profesor Akil Mark Kocin për ndihmën e dhënë rreth biografisë së materialit për botim në sitin tonë virtual Floart - Press, për doajenin e muzikës shqiptare, kompozitorin e mirënjohur Profesor Rexho Mulliqin.

PËRMBAJTJA :

PARATHËNIE.....	5
MBI KRITIKËN LETRARE.....	11
DANTE ALIGERI.....	54
IBRAHIM RUGOVA KULTIVUES I MODERNITETIT.....	60
KRIST MALOKI, DIJETARI SHQIPTAR I GRAC-it.....	72
ALEKSANDËR XHUVANI.....	80
ASPEKTET POZITIVE E NEGATIVE TE PSIKOLOGUT FREUD.....	86
NAIM KELMENDI – POET E PUBLICIST.....	130
SHEFQET DIBRANI - ANA TJETËR E POEZISË.....	135
JUSUF GËRVALLA, KËNGËTARI, POETI DHE ROMANCIERI.....	140
AMIKO KASARUHO.....	149
MEHMET KAJTAZI.....	153
BEKIM FEHMIU.....	160
ISMAIL KADARE.....	170
RAMIZ KELMENDI.....	186
MBI VEPRËN E KADRUSH RADOGOSHIT.....	193
ENGJËLL I. BERISHA : KUJTESË E DEHUR.....	197
LETËRSIA SOT NË KOSOVË DHE DIASPORË.....	204
JAKOV XOXHA.....	216
LETËRSIA DHE PSIKOLOGJIA.....	223
ANTROPOLOGJI, JAKOV MILAJ “RACA SHQIPTARE”.....	230
STERJO SPASE.....	265
HAKI STËRMILLI – SIKUR TË ISHA DJALË.....	274
FOQION POSTOLI, LULJA E KUJTIMIT.....	280
KOMPOZITORI I HARRUAR REXHO MULLIQI.....	284